


Fatbardha N. Demi

SELLENIZMI

Besimi që sundon botën



2016

Përmbajtja

Dy fjalë për lexuesin	7
RRUGA E ZBULIMIT TË EMRIT TË BESIMIT PELLAZG DHE I VASHËS KRAHË-SHQIPONJË	11
PERËNDESHA MË E FUQISHME E TË GJITHA KOHRAVE - NË XHOKEN E MIRDITORES.....	25
SI U HYJNIZUA «BESA» E ARBËRVE NË TEMPUJT E FARAONËVE	41
BESIMI HËNOR DËSHMI E AUTOKTONISË SË KOMBIT ARBËR.....	50
EMRI «JEZUS», «KRISHT» DHE «KRYQ» SHPJEGOHEN VETËM ME GJUHËN DHE BESIMIN E PELLAZGO-SHQIPETARËVE	65
NGA DODONA NË TIBET	78
SHQIPE-RI, EMRI PARAHISTORIK I ZOTIT, NË BOTËN MODERNE.....	94
SHQIPE-RI, EMRI PARAHISTORIK I ZOTIT, NË BOTËN MODERNE.....	107
PLISI - MITI I ORIGJINËS SË PËLLAZGËVË HYJNORË.....	120
BIBLA - HISTORIA E NJERËZVE ME PLIS	135
HËNA DHE DIELLI, SIMBOLE KULTIKE NË DY KOKAT E SHQIPONJËS PELLAZGE.....	148
TEK ZOTI PASH VËNDIN TIM	171
BASHKJETESA FETARE DHE ANA TJETËR E MEDALJES	185
PIKTORI QË PËRJETËSOI NË HELLADË HISTORINË E SHQIPETARËVE.....	196
DARDANIA E PAZBULUAR	209

Për të praktikuar shkencën, artin, për të sajuar më në fund diçka interesante për njerëzimin, duhet të flasim vetëm atëherë, kur ka diçka të re për të thënë.

Walter Żelazny

Dy fjalë për lexuesin

Emri sellenizëm është i panjohur, jo vetëm për lexuesin e thjeshtë të ditëve të sotme, por edhe për studiuesit e lashtësisë. Nga titulli kuptohet se bëhet fjalë për besimin. Por të kujt popullsie?

Ky libër nuk ka qëllim të bëjë “mësime” mbi fenë, përkundrazi, temat zënë fill nga jeta jonë e përditëshme, për simbolet e varseve që ne i varim në qafë, i bëjmë tatuazhe, apo i shënjtërojmë në institucionet fetare dhe ato shtetërore. Gjatë vizitave turistike dhe në faqet e revistave, ne admirojmë pikturat, skulpturat dhe objektet arkeologjike të qyteteve më me emër të lashtësisë, shqiptojmë emërtime të lumenjve, deteve, oqeanëve, maleve dhe varg-maleve, të shumë qyteteve dhe deri të shteteve të sotme, flasim në një gjuhë dhe na pelqejnë të ndjekim disa tradita, pa e ditur se origjina e tyre, lidhet me mitet, simbolet dhe botkuptimin e njeriut të lashtë primitiv.

Ndoshta emri “besim” siç e kuptojmë ne sot, nuk është plotësisht i saktë për ato kohë të largëta. Sado e çuditshme të duket, por për “ditët e para” të shoqërisë njerëzore, do të përshtateshin më sakt emërtimet e sotme: fe, filozofi, mjekësi, art, gjuhësi (krijimi dhe pasurimi i fjalorit për komunikim), poezi (vargëzim), numërim (matematikë, gjeometri), astronomi (njohjen e ndikimit dhe shfrytëzimin e pozicionit të yjeve), administrim (organizimin dhe ligjet e mbretërive), etj. Te gjitha këto fusha, në studimet historike e kanë zanafillën në atë që emërtohet SELLENIZMI, duke nënkuptuar: mitologji dhe shkencë.

Këtë fakt e dëshmojnë botimet që lexojmë mbi lashtësinë, ku shumë Perëndi, të Egjiptit të lashtë, të oborrit hyjnor mbi Olimp dhe tek mitet e popujve të tjerë, paraqiten si krijues, mbrojtës apo zbatues të të gjitha shkencave dhe arteve të lart-përmëndura.

Sellenizmi, ka patur në shërbim të tij vetëm një mjet: KRAHASIMIN. Mbi bazën e ngjashmërive apo dallimeve, të dukurive qiellore dhe tokësore në botën që e rrethonte, njeriu primitiv e emërtoi veten, natyrën dhe thurri histori mitike.

Studiuesit e sotëm bëjnë përpjekje për ta matur kohën e lindjes së njeriut “që mendon”, duke e lidhur me kohën e përdorimit të zjarrit dhe të gurit, si mjet jetese. Nga provat arkeologjike (shpella e Petralones në Greqi) mendohet se kjo ka ndodhur afersisht para 700 mijë vitesh nga ditët e sotme.(1)

Diku nga mesi i kësaj periudhe kaq të gjatë kohore, e emërtuar Pléistocène, mund të hamendësojmë edhe zanafillën e besimit, gjuhës (një rrokëshe, në atë kohë me një / dy gërma) dhe kërkimit “shkencor” të njeriut primitiv. Në libër, mosha e besimit dhe e gjuhës është vendosur bazuar në artin e shpellave. Por fakti, që gjuha shqipe ruan një fjalor të pasur me fjalë një rrokëshe, të cilat mbartin edhe një kuptim simbolik-besimtar, tregon se zanafilla e saj lidhet me kohën e cikleve akullnajore të Pléistocenit, pra afersisht para 400 mijë vjetëve.

Libri hapet me studimin se ç’kuptim ka emri SELLENIZËM dhe përse jemi të bindur se i përket besimit hënor. Siç do ta vë re menjëherë lexuesi, nuk kemi të bëjmë me një material akademik historik apo gjuhësor, por me trajtime të temave të ndryshme nëpërmjet analizës historike, të paraqitur me një formë të re, më të kuptueshme, por pa u shkëputur nga metoda shkencore.

Aty janë shtruar mendime për tradita, emërtimet dhe sidomos mbi simbolet, që në botimet historike nuk kanë gjetur shpjegime ose janë shpjeguar gabim apo nuk janë trajtuar asnjëherë, si psh : Nga e ka origjinën simboli dhe emri i fjalës Kryq, Krisht, Papë? Sa e lashtë është Besa e traditës së shqiptarëve ? Qeleshja e jonë ka qënë thjesht një veshje, apo një nga simbolet më të lashta « të të dërguarit të Zotit »? Kush ka qënë Zoti i parë?

Lexuesi do të ketë mundësi të njihet me mbretërit e parë të lashtësisë, për të kuptuar se çfarë përfaqson «svastika» e huazuar nga nazizmi apo të mësojë rolin besimtar të emrit që përdorim sot, Shqipëri dhe Shqiptar etj.

Pothuaj tek të gjitha shkrimet do të zbuloni faktin :

- se Besimi në lashtësi ka qënë burimi i krijimit të fjalëve të reja, që i përdorim edhe sot në jetën e përditëshme, pa ua ditur origjinën si psh hëna, dielli, ara, yll, ylber, mal, oqean, kau, kal, rreze, etj.

- se GJUHA dhe BESIMI, të lindura (mund ta pohojmë) njëkohësisht në agimin e shoqërisë njerëzore, kanë zhvilluar e përsosur njeri-tjetrin dhe sot janë « mjetet » më të sakta matëse , për të dëshmuar origjinën, hershmërinë apo vonshmërinë dhe përhapjen gjeografike të gjuhëve dhe popujve të zhdukur apo të atyre që njohim sot.

- se pa u njohur me DIALEKTET, të folurën e gjysheve e stërgjysheve tona, pa njohur

besimin mitik, që në formë të copëzuar është ruajtur tek TRADITA rituale dhe folklorike e popullit, dokumentet e « gurta » ARKEOLOGJIKE dhe ETNOGRAFIKE, nuk do të arrijmë dot tek E VËRTETA në studimet historike mbi lashtësinë.

Libri vijon me tre materiale nga ngjarje të shekullit 19:

- Mbi shkollën e parë Albanologjike, të formuar nga etërit e besimit bizantin ortodoks dhe intelektualët arbereshë të Italisë. Studimet dhe tezat e shtruara prej tyre, mbi historinë e gjuhës dhe të Kombit tonë, para më shumë se një shekulli , ruajnë dëshmi të panjohura apo të pashkruara në tekstet e sotme të këtyre shkencave.

-Mbi “luftën fetare” midis shqipetarëve, panorama e së cilës (betejat, shkatërimet, “Perënditë” europiane që vendosin fatin e ndërluftuesve, dhe aratisja e dhunëshme e popullsisë), është një pasqyrim besnik i luftës trojane të përshkruar nga Homeri. Nuk mungon sigurisht edhe Kali i Trojës.

- Mbi “Iliadën”, jo me vargje por me piktura, të Teofil Haxhimihalit nga ishulli i famshëm i Lesbos, që perjetësoi bëmat e kohëve të lashta, mesjetare dhe të ditëve moderne, të historisë sonë.

Në fund, nuk mund të lija pa shtuar edhe studimin e emrit të fiseve më të famshme të Lashtësisë Euro-Aziatike, të cilat shkrimet e shenjta biblike i emërtojnë fise udhëheqëse (lider) : fiset DARDANE dhe të vendit të tyre, DARDANISË.

Po përse e kam cilësuar « Besimi që sundon botën » dhe kush ishin ata që e zbuluan dhe e përhapën në çdo kontinent ? Këtë do ta mesoni vetë, nga libri që mbani në dorë.

Me qenëse të gjitha materialet e librit, fillimisht janë shkruar për botime në gazetë dhe forume të ndryshme dhe jo të grupuara siç po paraqiten sot, për t'i bërë të kuptueshme për lexuesin e rastit, më është dashur në disa raste, të përsëris fakte mbi besimin dhe simbolet e materialeve të më parshme. Për të ruajtur formën origjinale të shkrimeve dhe duke besuar në durimin e lexuesit kurioz të lashtësisë, nuk e kam prekur tekstin e tyre.

Ky libër i kushtohet prindërve, të cilët më mësuuan të dua Kombin tim dhe të gjithë studiuesve, profesionistë dhe autodidaktë, që më ndriçuan rrugën e njohjes së Historisë së jashtëzakonshme të Shqipetaro-Arbërve.

Fatbardha Niazi Demi 16.02 .2016

fatbardha_demi@yahoo.com

RRUGA E ZBULIMIT TË EMRIT TË BESIMIT PELLAZG DHE I VASHËS KRAHË-SHQIPONJË

Çdo popull e njeh për bukuri zanafillën e vet...
(*Dhimitër Pilika*)

Historiani italian Pietro Scopola shprehet « Të mos krijojmë bindjen se Historia na e jep të shkuarën siç ka ndodhur. Historia na jep copëza të së kaluarës, pjesë, dukuri të saj, që është një proces në vazhdimsi. Ky është një hulumtim gjithëmonë i hapur, që duhet ushqyer nëpërmjet ballafaqimit. ("La verita storica") E drejta e ballafaqimit na krijon mundësinë të shprehim mendimin tonë, për dukuritë dhe tezat e shtruara në këtë shkencë ndër vite apo edhe ndër shekuj. Me këtë ide, po shtroj disa këndvështrime të mija, të rrjedhura nga studimi i periudhës së Lashtësisë.

Mendimi i I-rë: Helenizmi nuk është përfaqësues i gjuhës dhe i arritjeve të të gjitha fushave të „botës greke“, por i besimit pellazg. Autorët e lashtë gjithëmonë e kanë lidhur atë me trevat arbërore.

Përpara se të flasim se ç'përfaqëson „Helenizmi“ duhet të sqarojmë emërtimin „Helenë“.

Në shkrimet e sotme historike, duke patur parasysh popullsinë e lashtë të Ballkanit, krahas emërtimit „Helenë“, njihet edhe përdorimi i emërtimit „Grek“ nga latinët, dhe „Jonë“ nga popullsia e Lindjes. Po nga e ka prejardhjen emri „Helenë“? Sipas mitit, Heleni ishte një Hero (sipas konceptimit të mitologjisë së Lashtësisë), nga pasardhësit e të cilit, Eolo, Doro dhe Xuto u formuan fiset e Akejve, Eoleve, Joneve dhe Dorëve që në shekujt e mëvonshëm formësuan popullin helen. Dukuria që vihet re shpesh në shpjegimin e emërtimeve të lashtësisë është se, studiuesit nisen nga mitet e vonshme për të shpjeguar emërtimet zanafillore. Kështu psh emërtimin *(H)el-las* (Ελλάς) e shpjegojnë si “njerëzit tanë prej guri” duke e lidhur me mitin e Deukalionit dhe Pirrës të cilët pas Permbytyes, krijuan njerëzit duke hedhur gurrë pas kurrizit sipas porosisë së Zeusit. (1) Me qënëse emri i helenëve ka lidhje me vëndin e quajtur edhe sot Hellade, le të zbulojmë se çfarë na thonë, historianët në librat e tyre.

Aristoteli e vendos Hellasin e lashtë ndërmjet Dodonës dhe lumit Akeloe (Acheloo) në trevat ku jetojnë Sellët që më vonë u emërtuan si Hellenë (Aristotele, *“Meteorologica, I, 352b”*) Ptolemeu e quan Epirin “Hellas prehistorik” ndërsa Polibi e quan popullsinë e Epirit dhe Maqedonisë si hellenë në të gjitha kuptimet (J. Juthner, *“Hellenen and Barbaren”, Leipzig, 1928, pp.4*) (2) Sipas këtyre të dhënave, studimi i emërtimit “helen” ka një rëndësi të madhe për Albanologjinë, me qënëse Dodona dhe Epiri lidhen me historinë e lashtë të iliro-epirotëve pellazgë. Gjithashtu, duke patur parasysh se emërtimi “Helenizëm” përfshin pjesën më të madhe të periudhës së Lashtësisë, studimi është i rëndësishëm edhe për Historinë Europiane dhe atë Botërore.

Sipas Xhuzepe Katapanos “Emri në parim, ishte si një formulë strukturore, pasi shprehte jo vetëm natyrën e brëndëshme, por edhe rolin e qënies të cilës i ngjitej” (3). Studiuesit pohojnë se, Mbreti në lashtësi ka patur edhe detyrën e Priftit të Madh dhe, duke gjurmuar pikërisht në këtë funksion, do të nisim rrugëtimin për të zbuluar origjinën e emrit Helen, nga i cili buron edhe emërtimi “Helenizëm”. Unë mendoj, se emërtimi zanafillor i Helenit ka qenë “Selleni”, që me zëvendësimin e “s” me “h” dhe shpesh, mos theksimi i kësaj të fundit, ka ardhur deri më sot në emërtimin Eleni dhe i popullsisë “hellenë” dhe i vendit “Helladë”. Ku e bazoj këtë mendim? Sipas studiuesve të huaj, emri “Hellas” i vëndit vjen nga “Sellas” dhe do të thotë “toka hënore”, “vëndi ku adhurohet Hëna”. (4) Pra emri i këtij Prifti të Madh-Helenit, lidhet me faktoren e Dodonës dhe besimin *HËNOR*, i përfaqësuar në mite nga Perëndesha Sellena.

“Sellena” në mitin e Pellazgëve

Kulti i Hënës është besimi i parë i institucionalizuar i Pellazgëve dhe në hierarkinë e hyjnive, Perëndia e Hënës (me numrin 30) është më e rëndësishme se sa e Diellit (me numrin 20). Edhe sot, java fillon jo me “e djelë”, sipas emrit të Diellit, por me ditën që ka emrin e Hënës, “e hënë”. Kjo dukuri ndoshta ka lidhje me lehtësinë për t’u vëzhguar nga njeriu primitiv i Hënës. Tek pellazgët (flitet për trevat arbërore), Hëna përfaqësohej nga Perëndesha Sellenë. Sipas mitit, ajo e niste rrugën e saj në qiell në momentin kur

perëndonte Dielli. Në artin e lashtësisë, përshkruhet si një vashë e re me një ndriçim të argjendë, veshje të lehtë, hypur mbi një karocë të tërhequr nga kuajt të bardhë apo një dem. Kuajt e bardhe dhe demin (Kaun) si simbole besimtare, i gjejmë të shprehur në të gjithë trashëgiminë arkeologjike dhe mitike, të Europës pellazgjike (Euro-Afro-Aziatike).

Figura e Demit (Kaut) ishte qëndrore në besimin hënor dhe shprehte forcën krijuese. Në skulpturat, Sellena paraqitet shpesh duke vrapuar dhe nga era, veli i kokës merte formën e henës që i rrinte si kurorë. Simboli i saj në veprat e artit të kohës, që pikerisht harku hënor.



Altari me figurën e Selenës shk.II pK Louver; Amfiteatri i Dodonës, më i madh se sa ai i Athinës, ndërtuar nga mbreti Pirro (shk III pK).

Sa herë që ndodhte eklipsi i Hënës, mendohej se ajo ishte gëlltitur nga një dragua, dhe për ta shmangur këtë fatkeqsi, adhuruesit e saj zhvillonin rite të ndryshme. Në mite, ishte e dashura e Panit, që siç e gjejmë tek libri i Niko Stillos (*Etruskishte Toskerishte*), emërtohesh edhe Alpani (Albani) (5), Vatos, Asi, Mendisi, Junas dhe me shume emera te tjerë, dhe ishte mbret thesprot, pikerisht aty ku ndodhej Dodona. Po sipas miteve, me djaloshin Endimione ajo pati 50 femije (*Periegesi*, Pausania (V, 1, 4) numër që përkon me fëmijet e Priamit, të bijave të Kadmosit dhe 50 bijve të quajtur Pallantidet të Athinasë Pallante, të qytetit me të njejtin emër. (6)

Tek Homeri ajo është përshkruar si një figurë me krahë. (7) Krahët e pasqyruara në skulpturat e Sellenës janë krahë shqiponje, siç përshkruhet edhe te “Odiseu”, ku tregohet se ajo shndërohet në një shqiponjë. (8) Një model të së cilës e gjejmë në një skulpturë të famshme të Samothrakës, e kuptuar gabimisht si simbol i Nikes (fitores). Në fakt skulptura i përket Sellenës, sepse tempulli është i përmëndur për ritet e mistereve, që siç dihet janë rite të natës, pra kur udhëton Selena.

Në tempullin e Samothrakës, gjatë këtyre riteve pellazge, u njoh edhe Filipi i II-të me Olimbinë (Mirtalin), prindërit e Aleksandrit të Madh, një dëshmi tjetër e përkatësisë së përbashkët etnike të tyre.



(nga e majta) Skulpturë e Aleksandrit të Madh me hënën mbi kokë dhe tre yje ,që dëshmojnë qartas besimin hënor të iliro-maqedonëve dhe iperiotëve pellazgë. Këtë simbol e rigjejmë tek Ilirët e mesjetës dhe të përdorur gjërësisht në traditën e shqipetarëve. (djathtas) Në qëndër ylli gjashtë cepësh me një tophth (simbol i Zotit) në një brez argjendi. Argjendi dëshmonte besimin hënor.

Aty morën pjesë në ritet esoterike edhe Herodoti, mbreti i Spartës Lisandri dhe shume athinas të shquar të asaj kohe. Që Selena është pellazge na e tregon edhe miti, sipas së cilit ajo ishte bije e Titanëve, Ipero (Shqipës) dhe Teias, dhe Titanet ishin Pellazgë. Sipas Apollodorit, Sellena ishte motra e Elios, Diellit (Apollodoro ,Biblioteka I, 2, 2) Tek romaket kulti i saj nderohej me emrin Luna (Hëna).

Me dritën e saj të zbehtë Hëna e mbronte njeriun nga terri i natës. Në orët e para të mëngjezit , Dielli çfaqej përsëri e përsëri, gjithmonë pasi largohej drita e argjëndtë e saj. Pra Hëna/Sellenë ishte ajo, që u “sjell” (me një “j”) pothuaj të pazëshme) njerëzve Dritën dhe Ngrohtesine, nga buron “jeta” e Natyres. Prej kesaj “pune” të saj është emërtuar S(j) ell-ena (dmth “sjellë-se”) Priftërinjtë që i shërbenin Perendeshës së natës u emërtuan “sellë”. Në kohën që është shkruar “Odisea” (afërsisht ne vitin 750 pK) ishin priftërinjte “sellë”, që shërbenin në Dodone. Në kohën e Herodotit (480-425 pK), këtë shërbim e bënë priftëreshat. (9) Që emri i saj zanafillor ka qenë “Sellenë” dhe jo me një “l”, na e dëshmojnë toponimet e ndryshme. Kështu vetëm në Francë gjejmë 12 komuna në emrin e të cileve pasqyrohet i veçuar emri “Sellë” : Komuna Selles-Saint-Denis në rajonin e Pikardisë e banuar që në kohët prehistorike, Komuna Causse-de-la-Selle rajoni Languedoc-Roussillon, La Selle-en –Luitrè rajoni Bretagne, La Selle-Croannaise rajoni Pays de la Loire, La Selle-en-Hermoy rajoni Centre, La Selle –la-Forge rajoni Basse Normandie, etj. Për të dëshmuar origjinën e këtyre emërtimeve, deri në ditët e sotme kanë ardhur simbolet pellazge të besimit hënor.



(foto majtas) Në komunën Selle-sur-le-Bied ne rajonin Centre, emblema në qëndër ka simbolin e hënës me tre yje në një fushë të zezë.

Gjithashtu një vargmal në Francë e ka të përfshirë këtë emër : Aiguille du Plat de la Selle. (10) Sipas studiuesit të historisë dhe besimit Ralph Stenly, Prifti ishte ndërmjetësi midis njeriut dhe Perëndive. Para njerëzve ai ishte përfaqësues i Perëndisë, si dhe shërues i trupit dhe i shpirtit të tyre.

Shpesh ata ishin mbrojtësit e kulturës, të shkrimit, të ligjit dhe ishin shpikës, historianë dhe astronomë. (11) Si përfaqësues i kësaj Perëndeshe (Sellenës), Prifti i Madh i besimit hënor, i cili ishte njekohesisht edhe Mbret, u emërtua *Selleni*. Në studimin „*Etruskishte Toskërishte*“ të Niko Stillos, për herë të parë, na jepet pamja e plotë e Elinait (Sellenit), siç emërtohet në shumë pasqyra etruske. „Eleni“ është një nga emrat e shumtë të Mbretit profet dhe Priftit të Madh të Etolise ndër të cilët mund të përmëndim Ari, Nako, Atunis, Ati, Minos etj dhe ishte bir i Alpanit (Albanit) apo Panit mbretit të Thesprotisë . (12)

Emërtimin “sellë”, e merrnin priftërinjtë në Dodonë, që zgjidheshin nga Prifti i Madh dhe u jepej vetëm atyre dhe jo banorëve. Këtë na e dëshmon edhe Homeri tek “Iliada”: “Zeus i plotfuqishëm Dodonas/Zot i largët Pellazgjik/ që mbretëron mbi Dodonë, në këtë vënd të ashpër të Sellëve të shenjtë, me këmbët që asnjëherë nuk lahen/ dhe flenë në dhe!” (13), dhe këto rite i bënin priftërinjtë dhe jo banorët. Në Enciklopedinë “Imago-Mundi” në kapitullin “Orakujt grekë”, shkruhet se Sellët akoma quheshin Tomoures (14) ,qe na tingellon i afert me emërtimin e Malit Tomor, (Berat) ku mendohet se ka qene tempulli i pare i Dodones pellazge. (15)

Shkruesit e më vonshëm, duke dashur të përcaktojnë karakteristikën dalluese të banorëve përreth Dodonës, dmth “adhurues të Sellenës”, e përgjithsuan emërtimin “*sellë*” edhe për ta, dhe “Sellenizëm”(Hellenizëm) per besimin hënor dodonas. Sipas Enciklopedisë Universale, Sellët janë përmëndur nga Homeri “Iliada”XVI,v.234; Sofokliu “Trachyniennes, v1166; Euripidi “Erechtèe,frag 355 etj.(16)

Deri në shk 19 emërtimi “s/hellenizëm” shprehte vetëm besimin. Edhe në Testamentin e Ri, ky emërtim është përdorur në kuptimin e besimit.(Vangelo secondo Marco 7,26) (17). Kete e dëshmon edhe fakti se në kohën e sundimit të Perandorit dardan të Bizantit, Justinianit I (Giustiniani I, 482-565), me anën e dy kapitujve të Kodit shtetëror (*Codice Giustiniano Cod.*, I., xi. 9 e 10) urdhërohej shkatërimi përfundimtar i besimit Hellenik tek nënshtetasit e Bizantit, pavarsisht shtresës që i përkiste. Në shekullin e 19, me një “deus ex machina”, s/hellenizmi, ne tekstet e historise, u bë përfaqësues i përhapjes së gjuhës artificiale greke, administrimit shtetëror, arkitekturës, të këmbimeve tregëtare, ndryshimit ekonomik dhe të mënyrës së jetesës, që nga koha e pushtimeve të Aleksandrit të Madh e deri në ditët e sotme.

Disa të tjerë e përcaktojnë hellenizmin si “një periudhë klasike e sinkretizmit (trazimi me doktrina fetare nga burime të ndryshme) në bashkësi me faktorët kulturorë, ekonomik dhe politik”.(18) Në rast se hellenizmi do të përfshinte të gjitha fushat e lart-përmendura (gjuhë-kulturë-ekonomi-politikë-ndërtim,etj) ,mbas Kodit shtetëror te Perandorit Justinian

I ,popullsia e Perandorisë që shtrihej në tre kontinente, duhej të ishte kthyer në periudhën e njeriut primitiv.

Faktet historike dëshmojnë se *Sellenizmi* - gjithëmonë ka përfaqësuar *BESIMIN* origjinal dhe në zhvillim, të Pellazgëve. Mos njohja e besimit hënor të Pellazgëve, Sellenizmin, ka sjellë keq-trajtimin e fakteve historike dhe të emërtimeve të objekteve arkeologjike. Në qytetin e lashtë të Butrintit , shoqëruesi i parkut arkeologjik të flet për “mure hellenike” në vënd të shumë-njohurave “mure cikloprike” të Pellazgëve dhe në asnjë studim historik ne nuk hasim : mure katolike, ortodokse, islamike apo budiste.

Mendimi i II-të. Roli i Sellenizmit ka qënë thelbësor në krijimin e dy kulteve më të rëndësishëm të besimit dhe mitologjisë Euro-Aziatike: Kultit të përfaqësimit të trefishtë dhe Kultit të Dhe-Mitrës.

Dodona ishte jo vetëm vënd kulti, por edhe një tempull studimor i dukurive natyrore. Duke vërejtur Hënë, njeriu primitiv zbuloi tre fazat e shfaqjes së saj. Kjo natyrë e trefishtë u vu re edhe në tre pozicionet e Diellit (lindje, mesditë dhe perëndim), në jetën e njeriut (foshnjëria, moshë e pjekurisë, pleqëria) si dhe botën bimore (mbirje-lulëzim-fyshkja) e shtazore të Tokës. Ky cikël , që përsëritej në menyrë të ngjashme në Qiell dhe në Tokë, ishte origjina e lindjes së kultit të Tokës, Dhe-Mitrës (Dea Madre), me tre fazat e Hënës si dhe të besimit të parë të njeriut , atij *Hënor*.

Në të gjitha qytetrimet dhe besimet e mëvonshme, numri 3 është trajtuar si thelbësor, që përfaqëson njeriun të krijuar nga Qielli dhe Toka (19) Në besimin hënor dhe në mite, u pasqyrua simbolikisht me elemente të trefishtë të trupit të njeriut, figurave mitike, tek kafshët apo në grafikë, duke u bërë një nga përbërësit e rëndësishëm të besimit në Euro-Afro-Azi.



(Nga e majta) Paraqitja e tre formave të Hënës në kompleksin arkeologjik të Catal Huyukut (Turqi) e vitit 7500 pK; Sellena / Ecate me formë trupore të trefishtë (Muzeu i Vatikanit); Pasqyrimi i simbolit të trefishtë tek besimtarët druitë të Europës Veriore Kurorën rezatuese hënore mbi kokë, simbol i Sellenës, më vonë e gjejmë tek paraqitja e Artemidës.

Duke ndjekur paraqitjen e figurave hënore në objektet arkeologjike dhe në mite, dallohet qartë kalimi i besimit hënor të lashte në tre faza:

1. Me paraqitjen e Hënës në formë të trefisht në artin e lashtësisë, ku është shprehur pushteti i saj i vetëm me forcë të trefishtë.

2. Me kalimin e kohës, në mite ajo nuk ishte më figurë simbolike e NJË - Zoti, të vetëm qiellor(femër), por u përfaqësua me tre figura të ndara. Sipas themeluesit të studimit modern të mitologjisë Karol Kerenyi (Károly Kerényi, 1897- 1973), Hëna në qiell quhesh Ecate, mbi tokë Artemida dhe nën tokë Persefone (Korenyi, op.cit. p..41) (20)

3. Hesiodi, poet i shk 8-7 pK, nuk e përmend më tiparin e trefishte të saj dhe ajo trajtohet si figurë e thjeshtë .(21) Ky fakt tregon kohën e ngritjes së kultit diellor, shprehje e një shoqërie tashmë patriarkale të mbretërve krye-priftërinj , të fort ushtarakisht.

Pavarsisht këtij zhvillimi, Hëna mbeti një figurë e rëndësishme e besimit ,sidomos atij okult, dhe simbolet e saj u perjetësuan në besimin e të gjitha kohëve e veçanrisht në traditën e popujve. Sipas studiuesit V.Tole “ numri 3, ka qenë një numër formule për pelonasit ilirë, të cilët kur mbronin qytetin e tyre nga maqedonasit, flijuan 3 djem, 3 çupëza, dhe 3 dele të zeza. Me numrin 3 lidhet edhe udhëtimi i fundit i Uliksit në Epir, ku Tirezia e porositi Uliksin që t'i bëjë fli Posejdonit pikerisht tri kafshë: një dash, një dem, dhe një derr” (22)

Sipas studiuesve Jakov Levi dhe Luigi Previdi (“*I Numeri sacri e il loro simbolismo*”), në besimin arkaik, numri 3 është përfaqësim i gjithshkaje: i fillimit, i fundit, dhe asaj që përfshihet ndërmjet tyre. Në mitologji ky përfaqësim i trefisht shprehet tek : a) tre vajzat e Natës (Sellenës), mostrat Moire, b) tre virgjëreshat: Athinaja, Artemida dhe Persefone, c) në figurën e Zeusit (Hyspsistos, Chthonios dhe Posejdonit/ Dionisit). Për Dante Aligerin, njohës i mistereve të lashta, numri 3 ishte “i përsosuri”, me të cilin është e lidhur e gjithë “Komedia Hyjnore”. (23) Në kristianizëm, numri 3 përbën boshtin filozofik të besimit, të shprehur tek Trinitia, trashëguar nga besimi i parë i njeriut primitiv , ay Hënor.

Në tekstet e lashta Sellenës i këndohej: ”Ata të quajnë Ekate/ Perëndeshë me shumë emra, Mene/ Artemide lëshuesja e shigjetave, Persefone/ Padrone e drerëve, reze drite në erësirë/ Perëndeshë me tre zëra/ Perëndeshë me tre koka/.../ ti që na blaton një jetë të trefishtë/.../ nënë e Perëndive/e njerëzve, e natyrës,nënë e të gjitha gjërave” (24)

Siç vërehet në poezine e mësipërme, Sellena trajtohet si Krijuesja e natyrës tokësore, e njohur në gjuhën pellazgo-shqipe Dhe-mitra. Në formën Dhimitra/Dhimitri vijon edhe sot të përdoret tek shqiptarët.




Në këto foto, nga faltorja e Catal Huyukut, Turqi (7500 pK), është pasqyruar një Perëndeshë e trefishtë, figura e Dhe-Mitrës (Dea-Madre) dhe koka të Demit (Kaut), simbol i kultit të Hënës, forcës së saj krijuese.

Në gadishullin Arabik, para-islamik, grupi i përbërë prej tre Perëndeshave të quajtura tre bijat e Allah-ut, i gjejmë me emerat: al-Lat, Uzza dhe Manat dhe bashkërisht janë quajtur “tre gru”, që është fjalë origjinale e gjuhës pellazgo-shqipe, “tre gra”(në njëjës, një gru-a) dëshmi e ndikimit të Sellenizmit në mitet e Azisë. (25) Figurën e Perëndeshës së trefishtë e gjejmë edhe në besimin e Shakitizmit, degë e Induizmit ku tre Hyjnesha (Sarasvati, Lakshmi dhe Kali), janë tre pamjet e Maha Devi (Perëndeshës së Madhe), etj.(26) Këto grupe prej tre Perëndish , shprehin ndikimin e besimit hënor pellazg në mitet e Euro-Afro-Azisë.

Sipas studiuesve, Dodona ishte një « laborator studimor i vëzhgimit të kohës » për punët bujqësore. Kalendarin e pellazgëve bazohet mbi Hënën siç vazhdon të përdoret edhe sot në kalendarin e hebrenjve dhe muslimanëve (27)

Zhvillimin e bujqësisë në trojet arbërore, e dëshmon studimi i periudhës neolitike i Pr. Susan Allenit i Universitetit të Cincinnati, Amerikë. Në juglindje të Shqipërisë, në Vashtëmi është zbuluar ferma më e vjetër në Europë (6500 pK). Në studim, tregohet se baza e ushqimit në rajon ishin drithrat, por mbarë-shtroheshin edhe kafshë si derrat, bagëti të imta si dhe kafsh të egra si kaproj e peshq. (28) Dhe-Mitra përfaqesonte Perëndeshën e grurit dhe në përgjithësi të bujqësisë, të rinisë dhe të tokës së gjelbëruar, krijuese e ciklit të stinëve, e jetës dhe e vdekjes, mbrojtëse e martesës dhe e ligjeve të shenjta. (29) Kulti i Dhe-Mitrës sipas studiuesve, ngjitet deri në periudhën e Neolitit apo Paleolitit, i paraqitur në formën e figurinave prej balte të zbuluara pothuaj në të gjithë Europën të lidhur me Tokën, ripërtëritjen, si ndërmjetëse femër midis botës hyjnore dhe asaj njerëzore. Sipas Robert Graves, ajo i kushtohet Hënës dhe ciklit të trefishtë të njeriut (lindje-pjekuri-vdekje).(30)



(nga e majta) Perëndesha hënore Ishtar (1800-1750 pK) Vihen re krahët fluturues të Sellenës, dy bufë-zogj të natës dhe dy luane, simbole të pushtetit të saj. Gjithashtu sfondi me ngjyrë të zezë paraqet natën. Këmbët e saj në formë kthetrash drejtohen ngultas drejt Tokës; Ylli tetecepesh, shënjë e hyjnore (përfaqësues i botës së natës së Sellenës), simbol i Perëndeshës Ishtar; Dhe-Mitra. Figurine e mijëvjeçarit XXII pK.

Kulti i Dhe-Mitrës, me emërtime të përafërta apo të reja, ka qënë kryesor në Arabi, Armeni, Canaani, Kartagenë, Kinë, Kretë, Egjipt, Ephesi, Pellazgji, Indi, Israel, Japoni, Mesopotami, tek Fenikasit, Frigasit etj dhe kudo ajo ishte e lidhur me figurën e Hënës. Në rrugën e zhvillimit të Sellenizmit, disa attribute të Dhe-Mitrës iu kaluan Perëndeshave të reja, duke sjellë shtimin në mitologjinë pellazge të numrit të tyre në zonën ballkanike, si Ecate me tre pamje (e pjellorisë), Gea, Era, Aferdita (simbol i dashurisë, bijë e Dionës), Persefona (pjellorisë së Tokës, natyrës e stinëve), Artemida (e gjuetisë, si Sellena, motër e Apollos-Perëndisë Diell) dhe tek etruskët kemi Mater Matuta, Cibeles, tek romakët Cerere, në Azinë e afërt Perëndesha e Mirë, Nën-Madhja (mijëvjeçari i II pK) (31)

Në Egjipt e gjejmë me emërtimin Iside, në Asiri dhe Babiloni *Ishtar* dhe tek Shumerët *Inanna*. Tek pellazgët dardano-thesprot, Dhe-mitra dhe bija e saj Persefoni, ishte në qëndër të praktikimit të kulteve të mistereve në Samothrakë dhe ato eleuziane dhe zhvilloheshin gjate natës.

Figurat femërore që lidhen me Hënën (Sellena, Hekate etj) sipas studiuesve, paraqet periudhën më të lashtë të zhvillimit të shoqërisë njerëzore, e cila emërtohet si periudha e Matriarkatit, ku gruaja ishte *Krijuesja* sikurse edhe Toka, pra ishte objekt adhurimi. Sipas psikiatrit dhe antropologut K.Jang (Carl Gustav Jung, 1875-1961) Dhe-Mitra është një nga fuqitë ndriçuese të subkoshencës, simbol i një fuqije kontradiktore, shkatëruese dhe

shpëtimtare, ushqyese dhe gllabëruese. (Erich Neumann, Carl Gustav Jung e Gianfranco Tedeschi, *Storia delle origini della coscienza*) (32)

Studiuesit janë të mendimit se Perëndesha dodonase Diona, së cilës i kushtohej faltorja e Dodonës shumë kohë para se Zeusi të bëhej zot i saj, ishte pamja më e hershme e asaj që më vonë u emërtua Nëna Tokë (Dhe-Mitra) apo Gea, dhe se para Oborit Olimpik ka ekzistuar një Obor më i hershëm i katër Perëndive: Qiellit, Bubullimës, Diellit-femër dhe Tokës (33)

Në disa bazorelieve të lashta, Sellena paraqitet pikerisht si pamja e përkohëshme e Diellit (zanafilla e mitologjise dodonase ku Hëna paraqitet si Dielli gjatë udhëtimit mbas perëndimit).(34)

Në hymnin e gjetur në Nag Hammadi (shk 3-4 pk) Isida egjptiane vetë-paraqitet: “Unë jam e para dhe e fundit/.../une jam e martuara dhe e virgjër/une jam nëna dhe bija/.../ Une jam sterile ,e megjithate kam femijë të shumtë/.../Une jam Nëna e babait tim/Une jam motra e burrit tim/ Dhe ai është fëmija im i braktisur/Më nderoni gjithëmonë/Sepse unë jam Skandalozja dhe e Mrekullueshmja (35)

Me fuqizimin e pushtetit të burrit dhe njohjes së rolit të tij në krijimin biologjik të njeriut, Perënditë burra zënë vëndin qëndror në kultet pellazgjike. Kështu Zeusi eklipsoi figurën e Dionës në Ballkan, Thoti-Osiris atë të Isidës në Egjipt, Nanna atë të Inanna-Ishtarit në Azi etj. Kjo dukuri e “pushtimit” të fronit mbretëror nga ana e figurave mashkullore, shprehet në mitologji në paraqitjen e Perëndeshave hënore, si bija, gra apo motra të Krijuesit-mashkullor, në të gjitha mitet e Euro-Aziatisë dhe më gjerë.

Zeusi, figura mashkullore e periudhës së mbretërimit të Dionës në Dodonë, emërtohesh edhe Zeus Cthonios (i Tokës), Katachthonios (i Nëntokës) i pasqyruar në skulptura apo relieve si djalosh apo gjarpër. Për nder të tij bëheshin flijime të njehta si për Dhe-Mitrën dhe Persefonin, duke hedhur në puse kafshë me lekurë të erët.

Mndimi i III: Sellenizmi ka patur si simbol Shqiponjën mbretërore dhe ishte besim i popullit dardano-thesprot (ipe - boreal) që krijoi bazën mitike të Euro-Azisë.

Përse Sellena, përfaqësuese e besimit hënor pellazg, ka krahë të Shqiponjës? Në bazë të vëzhgimeve të Priftërinjve dijetarë të Dodonës, Hëna ishte rreze-dhënëse (sjell-ëse) “vrapuese” e pandalshme e ditës dhe e natës. U vu re gjithashtu se Hëna kishte një ndikim të madh mbi Natyrën, botën bimore, shtazore dhe njeriun. Pra përfaqësonte “pushtetin” mbi gjithshka që ndodhej në Qiell dhe mbi Tokë.

Duhet theksuar, se e gjithë metoda e grumbullimit të njohurive, e krijimit të Miteve sikurse dhe e vënies së emërtimeve, tek Pellazgët, bazohej tek *KRAHASIMI*.

Sipas gjuetareve primitivë, shqiponja në qiell dhe luani në tokë, qëndronin mbi kafshët e tjera për ato veti, që u nevoiteshin vetë atyre për të mbijetuar: durimin në gjueti, shpejtësinë e rrufeshme (cilësi e Pirros për të cilën edhe ju dha emërtimi “ipero” - shqiponjë), sulmin e befasishëm, syrin e mprehtë dhe goditjen përfundimtare. Për rrjedhojë krahët e shqiponjës dhe luani, në gjetjet arkeologjike, do të shoqërojnë Perënditë më të fuqishme të Mitologjisë së përbotshme (siç e kemi në foton lart të Perëndeshës shumëre Ishtar) si shprehje e *PUSHTETIT* mbi të tjerët.

Në fillim të shk 20, arkeologu Karl Ptash (1865-1945) gjeti në Apolloni nje stele mortore qe pasqyronte nje kafsh gjysem shqipe dhe gjysem luan. Studiuesi Dhimiter Pilika pohon se “kjo gjetje ne Apolloni, ka mishëruar një sintezë midis dy simbolesh të mirëfillta dodonase, shqipes dhe luanit” (36)

Në këtë formë, e gjejmë edhe në artin prehistorik të shumerëve, si simbol të sundimit mbi tokë dhe në qiell (36)

Nga e gjithë familja e kësaj shpeze, Pellazgët arbër vlerësonin Shqiponjën mbretërore (Aquila chrysaetos- Linnaeus,1758) për fuqinë e saj fizike, syrin e mprehtë dhe shikimin në largësi, kokën e madhe dhe krahë të gjera. Fluturimi i saj në qiell është madhështor dhe zbritja mbi gjahun nis vrullshëm që nga lartësitë.



Për rrjedhojë, Priftërinjtë që ishin njëkohësisht të zotë edhe për të thurrur vargje (dukuri shumë e dukshme edhe në ditët e sotme tek arbërit, si të veriut ashtu edhe të jugut) e paisën Hënën/Sellenë, (foto majtas) me krahë te shqiponjës së maleve të tyre. Sellena u paraqit si një vashë e re (sepse të moshuarat nuk e kanë vrapin e lehtë).


Studiuesi Dh. Pilika vëren se, sipas zbulimeve të qeramikës së shekujve VI,V pk e tehu, pa dallim shteti, shprehet fakti se në pikpamjen e përgjithshme te asaj kohe mbi simbolin e shqiponjes, ajo lidhet me Dodonen si epiqender dhe me rrezatimet e saj gjithandej... (37) Shqiponja kishte një përparësi ndaj luanit, ajo mund ta vështronte nga afër Diellin. Kështu ajo u bë simbol i marrjes së drejtpërdrejtë të dritës hyjnore dhe u nderua si zog i shenjtë, esoterik dhe si simbol i diturisë, për këtë arsye në mitet pellazgjike ajo përfaqësonte Zeusin, apo më sakt

Zeusin-thesprot sipas Eskilit. (Eschyle-Prométhée, v.832)

Shqiponja pellazge është e zezë, sikurse edhe në flamurin e arbërve, e pasqyruar edhe tek lutja e Priamit drejtuar Zeusit për ta ndihmuar të marrë trupin e të birit të vvarë: ”zogu që për ty është më i shtrenjtë dhe që ka një fuqi të mbinatyrshme/.../gjuetar i errët që quhej zioshi” (Omero, Iliade, 24, 308-321)

Në emblemat sllave ajo është e bardhë apo e verdhe, shënjë e ndikimit të simboleve pellazge, por mos njohjes së mitologjisë së tyre. Figura e Shqiponjës apo i krahëve të saj është tregues i *PUSHTETIT* dhe i *FORCËS* dhe kështu është trajtuar si në luftrat e lashta, të mesjetës dhe në ditët e sotme (të kujtojmë simbolet e nazizmit). Por simboli i Shqiponjës, në besimin mitik të *Sellenizmit*, përfshinte edhe shumë attribute të tjera.

Figurat njerëzore mitologjike që kanë krahë shqiponje apo të stilizuara, krahas pushtetit dhe forcës, përfaqsonin diturinë, moralin, dashurinë, vet-përmbajtjen dhe sidomos përkushtimin ndaj vëndit të tyre. (Shqiponja mbretërore mashkull, kur formon çiftin, i qëndron besnik femrës dhe nuk e ndëron territorin e tij) Paisja me këto cilësi, ishte një nga detyrimet themelore për udhëheqësit fetar, filozofët, mbretin dhe faraonin e ardhshëm si dhe elitën e zgjedhur. Ky ishte edhe synimi i shkollave ezoterike: T’i arsimonin dhe t’i edukonin me moral *Udhëheqësit* në të gjitha fushat. Vetëm të paisur me këto cilësi, një Komandant apo Mbret mund të korte fitore në luftë apo drejtimin e mbretërisë së tij. Për suksesin e tyre në këto detyra, ata i bënë flijime kultit të Hënës-Sellenë me krahë shqiponje, shprehese e *Sellenizmit*.



(foto majtas) Në relievin e Piramidës që i përket Ptahhotepit krahas shqiponjës, simbolit të Perëndisë Ra “që di gjithshka”, jepet figura e pendës së saj. Penda që paraqitet në figurat mitike dëshmon jo vetëm “diturinë” e këtyre Perëndive, por edhe “shënjtërinë” e tyre. Pendën e shqiponjës e gjejmë edhe tek Perëndesha Maat (mbrojtëse e ligjit dhe gjykatëse e shpirtave të njerëzve mbas vdekjes).

Lufta kundër vashës krahë-shqiponjë në Senatin romak

Që figura me krahë, e ashtuquajtura “Nike-Fitore” është në fakt Hëna/Sellenë simbol i besimit *Sellenik*, na e dëshmon edhe “tragjedia” e saj në Senatin romak të emërtuar Kuri (Curia Iulia) që shërbente edhe si një objekt fetar.

Gjurmë të Curi-ve, sipas studuesve të Lashtësisë, i gjejmë që në kohën e tribuve të kohës së Romulos. Emertimin “Kuiri-ja” nuk ka shpjegim në gjuhën italiane, por në shqip, këtë fjalë e gjejmë tek Kanuni i Lek Dukagjinit, (Nyja 56 , §.232), me kuptimin e një vendi të përbashkët i banorëve të fshatit. Por, po ta zërthejmë në formën “ku + ri”, (c në shqip

lexohet k) shpjegon vendin , “aty ku rrinë njerezit” dhe tek shqipetarët njihet me emrin “kuvënd”. (38)



Pamje e altarit ku ishte vendosur Sellena dhe pamja e jashtme e Curi-Julia në Romë.

Në këtë Cu-ri, të nisur nga Jul Çezari (Jules Cèsar) në shk 1-re pK, mbi rrënojat e Forumit të Madh (nga latinët “*Forum Magnum*”) por e përfunduar nga Oktaviani në vitin 29 pK, dhe mbas një zjarri nga Perandori ilir Deokliciani, u vendos në altar statuja e Sellenës me krahë, simbol i besimit hënor *Sellenizmit*.

Kostandini II-të e hoqi në v357, Juliani II-të (Julien le Philosophe) që ndoqi politikën e rikthimit në besimin autokton, e rivendos në v 361, Perandori Graciano (Flavius Gratianus) fanatik i kristianizmit, e heq përsëri në v 382 duke anuluar edhe të gjitha privilegjet murgeshave të perëndeshës Vesta-Vatra, që e mbanin zjarrin gjithmonë te ndezur, dhe priftereshave të besimit të lashtë *sellenik*.

Ishte koha kur Perandori Teodosi I-rë me Ediktin e Selanikut (v 380) kishte shpallur kristianizmin si besimin e ri të Shtetit. Një pjesë e senatorëve romakë hartuan një petition kundër këtyre masave, por peshkopi i Romës Damasi I-re, iu kundervu atyre me një kundërpeticion të senatorëve kristianë. Për rrjedhojë, vasha krahë-shqiponjë Sellena, u flak jashtë derës së Curies. Një aristokrat i madh i Romës, i njohur për luftën e tij për të mbrojtur besimin e të parëve , Simmaku (Quintus Aurelius Memmius Symmachus) në vitin 384 i drejtoi tre Perandorëve Valentinit II-te, Teodosit dhe Arkadios një lutje (*Relatio tertia in repetenda ara Victoriae*) për të hequr masat e repta kundër besimit të lashtë (Symmaque, *Relatio III*) dhe për të rivendosur mbi altar vashëzën Sellenë ku shkruhej: “Ne vezhgojmë të njëjtat yje , kemi të njëjtin Qiell dhe na rrethon i njëjti univers, ç’rëndësi ka se sejcili kërkon të vërtetën në mënyrën e tij?” (*Relatio III*, 10) , por Ambrozio i Milanos (Aurelius Ambrosius, 374-397), një nga katër « baballarët » e Kishës latine, që kishte një ndikim të madh mbi perandorin, nuk lejoi rikthimin e Sellenës me krahë në Curi.(Saint Ambroise, *Épître XVIII*) Imperatori kristian i moderuar Eugenio (Flavius Eugenius) i mbeshtetur

nga senatoret e besimit pellazg, e kthyen përsëri statujen mbi altar në vitin 393 (Paul Petit *Histoire générale de l'Empire romain*). Eugenio u mund në luftë nga Teodosi I-rë në vitin 394, i cili vulosi përfundimisht dëbimin e saj nga altari i Curi-as. (40)

Kjo përplasje për vashëzën Sellenë krahë-shqiponjë, që zgjati afro 40 vjet, u shua për aresyen - sipas historianit bizantin Zosimo- se gjatë kësaj kohe, shumica e senatorëve përqaftuan besimin kristian. (*Historia nova* V, 41, 3) A do t'i bëhej një luftë e tillë nga romakët, kultit të Fitores?

Si përfundim: Tema e trajtuar më sipër, pasqyroi në formë të përmbledhur një material jashtzakonisht të gjerë mbi besimin HËNOR pellazg. Të gjithë Perënditë e zanafillës së miteve ishin hënorë, të lidhur me Hënën dhe qiellin e natës. Kam dashur vetëm sa të rizbuloj emërtimin dhe disa dukuri të këtij besimi, duke nxitur studimet e mëtejshme për njohjen e zanafillës së mendimit tek Pellazgët.

Mendimi im është se : SELLENIZMI ka qënë BESIMI i Parë, Original dhe në Zhvillim, i pallazgëve dardano-thesprot (ipe-borealë), që ka ndikuar fuqishëm në besimet e lashta dhe të më vonshme të të gjithë Europës Pellazgjike (Euro-Afro-Aziatike). Ky ndikim ndihet në strukturë, në simbole e në rite. Ka qënë autori i DY kulteve më të rëndësishme të besimit dhe mitologjisë : Kultit të përfaqësimit të trefishtë dhe Kultit të Dhe-Mitrës.

Gjithashtu Pellazgët janë Poetët që thurrën dhe u kënduan në Mite forcave të Natyrës, Gjigandëve, Heronjve, Titanëve dhe Oborreve të Perëndive. Është besimi që krijoi idenë e Rimëshirimit (të pasqyruar më vonë tek idea e Ringjalljes). Trevat e Arbërve , është vëndi ku u krijua Parajsa dhe Ferri dhe ku njeriu kuptoi se “Të jesh i ditur, do të thotë të jesh i fortë !”

PERËNDESHA MË E FUQISHME E TË GJITHA KOHRAVE - NË XHOKEN E MIRDITORES

*Gjatë mijëra shekujsh, shqiptari nuk ka mundur të harrojë se është Pellazg.
Eduard Shnajder*

I- Simbolet pellazge tek veshja e shqiptarëve

Një ndër humanistët e mëdhenj dhe zëri më poetik i Europës së shekullit 19, Xhorxh Bajroni në letrën e tij drejtuar nënës nga Shqipëria osmane, i shkruante: « Kostumet kombëtare shqiptare, afër 130 variante, janë një dukuri e fuqishme e vlerave estetike të kulturës popullore. Një shfaqje e veçantë është fustanella. Kjo vëshje e burrave (një fund i bardhë pala-pala, i gjatë deri tek gjuri) është e plotë, kur lidhet për beli me një brez të gjerë, me silahet, me çorapet e leshta e kalca, me opingat me xhufkë në majë, me takije, me jelek, me mëngore e me xhamadanë, të gjithë të stolisur me ar e argjend ». (1)



(a) Pikturë e Bajronit me veshje shqiptare (b) Jeleku, brezi dhë armët, pjesë e veshjes me fustanellë të Shqipërisë së Jugut. (2)

Por veshja e traditës së shqiptarëve, përveç shumë-llojshmërisë krahinore, bizhuterisë së pasur, armatimit, arit dhe argjendit që e mbulon, zotëron edhe « thesare » të tjara, të pa njohura edhe në ditët e sotme - atë të *MITEVE TË BESIMIT PELLAZG*.

Në legjendën e Krijimit të Botës që tregonin shqiptarët e shëkullit 19, thuhet se Zoti, mbasi krijoi ujin dhe tokën e sheshtë, pa se vepra e tij ishte e paplotë dhe natyra monotone. Për të kënaqur njerëzit që do të krijonte, morri rrugën për ta zbukuruar Botën. Kur mbriti aty ku banonin shqiptarët, thesi i shpëtoi nga duart dhe kodrat e malet që ndodheshin brënda tij e mbuluan vendin. (3) Ndoshta Zoti i gjithë-ditur, hodhi qëllimisht shumë male mbi vendin e shqiptarëve të vjetër, që “portreti” i tij i parë dhe kujtimi i miteve zanafallore, të mos humbisnin kurrë. Studiuesit e folklorit të shqiptarëve kanë pohuar se “kujtesa tregimtare e tyre shkon deri në kohët me të lashta”. Francezi Eduard Shnaider pohon se: “Aventurat më të çuditshme të Uliksit, si para Trojës ashtu dhe gjatë kthimit të tij, tregohen në gjithë shtëpitë e malësorëve shqiptarë, kur mblidhen mbrëmjeve rreth zjarrit” (4)

Në zemër të këtyre maleve të Shqipërisë edhe sot, në ditë dasmash a festash, banorët veshin rrobat e traditës, të zbukuruara me *SIMBOLE* pellazge.


Zbukurimi në lashtësi i trupit me tatuazhe, i bizhuterive, armatimit, i veshjes dhe në përgjithsi i të gjitha sendeve që e rrethonin njeriun, me simbolet e besimit, kanë patur vetëm një qëllim : Të *MBROJTIES* prej vdekjes, sëmundjeve, prej vrasjes nga fiset e tjera

apo sulmit të kafshëve, prej fatkeqësive natyrore, etj. Njeriu gjatë të gjithë historisë së tij, të lashtë dhe moderne, ka ndjerë nevojën e « dorës së Zotit » dhe për këtë qëllim e ka rrethuar veten me simbolet kultike të tij.

Në këtë material, do të përqëndrohem vetëm tek një figurë e veshjes së gruas nga Mirdita, (Malësia e Shqipërisë Veriore). Për mendimin tim, e gjithë veshja i kushtohet kësaj figure dhe kultit të saj, të mbiquajturin sot « kryqi egjiptian ». Në foton posht, ku jepet më besnikrisht forma historike, shikojmë se qëndristarja i ka dhënë vendin qëndror, duke mbuluar pothuaj krejt kurrizin e femrës. Të gjitha zbukurimet e tjera në xhoke, janë simbole që tregojnë besimin që kjo figurë përfaqëson.



Po ta vërejmë me vëmendje, do të na lind përshtypja e një forme të stilizuar të trupit të njeriut. Studiuesit e artit të shpellave, do të zbulojnë lehtësisht « autoportretin » e banorëve të tyre. Këtu më poshtë kemi dy vepra arti të njeriut të Paleolitit, që përputhen nga ana grafike me figurën në xhoken mirditore. Ndërsa në të parën (fig.a) njeriu mban duart poshtë, në të dytën duart janë të ngritura lart.



(5)

Dallimi midis tyre qendron në faktin se në (fig.a) kemi një « fotografim » të thjeshtë të njerzve. Ndërsa në foton e dytë (fig.b) « artisti » i lashtë ka shprehur një moment shumë të rëndësishëm: kryerjen e një riti kushtuar Zotit në qiell. Lutësi, ndoshta Kreu i fisit (shamani) ka pranë rrethin me një pikë në qendër, i cili është simboli universal i paraqitjes së Zotit edhe në veshjen e traditës së shqiptarëve sidomos tek bizhuteria e Malsisë së Madhe.

M.Eliade studiuesi i besimeve të lashta pohon se : « Në rast se i quajmë Paleantropët, 'plotësisht njerëz', për rrjedhojë ata zotëronin edhe një farë besimi dhe praktikonin disa rite (...) Nga materialet arkeologjike dëshmohet se besimi i gjuetarit paleolitik çfaqet në artin e shpellave që para 30 000 viteve ». (6) Në fotot poshtë, kemi të paraqitur të njëjtin pozicion të duarve si tek xhokja e mirditores, që shpreh njeriun duke i drejtuar lutje Zotit. Ky simbol u trashëguar edhe tek dinastia shqiptare e Perandorëve Paleolog. Rëndësinë besimtare të këtij simboli, e dëshmon ky detaj i qëndisur mbi robë (fig. djathtas).



Amuletë prej balte; Objekt (i vitit 1499) i careshës ruse Sofia Paleolog, me origjinë nga dinastia bizantine arbërore e Paleologëve. Ky fakt dëshmon se simboli parahistorik është trashëguar edhe tek shqiptarët e Jugut. (7)

Në shumë vizatime të shpellave apo objekte arkeologjike, si kjo amuletë e emërtuar « venera para-historike », qëllimi i të cilave ka qënë sigurimi i mbrojtjes hyjnore. Tek simboli ,i amuletës, si në shumë vizatime të shpellave dallohet qartë « bishti ». Njeriu primitiv vishej me lëkurën e kafshëve për t'u mbrojtur nga të ftohtit. Në këtë veshje bënte pjesë edhe bishti, siç e shikojmë tek vizatimi i njerëzve në vazot prej balte të një periudhe shumë më të vonshme të Gadishullit Pellazgjik (Ballkanik). Gjurmë të këtij « kujtimi », studiuesi Franc Nopça e ka gjetur tek besimi, se ka njerëz me bisht. Këtë e ka zbuluar tek popullsia në Shqiperi, Greqi, Azi e Vogël dhe Dalmaci.

Mbajtja e duarve të drejtuara nga Zoti, ka mbijetuar në pikturë deri në periudhën e Mesjetës dhe Rilindjes europiane. Një pozicion i caktuar dhe i përsëritur në vazhdimsi i duarve, i këmbëve apo i trupit, janë simbole që përmbajnë dëshmi historike që duhen

« lexuar » tek materialët arkeologjike, njësoj si dokumentet e shkruara. Ato na japin të dhëna të rëndësishme për besimin, njohjen e figurave mitike dhe periudhën historike të një popullsie në lashtësi.

Përfundimi i parë : Nga ana grafike mund të pohojmë që në xhoken mirditore kemi të shprehur një figurë njerëzore që lidhet me besimin para-historik. Në studimin e L.Danos “*Perëndesha Athina dhe simbole të tjera kozmogonike*” kushtuar veshjes së gruas malësore të Shqipërisë së Veriut, autorja ka dalluar figura të stilizuara që lidhen me mitet pellazge, si busti i Athinasë me sy kukuvajke, ornamente të kultit të Meduzës, svastikën, dragoin, syrin e Osirisit, gjarprin, kryqin, akrepin etj. (8) Edhe kjo figurë njerëzore e xhokes mirditore, na bën të mendojmë se paraqet një mit të besimit të Europës pellazgjike. Por *MITIN* e kujt mbart mbi kurriz malësorja shqipetare ?

II - Perëndesha Zog ose Perëndesha e Madhe

Psikologu Karl Jang (Carl Jang) pohon se “Historia e lashtë e njeriut, në ditët tona, na zbulohet nëpërmjet pamjeve simbolike dhe miteve që kanë mbijetuar nga njeriu i lashtë (...) Nuk janë ngjarjet e së kaluarës historike ato që na mundësojnë të mësojmë (mbi të shkuarën-shën im), por statujat, vizatimet, tempujt dhe gjuhët, që na përcjellin besimet e lashta”. (9) Edhe në materialin tonë, nuk do të kishim patur kurrë mundësinë për ta njohur “fytyrën” e këtij portreti dhe mitin që përfaqëson, po të mos kishim patur ndihmën e materialeve arkeologjike, të besimit dhe kulturës së traditës.

Pjesa më e vështirë, që na pengon të dallojmë pamjen njerëzore tek figura në xhoken është pikërisht pjesa e kokës e cila ka një formë pothuajse trekëndëshe, të zgjatur në pjesën e poshtme. Megjithëse e stilizuar për qëndisjen mbi robë, dallohet qartë nga forma e kokës, vijave dhe ngjyrave të ndryshme të përdorura, se ka ngjashmëri me objektet arkeologjike të skulpturave të njeriut me kokë zogu. Në pjesën e kokës, foto poshtë (fig.a) shikojmë tre vija që bashkohen afër pjesës së qafës. Tre vijat jeshile dhe ngjyra portokalli në pikën e takimit të tyre, na jep idenë e sqepit të çvendosur përpara të shpendëve. Kjo paraqitje është e afërt me fytyrën në skulpturën e femrës së sumerëve (Mesopotami) (fig.b) dhe figurinave të Europës së lashtë, në studimin e M.Gimbutas “*Il linguaggio della Dea* » të cilat ajo i quan Perëndesha-Zog. (10)



Që në xhoken mirditore kemi të bëjmë me figurën e një femre, e dëshmojnë simbolet gjeometrike që e mbulojnë trupin e saj (do flitet më poshtë) si dhe fakti që ajo gjëndet vetëm në veshjen e gruas dhe jo si simbolet e tjera të besimit, që paraqiten në rrobat e të dyja gjinive. Pozicioni i duarve mbi bark në skulpturën (djathtas), tregon për një kohë më të vonshme se sa femra me kokë zogu e xhokes. Ajo flet për periudhën kur femra u hyjnizua si «krijuese» e njeriut, që mendohet se i përket periudhës së Mesolitit (fundi i periudhës së akullnajave rreth vitit 8000), në kohën e zbutjes së kafshëve dhe fillimit të agrokulturës. Ndërsa Hyjnesha e xhokes nuk përfaqëson gruan “lindëse”, por është *ORAKULLI*, i hyjnizuar afro 15000 vite para përdorimit të agrokulturës, dhe sipas besimit pellazg, përfaqëson vetë *KRIJUESIN* në Tokë. (11) Mos të harojmë gjithashtu se *ZOTI* i parë Krijues ka qenë Hëna (më saktë Drita hënore, prandaj edhe besimi i Pellazgëve ka qenë hënor), e cila e ndryshonte formën e saj njësoj si trupi i femrës kur është shtatzanë. Kështu, tek njeriu para-historik u krijua bindja së Hëna ishte «lindësja» femër e natyrës që e rrethonte.

Në tekstet e lashta, Perëndeshës Sellena që përfaqësonte Hënën në mite, i këndohej: ”Nënë e Perëndive/e njerëzve, e natyrës, nënë e të gjitha gjëravë” (12) Ajo u pa si *NDËRMJETESJA* midis njeriut në Tokë dhe Zotit në Qiell. Historia na dëshmon se Orakujt e parë në besim kanë qenë gra. Le të kujtojmë Kasandrën, vashen fat-thënëse trojane, bij e mbretit Priam, që parashikoi shkatrimin e Trojës. Johan G. von Hahn tregon se gjurmët e kësaj periudhe para-historike, i gjejmë tek gratë shqiptare të cilat besojnë se të tretën ditë pas lindjes, vijnë tri gra të padukshme te djepi i foshnjës dhe caktojnë fatin e tij. Këto gra quhen Fatite. (13)

M.Gimbutas, studiuesja e artit para-historik pohon se : « Statujat e meshkujve, zenë vetëm 2 deri në 3% të materiali arkeologjik të Europës Antike (...) Në asnjë periudhë të Paleolitikut nuk gjënden gjurmë të ndonjë figure të mashkullit- krijues (prind). Forca krijuese e njeriut, duket sikur i dedikohet vetëm femrës, prandaj dhe u adhurua si Perëndesha e Madhe (...) Për periudhën para-historike, preferoj emërtimin e saj « Perëndesha e Madhe » - pohon studiuesja - sepse e përshkruan më qartë pushtetin e saj absolut, forcat e saj krijuese, shkatruese dhe rigjeneruese ». (14) Edhe studiuesi i besimeve të lashta, Mircea Eliade pohon se edhe në besimet e Azisë : « Perëndeshat, zënë pjesën më të madhe në Panteonin

e perëndive të Indisë së lashtë dhe është domethënës mbizotërimi i Perëndeshës së Madhe, në besimin hinduist ». (15)

Mitet pellaze (të emërtuara padrejtësisht greke) që njohim sot, nuk e pohojnë këtë fakt, të cilin na e dëshmon arkeologjia. Kjo tregon se janë mite të vonshme, që ju kanë përshtatur miteve të hershme, figurën mashkullore, për nevojat e një shoqërie që tashmë e kishte ndryshuar strukturën e saj. Tradita e shënjtërimit të gruas në para-histori është trashëguar tek shqipëtarët deri në kohët e vona. Në ligjët e repta të Kanunit të Maleve (Lek Dukagjinit) mbi hak-marrjen (Libri i tretë, Martesa, nyja 23) shkruhet: Ky kanun nuk e përfshin gruan, për arsye se edhe me qëllue se vret kënd, “gruaja s’bjen në gjak” (nuk vritet, siç është zakoni i hak-marrjes- shën im). Këto ligje kanë vepruar deri në shk.20 tek shqipëtarët e Malësisë.

III - Simboli, zbulim i njeriut para-historik

Njeriu para-historik njohu veten dhe natyrën nëpërmjet krahasimit të gjithshkaje që shikonte dhe dëgjonte. Pa këtë “analizë” të ndryshimeve dhe ngjashmërive të botës përreth, nuk do të kishte patur mundësi të çfaqej tek para-ardhësit tanë dukuria e të menduarit. Pra, pa analizuar dallimet dhe ngjashmërinë që shfaqej në botën përreth, njeriu do të kishte mbetur indiferent ndaj saj , dhe nuk do të kishte patur mundësi të njihnte natyrën dhe vetveten.

Krahas përpjekjeve për t’i emërtuar me pasthirma apo grup tingujsh botën përreth, në mënyrë instiktive ai u përpoq të shprehej duke e kopiuar sendin, duke imituar formën e tij në natyrë. Pra vizatimet, gdhëndjet në dru,balt etj, që i shikojmë në objektet arkeologjike, mund t’i quajmë pa gabuar një “gjuhë” e cila shpreh sikurse edhe fjala. Pikërisht kjo “gjuhë” ka qenë vendimtare në materialet, mbi besimin pellazg dhe ecurine e zhvillimit ideor të njeriut, nga para-historia deri në ditët e sotme. Kjo sepse periudhat historike kanë qenë jashtzakonisht të gjata në krahasim me periudhën e shkrimit dhe shumë objekte të lashtësisë, i kanë rezistuar kohës të pa ndryshuara.

Kjo “gjuhë figurative” është zanafilla e krijimit të simboleve dmth njeriu primitiv mësoi të dallojë detajin, që jepte qartësisht karakteristikën thelbësore të figurës, por njëkohësisht edhe të një ideje që lidhej me këtë figurë. Duke vizatuar gjirin, ay shprehte femrën dhe funksionin e saj jetë-dhënës, duke bërë një vijë të përdredhur, tregonte gjarpërin dhe idenë e rigjenerimit, etj. Sipas Cirlot : « Analogjia është ndoshta guri i themelit i tërë ndërtesës simbolike...Analogjia si një proces unifikues dhe regullues shfaqet vazhdimisht në art, në mite dhe në poezi » (16) Se sa kohë u desh për të aritur në përdorimin e simbolit, që është mjeti më praktik i shkencës, artit dhe i çdo aktiviti të njeriut të sotëm, ne vetëm mund të hamëndësojmë. Simboli u bë mjeti më i rëndësishëm i besimit zanafillor. A e krijoi Simboli,

Besimin dhe Fjalën apo Fjala ishte krijuesja e parë, siç thuhet në Librat e shenjtë, këtë nuk mund ta dimë. Ato mund të kenë qenë edhe bashkë-kohëse duke nxitur zhvillimin e njëra-tjetrës.

Studiuesit e mitologjisë dhe të besimit, por edhe historianët e gjuhësisë, i japin shumë pak rëndësi këtij mjeti shprehës (simbolit) të njeriut të parë europian. G.Dumezil pohonte se “Simbolizimi është para-rendës i një gjuhe apo gjesti. Ai lejon, në mos paraqitjen, se paku afrimin dhe përcaktimin e natyrës së gjërave “ (17)



(a) Figurat gjeometrike të objekteve arkeologjike të kultures Vinka (5200-4000 pK)
 (b) Figura gjeometrike qe dëshmojnë se statuja është një femer, mijëvjeçari IV. (18)

Studiuesi i simboleve në gjuhë, besim dhe shkencat moderne, Petro Zhei pohon: “Simboli është gjuha me të cilën Zoti shprehet”.(19) Ajo që mbetet fakt i padiskutueshëm është se: Zbulimi i *SIMBOLIT*, *BESIMIT* dhe *FJALËS* është vepër e njeriut “me bisht” të parahistorisë !

Në librin e M.Gimbutas “*Gjuha e Perëndeshës*” (Il linguaggio della Dea), mbi figurat gjeometrike në objektet arkeologjike të Europës së Neolitit të Lashtë (7000-3500 pK), autorja na zbulon se çfarë kanë shprehur simbolet e lashta dhe lidhjen e tyre me njëra-tjetrën. Për herë të parë faktohet, se këto figura gjeometrike shprehin Perëndeshën më të lashtë të Miteve të para , të panjohur deri më sot. Po të vërejmë figurat gjeometrike që mbulojnë “trupin” e Perëndeshës-Zog (fig.a poshtë) dallojmë zig-zakun që na jep idenë e rombit, trekëndësja me ngjyra të ndryshme dhe kryqin në qendër, i formuar nga dy V të bashkuar në këndin e tyre. Më poshtë lulen/yll (dy kryqe kënd-drejtë të kryqëzuara) në qendër të të cilit ndodhet një topt, simbol i vetë Krijuesit. Zig-zaku nuk është gjë tjetër veçse përsëritja në vijëmsi e figurës gjeometrike V, dhe sipas studiuesve është figura gjeometrike më e vjetër e zbuluar deri më sot. Njeriu i Nandertalit e ka përdorur para 40 000 viteve. (20)



(nga e majta) Simbolet gjeometrike të kultit të Perëndeshës femër brenda figurës së qendisur që përsëriten edhe në pjesët e tjera të xhokës; Pjesë e zbulurimve prej argjendi ku dallohet po ajo lule si tek xhokja, hëna dhe zig-zaku si korniz e gjysëm-rrethit posht hënës.

Figurat gjeometrike, pohon M.Gimbutas, që janë mbledhur nga qindra objekte arkeologjike që i përkasin kulturave Kukuteni (Cucuten), Karanovo, Tisza, Bük e Vinka, ku paraqitet V në pozicione të ndryshme (vetëm apo në formën e linjës së zig-zagut, rombit, trekëndshit, X, M, etj.) duken se shërbejnë për një qëllim të vetëm: Pasqyrimin e Perëndeshës. (21) Në kohën kur mashkulli-Mbret dhe Kryeprift- u ul në fronin e Perëndeshës parahistorike (në periudhën e patriarkatit), ay i morri shumë figura gjeometrike të kultit të saj. Shëmbull këmi simbolin e svastikës, së cilës nuk ja dimë emrin në periudhën e besimit zanafillor pellazg, kur përfaqsonte Perëndeshën Zog. Por në periudhën e familjes hyjnore të Albanit (Alpanit) të Çamërisë, babait të Zeusit, emri që ju vu këtij simboli pasqyronte mashkullin (Zeu+asht+Ka) dhe u bë simbol i tij në mite. Ky ndryshim “i pronarëve” të simboleve të besimit, bëri që kuptimi i tyre i parë figurativ të harrohet dhe t’iu përshtaten miteve të padronëve të rij. Megjithatë, simbolet dhe figurat e shenjta femërore të Europës së Lashtë -pohon M.Eliade - nuk janë çrrenjosur kurrë tërësisht. Ato qenë ngulitur aq thellë në psikikën e njerëzve, sa do të mund të zhdukeshin vetëm me çfarosjen totale të popullsisë femërore.(22) Këtë e dëshmonë objektet arkeologjike dhe simbolet e sotme fetare.

Simbolin e Perëndeshës Shqiponjë e rigjejmë në Kartagjenë dhe Egjiptin e lashtë, nën emrin e perëndeshave hënore : Tanit (TNT) me simbolin (fig.1) dhe tek “kryqi” i Isisit , Ankh (fig.2). Simboli Ankh është figura më e rëndësishme në vizatimet dhe skulpturat e Piramidave. Ky simbol mbijeton në kohën e sotme tek kryqi latin (fig.3) dhe franceskan Tau (fig.4).



Në historinë dhe etnografinë e shqiptarëve janë pasqyruar simbolet parahistorike të Zotit femër, të trashëguara nga paraardhësit pellazgo-ilir.



- Skicë e flamurit shqiptar të Arbëreshëve të Sicilisë, që e përdorën në vitin 1910. Skica është modeluar sipas fotos së manifestimeve të arbëreshëve, viti 1910.

Në foton (fig.a) në flamurin e Arbëreshëve të Italisë (1910), mbi kokën e shqiponjës kemi simbolin para-historik V (të femrës) që dëshmojnë trashëgiminë e besimit hënor pellazgjik tek shqiptarët e shk 20. Djathtas (fig.b), simboli parahistorik i femrës Zig-zak, në jelekun e burrave. (Kostum nga Shkodra P.Marubi 1895-1900) ; Furkë nga krahina e Gjirokastrës. Tre dhëmbët, shqiponja, ylli dhe brezi i zik-zakut ,janë shënja të simboleve të besimit hënor Pellazg. (23) Me anën e simboleve njeriu primitiv ka shprehur karakteristikat e Perëndive në mitet pellazge, që na ndihmuan edhe ne, për të zbuluar Perëndeshën para-historike në xhoken mirditore.

Përfundimi i dytë: Perëndesha-Zog është *FEMRA*, njeriu i parë tokësor i adhuruar në besimin zanafillor para 30 apo 50 mijë viteve. Por në rast se do të kemi parasysh se “dokumenti” më i lashtë i përdorimit të zjarrit është afro 600 000 vjeçar, zbuluar në Choukou-tien (24), mund të themi se besimi ka moshë shumë herë më të madhe.

Kjo Perëndeshë, e pa përmendur në studimet mbi historinë e njeriut, ishte *FEMRA-ZOG* e krahasuar me *KRIJUESIN* qiellor dhe ka luajtur rolin e Mbretëreshës, Orakullit dhe Burimit të Jetës njerëzore. Vetë besimi i Pellazgëve e kishte bazën tek figura femrore dhe kjo shprehet jo vetëm në studimin e M.Gimbutas, por edhe në gjuhën shqipe (do të trajtohet në një matërial tjetër). Ajo ishte Perëndesha e maleve, e gurëve, e ujit, e pyjeve dhe e kafshëve, personifikimi i forcave misterioze të natyrës (25) dhe ishte figura e parë e besimit pellazg, që u krijua me trup njerëzor.

IV- Takimi me Zotin

Kjo ndjenjë e ka tunduar gjithëmonë njeriun modern kur hyn në kishë, xhami apo objekte të tjera kulturi. Kjo dëshirë ka lindur para dhjetra apo qindra-mijë vitesh, kur njeriu “me bisht” besoi në një Qënjë të mbinatyrshme qiellore, e cila kishte krijuar natyrën dhe fisin e tij dhe u dërgonte dritën dhe ujin, që u jepnin jetë të gjitha gjallesave mbi Tokë.

E.Shnaider pohon se “ Pellazgët besonin, se çdo gjë që ndodhte përreth tyre lidhej me fuqinë e natyrës, që mendja e tyre primitive nuk i jepte asnjë formë materiale, të cilën të mund ta emëronte apo t'i jepnin një formë”. (26) Nganjëherë, me zjarrin qiellor (rrufetë) e atë tokësor (vullkanet) dhe ujin e tmershëm (përmytjet), Ai zhdukte gjithshka. Njeriu primitiv vendosi t'i afrohej dhe “të fliste” më të padukshmin, t'i lutej që ta mbronte e të kujdesej për jetën e tij. Unë mendoj së përpara së t'i krijohej ideja të luante rolin e “ndërmjësit” me Krijuesin, njeriu i pafuqishëm, ia la këtë detyrë (në mite) zogjve të qiellit. Besoj se këtu e ka burimin edhe tradita shumë popullore tek shqipëtarët, për të « lexuar » fatin e tyre tek kockat apo stomaku i zogjve. Ismail Qemali, themeluesi i shtetit shqipëtar të 1912, ishte gjithashtu njohës i mirë i « shenjave » tek zogjtë. Pra duhet të pranojmë se si simbole, në besimin pellazg shërbyen jo vetëm figurat gjeometrike, por edhe figurat nga bota bimore e shtazore.

Studiuesit e besimit pohojnë se gjatë të gjithë periudhës së zhvillimit të shoqërisë njerëzore, disa simbole të shenjta në besim, kanë mbetur të pandryshuara deri në ditët e sotme. M.Gimbutas pohon se: «Ajo që na çudit nuk është ndryshimi gjatë mijëra vjetëve të simboleve, përkundrazi vijëmsija e tyre që nga periudha e Paleolitikut » (27) Kjo dëshmohet edhe për shpendin që përdori njeriu i lashtë kur « krijoi » Perëndeshën-Zog. Lind pyetja se cili shpend u hyjnizua dhe vazhdon të jetë *SIMBOL* i shenjtë i *BESIMIT* edhe në ditët e sotme?

Me qenëse po flasim për para-historinë, do të bazohemi në intuitën dhe analizën llogjike të fakteve dhe sidomos tek lidhja me objektet arkeologjike të periudhave të më vonshme. Gjatë të gjithë kohës së Lashtësisë, shikojmë shumë shpend të adhuruar që janë pasqyruar në objektet e qeramikës dhe pikturat murale si: mjelmën, pëllumbin, rosën, lejlekun, palloin, shqiponjën, etj. Por asnjë detaj i kokës, tek Perëndesha e Europës Antike, nuk na ndihmon të përcaktojmë, se cilit zog ja besuan këtë rol të lashtët. Nga simbolet e përdorura mbi objektet arkeologjike, duket se « studiuesi » primitiv e shikonte femrën si një burim i « ujit të jetës ». M.Gimbutas e mbështetur tek ky fakt, fytyrën e Perëndeshës e quan të huazuar nga një « zog uxor », por pa e përcaktuar me emër. Me qenëse besimi lidhet me Krijuesin i cili ndodhet në qiell, unë mendoj se nuk kemi të bëjmë me një zog uxor dhe siç dihet, kurorën e « mbretëreshës » së maleve dhe lartësive të mëdha, e mban vetëm *SHQIPONJA*.

Emri i Shqiponjës dhe jo i ndonjë shpendi tjetër, zë vend në mitet qiellore pellazge: Ipero, (Ipe = shqiponjë në dialektin çam) ka si bijë Hënën, Diellin dhe Agimin (Selene, Elio, Eos).

Shumë Perëndi të Olimpfit, si Zeusi apo Athinaja, shpesh kthehen në shqiponja mbi fushat e luftimeve. Janë të ralla skulpturat e Zeusit ku nuk është pranë Shqiponja, shpendi që në besimin pellazg, përfaqson *FRYMËN* e Krijuesit në tokë . Gjithashtu në fjalorin Teosofik të Helena P.Blavatskit (Helena P.Blavatsky) shkruhet se Shqiponja është një prej simboleve më të lashta. Nga helenët trajtohej si emblema e shenjtë e Zusit dhe ishte Perëndia më e lartë e Druidëve. Filone shkruante në « Quaestiones et Solutiones in Genesis » se AIN është « Zoti i Dytë dhe Mënçuria e tij » (Ain është emri i Shqiponjës në gjuhën e Arbëreshëve, Shqipëtarëve të Italisë) (28) Në skulpturat e para të Perëndive (femra dhe meshkuj) të lashtësisë, të gjithë kanë krahë ose paraqiten si shqiponja.

Duhet të kemi parasysh se besimi i pellazgëve ka qenë *HËNOR*, dhe të gjithë perëndite me karakteristika të shqiponjës, kanë qenë Perëndi hënore. E theksojmë vazhdimisht këtë fakt, sepse nuk përmendet në studimet mbi besimin e Lashtësisë. Albanologu gjerman Hahn (Dr. Johan George von Hahn) shprehet se Enea ishte përfaqësuesi i kolonizimit tyrenopellazg dhe ku zinte vend, përhapte edhe kultin e Hënës. (29) Ndërsa E.Shnaider tregon se Pellazgët « duket se adhuronin më shumë Hënën se sa Diellin, kundër të cilit gjuanin me shigjetat e tyre. » (30) Franc Nopça pohon se : “Nuk kemi shumë të dhena, që në Shqipërinë e dikurshme të mbahej dielli si një qenie e shenjtë” (31)

Pra « ndërmjetsja » me Zotin, para se këtë detyrë ta kryente njeriu, ka qenë Shqiponja dhe në periudhat e më vonshme, Femra me maskën e zogut (në periudhën Paleolitike), që është parafytyrimi i parë e një Perëndie me trup njeriu. Deri më sot, nuk njohim ndonjë emërtim për këtë Perëndeshë të para-historisë. Unë do ta emërtoj : *PERËNDESHA SHQIPONJË*, emër që i përgjigjet portretit të saj në besiminin zanafillor europian. Në periudhat e më vonëshme, vërejmë së kjo Perëndeshë, ka kokën e femrës kursë trupin më forma të zogut (fig. a,b poshtë). Ky detaj shpreh periudhën, kur në besim u hyznizua koka e njeriut (truri) si vendi ku ndodhej « shpirti i pavdekshëm».

(32)



Një kopje e përsosur e Perëndeshës-Shqiponjë e periudhës historike të lashtësisë është Perëndesha Sellena nga tempulli i Samothrakës.

Kësaj Perëndeshe hënore i kushtohej edhe tempulli i Dodonës. Romakët, që nuk i njihnin mitet e lashta pellazge, e sollën këtë skulpturë në Romë me emrin « Fitore », si simbol të fitores së tyre mbi Gadishullin Ilirik (Ballkanin). Në periudhën e Justinianit, u prodhuan shumë monedha ku pasqyrohet Perëndesha me krahë shqiponje, ku shkruhej: *VICTOIRI* (Fitore).

Me krahët e shqiponjës, kokën apo kthetrat e saj, u veshën në skulpturat e lashta jo vetëm figurat njerëzore, por edhe kafshët, sidomos luani dhe kali. Le të kujtojmë udhëtimin e përvitshëm të Apollonit në tokën e Ipe-borealëve. Karoca e tij tërhiqej nga kuaj me krahë shqiponje apo grifonët (shqiponjë/luanë).



Detaj nga nje objekt arkeologjik kushtuar Perëndisë Marduk, të Babilonisë. (33)

Krahas zhvillimit të shoqërisë njerëzore, që solli zëvendësimin gradual, por jo tërësor, të sistemit matriarkal me atë patriarkal, Perënditë meshkuj (mbret, priftërinj, ligjvënës dhe komandat ushtrie), gjithashtu « u veshën » me petkun e shqiponjës, përfaqësuesit të Krijuesit qiellor (tashmë Zotit-mashkull).



(34) Në fotot lartë janë rradhitur (nga e majta në të djathtë) Perëndia Horos i Egjiptit; i Sumerëve ; Vishnu i budizmit dhe i artit aztek me “kostumin” e shqiponjës.

Kjo galeri e Perëndive-Shqiponja, deshmon qënien e *NJË* besimi zanafillor, atij *PELLAZGJIK*, i cili u përhap në të gjithë kontinentet, për t’iu përshtatur më vonë miteve të reja. Studiuesi Petro Zhei (« *Shqipja dhe Sanskritishtja* ») shprehet se “Mendimi mitik është mendimi i filozofëve dhe feve të lashta dhe ka qenë i njejtë për të gjithë Botën e lashtë dhe të stërlashtë, ashtu sikundër mendimi shkencor është sot i njejtë për të gjithë popujt e Botës, të paktën për pjesën më të madhe”. (35)

V - Kryqi dhe Shqiponja, simbolet para-historike, në Europën kristiane

Kristianizmi , mbas shekujvë të reformimit dhe ndërtimit si një besimi i ri, mbas persekutimeve të Apostujve (përhapësve) dhe përkrahësve të tyre, më së fundi triumfoi, (Perandori Teodosi I-rë me Ediktin e Selanikut {v 380} kishte shpallur kristianizmin si besimin e ri të Shtetit) dhe sot është besimi kryesor në Europë.

Studiuesit vënë në dukje se për ta popullarizuar besimin e ri, në mitet dhe objektet e artit, ay shfrytëzoi simbolet dhe figurat e Perëndive të besimit të lashtë Pellazg. Këtë dukuri na e pohon edhe E.Shnaider : “Në qoftëse shqiptarët , të çdo besimi, e respektojnë me fanatizëm altarin e Kishës së krishtërimit, e bëjnë së ju kanë thënë se altari i flijimit është hyjnor, sepse aty gjëndet një gur i shenjtë që u kujton traditën e adhuruar, betimin më të rëndësishëm e më të shenjtë (betimin mbi gur-shën im) “ (36) Në legjëndat që tregojnë shqiptarët, gurët janë brinjët e Nënës-Tokë nga u krijuan njerëzit.

Në ikonat mesjetare kemi Shënjtoretë meshkuj me krahë shqiponje, që kanë marrë paraqitjen nga Perëndesha Shqiponjë dhe Perënditë hënore të lashtësisë.



(nga e majta) Një ikonë e mesjetës shqiptare ; Mbi një kapak kutije të shk13, shikojmë simbolet e besimit pellazg: shqiponjën, dy grifonë (luan /shqiponjë) dhe një nga shenjtorët më krahë shqiponje. (37) Në qendër ndodhet Krishti me libër në dorë, që shpreh faktin se është besim i mësuar nga libri, në dallim nga ay pellazg, i cili ishte besim *NATYROR* dmth i pashkruar, i përftuar gjatë zhvillimit historik të shoqërisë njerëzore. Vetë simboli kryesor i besimit kristian, Kryqi (dy V të bashkuara në anë të kundërt) është figura gjeometrike më e lashtë që ka shprehur femrën në para-histori dhe më vonë *KRIJUESIN*. Shqiponja dhe Kryqi (dy V), që në artin para-historik shprehnin Perëndeshën Shqiponjë, vazhdojnë të jenë simbolet kryesore të besimit dhe të shoqërisë së Europës së shk 21 e më gjerë.



(nga e majta) Altari në Kishën ortodokse të Kalabrisë, Itali ; Kryqi në gjoks i formuar nga dy V të bashkuar në kulm dhe tre V poshtë, dëshmojnë se kemi një statujë kushtuar femrës. Kultura Kukuteni, mijëvjeçari i V , M.Gimbutas (38)

Përfundimi i tretë: Paraqitja më e lashtë e Perëndeshës Shqiponjë, *ORAKULLIT* të parë me trup njeriu në besimin e Europës së lashtë, që vijon të përdoret edhe në ditët e sotme, ndodhet në xhoken e gruas nga Malsia e Mirditës (Shqipëri). Kjo veshje tregon një mit të mohuar në botimet mbi Historinë e Lashtësisë, megjithëse simbolet e saj janë sunduese edhe sot. Kjo Perëndeshë para-historike mbi veshjen e shqipetarëve, u tregon me gjuhën e saj simbolike, studiuesve të Historisë, se në venat e këtij populli rrjedh gjaku i para-ardhësve të tij *PELLAZG*, krijuesve të “shkencës” së lashtë të *MBIJETESËS: BESIMIT!*

SI U HYJNIZUA «BESA» E ARBËRVE NË TEMPUJT E FARAONËVE

*Besa është shqiptare !
Aristidh Kola*

Në rast se do të donim të veçonim tiparin më thelbësor të karakterit kombëtar të shqiptarëve, të pohuara nga kronikat historike, pershtypjet e udhëtarëve apo të huajve që jeta i lidhi me trevat tona, studiuesit e traditës apo politikanët e Rilindjes sonë, të gjithë do të përputheshin tek emërtimi: Besa !

Për të mos prekur ndjeshmërinë e disa « analistëve » të gatshëm për të akuzuar ndonjë autor shqipetar për « patriotizëm romantik », po sjell vetëm thënien e studiuesit francez Jacques Bourcart(1891-1965), i cili në veprën e tij « *Shqipëria dhe Shqiptarët* » (Paris, 1921) dëshmon se : « Të gjithë udhëtarët që shtegtojnë në Lindje, janë të një mendje kur është rasti për të lëvduar virtytet morale të shqiptarëve si : ndershmërinë e tyre të jashtëzakonshme, besnikërinë e tyre, karakterin e çiltër dhe gazmor, të hedhur e të gjallë dhe sidomos *NDERIMIN FETAR* që kanë për fjalën e dhënë, për *BESËN*. » (1) Fama e shenjtërisë së

besës dhe besnikërisë tek shqipëtarët, ka qenë shumë e njohur edhe në Europën e shk 18, siç dëshmohet në operën « Kështu bëjnë të gjitha » (*Così fan tutte*, Wolfgang Amadeus Mozart, 1790). Me qënëse tema ishte « besnikëria », libretisti Lorenzo da Ponte, të dy protagonistët i paraqet si princa shqiptarë. (2)



Përcaktimi « *nderimin fetar* », që Jacques Bourcart e ka pëdorur si krahasim letrar ndaj fjalës së dhënë, në fakt është një e vërtetë historike që dëshmohet nga materialet e arkeologjisë, te historisë, miteve, gjuhësisë dhe të traditës sonë popullore. Përfshirja në të gjitha këto fusha të një koncepti të vetëm, të « besës », shpreh vlerën e kësaj fjale si një *Simbol kombëtar arbër*.

Përse e përfshij emrin e « besës » në arkeologji ?

Sepse përfaqësues të kësaj fjale shqipe « *BES-a* » janë gjendur në statuja, figurina dhe relieve të madhësive të ndryshme të lashtësisë. Fare rastësisht, duke rrëmuar në shkrimet mbi dinastitë « *thinite* » të Egjiptit (fjalë shqipe-të thinjta, të vjetra), hasa në Perëndinë Bes. Për këtë emërtim nuk jepej asnjë shpjegim, por pershkruheshin « punët » e Perëndisë, për të cilat nderohej jo vetëm nga Faraonët, por edhe banorët e thjeshtë që kujdeseshin të kishin figurina të tij në shtëpitë e tyre. Pra i faleshin të gjitha shtresat e shoqërisë. Falë Tempullit që ndodhej në afërsi të lokalitetit të Denerës, që i përkiste Mbretërisë së Egjiptit të Lartë, pata mundsinë të njihesha me « portretin » e Perëndisë së gjithë-fuqishme, që studiuesit i kanë emërtuar « shamanë ». Para se të flasim se çfarë përfaqëson ky emërtim, le të njihemi me pamjen dhe veprat e Perëndisë Bes.

Në gjuhën e lashtë kopte të egjiptianëve, kjo Perëndi emërtohej – Bës, por nuk i dihet kuptimi dhe sot e kësaj dite nuk sqarohet nga studiuesit emri i tij. Esoteristja e shekullit 19, Helena Blavatsky, një nga njohëset më të mira të miteve, sekreteve të simboleve dhe emërtimeve të lashta, pohonte se kjo Perëndi ishte me origjinë të huaj, pra jo egjiptiane. (3) Natyrshëm lind pyetja : Mos valle Perëndia Bes, i perkiste mitologjisë së hereshme të fiseve “albani” të Alba-Longës (ku gjithashtu janë gjetur skulptura të tij) dhe ka lidhje historike me shqipëtarët e sotëm Albanë, me qënëse e vetmja gjuhë në të cilën emri Besa ka kuptim është gjuha shqipe? Studiuesit, të nisur nga vëndi i zbulimit të skulpturave të Perëndisë Bes (Itali dhe Egjipt) dhe pa marrë parasysh traditën e popujve të hapësirës Mesdhetare, nuk e kanë shtruar asnjëherë hipotezën e origjinës pellazge dhe arbërore të tij, dhe si për shume fakte të Lashtësisë, e kane futur në dosjen e “çështjeve të pazgjidhura”.



Dy skulptura te Perëndise Bes, e para e gjetur ne Gadishullin Italik, e dyta ne Tempullin e Denerës, Egjipt.

Në skulpturën (majtas) paraqitet si një njeri trup-shkurtër, i moshuar, që përfaqëson diturinë. Kjo statujë është zbuluar në rrënojat e një shtëpie, të qytetit të lashtë Alba-Longa në Gadishullin Italik. Emri Alba lidhet me emërtimin Albani të kodrës ku ngrihej ky qytet dhe liqenit me të njejtin emër, në jug-lindje të Romës, i cili në zanafillë ishte koloni e saj.(4) Në foton tjetër (djathtas) skulptura e Perëndise Bes, i perket Tempullit të Denerës, (Egjipt). Edhe këtu paraqitet si një njeri i shkurtër, me një kokë energjike si të luanit dhe me mjekër të dendur. Të bën përshtypje gjuha e nxjerrë dukshëm jashtë, siç pasqyrohen figurat mitike në pikturat e vazove dhe mburojat pellazgo-ilire (fotot poshtë).



(majtas)Vajtimi i Akilit. Vazo nga Korinthi, 560-550 pK, Luver. (5)

Kjo paraqitje në skulpturat apo vizatimet mbi objektet metalike dhe balte, ka një kuptim simbolik që i përket besimit të hershëm pellazg, për të dëshmuar natyrën hyjnore të Perëndive apo Heronjve të mitologjisë. (trajtuar në “*Shqipe-ri, emri parahistorik, në Botën moderne*” F.Demi).

Sipas studiuesve, kjo Perëndi është “importuar” në Gadishullin Italik nga Egjipti .(6) Por Herodoti (484-425 pK), që mbahet si “babai” i Historisë, ka një mendim tjetër. Ai ka shkruar : « Nuk kam sigurisht qëllim të tregoj, gjithë sa dëgjova për hyjnitë e tyre (të egjiptianëve-shën im), përveç emrave të vet, se mendoj që të tërë njerëzit të njejtat (gjëra) besojnë për hyjnitë ».(7) Ky pohim tregon se në të gjithë hapësirën Mesdhetare, në Lashtësi ishte përhapur i njejtë besim, por i përshtatur për vendin dhe kohën kur është adhuruar.

Por, përse Perëndia Bes gëzonte një vend të rëndësishëm, si në tempujt madhështorë, ashtu edhe në çdo shtëpi të banorëve të thjeshtë ? Shpjegimin e gjejmë tek objektet arkeologjike. Në Sardenjë , në rrënojat e Tempullit të “Torre di Chia” (shk VII-VI pK) janë gjendur statuja të Perëndisë Bes dhe pranë tij, ndodheshin shumë figurina të njerëzve, duart e të cilëve tregonin pjesë të ndryshme të trupit. Studiuesit mendojnë se i tregohej Perëndisë, vëndet ku ndjenin dhimbje dhe kërkonin shërim. (8) Për njeriun primitiv , problemi më i rëndësishëm ishte të mbijetonte. Frika e madhe nga vdekja dhe nga vuajtjet që ndjenin në trup, i detyronte njerëzit të kërkonin shpëtimin tek lutjet drejtuar Perëndisë Bes, i cili mbronte shëndetin e tyre. Mjeshtëria e shëruesit shikohej në Lashtësi si shprehje e dhuntisë hyjnore e ardhur nga Zoti, e cila përftohej me mësimet shumë-vjeçare nga Priftërinjt e tempujve. Mbreti, priftërinjtë e ardhshëm apo filozofët, krahas besimit, rriteve dhe “shkencave” të tjera, merrnin njohuri edhe mbi mjekësinë. Edhe Aleksandri i Madh e kishte këtë “profesion” të mësuar nga Aristoteli, i cili ishte edhe vetë mjek. “Leka, për këtë dituri, kish një dëshirë të madhe aq sa ndonjëherë e praktikonte dhe vetë”, pohon Mehdi Frasheri në librin “*Historia e lashtë e Shqipërisë dhe e Shqipëtarëve*” (9)

Fillimisht Perëndia Bes ishte mbrojtëse e Familjes së Faraontit (që ishin mbretër pushtues pellazg), më vonë, këtë detyrë e shtriu edhe mbi çdo familje të Perandorisë. Në luftë me “shpirtrat e këqinj” përdorte, jo vetëm thikën tehë-shkurtër e njohur nga historianët si “thika ilire”, por edhe pamjen e tij prej fytyrë-luani, si dhe veglat muzikore (tamburin, etj). Në Egjipt njihej si mbrojtës i shtëpisë nga syri i keq, i martesës, i lehonave dhe të porsalindurve, prodhimtarisë, i muzikës, i artit etj. Sipas mitologjisë egjiptiane ishte edhe Perëndia e vatrës. Përfshirja e të gjitha këtyre “punëve” tek një Perëndi, dëshmon lashtësinë e saj, siç vërehet në zanafillën e Mitologjisë së Pellazgëve.

Sipas studiuesve, Perëndia Bes ka qënë e pranishme në të gjitha periudhat e besimit të lashtë egjiptian. Deri në periudhën e Faraonit Akhenaton (Dinastia XVIII, viti 1350 pK) është paraqitur me krahë, që mendoj se janë të shqiponjës, sikurse tek të gjitha Perënditë e para, që tregonte përkatësinë e tyre ndaj besimit hënor dodonas, “Sellenizmit”. Perëndesha Sellenë që përfaqësonte Hënën, ishte bijë e Iperos (shqiponjës në dialektin çam) dhe në skulpturat ka gjithëmonë krahë shqiponje (më gjërësisht tek shkrimi “*Rruga e zbulimit të emrit të besimit Pellazg...*” F.Demi).



Paraqitja e Perëndisë Bes në monedha me Kaun, simbolin kultik të Perëndeshës Sellenë (Hënës).

Përse mendoj se Perëndia Bes lidhet me besimin sellenik të Dodonës dhe me arbërit?

Së pari : Nga vetë emri. Deri më sot, studiuesit e huaj nuk e dinë domethënjen e emrit të Perëndisë dhe origjinën e saj. Por ata e lidhin figurën e Perëndisë Bes me një citim në “Librin e të Vdekurve” (CXXXIII), (teksti i shënjtë i faraonëve në udhëtimin e tyre pas vdekjes) ku shkruhet “ Ai nuk ka thënë se ç’farë ka parë, nuk ka përsëritur se ç’farë është thënë në shtëpinë e Zotit me fytyrë të panjohur”.(10) Pra, një njëri që ka bërë betimin, “ka dhënë *BES-ën*” për të mos folur mbi ç’farë di, fjalë që gjëndet vetëm në gjuhën pellazgo-shqipe dhe në asnjë gjuhë tjetër.

Së dyti: Dhënia e besës për të ruajtur të fshehtën hyjnore, e lidh këtë Perëndi me esoterizmin (besim dhe shkencë) e Lashtësisë, ritet e të cilit zhvilloheshin natën , kur “sundonte” Perëndesha Sellenë – Hëna, dhe mbaheshin sekret, pra i perkasin besimit hënor dodonas. Sipas Herodotit orakulli i Dodonës “konsiderohet më i lashti helen (dmth pellazgjik-shën im) dhe në atë kohë ishte edhe i vetmi “ (Herodot II 52) (11)

Së treti: Fakti që Perëndia Bes është mbrojtëse e gjumit, e lidh me ritet e mistereve origjina e të cilave është pellazge. Plutarku (Mestrio Plutarco, viti 46 -120) pohon se “nuk është pa një frymëzim shënjtërie ay që ka thënë, se gjumi është i barabartë me misteret e vogla të vdekjes, sepse gjumi është realisht një *inicim* i parë drejt vdekjes” dhe Plotino (viti 203-270) saktëson “rizgjimi i vërtetë qëndron në zgjimin (e shpirtit) jashtë trupit (pas vdekjes).”(12)

Në Egjiptin e lashtë, esoterizmi dhe shkolla e mistereve, lidhet me figurën e Perëndisë Thot, që e gjejmë që në periudhen para-dinastike të faraoneve. Si Perëndi hënore krahasohet me “diellin e vdekur” (Hënën, e cila mendohej si Dielli i natës).(13) Edhe Perëndia Bes, sikurse të gjitha perëndite e lashta të Egjiptit, i përkiste besimit *HËNOR*.

Sipas miteve pellazge, në fillim ka ekzistuar Errësira dhe Nata dhe më vonë u krijua Dita,

për rrjedhojë, kulti i Hënës ka qënë i pari tek njeriu primitiv. Sipas studiuesit arbëresh Xhuzepe Katapano (*Thoti fliste shqip*), Thoti ishte shpikësi i alfabetit hieroglifik fonetik egjiptian, mbi bazën e gjuhës pellazo-shqipe dhe i përkiste kombit arbër (14) Vetë emri i tij, shpjegohet vetëm në shqip, dmth: “ai që na thotë...” dhe në besimin egjiptian përfaqësonte Hënën. Pra, besimi hënor i Dodonës-*Sellenizmi*, jo vetëm që është më i lashtë se besimi egjiptian, por ky i fundit është një shprehje e zhvillimit të tij, nga një besim hënor (më sakt, i Dritës hënore) drejt një besimi diellor (i Dritës diellore) i përcjellë në Egjipt nga mbretër prifterinj dhe dijetarë pellazgë që sunduan aty.

“Iliria historike -shprehet Xh.Katapano- është degëzimi i fundit i rrymës tepër të madhe boreo-ilirike”, që zhvilloi në një shkallë të lartë shkencën, artin, filozofinë dhe esoterizmin, veçanrisht në Itali dhe Egjipt “ prej ku Thoti ka përhapur në të gjithë botën dritën e Dijes”. (15) Duhet të mos harojmë, se Afrika Veriore bënte pjesë në “Europën Pellazgjike” dhe është sunduar për një kohë të gjatë nga mbretër të huaj. Pra kemi të bëjmë me një besim të popujve iliro-pellazg, të cilëve u përkiste edhe Perëndia Bes, siç e dëshmojnë jo vetëm emri, por edhe simbolet shoqëruese të tij. Perëndinë Bes, (ndoshta ishte vetë Thoti) në mënyrë figurative mund ta shikojmë si ruajtësin e “mbretërisë së Dijes”. Dija, si në lashtësi edhe sot, është “arma” e *mirqënies* dhe e *mbrojtjes*.

Së katërti: Perëndia Bes përfaqësonte “Fjalën e dhënë” dhe tek arbërit ajo ishte e shenjtë, gjë që nuk vërehet tek popullsitë e tjera. Në botkuptimin e Kombit tonë, *BES-a* përfshin vetë thelbin e të qënës njeri dhe shpreh një *detyrim* ndaj të tjerëve, për çështje nga më të ndryshme. Siç vëren historiani i besimeve Bernard Cook, tek shqiptarët :“Bes-a (sinonim i nderit) zë vëndin e parë në kodin e sjelljes së njeriut dhe marrëdhëniet shoqërore”. (16)

Ata që në karakterin e tyre janë mbrauajtur me *BES-ën*, u japin të tjerëve sigurinë për mbrojtjen e jetës së tyre dhe familjes, realizimin e qëllimeve dhe nismave të ndryshme, shprehin bashkëpunimin dhe frymëzojnë optimizmin në përballimin e çdo vështirësie në jetë. Pikërisht këtë detyrë “fetare” kryente edhe Perëndia Bes në Egjipt, u krijonte njerëzve ndjenjën e *sigurisë*, *mbrojtjes* dhe të *optimizmit*.

Francezi J.Boucart vëren se: “Fjala « besë » më tepër do të thotë “mbrojtje e betuar”. Por duke qënë një fjalë thellësisht shqiptare, është shumë e vështirë të përkthehet. Besa është njëherazi e vërteta, burrërija, mbrojtja, betimi, besnikëria ndaj zbatimit të një marrëveshjeje ose detyrimi...Kjo fjalë ka edhe kuptime të tjera. Për ne udhëtarët, Shqipëria na del në pah pikërisht sipas një kuptimi të besës: besa është feja e mikpritjes...mikpritja shqiptare i jep të huajit tipare të shenjtë” (17)

Aq e plot-fuqishme ishte forca e fjalës së dhënë tek Iliro- Iperiotët (epirotët), sa edhe traktatet midis mbretërive bazoheshin mbi të. Mbreti i Mollosëve Pirro, kur nënshkroi me maqedonasit traktatin e paqes me be, therri tri fli: një cjamin, një dash dhe një dem. (18) Pra “besa” ishte e shenjtë dhe i bëheshin flijime si një Perëndije. Kjo dëshmohet edhe nga mitet pellazge, ku Zeusi cilësohet si mbrojtësi i shënjtërisë së fjalës së dhënë. Shkelësi i saj në

Lashtësi, dënohej me turpërim publik.(19) Edhe me ardhjen e kristianizmit, roli i “Bes-ës” ishte qëndror në jetën e përditshme, Perëndia e lashtë mori emrin San Besso (Shën Bes-i). (20) dhe çdo vendim i rëndësishëm e jetik, në të gjithë hapsirën e etnisë iliro-romake, merrej mbi bazën e “be-sës”. Historikisht, të gjitha marrëveshjet midis arbërve emërtoheshin “*BES-LIDHJE*”.

Në trevat arbërore, sot na kanë mbritur gjashtë Kanune (“Kanun’i vjetër”, “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, “Kanuni i Çermenikës”, “Kanuni i Papa Zhulit”, “Kanuni i Labërisë” dhe “Kanuni i Skënderbeut” ose ndryshe “Kanuni i Arbërisë”) dhe të gjitha kanë në themel *BES-ën*. Rolin e saj qëndror në jetën e arbërve, e gjejmë të shprehur qartazi: “Beja lën gjak e varrë/Beja lën tokë e kufi, gjà e çdo gjà” dhe bëhej mbi kokën e fëmijeve, mbi bukën e kripën, mbi zjarrin e vatrës, me një gur në krah dhe mbi varrin e të parrëve. (kreu V, Betarët “Kanuni i Lek Dukagjinit”,variantii Pukes.)(21)

Të gjitha këto “rite” të bërjes së Be-së, shprehin lidhjen e botës arbërore, me Mitet e Lashta dhe besimin e periudhës më të herëshme të shoqërisë njerëzore. Ata që e shkelnin “besen” (fjalën e shenjte), sipas Kanunit, humbnin pasurinë, por edhe shpirtin e nderin në katund e fis. “Burr, ma kush s’ë njuh” (kreu X, neni 236 Kanuni i Lek Dukagjinit ,varianti i Pukës).

Mbajtja e fjalës, historikisht është ushqyer që me gjirin e nënave arbëreshe dhe ishte tipari me të cilin të huajt i dallonin shqiptarët nga popujt e tjerë ballkanik dhe europianë. Edhe në ditët e sotme dhënia e “besës”, si shumë elemente të tjera të trashëgimisë pellazge, vijon të praktikohet në betimin e Presidentëve, të qeveritarëve dhe në gjukata, por pa shënjtërinë e saj që kishte në lashtësi.


Besa, tipar kryesor i njerezve te veprimit per Kombin

Në figurë e mëposhtme paraqitet një kapëse, ku Perëndia Bes shtrëngon prej brirësh dy dhi dhe sipër kemi dy mjelma. Këto janë simbolet e Zeusit thesprut e dodonas, që i gjejmë tek përkrenarja (dhinë) dhe vula sekrete e Skënderbeut (mjelmat).(22) Ky kompozim në kapëse, ka një kuptim simbolik besimtar, qe do të trajtohet ne shkrimet e tjera.



Në kuptimin e saj filozofik, kjo paraqitje e Perëndisë Bes, ka për bazë, “forcën shpirtërore” (në kuptimin besimtar-hyjnore), kodin më të rëndësishëm të Jetës, që mësohej në shkollën e mistereve egjiptiane të Thotit, të shprehur nga kompozitori i madh Ludwig van Beethoven (1770-1827), i cili qe gjithashtu njohës i esoterizmit: “Jam përherë në gjëndje të kap fatin prej brirësh e ta sundoj atë sipas dëshirës, me fuqinë e vullnetit”. (23)

Xhuzepe Katapano e qartëson domethenien e kësaj shprehje: “Do të ndalem në këtë aspekt të veçantë të doktrinës së Thotit, pasi e gjykoj si të rëndësishëm, themelor në formimin e njeriut të fortë (e përdor këtë cilësor në kuptimin *i plotë*, jo i mangët), si të domosdoshëm për ta inicuar, (mësuar-shen im) që fëmijë, gradualisht, jo vetëm në gjimnastikën fizike - për t’i dhënë forcë dhe harmoni trupit, por edhe në atë të intelektit dhe të vullnetit (të këtij mbi të gjitha) – për ta bërë njeri të vetëdijshëm, me moral dhe të pushtetshëm: të përgatitur, të kalitur, të gatshëm për tu përfshirë në shoqëri si element i vlefshëm (pra i domosdoshëm dhe i dobishëm); të aftë, sepse të paisur me “energjinë” e nevojshme për të prodhuar, me ndjenjën më të lartë të përgjegjësisë, të mira dhe pasuri, në kuptimin më të gjerë dhe tepër fisnik të fjalës.” (24) Ky shtjellim i Xh.Katapanos, tregon rrugën e hyjnzimit të njerëzve, sipas moralit të besimit pellazg që mësohej në shkollën e mistereve të Thotit. Në shk e 15-të vijues i kësaj filozofije mbi jetën dhe i besimit të lashtë, u bë një figurë e shquar e Rilindjes europiane, arbëreshi Gjergj Xhemisto Pletone (1355-1452), i cili në qytetin e Mistrës (Sparta e lashtë, Peloponez), sikurse Thoti, themeloi shkollën fetare të mistereve, të vetmen në atë kohë, ku mësohej filozofia dhe gjithë dituritë e lashtësisë. Ky erudit-patriot, në bisedat, mesimet dhe shkrimet e tij drejtuar Perandorëve bizantinë Paleologë dhe bashkombësve të tij, u bënte thirrje për përkushtim ndaj vendit dhe popullit të tyre, sepse: “kur privati ndahet nga interesi i përgjithshëm, që të dy humbasin” (shoqëria dhe individi-shën im) (25)



(nga e majta) Perëndia pellazge Thot, mësues dhe ruajtës i Dijes në Egjiptin e lashtë; Portreti i Xhemisto Pletone, filozof arbër dhe mësues i shkencës dhe filozofisë së lashtë, shk15 dhe Sami Frashëri, filozof i shquar dhe hartues i librave të para shkollore të shqiptarëve, shk 19-20.

Të njëjtën rrugë ndoqën edhe figurat e shquara të Rilindjes si Sami Frashërit (1850-1904) dhe Naim Frashëri (1846-1900), njohës të filozofisë besimtare të lashtësisë, si dhe shumë etër fetarë ortodoks, katolik apo mysliman, që ju përkushtuan Kombit shqiptar. Këtë përkujdesje mbarë-popullore, në kohën faraonike dhe romake e përfaqësonte Perëndia Bes.

Si përfundim: Emri “*BESA*” apo “Fjala e dhënë” është një dukuri e besimit tek shqipëtar-arbërit me rrënjë që nga lashtësia e herëshme (dhe jo nga Mesjeta, siç shkruhet sot) dhe është përfaqësuar nga Perëndia Bes. Sikurse në lashtësi, mbajtja e *BESËS* ka qënë *E SHENJTË* për shqipëtarët, siç është dëshmuar në të gjitha shkrimet e të huajve deri në shk 19. Mbreti apo Prifti tokësor, i etnisë pellazge të cilët sunduan në të gjithë hapësirën Euro-Afro-Aziateke, që u hyjnizua tek kjo perëndi, ka bërë vepra heroike dhe ka sjellë begati për popullin e tij, duke përcjellë mesazhin hyjnor të besnikërisë dhe të përkushtimit ndaj Racës së vet.

BESIMI HËNOR DËSHMI E AUTOKTONISË SË KOMBIT ARBËR

Zgjidhja më e keqe, qëndron pikërisht në fshehjen e historisë pas një strukture të ngritur tashmë, ku ajo bëhet objekt dhe mohohet si vlerë.

Emmanuel Mounier

Po të pyesim shqiptarët e shekullit të 21, se ku ndodhet krahina e Manit, duke patur parasysh historinë e famëshme të saj, nuk do të mundin të na përgjigjen. Kjo për faktin, se në tekstet e Historisë nuk ekziston një emërtim i tillë. Siç duket vendimet politike të 1913 mbi Ballkanin dhe veprimet ushtarake që i ndoqën, ndanë jo vetëm territorin dhe popullsinë, por edhe historinë e Shqiptarëve. Historia e vërtetë e krahinës së Manit, pjesë e Akaisë dhe Moresë së më vonëshme, krahas asaj të Dardanisë (Kosovë-Sërbi-Maqedoni) Thrakisë (Bullgari-Greqi-Turqi), Thesprotisë dodonase (Greqi) dhe krahinave të tjera, sot është fshirë ose tjetërsuar, jo vetëm në literaturën historike europiane por edhe atë shqiptare. Bëhet fjalë për një hapësirë kohore që zë fill nga para-historia e deri në ditët tona. I vetmi fill, që lidh sot shqiptarët me këtë krahinë, është kënga e famëshme “Moj e bukura More”, e arbëreshëve shqiptarë të mërguar në Itali në shk15.



Mani në hartën e sotme administrative (Greqi).

Historia e Manit është simotra e historisë së iliro-shqiptarëve, jo vetëm për rrënjët e saj mijërvjeçare në kohë dhe të popullsisë së saj autoktone pellazgo-arbërore, por edhe për tiparet dhe karakteristikat e saj luftarake. As Filipi i V-të i Maqedonisë (238-179 pK) dhe as romaket që nënshtruan të gjithë Peloponesin, nuk mundën ta pushtojnë këtë krahinë malore.(1) Mani dhe banorët e saj manjotë, gëzuan autonomi administrative pothuajse në të gjitha kohërat, fakt që dëshmohet edhe për zonat e tjera malore shqiptare. Studiuesi Veis Sejko pohon se “Bëjnë plot 2065 vjet pavarasi administrative, ushtarake dhe ekonomike e Malësisë shqiptare e cila gjatë kësaj kohe ka krijuar një kulturë të pastër kombëtare me të cilën ne mund të krenohemi”.(2) Në Areopol, kryeqyteti i lashtë i Manit, emri i të cilit i kushtohet Perëndisë së luftes-Ares, Petrobej Mavromihali më 17 mars 1821, ndezi i pari luftën për pavarasi kundër Perandorisë Osmane, (3) që u kurorëzua me ngritjen e shtetit të parë të pavarur në Ballkan, ay i shqiptarëve (1821-1834) i tjetërsuar nga aleanca ortodokso-anglo-ruso- franko-prusiane, në shtetin helen të Helladës (Greqi). Homeri ishte i pari, që i përmënd qytetet e krahinës së Manit në Librin e dytë të Iliadës. Mitet gjithashtu na kujtojnë se Paridi, princi i Trojës, mbasi e rrëmbeu Helenën, gruan e Menelaut, e kaloi natën e parë pikërisht në ishullin Cranae të krahinës së Manit. (4) Gjashtë kilometra larg qytet-shtetit të Spartës (në Man), në qytetin e Mistrës, e ngrysi jetën e tij eruditi arbër Gjergj Xhemisto Pletone (1355-1452), një nga figurat më të shquara të Rilindjes Europiane. Napoleon Bonaparti, bir i një familje të emigruar nga kjo krahinë, sikurse edhe të parët e familjes së shquar Medici, ju drejtohej banorëve të Manit si “pasardhës të Spartës”. Edhe udheheqësi arbër i luftës së 1821, Theodor Kolokotroni, i quante bashkë-kombasit e tij manjote “spartanë”.(5) Ky emërtim nuk qe një përvetësim i emrit, prej lavdisë që gëzonin banorët e shtetit të Spartës, siç ka ndodhur rëndom me fiset aziatike të ardhur në Europë.

Por rrjedhojë e njohjes së origjinës së tyre, traditave kulturore, zakonore dhe të besimit të njejtë të maniotëve të shekujve modernë, me ato të spartanëve të lashtë. Një dëshmi e autoktonisë së arbërve, në jugun e Gadishullit është edhe vetë emërtimi “Mani” i krahinës, që e ka burimin tek emri i Hënës dhe besimin hënor (*sellenizmi*) dodonas dhe përbën objektin e këtij shkrimi.

Po ç’lidhje ka emërtimi i krahinës “Mani” me emrin e Hënës?

Fillimisht kjo lidhje ishte një hamëndesim, i mbështetur nga fakti se besimi dodonas ishte hënor dhe emërtimin “mani” apo forma të rrjedhura nga kjo rrënjë e Hënës, gjëndeshin në vëndet e tjera. Me sa di, emri “Mani” apo i përafërt me të për Henën, nuk njihet në fjalorin shqipëtar të sotëm. Antropologu William Smith (1846-1894) në veprën e tij “*A Dictionary of Greek and Roman biography and mythology*” pohon, se “Mene” ishte një nga emrat e Hyjneshës hënore Sellena e Dodonës.⁽⁶⁾ Edhe në mitologjinë romake gjejmë perëndeshën Mena të cilën Plinio (Plinio 29, c.4) dhe profeti biblik Isaia (650 pk, Isaia C.67 v.11) e pohojnë si hyjneshë të Hënës.⁽⁷⁾ W.Smith gjithashtu sjell një dëshmi të Stephanus Byzantinus (s. v. Μάσταρα), se Hyjnesha Rea, nga Lidjanët emërtohes “Ma” dhe i sakrifkoheshin demat, simbol kultik i Hënës. (Comp. Welcker, Trilog. p. 167.)⁽⁸⁾ Por edhe i biri i Reas, Zeusi/Giove romak, ndër emrat e shumtë të tij ishin Maius dhe Sum-manus.⁽⁹⁾

Për t’u bindur dhe gjetur formën zanafillore të këtij emri, do të duhet të kërkojmë emërtimin “Man” të Hënës, në fjalorin dhe mitologjinë e hapësirës “Euro-Afro-Aziatike”, ku u përhapën fiset pellazge. Kjo metodë krahasuese gjuhësore dhe e besimeve, plotëson boshllëkun në studimet e Lashtësisë, e krijuar nga mungesa e dëshmive për arsye natyrore apo njerëzore. Historiani i lashtësisë, Franz Altheim (1898-1976) më 1939 shkruante: “Ne duhet të mësohemi të mendojmë jo mbi një kulturë, por mbi kulturat, perandoritë dhe hapësira të medha”. Kërkimi përfshiu emërtime: në fushën e besimit, mitologjisë, riteve, dukurive shoqërore historike e shkencore, të toponimeve etj, që njeriu primitiv dhe ay modern, i ka lidhur me besimin hënor dhe Hënën, që kanë emrin apo rrënjën e emrit të saj. Kjo rrugë ka vështiresinë e saj, sepse siç vëren studiuesi Niko Stillo: “Etimologjia e shumë emrave pellazgjike nga grafia e tyre greke apo latine, nuk është kurdoherë e saktë, sepse të dyja këto gjuhë, shumë nga emrat e lashtë i kanë fallcifikuar gjatë transkriptimit të tyre.”⁽¹⁰⁾ Në këtë material do të pasqyrohen vetëm disa prej tyre. Në gjermanishten e lashtë të veriut, Hëna emërtohej “Man” dhe në folklorin e gjerman-folësve të Belgjikës emërtohet “Mana”.⁽¹¹⁾

Në mitin e popujve gjermanik të Skandinavisë, Hënën-Mana, çdo natë e ndiqte ujku “Hati” për ta ngrënë. Rrënja e emrit “Ha-ti” dëshmon kuptimin edhe të emrit të Hënës në shqip: “Ha-na”, dmth atë që “e hanë”, kur çfaqej e përgjysmuar apo zhdukej nga qielli i natës. Në Shqipëri, kur zihej Hëna mendonin se e hante Lugati apo Lubia dhe qëllonin me pushkë në drejtim të tij. (*Fjalori i Mitologjisë dhe Demonologjisë Shqiptare.*)



Studiuesi Massimiliano Franci në librin “Astronomia e Egjiptit” pohon se: “Vëzhgimi i Hënës i pasuroi egjiptianët me mjetin e parë për matjen e kohës, të gjatësisë së vitit, të muajve dhe ndarjen e tyre në javë”. (12) Hëna i dha emrin e saj: njesisë matëse “unë mas”, muajit, si dhe ditës së parë të javës. Këtë e vërejmë në gjuhë të ndryshme : [hëna-muajidita e parë e javës] në gjuhën angleze “moon- month-monday”,suedeze “moon- manad-mandag”, gjermane “monat-mond-montag”, persiane “mâh-mâh”(hëna dhe muaji),etj. Ky fakt dëshmohet edhe tek popujt që erdhën në shkVII-XI në Europën lindore dhe Gadishullin Ilirik, që sot quhen “sllavë”. Ashtu sikurse morrën prej Ilirëve mënyrën e administrimit, njohuri bujqësore dhe mjeshtëri të ndryshme, morrën edhe besimin dhe emërtimet. Në sllavishten e vjetër (gjuha e vjetër kishtare), muaji dhe Hëna kanë të njetin emër “mésjac”, që përdoret edhe sot nga rusët, ukrainasit, maqedonasit, kroatët etj. Me pushtimin romak hyri në përdorim emri “luna”, ndërkohë që rrënja apo emri i Hënës tek emri i muajit, ka mbetur i pandryshuar. Siç vihet re, rrënjët e emrave të Hënës janë “ma/me/mo/mi”etj. Dihet se, fillimisht njeriu përdori vetëm bashtinglloret dhe në rastin tonë ajo është “m”.

Për formën “mana” te emrit të Hënës, na dëshmojnë emërtimet në gjuhën e vjetër gjermane të veriut “man”; në gjermanishten e sotme “mond”; daneze “manen” (13) Sipas studiuesve, emri “man” në gjuhën e vjetër gjermane, angleze dhe skandinave, e ka origjinën nga gërma “m” e alfabetit të lashtë grek (pellazg-shën im). (14) Me fillimin e përdorimit të zanoreve, rrënja zanaflore, mendoj se ka qenë “ma”, ndërsa rrenjët e tjera janë rrjedhojë e shqiptimeve të ndryshme të germës “m”, nga kalimi i kohës, dialektore apo nga emërtimet pellazgjike të folura prej popujve të mëvonshëm të racës jopellazge. Rrënja zanaflore dëshmohet edhe nga emërtimet një rrokëshe të lashta: “**mal**”, “**mama**”, “**mas**”, etj, që janë të rrjedhura nga rrenja “**ma**” e Hënës, siç do ta shikojmë më poshtë. Dëshmi është edhe emri i Amazonave në mite, për të cilin studiuesi Arif Mati pohon se “ sipas një burimi armen, ky emër do të ketë nënkuptuar “gra të hënës” (15) Këtë e dëshmon edhe lidhja e tyre me Perëndeshën Artemide, një nga përfaqesueset e Hënës në mite. (*Enciclopedia Italiana* ,1929)

Ndjenja e parë që e ka zotëruar njeriun pre-historik ka qenë frika, e cila ishte një formë instiktive e mbrojtjes, shmangies së rrezikut dhe mundësisë për të jetuar. “Frika është

ndjenja më e lashtë e botës”, shprehet studiuesi Massimiliano Franci (16) Kjo ndjenjë është e përbashkët me botën shtazore. Tek shqipetarët ka mbetur shprehja “frika ruan vreshtat”, duke treguar elementin mbrojtës të saj. Besimi lindi si nevoje për t’u mbrojtur. Në hapat e para të njeriut, dukuritë kryesore të natyrës emërtoheshin krahas thurrjes së miteve për to, për t’i kuptuar dhe shpjeguar ato. Rrënja “ha” e Hënës (Hana), e sipër-përmendur, mendoj se shpreh perudhën kur mitet akoma nuk përfshinin hyjnite në formën njerëzore. Kjo periudhë i përket besimit natyror (pa tempuj) pranë lisit në Dodone, apo të drurëve të pyllit, tek besimi “druid”(nga “dru” në shqip) i galo-keltëve. Toponime me emrin “hana” gjenden në një hapësirë të gjerë gjeografike, si në Amerikë, ishullin Hawaii, Etiopi, Iran, Çeki, Norvegji dhe “hanna” në Iran, Pakistan, Poloni, Kanada, dhe 12 qytete në shtetet amerikane, (17) dhe është origjina e emrit të njeriut Ana, aq të përhapur sot në botë.

Në kohën e çfaqjes së tempullit pellazgjik-Dodonë, i cili i kushtohej kultit të Hënës, në fronin e tij që ulur hyjnesha Dione, e cila nderohej edhe nga romaket e Asirët e lashtë. Kjo hyjneshe ishte njëkohësisht edhe Hyjnesha Mëmë (Dea Madre). (18) Rrënja “di” që shpreh dritën dhe dijen në gjuhën shqipe (në mite-Diona) është trashëguar si emër i Krijuesit edhe në besimin e sotëm të krishterë: *Di-o*. Studiuesi G.Dumezil, duke marrë të gjitha gjuhët e reja dhe të vjetra, pohon se emri “dio”, e ka origjinën nga gjuhët indo-iranike, nga ajo vedike në formën « deva ». Ky fakt, sipas studiuesit, dëshmon plotësisht ndikimin e gjuhës së popujve “indo-europian”. Gjuha pellazgo-shqipe dhe besimi hënor, e përgënjeshtrojnë këtë teze të shkencës historike botërore, sepse në fjalorin e saj gjëndet shpjegimi zanafillor i fjalës “Dio” nga “di” (di-une di dhe di- agoi,u be drite,dialekti çam) dhe gërma “ i ”, për besimin e pellazgëve, përfaqësonte *FJALËN KRIJUESE*(Zotin) . (19) Emri Diona, nga studiuesit mendohet si bashkë-kohëse me të hyjneshës Sellena (Mene) që përfaqësonte kultin e Hënës (sepse “**di**” = “**mend**”). Megjithatë, unë mendoj se forma zanafillore ka qenë “ma” dhe jo “me”, sepse në sanskritishten e lashtë, emri “**manas**” [man-as] do të thotë, mëndje.(20) Këtu shikojmë po atë kalim, të një “a” hundore në “e” si tek hana-hena. Si zotëruese e misterit “të krijimit” të racës njerëzore, femra shikohej e ngjashme me Hënën “mëmë” dhe Tokën, që krijonte bimësinë. Në gjuhën e sumerëve të Mesopotamisë (3000pK) emri “Ma” do të thotë “tokë” (21).




Tempulli i Dodonës dhe (djathtas) Hëna mbi kokën e Sellenes.

Rrënjën “ma” e gjejmë edhe në fjalorin sanskrit për tokën - “**mahati**”. (22) Këtë botkuptim, e shprehin shumë skulptura të femrave në lashtësi që tregojnë gjirin, si dhe emri “Ma” i Reas, nënës së Zeusit apo Cibelës, kulti i së cilës ishte më i rëndësishmi në të gjithë Lindjen e Afërme.



(majtas) Rea-Perëndeshë hënore, që dëshmohet nga kau pranë figurave të saj, simbol kultik i Hënës; Simboli i Hënës/Sellena, mbi një objekt varri. (23) Homeri tek Iliada e përshkruan Selenën, me sy dhe brirë kau dhe i drejtohet: “ mëma universale”. Robert Graves pohon, se në tërë Mesdheun dhe Europën qendrore, Hëna trajtohej si « mëma » e të gjitha gjerave, si dhe e të gjitha Perëndive, zonjë e Jetës dhe e Vdekjes. (24)

Në gjuhën shqipe kemi emërtimin « mëmë-dhe » (“at-dhe” i përket periudhës së vonë, të patriarkalizmit) dhe shpreh simbolikisht, besimin e pellazgëve se ishin “të lindur nga dheu”. Zbulimi i parë “shkencor” i njeriut para-historik, ka qenë ndryshimi i Hënës : rritja e formës së hënes-hëna e plotë-zvogëlimi i formës së hënës. Këto tre faza të Hënës që përsëriteshin ritmikisht, ndiqte edhe jeta e njeriut (lindja-maturim-plakja) si dhe bota bimore e shtazore në natyrë. Pikërisht ky “zbulim” u bë shkas i krijimit të besimit hënor dhe të zbulimeve të rëndësishme praktike të mëvonshme, si matja e kohës, numërimi, përdorimi i baticave të ujit, etj.



Arkeologu Alexander Marshack (1918-2004) ka zbuluar në artin e njeriut të periudhës magdaleniane (para 13.000 vjetëve) forma të drapërit - hënë dhe tre rrathëve që vijnë duke u zmadhuar, që lidhen me 3 fazat hënore. (25) Në një papir të gadishullit pellazgjik, gjejmë shprehjen “tre fytyrat e Sellenës” (26). Në mitologjinë e mëvonëshme të Euro-Afro-Azisë, do të gjejmë shpesh grupin prej tre perëndish (Hekate, Persefoni, Sellena, tre Karite, tre Moirat, tre Erinat, etj) Karl Jang vëren se kjo lidhje në grup tresh, është shfaqur që herët në lashtësi dhe përbën, modelin e parë në historinë e besimit, dhe të Trinitit kristiane. (C. G. Jung. “*A Psychological Approach to the Dogma of the Trinity*”) (27) Mirëza Eliade pohon, se koha e ndimit të fazave hënore është përdorur nga njeriu primitiv afro 15 mijë vjet para njohjes së bujqësisë dhe është e kuptueshme rëndësia e Hënës në mitologjinë e herëshme dhe sidomos përfshirja në “sistemin” e simbolit hënor, të dukurive nga më të ndryshme si: gruaja, uji, bimësia, gjarpëri, vdekja, ri-ngjallja, etj (28)

Perfundimi i parë: Të gjitha veprimet apo dukuritë njerëzore dhe të natyrës, që lidheshin me Hënë, trashëgonin prej saj rrënjën zanafillore “m/ma” apo emrin e saj, me variantet e mëvonëshme të zanoreve: “e,o,i,u”. Shëmbull, siç e përmendëm më lart, kemi emërtimin e njejtë të Hënës-muajit-ditës së parë të javës. Në gjuhën shqipe kemi “Hëna-e hënë” por ka mbetur emërtimi “muaji”, që tregon qënien e emrit kultik “man-a” të Hënës edhe në gjuhën shqipe.

Hëna në besimin pellazg

Mitologjia pellazge, ka krijuar figura madhore të hyjneshave hënore të lidhura me natyrën: me pyllin, kafshët dhe gjuetinë, ujin, peshqit dhe lundrimin, tokën dhe malet etj. Më e shquara ndër të cilat, sot njihet hyjnesha Artemisi (në mite përfaqëson Hënë e re). Tempulli më i lashtë i njohur deri më sot kushtuar asaj ndodhet në Apolloni (Shqipëri) ndërtuar rreth vitit 525 pK. (29) Një tempull tjetër madhështor i Artemisit ngrihej në Spartën e krahinës së Manit, fakt që dëshmon për banorë që praktikonin të njejtat kulte. Sipas Enciklopedisë Treçani, Artemisi që themeluesja e shoqërisë së Amazonave (murgeshave hënore) dhe në paraqitjet e herëshme ishte me krahë. (30)

Me një emër të afërt - Artume- në mitologjinë etruske emërtohet Perëndesha e hënës, natës, e vdekjes dhe rritjes së natyrës. Ndërsa Perëndesha **Mania** së bashku me të shoqin, **Manthus**, ishin ruajtësit e botës së përtejme, nga e ka origjinën edhe emri i qytetit Mantova

në Itali. (31) Artemisi në gadishullin Pellazgjik, fillimisht qe adhuruar si hyjnia Mëmë (Dea Madre)(32) sikurse edhe ajo etruske -**Mater Matuta**- festën e së cilës romaket e festonin më 11 qershor (“matralia”).

Gjuhëtari francez George Dumezil (1898 –1986) e barazon me Aurorën (dritën e mëngjezit-lat. matutinus) dhe e lidh me emërtimet: “Maturus, Matuta, matutinus, manus (manis), manes, **mane**” (33) Në traditën popullore shqiptare është e njohur edhe hyjnesha e natyrës-Thana apo Zana sipas E. Çabeit, që mund të hamendsohet si një emërtim i ardhur nga “hana”. Sipas studiuesit Moikom Zeqo, hyjnesha Thana (*Thalana, Thana, Thalne*) kishte po ato attribute si hyjnesha hënore Artemisi. (34)



Tatuazh (foto majtas) i përdorur nga gratë dhe vajzat e krahinës së Zadrimës, sipas mendimit tim, shpreh Hënën në dy pamjet e saj: të dukshme dhe të padukshme, ose dy fazat kryesore: Hëna e plotë rrezatuese dhe Hëna që nuk shihet, apo « e zezë » siç njihet në praktikën e mistereve (esoterike), të heshtjes, të forcave magjike dhe të botës së të vdekurve. Paraqitja e rolit të dyfishtë të Hënës, në traditën popullore (« të mirë » dhe « të keqe ») është me rrenjë mijëra-vjeçare. (35)

Hëna paraqitet si hyjneshtë e *JETËS* në periudhën e solsticit të dimrit dhe e *VDEKJES* në kohën e solsticit të verës. (36) Çfaqja e Hënës në qiell me tre forma të ndryshme, krijoi një sërë mitesh dhe bestytnish, që shprehnin tre periudhat kohore të njeriut : jetën, vdekjen-botën e përtejme dhe ringjalljen. Zakonisht në ritet e vdekjes, lidhja me Hënën shprehej nëpërmjet numrit 3. Në librin e tij “*Pikëpamje fetare, doket dhe zakonet e Malcisë së Madhe*”, Franc Nopça na dëshmon se : “Në Malcinë e Madhe dhe të Vogël ,para se ta nxjerrin të vdekurin nga shtëpia, e ngrenë dhe e ulin qivurin tri herë. (37)

Kur e nxjerrin të vdekurin nga shtëpia mbartësi i parë i qivurit pret tre dhëmbë te trari që mban derën. Gërmimi i varrit e fillon punëtori më i vjetër , pasi ka bërë tre dhëmbë në bishtin e kazmës ose lopatës. Ditën e tretë mbas varrimit, të njohurit e të vdekurit vizitojnë varrin e tij dhe qajnë e ulurisin mbi varr, ndërkaq shtrohen dhe hanë.(38)

Ky numër - 3, që ndiqet me përpikmëri në rastet e vdekjes, është ligjëruar edhe në Kanun: “Asht me ba gjamë mbi të dekunin tri herësh, tuj përsritun fjalën- i mjeri un”!

Lidhja zanafillore e numrit 3 me Hënën, me kohë u harrua, por ritet dhe kultet e besimit pellazgjik, vijuan të kryheshin deri në ditët e sotme. Siç pohon Georges Dumezil, “Në kohën e romakëve , veprimet tradicionale të kulteve ndiqeshin me përpikmëri edhe kur nuk do t’i kuptonin më”. (39)

Të gjitha perënditë e para dhe më të rëndësishme në mitologji, ishin hënore (paraqiteshin me krahë të shqiponjës, sepse Hëna ishte bijë e Ipe-ros=Shqipes) dhe trashëgonin, sikurse edhe ajo, lidhje të dyfishta dmth me qiellin dhe tokë/nëntokën.

Nga studimi i formës së ndërtimit të varreve del, se në lashtësi, nuk kuptohej dukuria natyrore e vdekjes. Mendohej se, sikurse Hëna dhe bimësia në tokë, rishfaqeshin pafundësisht edhe i vdekuri “do të rilindte”. Prandaj Pellazget ia kthenin trupin “mëmës Tokë”(Dhemitrës) që “ta lindëte” përsëri. Këtë e dëshmojnë varret në formën e mitrës së gruas me një dalje të zgjatur. Studiuesi Reichel-Dolmatoff, përshkruan “ritin e vdekjes” (më 1966), gjatë një varrimi tek indianët e fisit Kogi (Columbi). Mbase zgjodhi vëndin, « shtëpine e vdekjes » magjistari i mbiquajtur “mama”, shqipton: « Këtu është mitra » dhe futin trupin mbrënda. (40) Në Sardenjën pellazgjike, janë zbuluar afro 321 varreza të përbashkëta fisnore, që i përkasin qytetritit nuragjik, (2000 vjet pK deri në shekullin e dytë), ku planimetria e brëndëshme kishte zgjatimin për “ri-lindjen” e të vdekurve. Ato janë emërtuar nga banorët “varre të gjigandëve”.



(majtas) “varri i gjigandëve” (Siçili) (41) Në planimetrinë e brëndëshme të varrit në Mana-Kerioned (Francë) vihet re ndërtimi me gurë në formën e mitrës me një zgjatim për dalje, « ri-lindjen ».(42)

Krahina mban të njejtin emër “Man-e”, si “Man-i” i gadishullin Peloponez.

Studiuesja e besimit druid, Emma Restall Orr, shprehet se, paraqitje të figurave që dëshmojnë numrin 3 shprehin

“lëvizjen e shpirtit” dhe se “kjo energji shpirtërore është thelbi i jetës”.(43)



Figurë që shpreh numrin 3 (Triskele – Amfreville) në një helmëtë luftëtari . (44) Ne sot, vetëm mund të hamëndsojmë se si ju lindi paraardhësve tanë të lashtë, ideja për qënien e një pjese të pavdekshme në trupit e tyre. U desh të kalonte shumë kohe, deri sa do të kuptohej se i vdekuri nuk ngjallej dhe të lindte idea e SHPIRTIT.

Kjo kohë pasqyrohet në fushën e arkeologjisë, me mënyrat e ndryshme të varrimit (varrosje, djegje, mumifikimi) të cilat gabimisht nga studiuesit, bëhen dëshmi për të përcaktuar dallimin racor midis fiseve dhe popullsive. Në fakt, ndryshimi i mënyrës së varrimit është shprehje e idesë së vdekje-ringjalljes që pati popullsia pellazge, në periudha të ndryshme kohore.

Ndërgjegjësimi se i vdekuri nuk ringjallej, nuk do ta ndalonte njeriun e lashtësisë të kërkonte “pavdeksinë”. Edhe në trupin e tij duhej të ndodhej pjesa e “pa vdekshme”(energji krijuese), siç kishte edhe Hëna. Keshtu lindi ideja e “shpirtit të përjetshëm”, që shkëputej nga trupi i të vdekurit (i cili i përkiste dheut) për t’u ngjitur në botën e përtejme dhe ky vënd ndodhej në yllin e afërt dhe të madh tokësor- në Hënë. Këtë pohim e gjejmë, jo vetëm tek

autorët e lashtë si Plutarku, por edhe në fiset e sotme të Polinezisë aziatike. (45) **Mania**, në mitologjinë romake ishte perëndesha e botës së përtejme dhe « mëma » e shpirtrave të të parëve. Kulti i saj nderohej edhe në Arkadi (krahina e Manit) (46)

Le të kujtojmë vajtimin e Ajkunës për vdekjen e të birit, kur i drejtohet Hënës si padrone e botës së përtejme: “Dy fjalë Hanës thekshëm ia thotë nana:/ t’u shkimtë drita, t’u prishtë bukuria/ si s’ma çove në Jutbinë ti lajmin/ n’ Lugje t’Verdha shpejt me dalë e mjera,/ bashkë me hy n’nji vorr me djalë të vetëm!”(47)

Të gjitha dukuritë si: vdekja-shpirti-varrezat-bota e përtejme-forca magjike vepruese etj, që sipas besimit mitik lidheshin me Hënën, « mëmën universale, që mbretëron mbi gjithshka dhe mbi këdo » siç i këndon Homeri (Iliada), do të marrin rrënjën apo emrin e plote të saj. Emri në lashtësi luante rolin lidhës midis sendeve-njerëzve-ngjarjeve, pra kishte kuptim më të gjerë se sa përcaktimi i një njeriu, një objekti apo një dukurie natyrore. Emri luante rolin e një simboli, në rastin tonë, atij hënor.

Vdekja, varret dhe shpirti “mana”

Siç e pamë edhe më lart, Hëna krahas jetës si “mëmë krijuese”, lidhej edhe me vdekjen dhe varret.

Në mitologjinë finlandeze “mana” emërtohet vdekja dhe vëndi ku shkojnë të vdekurit (49) Në gjuhën shqipe, për vdekjen, kemi fjalën “mort-ja”, italiane « morte», spanjisht « muerte», latinisht « mortem ». Në gjuhën sanskrite fjala “mara” përcakton vdekjen dhe vëndin e të vdekurve, ndërsa “marīci” vëndin e ndriçuar- parajsën hënore.(50) Në gjuhët e tjera semitike dhe afro-aziatike, fjala që kishte kuptimin e vdekjes: ne gjuhen arabe « mawt », hebraike « mot » ose « mavet » ne gjuhen malteze « mewt » siriane « mautā », etiopiane « mot », etj. (51) Sipas « Enciklopedisë së miteve » të Micha F. Lindemans, në mitologjinë romake emri « **man-es** » përfaqësonte shpirtin e të vdekurve dhe nderohej si perëndi. Germat « D » dhe « M » (Dis Manibus-lat. Perëndisë Man) janë përdorur gjërësisht në pllakat e vareve. (52)



(majtas) Pllakë varri e shk III kushtuar D-M “Dis Manibus”(Perëndisë Mani). Në peridhën kristiane të romakëve u përdorën tre gërma: D-M-S (S=Sacrum, e shenjtë);

Gjuhëtarët kanë mendimin se fjala “man” e ka origjinën nga gjuha sanskrite, ku “manas” do të thotë shpirti. (53) Në *Librat e shenjtë* të etruskëve apo siç quheshin *Librat e Akerontit* (Akeronti përcillte shpirtrat e të vdekurve mbi lumin me të njejtin emër në Epiri dhe buron nga fjala shqipe “ha” dmth ai që i ha ata që kane

rojtur), ku përshkruheshin ritet e shenjtërimit, flitej edhe për hyjnitë **Mani**. Sipas mitologëve, kulti i Manit i romakëve e kishte origjinën nga besimi etrusk. (54)

Në gjuhën babilono-aramaike “Mana” nënkuptonte “shpirtin e lehtë”. (55) Në ishujt aziatik të Malajzisë “**mari**” emërtohet shpirti i të vdekurit. (56) Në mitologjinë e lashtë baske (Spanjë), figura më e rëndësishme ishte hyjnesha hënore-**Mari** dhe ishte padrone e botës së përtejme, dhe lidhej me botën e të gjallëve nëpërmjet puseve dhe shpellave. (57) Edhe në ishullin e Kretës është nderuar hyjnesha **Mari**. Në fjalorin e fesë islame fjala “**Maâd** » tregon rrugën drejt botës së përtejshme. (58)

Shëmbujt e lart-përmëndur dëshmojnë rrënjën e emrit “ma” të Hënës, në emrat që lidhen me shpirtin, vdekjen, varret dhe botën e përtejme. Me qenëse “shpirtrat” mblidheshin në një vënd, në Hënë, në periudhën romake emërtoheshin në numrin shumës “i Mani”, duke përfaqësuar “shpirtrat” e familjareve të vdekur apo “kultin e të parëve” (59)

Për nderimin e tyre shqipetarët kryhejn rite edhe sot në data të caktuara. Deri vonë besohej se shpirtrat e familjarëve të vdekur, herë pas here vinin pranë familjes së tyre të gjallë. “Në Mërtur dhe Nikaj (Shqiperi)-pohon baroni Franc Nopça- është zakoni i përgjithshëm, kur për festa ndezin qirinj , t’i lenë dritaret hapur, që të hyjnë shpirtrat e të parëve dhe të marrin pjesë në festat. Diçka të tillë thotë Wuttke për gjermanët e vjetër, të cilët besonin , se shpirtrat e të vdekurve ktheheshin në shtëpi me rastin e festimeve” (60)

Në Romën e lashtë për “kultin e të parëve” (shpirtin e të parëve) përdorej emërtimi “**mana-num**” ku rrenja “num”, sipas studiuesit Xh.Katapano, në hebraishten e lashtë, tregon vijëmsinë e qënies nëpërmjet brezave; një brez që vjen nga një tjetër më i vjetër, prej nga formohet një zinxhir individësh të të njejtit lloj. (61)

Në gjuhën sanskrite fjala “pitarau” = prindër, simbolikisht pasqyrohet me një shtëpi. Kjo fjalë vjen nga “pitr” = ai që të mbron. (62) Shtëpia pranë kokës së Paridit, shpreh shpirtrat “mani” (shpirtrat e të parëve, prindërve) që e mbrojnë atë.



(majtas)Elena dhe Paridi, (shk IVpK), muzeu i Luvrit, Paris. Në lashtësi, për të lehtësuar shpirin “mana” që të shkëputej nga trupi, lihej trupi mbi tokë deri sa të mbetesh vetëm skeleti, i cili pastaj varrosej. “Dikur ka qenë zakon në Malecinë e Shqipërisë së Veriut- vëren F.Nopçia- të vdekurit i vinin në një ndërtesë të veçantë mbi skare prej hekuri, gjersa treteshin dhe kockat binin në gropë, në tokë. Në Karme dhe Galishte më kanë treguar një vënd ku ndodheshin ndërtesat, që shërbenin për këtë qëllim, që të kujton « Kullat e heshtjes të Parsëve të Indisë »”.(63)

Ky rit është praktikuar edhe në Siçili. Shpirti i të vdekurit nga iliro-pellazget emërtohej “mani” duke marrë emrin e vendit ku shkonte, atë të Hënës. Kjo është një ligjësi gjuhësore që përdoret edhe sot e kësaj dite (Tiranë-tiranas, Prishtinë-prishtinas) .

Perfundimi i dytë: Për sa më sipër, faktet tregojnë se emri kultik i Hënës në besimin e Pellazgo-Ilirëve ka qenë MAN-A , dhe me emrin e saj (Man-i) është emërtuar krahina në Peloponez.

Emri i Zotit në lashtësi, simpas besimit mbahej i fshehtë, fillimisht nga fiset e tjera, sepse siç vërejnë studiuesit, besimi lindi si një mjet mbrojtjeje. Në shekujt e më vonshëm, edhe emrat e Perëndive të herëshme prehistorike, nuk tregoheshin dhe autorët e lashtësisë, padrejtësisht dëshmojnë se Pellazgët e gadishullit Ilirik, nuk u kishin vënë emra Perëndive të tyre. Nga kjo periudhë e besimit, për Krijuesin u ligjësuat që të mos i përmendej emri, ndërkohë u hyjnizuan me emra, “pasardhësit” e saj: Hëna/Sellena, Dielli/Apollon dhe një varg i gjatë Hyjnish e Hyjneshash, të ndër-lidhur ndërmjet tyre, me një fill të ngatëruar farefisnor. Emri Mana i Hënës apo rrënja e saj “m/ma” është përhapur në shumë emërtime të dukurve natyrore dhe të shoqërisë njerëzore në të gjithë Botën, dhe sidomos në terminologjinë e besimeve të mëvonshme.

Hëna - forca hyjnore

Çfarë përmbledh në vetvete emërtimi *FORCE*? Para së gjithash, në besim dhe mite, “forcën krijuese të jetës” mbi tokë dhe të magjisë hyjnore, që buron nga Krijuesi i plotfuqishëm. Sipas antropologes Antoneta Bertocchi, njerëzit primitivë i lyenin kockat e të vdekurve me bojë të kuqe (ngjyrën e gjakut), sepse mendonin se gjaku përmbante një forcë jetësore magjike (mana) që do të siguronte “ringjalljen”. (64)

Emërtimin “Mana” (energji jetësore) gjëndet në gjuhën: Katalane (Spanjë), Çeki,

Danimark, Kore, Itali, Maqedoni, Japoni, Suedi, etj. Dhe në dukuri të tjera të besimit, në : Gjermani, Francë, Lituani, Poloni, Portugali, Finland, etj. *JETA* dhe *VDEKJA*, siç e pame edhe më lartë, janë të lidhura me dy përcaktime të figurës së Hënës. Për rrjedhojë edhe shpirti-mana” lidhej si me vdekjen ashtu edhe me jetën. Le të kujtojmë edhe një herë vargjet e Homerit drejtuar Hënës (Sellenë): “Sunduese, nënshtruese e rrëmbimit (forcës), sunduese e njerëzve, sunduese e gjithshkaje ”. (65)

Sipas studiuesit G.Dumezil, idea e “shpirtit” në zanafill, nuk lidhej me vdekjen, por me “energjinë – magjike” të përjeteshme tek sendet. Para se të bëhej Marsi - Perëndi e luftës, adhurohej kulti i heshtës dhe para perëndisë së Gioves, i ishte ngritur kult gurit. (66) Një «mana » të tillë, kishte edhe sëpata dy-tehëshe iliro-pellazge. Figura poshtë tregon një sëpate të periudhës minoike me formë gjysëm hënore.



(majtas) Labrys me dy tehë në një enë; Tibet, “gurë-mana” pranë të cilëve janë vendosur dy brirë në formën e harkut hënor; Heshta në formë të harkut hënor në Muzeun e Kalasë Rozafat, Shkodër. (67)

Sëpatat « dy tehëshe », sipas G. Dumezil, janë përdorur që në Paleolitik gjatë flijimeve në Kretë e deri në Azinë e vogël dhe shihej si simbol i Perëndisë së rrufeve dhe stuhisë - Zeus/Jupiterit. (68)

Hyjnesha Çerere, e adhuroar nga etruskët, mbante një sëpatë dy-tehëshe, simbol hënor “i jetës dhe vdekjes” (sëpata përdorej për punë-*jeta* dhe për luftë-*vdekja*) (69) Armët kryesore të Amazonave ishin : harku, sëpata dy tehëshe dhe një mburojë e vogël në formën e gjysëm-hënës e emërtuar « pelta ». (70)

Sipas besimit Budist, energjia-jetësore, “shpirti mana” ndodhej edhe në gurët (me fjalë të shenjta) që viheshin përgjat brigjeve të lumenjve, rrugëve, mureve apo si grumbuj gurësh, që shprehnin shpirtin mbrojtës të vendit. Ato emërtohen “guri-mana”. Në Europën veriore janë gjendur gjithashtu gurë me simbole figurative të « shpirtit-mana » të lidhura me kultin e Hënës (fig.1, poshtë)



(fig.1) “Guri-mana” më i lashtë i gjëndur në Danimark (Snoldelev stone). Në të shihet një kryq i thyer dhe tre brirë kau, simbol kultik i Hënës, që japin idenë e një helike ajri, që shprehin shpirtin e të vdekurit që ngjitet lart. (71)

Figura e malit zinte një vend të veçantë nderimi tek Pellazgët, si element natyror i përjetshëm dhe e lidhnin atë me “forcën-jetike” të Hënës-Mana, duke e emërtuar me emrin e saj: “**ma-l**”. Zeusi dhe perënditë , qëndronin në **majat** e **maleve**, jo vetëm se ishin më pranë Krijuesit, por edhe se ndodheshin mbi një objekt të “perjetshëm”- malin. Në gjuhën sanskrite fjala “gur” shqiptohet po « gur » dhe ka kuptimin: i rëndë, serioz, i nderuar, i madh, i rëndësishëm, etj (72)

Edhe vendosja e gurëve të përmasave të mëdha (menhire) në varre, mendoj se shërbente për të dëshmuar se shpirti i të vdekurve ishte “i përjetshëm” si mali, nga mirrejturi e guri. Le të kujtojmë se edhe sumerët (3000 pK) tokën, që ishte gjithashtu “e përjetshme” e emertonin “**ma**”. Rrënja “**ma**” ndodhet edhe në gjuhën sanskrite për malin dhe majat e maleve dhe « **mani** » emërtoheshin gurët e çmuar. (73)

Më vonë, njeriu primitiv këtë « energji-magjike » të sendeve i dha kuptimin e « shpirtit të përjetshëm -mana” duke e paisur njeriun me të. Një nga forcat-jetësore më të rëndësishme është ajo e mendjes, prandaj pellazgët e çvendosën shpirtin-mana nga zëmra, siç ishte në zanafill, tek truri, në kohën e Perëndise Ptah dhe Thot, në Egjiptin faraonik. Emrit të Hënës “**man**”-a, i dedikohet edhe emri i njeriut, që e zotëronte këtë forcë –jetësore, në trurin e tij. Njeriu nga vëzhgues u bë krijues, duke vënë në shërbim të tij natyrën, mitet dhe besimin. Në gjuhën sanskrite “**man-u**” do të thotë-njeri, krijesë që mendon. (74) Në gjuhën angleze, baske (Spanjë), në Vëndet e ulta, njeriu emërtohet “**man**”, gjermane, norvegjeze “**mann**”, suedeze “**människa**” armeniane “**mard**”, daneze “**mad**”, finlandeze “**mies**”, bullgare, sllovaqe, “**muzh**” etj (75)

Une mendoj se fjala “njeri” e gjuhës shqipe, lidhet gjithashtu me Hënën, me kohën kur njeriu para-historik, mësoi të numëronte fazat e saj. Mitologët dhe studiuesit e historisë së besimit, mund të sqarojnë më saktë, mitin e krijimit të njeriut të parë (1= një) të Adamit

(ai ishte “njeshi” dmth i pari), që Zoti i dha pamjen e ngjashme me pamjen e tij. Fakti që emërtimi “nje-ri” është i njejtë me numrin “një”, siç e ka vetëm gjuha shqipe, dëshmon origjinën pellazgo-arbërore të mitit “Të krijimit”, të emrit të Adamit dhe të arbërve, njerëz - bijë “të njeshit”.

Në gjuhën e sotme shqipe është ruajtur forma më e vjetër e emrit të Hënës (**Hana**) dhe mendoj se emri kultik i saj (**Mana**), lidhet me periudhën e hyjnizimit të figurës së gruas (me çfaqjen e matriarkatit). Gjithashtu mendoj se ky emer është formuar, nga shkrirja e dy emërtimeve që gjenden edhe sot në gjuhën shqipe, me të njejtin kuptim: “mama”=“nana” apo “nëna”(kjo e fundit më shpesh përdoret për gjyshet), duke na dhënë “mana”. Kam dëgjuar se gjyshet në fshatrat e Përmetit i thërrasin “mana”. Dihet se në besimin e pellazgëve, Hëna përfaqësoi Hyjneshën krijuese (Dea madre).

Si përfundim : Emri Mani i krahinës, në gadishullin e Peloponezit është formuar nga gjuha pellazgo-shqipe, si gjuhë e besimit të parë e njeriut europian, atij *HËNOR* dhe ka kuptimin: “Tokë hënore” apo “Tokë e shënjtë hënore”. Këtë fakt, krahas miteve dhe shkrimeve të autorëve të parë, e dëshmojnë edhe toponimet. Selino, është emërimi i lashtë i një lumi në Akai (Peloponez), nga emri i Perendeshës së *Hënës* - Sellena. (76)

Emri i Hënës MANA vjen nga para-historia dhe hedh poshtë pohimet e historianëve se shqipetaro-arbërit, janë të ardhur në Jugun e Gadishullit në shekujt e mesjetës. Besimi hënor pellazgjik, krijim i paraardhesve të shqipetaro-arbërve, vërteton shkecerisht se janë popullsi autoktone që, së bashku me fiset e së njejtës etni, zinin të gjithë hapësirën e emërtuar Gadishulli Pellazgjik, më vonë Ilirik dhe sot Ballkanik. Ky studim dëshmon se BESIMI, me të gjitha shfaqjet e tij (emërtimet, ritet, mitet, simbolet, shkrimet, gjuhën, muzikën, materialet arkeologjike, etj) është DITARI i pakundërshtueshëm i origjinës, lashtesisë dhe të vërtetave historike të popujve.

EMRI «JEZUS», «KRISHT» DHE «KRYQ» SHPJEGOHEN VETËM ME GJUHËN DHE BESIMIN E PELLAZGO-SHQIPETARËVE

« Zakoni i të mbajturit me fanatizëm i shenjave të veta dalluese ka një kuptim të përcaktuar qartë... dëshira e tij (e shqiptareve) për t'u identifikuar është më e madhe se frika nga vdekja.»

Rose Lane « Majat e Shalës »

Ka vite, që gjithmonë e më shumë 25 dhjetori, dita e Krishtlindjeve, po bëhet e pranishme në shoqërinë shqiptare. Si një popull tolerant, ay historikisht i ka festuar ditët e shënuara të të gjitha besimeve, pavarësisht në se i njihite apo jo domethënien fetare apo mitike të këtyre datave dhe riteve.

Me qenëse çdo dukuri ka një zanafillë, na lind pyetja se: “Nga e ka origjinën emërtimi i Jezusit, KRISHT dhe në gjuhën dhe besimin e kujt populli, ay arrin të motivojë simbolin kryesor të fesë kristiane, KRYQIN ?”

Sipas Ungjillit të Mateut, tregohet se Maria , nëna e tij që i ishte premtuar Jozefit, mbeti shtatzanë me Frymën e Shenjtë. Jozefit, që mendonte ta linte Marinë, iu çfaq në ëndër një ëngjëll i Zotit dhe i tha: «Jozef, biri i Davidit, mos ki frikë ta marrësh Marinë me vete si gruan tënde, sepse çështë ngjizur në të është vepër e Frymës së Shenjtë. Dhe ajo do të lind një djalë dhe ti do t'i vesh emrin Jezus, sepse ai do të shpëtojë popullin e tij nga mëkatet e tyre. (1)

Në Bibël nuk përmendet se kush ja vuri emrin « Krisht » (Christ) Jezusit të Nazaretit. Ka studiues dhe besimtarë, që e shpjegojnë emrin « Krisht », si pasojë e dënimit të Jezusit me një vdekje plot vuajtje trupore mbi një kryq. Kryqi, sipas besimit kristian, shpreh kryqëzimin, Krishtin, Fjalën dhe Figurën e dytë të Trinitis. Të gjithë besimtarët dhe studiuesit e historisë, bashkohen në mendimin se “kryqi” sot, përfaqson simbolin e besimit kristian.

Por, siç dëshmon studiuesi Joel B. Green (“*The Cambridge Companion to Jesus*”) “Dëshmia e mënyrës së vdekjes të Jezusit është shumë më e errët, se sa është paraqitur. Në literaturën e antikitetit Roman, nuk jepen përshkrime të aktit të kryqëzimit“ (2) Edhe teologu anglez E. W. Bullinger, në librin “*The Companion Bible*” (botuar më 1922) pohon se në katakombet e Romës, Krishti nuk është pasqyruar asnjëherë i dënuar mbi një kryq. (3)




(majtas)Dënimi i legjionarit romak Acacio, (viti 303) për shkak të përqafimit të besimit të ri kristian. (4)

Fotot tregojnë se shtyllat e vdekjes mbi të cilën dënoheshin njerëzit, para dhe pas vdekjes së Krishtit, nuk kanë patur formën e kryqit. Siç dihet, për krijimin e miteve të reja, duhet të kalojë një periudhë disa shekujllore nga ngjarjet historike. Gjatë kësaj kohe, miti pasurohet me material tregimtar, pasqyrim viziv nëpërmjet artit të gdhëndjes dhe pikturës, me rite e ditë të shënuara. J. Hall në “*Dictionary of Subjects & Symbols in Art*” ka pohuar se : “duke filluar nga shk V, kryqi filloi të gdhëndet në sarkofaget dhe objektet e tjera. Wallis Budge në librin “*Amulets and Talismans*” shton: « Para shk 4, Kryqi nuk ishte emblemë kryesore dhe simbol i të krishterëve”. (5)

Si përfundim del se, simboli i kryqit kristian është futur në periudhat e mëvonshme, nga koha historike e vdekjes së Jezusit. Format e ndryshme të kryqit që gjënden sot në Europë, na bëjnë të mendojmë, se keto figura grafike, duhet të kenë lidhje me simbole të miteve të tjera (që nuk lidhen me kryqëzimin) të një besimi shumë më të hershëm, të pa trajtuar deri më sot. Në Enciklopedinë e literaturës Biblike (*Cyclopædia of Biblical, Theological, and Ecclesiastical Literature*) dëshmohet se shenja e kryqit mbahej si simbol i shenjte


tek shume popuj të Antikitetit. (6) Sipas studiuesve, ndërmjet figurave gjeometrike, kryqi është simboli i tretë kryesor i ardhur nga periudha me e herëshme e lashtësisë dhe ka lidhje me qëndren, rrethin, katrorin dhe trekëndëshin.




Kryqi (1) latin , (2) françeskan , (3) grek, (4) ortodoks, (5) kryqi i Shen Andreas, dishepulli i parë i përmëndur nga Jesusi në Ungjill (Matth. 10,2) i shek X, (6) kryqi bizantin, (7) bask dhe (8) keltik.

Gjatë historisë njerëzore është vërejtur se çdo mit i ri, për të ndikuar mbi popullsinë, mbart në gjirin e tij simbole të miteve dhe besimeve të mëparshme. “Pothuaj çdo detaj i dogmës Kristiane -pohon studiuesja e simboleve të lashtësisë , H.Blavatsky , është huazuar nga Paganët. (*The Secret Doctrine* f568) Ky fakt e gjen shpjegimin në shkencën e psikologjisë. Si shëmbull mjafton të vërejmë flamurin e BE-së. Ylli me pesë-cepa që simbol i shkollës së ndjekësve të Pitagorës (530 pK) dhe që simbol i shoqërive mistike-besimtare, bashkësive shkencore dhe politike (7) dhe numri 12, përkonte me Perënditë mbi Olimp. Rrethi, i formuar nga yjet, shpreh në besim hyjnoren, përsosmërinë, përkryerjen, bashkimin , atë që nuk mund të ndalet dhe shkatërohet. (8) Studiuesi Petro Zheji shprehet se « Simbolet kapërcejnë vëndet dhe kohërat, situatat individuale dhe rrethanat e rastësishme... » (9) Këtë e dëshmon edhe studiuesi Joseph L. Henderson « *Miti antichi e uomo moderno* », i cili pohon se ka simbole që nuk e kanë humbur rëndësinë e tyre për racën njerëzore. (10) Përderisa besimi kristian e vuri kryqin në qëndër të mitit të tij, jam e bindur se ky simbol, mbart në vetvete një kuptim shumë të rëndësishëm, ndoshta më të rëndësishmin ndër simbolet e tjera të besimit zanafillor të shoqërisë njerëzore. Gjithashtu mendoj se, kjo peshë simbolike e kryqit në lashtësinë e herëshme, ka lidhje edhe me emërtimin « Krisht » , me të cilin shqiptohet sot figura qëndrore e kristianizmit – Jezusi i Nazaretit.

Më poshte kemi të paraqitur (a) shkrimin më të lashtë europian dhe (b-c) kryqe tek simbolet ilire dhe një tatuazh me kryqe i dorës tek shqipetarët e Maqedonisë, dërguar nga studiuesja Edibe Selimi Osmani (2.07.2013).



Në studimet e sotme, kryqi (dy-tre rrezesh) është përcaktuar si gërma të alfabetëve të lashtësisë. Në fig poshtë (a) simboli i dy kryqeve të kryqezuara, i përket alfabetit të mijevjeçarit të tretë pk. dhe (b) dy kryqe dy-rrezesh shprehin emertimin fonetik “tau” në shkrimin kuneiform të Mesopotamisë.(11)



I këtij mendimi është edhe Niko Stillo i cili pohon se “Simboli i kryqit të thyer është simbol apo shkronjë e shkrimeve lineare tepër të lashta në Europe” (13)

Meqenëse kryqin e hasim që në “artin” e njeriut të neolitikut, kur nuk ishte krijuar akoma shkrimi, arrijme në përfundimin se në periudhën e parë këto shenja nuk ishin shkronja, por lidheshin me besimin zanafillor. Studiuesi At Justin Rrota, në veprën e tij “Për historinë e alfabetit shqyp” (1936), na tregon një shembull të tillë: “Në botimin e Buzukut, gjejmë fijen qi na zgjidh nejet (hijen-shën im)e dyshimit mbi shenjet e posaçme të shkrimit të shqypes (...) Për të shprehe tingullin e « y »-s sonë, qi ky shkrimtar e përdori edhe për zânoren « u », ai vojti e muer shêjin e zodiakut (brirët e demit) qi është në përdorim në degë t’astronomis për ftyrën e Taroçit (Taurus).” (14)

Ne sot nuk kemi dokumente të shkruara, që të themi se ç’fare ka dashur të shprehë njeriu primitiv me shenjën e kryqit, që vizatoi në shpella apo kur e gdhendi në kockë, gurrë apo baltën e pjekur. Por mund të pohojmë, se në atë periudhë të herëshme, besohej në forcat e mbinatyrshme, të paaritshme prej tij dhe në rradhë të parë, ato që ndodheshin në qiell, si hëna, dielli, yjet, uji (shiu) dhe ajri, etj. Besimi dhe mitet më të herëshme, ju përkasin “banorëve” të kupës qiellore, dhe sot e kësaj dite aty ndodhet edhe banesa e Zotit. Studiuesi i besimeve Mircea Eliade (1907-1986) pohon se “Lartësia është diçka e paaritshme për

njeriun dhe si e tillë, i përket forcave dhe ekzistencës mbinjerëzore...Qielli 'simbolizon' përsosmërine, shenjtërinë, forcën, pandryshueshmërine...Thjesht nga të qenurit 'i lartë', që ndodhet 'lartë' e barazvlerëson me të qenurit i pushtetshëm" (15)

Njeriu i paleolitit ishte në « kërkim të Zotit », të ndjerë prej tij si një *FORCE* e pa-formë. Ay e shikonte atë tek shumë dukuri të natyrës qiellore dhe tokësore, nga të cilat varej jeta e tij dhe e fisit. Frika më e madhe për të qe zhdukja e dritës, kur terri i një nate pa hënë apo në thellësinë e shpellave, përpinte çdo gjë përreth tij. Në terr, nuk ekzistonte asgjë. Lufta kundër « territ » për të shpëtuar *DRITËN* (hënore dhe diellore), gjëndet në themel të miteve të para të njeriut.

Kryqi, përmban në vetvete elementin shprehës të zbritjes në tokë të *DRITËS* – rrezën (vijën e drejtë). Fjala e gjuhës shqipe “rreze”,vëren studiuesja e shkrimeve të lashta Nermin Vlora Falaski“ Është një fjalë që e hasim edhe sot në të gjitha gjuhët indo-europiane, (por) nuk haset as në greqisht, turqisht, arabisht dhe as në gjuhen kineze...” (16) Siç e vërteton Petro Zhei nëpërmjet fizikës moderne, gjuhës dhe miteve «Gjuha referon gjithnjë tek Qendra (Zoti) » (17)

Rrënja e emrit “rreze” gjëndet në emrin e Zotit tek egjiptianët e lashtë (Perëndia Rê / Ra- ajo që bije në tokë sipas Xh.Katapanos) dhe është e shprehur në muret e Piramidave në formën e vijave të drejta që përfundojnë me një dorë (dora e Zotit), por edhe në pikturat mesjetare të kristianizmit. Asnjë objekt tokësor, nuk kishte atë pamje të përsosur të vijës së drejtë si rrezja, e cila lidhte Dritën qiellore (Zotin) me Tokën. Ashtu sikurse në lashtësi edhe në besimet e sotme, çdo element i shënjtërisë, shprehet si një burim ndriçimi apo rrezatimi.



a



b

(nga majtas) Perendia Mitra ; Mozaik i Krishtit me rreze përreth kokës i shk 3 në bazilikën e Shën Pjetrit, Vatikan (18)

Dy rreze të kryqëzuara (kryqi) ishin një nga simbolet më të herëshme për Zotin-Dritë dhe Shqiponja ishte përfaqësuesja e tij në tokë. Në veprën “*Thoti fliste shqip*” studiuesi arbëresh Xhuzepe Katapano pohon se “Shqiponja dhe Ylli simbolizojnë që në kohët më të lashta , dritën, shpirtin pra vetë zanafillën e jetës dhe të çdo krijimi, që janë thelbësisht të rendit mendor ...(dhe) sipas Moisiut , shqiponja dhe ylli, janë sinonime” (19)



Trastë e gruas së Sopotit, Librazhd, fillimi i shk 20 (Veshje popullore , Vell 2.)


Të tre këto figura (hëna, kryqi-yll dhe shqiponja) përfaqësonin të *Plotfuqishmin* dhe janë pasqyruar së bashku apo të veçuara, gjatë të gjithë periudhës së lashtësisë, mesjetës, por edhe në kohët moderne, kur bëhej fjalë për fuqinë hyjnore.

Në qëndër të kryqit (foto majtas) qëndron shqiponja, që së bashku me dy hënat dhe yjet sipër, përfaqësojnë Krijuesin. Katër rrathët, me qëndrën e spikatur në formë ruaze, janë shprehje e botës hyjnore me Zotin në qëndër. “Raporti midis Zotit dhe Krijimit –shprehet Antonietta Zanatta- është i njëjtë me atë të rrethit dhe qëndres”. (20) Tre format kryesore të kryqit që njihen sot (X, †, T), kanë patur për lashtësinë vlerë të njëjtë mitike, gjë që dëshmohet edhe në alfabetet e para. (vini re germën-kryq fenikase, atë arkaike greke, formën T greke klasike, etruske dhe latine, me të njëjtën vlerë fonetike

Fenicio	Ebraico moderno	Greco arcaico	Greco classico	Etrusco	Latino classico	Latino moderno
†	Ⲛ	X	T	T	T	T

21

Kjo vihet re edhe në monedhat romake ku kryqi, ylli dhe germa “T” janë simbole të Zotit. Ne fotot poshtë, binjaket Dioskure dhe dy yjet mbi kokë, në monedhat romake te viteve 211-208 pk . Germa “T” mbas kokës së binjakeve dhe dy yje mbi kokat e kuajve janë shprehje të Krijuesit. (22)



Kryqi-yll dhe binjaket e Zeusit

Që simboli i kryqit-yll ka qënë, dy / tre rreze që ndërpriten me njera-tjetrën, me idenë e pranisë së Zotit, kemi dëshmi të shumta në materialet arkeologjike. Në shumë monedha të periudhës romake, mbi kokën e binjakëve: Kastorit dhe Polideukut, të njohur me emerit – Dioskurë, ndodhen dy kryqe-yje.



(foto majtas) Bazoreliev i Dioskurëve, mbi kokën e të cilëve qëndron hëna dhe dy yje, shk 2 pk si simbol hyjnor i forcës ushtarake të Perandorisë Romake. (23) Dioskuret, sipas mitit pellazg, ishin fëmijët e Ledës, (grua e Tindarit, mbretit të Spartës) e të Zeusit, që e mashtrroi duke u paraqitur si mjelmë. Dy binjakët, kanë mbi kokë qeleshet, që është

pjesë e veshjes vetem e traditës shqiptare. Ky është edhe një fakt tjetër, që dëshmon se mitet “greke” kanë për autorë, paraardhesit e shqiptareve, Pellazgët hyjnorë.

Më hollësisht për binjakët dhe babanë e tyre, Zeusin pellazg është shtjelluar në veprën madhore të Niko Stillos “*Etruskishte-Toskërishte*”, që vijon të mos përfillet nga Albanologjia e politizuar zyrtare në Shqipëri.

Në shumë objekte arkeologjike apo grafika edhe të kohëve të reja, kryqi-yll me hënën, paraqiten të bashk-shoqëruara si shprehës të njeri-tjetrit, siç e gjejmë në simbolin e besimit islam, të huazuar nga besimi pellazg. Ylli sipër hënës ishte simboli i Perëndeshës Afërdita dhe i

shtetit të Epirit. Ky simbol është pasqyruar edhe mbi qeleshen e Aleksandrit të Madh. Po kështu, në heraldikën e gazetës së arbëreshëve, hëna / kryqi-yll në qendër të shqiponjës dy krenore, shprehin tre simbole të Zotit dhe dëshmojnë lidhjen e tij me Kombin arbër.



detaj, (24)

Në librin kushtuar figurës së shquar arbërore Gjergj Xhemisto Pletones (shk15), Moreno Neri sjell një dëshmi të çmuar për temën tonë. Në një letër dërguar fëmijëve të Perandorit bizantin, me rastin e vdekjes së babait të tyre, shkruhet: “(Ai) i kaloi njerëz të shumtë të hyjnizuar që ka lindur Hellada, ashtu sikurse Faeton (Zeusi) ishte më i miri ndër yjet e tjerë” (25). Të mos harrojmë, se Ptolemeu e quan Epirin “Hellas prehistorik” ndërsa Polibi e quan popullsinë e Epirit dhe Maqedonisë, si hellenë në të gjitha kuptimet (26) dhe “(s) hellenizmi” ka qene deri në shk19, besimi i popullit arbër.

Emërimin “yll” nuk e gjejmë vetëm për Zeusin, por edhe tek fiset pellazge. Studiuesi Trevor Bryce në librin e tij “*The Kingdom of the Hittites*”, (Oxford 1998) duke ju referuar emrave të mbretërve hititë verën “ se ata kanë prapashtese -ili, mënyrë e cila i identifikonte ata me yllin... Përveç ilireve dhe hititëve, nuk ka asnjë popull tjetër në Azi apo Evrope, që të përdorë prapashtesën -ili pas emrit të një mbreti. Mes gjuhëve semitike, prapashtesa -ili, tregon thjesht Zotin.” Hititët dhe iliret kishin të njëjtën kulturë e qytetërim dhe të njëjtën gjuhe. (27)

Simboli i yllit qëndron edhe tek emërtimi “Ilirë”, që gabimisht kuptohet si “i lirë”. Në dialektin çam emri “ylli” shqiptohet “illi” dhe emërtimi historik i popullit tonë është “yllorë” dhe i vendit Ylliria. Ylli dhe Hëna ka qënë simbol i Ilirëve dhe i Perendeshes Aferdite.



(foto majtas) Këtë e mbështet mitologjia pellazge dhe emri i më vonshëm “Illyria”, ku ka ndodhur ndrimi i zanores “y” me “i” tek bashtingellorja e parë. „Yj“ (yj- yjnor – hyjneron) -dëshmon Nermin Vlora- këtë fjalë nuk e kam gjetur në asnjë gjuhë tjetër me përjashtim të shqipes(...)megjithëse ishte e përhapur në të gjitha mbishkrimet e lashtesisë, nga Egjeu deri në Atlantik (28)

Për sa u shtjellua më sipër mbi simbolin e kryqit në objektet arkeologjike, të traditës, studimet gjuhësore dhe historike, dëshmohet se : *KRYQI* në besimin dhe mitologjinë pellazge, ka simbolizuar *YLLIN* dhe ka përfaqësuar Krijuesin-Zotin.

Kryqi, shkenca e lashtë dhe miti

Në rast se do të shprehemi se, besimi i Pellazgëve dhe tempujt ishin institucione sa administrative të mbretit, aq edhe shkencore të lashtesisë, nuk do të bënim ndonjë lajthitje, por do të zbulonim ndryshimin e madh që ka patur besimi në lashtësi, me ate të ditëve të sotme. Brënda kësaj strukture *besimtare* (mitike dhe shkencore) të lashtesisë, kurdoherë, kryqi ka qënë i pranishëm. Këtë përfundim e dëshmon katërcipërisht materiali arkeologjik.

Siç vumë në dukje edhe më lart, kryqi është i shprehur me kryqezimin në qëndër të dy dhe tre drejtëzave (rrezeve) me kënde të ndryshëm apo 90° dhe në lashtësi mendohej se kishte një forcë magjike hyjnore.

Njeriu modern e ka shkurtuar me mijëra-vjeçarë, periudhën kohore të lashtësise. Duke mos qenë në gjendje të zbulojë plotësisht arritjet e shkencës së lashtë, të mbuluar me “vellon” besimtare të simboleve, sot kemi një shkencë historike dhe gjuhësore të mangët për nga faktet dhe lehtësisht të manipulueshme. Por studimet e kohëve të fundit, sidomos të studiuesve shqipëtarë, kanë sjellë trajtime të reja të simboleve dhe miteve pellazge. Një prej tyre është edhe vepra “Shqipja dhe Sanskritishtja” e Petro Zhejit, që vendos bazat e një shkencë të re në studimin e Lashtësisë, duke shfrytëzuar simbolet dhe mitet e besimit pellazg dhe të besimeve të mevonshme, gjuhën shqipe, sanskrite dhe hebreje, ligjet e fizikës moderne dhe gjuhësinë krahasuese.



Në foton e parë, në varkat e fisit ilir të Liburnëve, kemi një brez kryqesh që shprehin Hyjninë (kryqi) në botën tokësore (katrori), dhe do të thotë: “Zoti është pranë jush!” Në të dytën, tek statuja e Isidës (1360 pk.), qëndrimi i Perëndeshës hënore, shpreh kryqin e drejtë, të shoqëruar nga krahët e shqiponjës dhe hënën e plotë mbi kokë mes brirëve të demit. Kjo paraqitje e Isidës, do të bëhet simbol i kryqit në Egjiptin e Lashtë. (c) detaj i “kryqit te Isides” (29)

Për zbërthimin e simbolit të kryqit, ne do të mbështetemi pikërisht në këtë shkencë të re, të cilën autori e ka emërtuar «*Filozofia dhe Llogjika e Gjuhes*»: “Sipas mendimit mitik-pohon Petro Zhei - Qendra (pika e prerjes së vijave të drejta) përcaktohet si përputhja e të kundërtave që identifikohet në instance të fundit me ZOTIN... (30) Qendra = Zoti = Dashuri. Ky përfundim gjen një rikonfirmë të njëzëshme në të gjitha Shkrimet e Shenjta, sipas të cilave *Zoti është Dashuri, një dashuri pa kushte e me çdo kusht ...Qendra = Dritë*” (31)

Kryqi përfaqësonte mbrojtjen hyjnore të Zotit ndaj bijve të tij, por edhe lidhjen me të. Tek arbërit ka ekzistuar gjithëmonë bindja se ishin një popull *HYJNOR*. Shumë popuj e kanë shpallur këtë emërtim për veten, por përveç miteve të vonshme, nuk kanë mundur

ta vërtetojnë edhe me gjuhën e tyre. Siç dihet, gjuha ka lindur para miteve, prandaj është ajo, që e vërteton mitin dhe ky privilegj i ka takuar gjuhës pellazgo-shqipe. Ky fakt dëshmon se arbërit, janë ay *POPULL HYJNOR*, që thurri mitin e Krijimit dhe ngriti një besim institucional *SELLENIZMIN* (besimin hënor). Po sjell vetëm një, nga shumë fakte që e vërtetojnë mendimin tim. Sipas fjalorit të Biblës, emri Adam në hebraisht vjen nga “âdam” (kuqalash, i kuq, i lyer me të kuq) (Edom); është emër i dhënë Esaut pasi ai kishte shkëmbyer parë-birin e tij me një pjatë supë të kuqe (Zan. 25.30) (32). Në fakt, emri biblik Adam, gjen shpjegimin mitik vetëm në gjuhën shqipe : A+dam dmth “A-i pari + i damë, i ndarë/i krijuar” nga Zoti. Po sipas Fjalorit të Biblës lexojmë se: “Te Zanafilla (e para qenje e krijuar- shën im) quhet nga vetë Perëndia: njeri ose Adam (Zan. 5,2) për të vënë në dukje anën tokësore të qënies së tij... për njeri në hebraisht është fjala «îysh », që do të thotë « burrë » ose « mashkull »(Eks. 35,29) “bashkëshort”, “qenie njerëzore” (Num. 23,19)” (33)

Në gjuhën shqipe, emri “njeri”, ka si rrënjë emërtimin e numrit “një” dmth- Zoti, i cili është unik -“1” dhe i pandashëm. Pra Adami ishte Bir i Atit-Një dhe si vepër e Zotit, u emërtua me emrin e tij “një + ri”. Pra as në gjuhën hebraishte dhe as në gjuhën greke apo latine , numri “një” nuk ka lidhje me fjalën “njeri” dhe nuk përputhet, nga ana gjuhesore, me mitin e krijimit. Por nuk është vetëm gjuha shqipe, që vërteton se paraardhësit e arbërve dhe shqiptarëve të sotëm, i përkasin asaj race hyjnore. Kryqi tek fiset pellazge ishte pjesë e pandarë e veshjes dhe e gjejmë edhe në veshjen e traditës të shqiptarëve të sotëm.



(nga e majta)Burrë me fustanellë (gur i gjëndeur në Maribor të Sllovenisë shk VpK) dhe një veshje ilire me rypa në formë kryqi; Qostek, shk19, Tepelene. Zbukurim i veshjes së burrave në fomë kryqi dhe në katrorin në qëndër, ndodhet ylli rezatues gjashtë-cepësh. (34)


Në të njëjtën form, e shikojmë kryqin në gjoksin e të Perëndisë babiloneze dhe asire Shamash . Kur shikohen ngjashmëri të simboleve apo në mite me popujt e lashtë të Azisë së Afërt, studiuesit zakonisht u venë “vulën” se janë ndikime të ardhura nga Lindja.

Arif Mati, pas një pune afro 30 vjeçare mbi lashtësinë, dëshmon se Sumerët ishin me zanafillë nga Ballkani dhe të afërt me trojanët, thrakasit ose frigët, dmth një popull pellazg, “Popull i famshëm i malësorëve me kokë të rrumbullakët, të cilët kanë shkelur tokën e Lindjes së Mesme rreth viteve 4000” (35) Shqipetaret e ruajnë kryqin edhe sot në veshjen e traditës.

Studiuesi Petro Zhei në veprën e tij «Shqipja dhe Sanskritishtja» pohon se : «Qendra është e vendosur në pikën e ndërprerjes të të dy krahëve të kryqit ...(dhe) me qenëse O (zero, hiçi) është zgjidhja e vetme e ekuacionit të Qendrës = Zotin, kjo është njëllor si të thuash se ka vetëm një Zot. (36) Pra besimi pellazg apo “pagan”, siç u emërtua nga kristianizmi, ka qenë besim monoteist, që do të thotë se *ADHUROHEJ NJË ZOT*. (Të mos ngatërohemi me Perënditë e Olimpit , që ishin njerëz tokësorë të hyjnizuar)

Për lexuesin e thjeshtë, ndoshta është e vështirë të kuptojë shpjegimin shkencor të studiuesit Petro Zhei mbi simbolin e kryqit. Por, arti i lashtësisë na e pohon me gjuhën e tij shprehëse.

Në fotot e mëposhtme shikojmë se ideja e Zotit (Qendrës së prerjes së dy rrezeve) ishte e njohur për njeriun e lashtësisë dhe kryqi mbahej si simbol kryesor i besimit.



(a) Duart e mumjes egjiptiane të vendosura kryq dhe të mbuluara nga shqiponja. (b) Detaj, kryq i dyfishtë mbi kapakun e sarkofagut. Varrin e Faraonit Toutankhamon (c) Detaj, fëmija me duar të kryqëzuara, këmbë e fronit të Papës në Vatikan, i huazuar nga modelet pellazge. (37)

Simboli i kryqit si shprehje e Krijuesit, në Egjiptin e lashtë, dëshmon origjinën pellazge të Faraonëve, profetëve dhe mbretërve, që krijuan më vonë besimin e judaizmit (të izraelitëve), paraardhës i besimit kristian. “Ramsesi i II, i Madhi i dinastisë XIX, më i madhi dhe shkëlqimtari Mbret , nipi i tij Hosarsiph (djali i motrës) prift i Osiridës, sipas Menetonit dhe Strabonit, i quajtur më vonë Moisi nga çifutet, çështjen e të cilëve e pranoi më vonë, Salomoni-djalë i hitites së bukur Betsabea; që të tre ishin trojanë” (Gerhard Herm « *L' avventura dei Fenici* » Garzanti, 1974) (38) Dhe siç e pamë edhe më lart, trojanët ishin pellazg. Pra, simboli i kryqit-yll, u trashëguar në besimin kristian nga vetë pellazgët, por tashmë me një mit të ri - si objekt i dënimit të Krishtit.

Siç shprehej spiritualisti anglez Gerald Massey(1828-1907): Ikonografia [dhe dogmat gjithashtu] kanë mbijetuar në Romë nga periudha e para epokës së krishterë. Nuk ishin një falsifikim dhe as gjë tjetër, veçse një vazhdimësi e imazheve (simboleve-shën im), por me një shtrembërim të kuptimit të tyre. (39)

Nga e ka origjinën emri i Jezus Krishtit?

Në traditën e arbërve, një nga femijët trashëgonte emrin e gjyshërve, sipas gjinisë që kishte. Ky zakon e kishte burimin nga besimi pellazg, sipas të cilit shpirti (fryma e shenjtë) e të parëve “rilind” në tokë, në trupin e familjarëve të tij. Sigurish gjatë qindra shekujve, ky mit është haruar, por është ruajtur riti, si një detyrim i pasardhësve për të rikujtuar dhe nderuar të parët e tyre.

Edhe emri i Jezu Krishtit, ndjek po këtë mit të besimit pellazg. Tek “Ungjilli sipas Mateut”, për lindjen e Jezusit, shkruhet se ngjizja e tij u bë nga *Fryma e Shenjtë* e Zotit.

Shpjegimi i P.Zheit të emrit të Jesusit nëpërmjet gjuhës shqipe, e mbështet këtë mit: “Trekëndëshi i formuar nga blloqet e shkarkimit dhe arkitrau, dukej si një “sy” i madh qëndror, brenda tij, ishte skicuar një tetragrame (4shkronja) që në gjuhën çifute lexohen JHVE që përbën emrin e “të Pashprehshmit” dmth “*Ti je i Vetmi*” pikërisht si në arbërisht : Je VE(T). Ju kujtojmë se në hebraishten e lashtë H-ja shqiptohej E“ (40)

Ndërkohë në fjalorin e Biblës thuhet se: “Jezus në greqisht Jesus, i përgjigjet Jehôshûa në hebraisht dhe do të thotë *Jehôvâh shpeton*, Perëndia shpëton”. (41) Siç shihet, gjuha shqipe e shpjegon saktësisht fjalën JHVE, dmth Biri, ku u “fut” Fryma e Shenjtë e Atit, morri edhe emrin e tij, siç e gjejmë në traditën e popullit tonë. Ky mit nuk mbështetet me gjuhën hebraike.

Për emrin “ Krisht”, sipas fjalorit të Biblës është përkthim i emrit grek « Kristos » dhe i fjalës hebraike Mesia (Masîah) që do të thotë “I vajosur” (Gjo1,41). (42)

Edhe në këtë shpjegim, emri nuk zberthehet me anën e gjuhës hebraike, greke apo latine. Siç e pamë më sipër, Jezusi u emertua edhe Krisht nga emri i Atit, që përfaqësohej nga kryqi. Në gjuhën shqipe, rrenja “kri” është e njejtë, si për Krijuesin edhe kryqin (në dialektin çam shqiptohet “kri-q”), që nuk e gjejmë në gjuhët e tjera. Kjo rrenjë e përbashkët dëshmon lidhjen e Jezusit me simbolin e kryqit dhe Zotin (*Kri-sht, Kri-q, Kri-jusi*).

Nga materiali i mësipërm, ku për të mos u zgjatur nuk janë përfshirë edhe fakte të tjera, kemi provuar se:

1. Kryqi dy rrezesh me të dyja format e tij, (90° apo kënde të tjera) si dhe tre- rrezesh, ka qënë simbol i Yllit, dhe krahas Hënës dhe Shqiponjës, ka shprehur botën hyjnore dhe vetë Zotin. Të gjitha format e kryqit, kanë qënë sinonime të njeri-tjetrit, gjë që dëshmohet në materialet arkeologjike. Kryqe dy-tre rrezesh edhe sot shërbejnë për të shprehur grafikisht yllin.

2. Emri *Krisht* dhe *Kryq* kanë të njejtën rrënjë “kri”, siç e gjejmë në dialektin e Çamërisë, ku kryqit i thonë “kri-q” (sht dhe q, janë mbaresa), e dëshmuar edhe nga gjuhësia historike e shqipes, ku vërehet se gërma “y” është më e vonëshme. Rrënja “Kri” i përket në dialektin çam edhe emrit “Kriet”, që tek shqiptarët e sotëm shqiptohet Kryet apo Koka dhe ruan edhe në ditët e sotme kuptimin e “njëshit”, i të Parit të familjes apo Zotit të familjes, i cili mendon dhe vendos për të. Kjo dëshmohet edhe nga përdorimi i fjalës “Zot” për të Plotfuqishmin qiellor dhe për krye-familjarin, gjithemonë në kuptimin “i vetmi, i plotfuqishmi për fatin e ... dhe të përkatësisë”. Siç pohon edhe studiuesi Beonlev: “Fjala, me të vërtetë i përket gjuhës në të cilën ajo nuk gjëndet e izoluar, ku bën pjesë në të gjithë familjen e termave, nga të cilat njëra palë shpjegon tjetrën” (43)

3. Emri i kryqit lidhet me emrin e Jezu Krishtit nëpërmjet mitologjisë dhe gjuhës pellazgo-shqipe.

Perfundimi: Gjuha pellazgo-shqipe ka qënë gjuha e miteve të para të njeriut europian dhe e simboleve të besimit. Bashk-shoqërimi i Jezusit në art, me simbolet pellazge si : shqiponja, hëna dhe dielli, rrezet, syri i Zotit, kryqi, demi, dora, etj dëshmon zanafillën pellazge të kristianizmit

Emri i Jezu Krishtit dhe i Kryqit janë të gjuhës shqipe dhe shpjegohen me mitet e besimit të dardano-thesprotëve - *SELLENIZMIN* (hellenizmin). Ky besim, gjatë mijeravjeçarëve pati zhvillimet dhe ndryshimet e veta, duke u pasuruar në mite dhe duke krijuar besime të reja që trashëguan doktrina, rite ,simbole, emërtime dhe shume gjera të tjera, nga besimi i *PARË* zanafillor. Në Ungjillin sipas Gjonit shkruhet :“Askush se pa Perëndinë kurrë ; i vetëm-linduri Bir, që është në gjirin e t’Et është ai, që e ka bërë të njohur”(44) – duke trashëguar emrin e Tij, në gjuhën hyjnore të *ARBËRVE* !

NGA DODONA NË TIBET

Atlantidën, mbi historinë e së cilës janë shkruar mbi 20 mijë libra, e kam rikujtuar sepse mendoj se raca ilire prej saj ka ardhur.

Khuzepe Katapano

Ëndra e Hitlerit

Kjo ëndër zuri fill pikërisht në shkretëtirën e Saharasë, aty ku Piramidat madhështore të Faraonëve, qëndrojnë si të tërhequra mbrapa ndërtimit më të lashtë - *SFINKSIT*- vepër e Atlantidëve, që i kishin shpëtuar Përmytjes.

Më 1938, falë mikpritjes së derës mbretërore shqiptare të Egjiptit, studiuesi Khuzepe Katapano, (pranë Piramidave të Saharasë), vendosi të priste rrezet e para të agimit një rit i lashtë i fshatrave arbëreshe të Siçilisë.



Edhe mbas 46 viteve, kur e mbaroi veprën e tij « Thoti fliste shqip », ai e kujton këtë çast magjik : « Drita e Lindjes, ndërsa ngjitej drejt qiellit, përhapej me ngjyrim të zbetë trëndafili që forcohej gradualisht, duke ndriçuar qetësisht Sfinksin, me ato buzët e trasha të palëvizshme, në përputhje të plotë me emrin, i cili, si të gjithë emrat në zanafillë, tregonte thelbin dhe funksionin e tij : SFINGE. (SFJET+GJË, do të thotë « s'flet gjë,

hesht» , zbërthyer nga studiuesi Bernardo Bilota (1843-1918) « *Studime filologjike rreth parahistorikëve* » Kastrovilar,1915) (1)

Sfinks i është emërtuar “Varri i Hermesit”, i njohur në Egjiptin e Lashtë me emrin shqipëtar « Thot » (ai që thot/na flet) nga doktrina e të cilit u frymëzuan Iniciuesit e Mëdhenj të njerëzimit si Rama (cikli arian), Krishna (inicimi bramanik), Orfeu (misteret dionisiake), Pitagora (misteret e Delfit), Platoni (misteret eleuziane) dhe Moisiu (misioni izraelit).(2) Askush deri më sot nuk ka mundur të hyjë në varrin e Thotit. Sfinks i ashtu si shqiponja e Ilirëve apo e Perandorisë Romake, përfaqëson *DRITËN* dhe *DIJEN* në përgjithësi, (në dialektin çam, fjala « di » do të thotë « dije » dhe « u bë dritë, agoi »). (3)

Viti 1938, për rastësi të fatit, do të shënonte dy nisma që lidheshin me ndërtuesit e Sfinksit :

E para, ajo e Xh.Katapanos që zbuloi alfabetin fonetik të hieroglifëve egjiptianë, me anën e gjuhës shqipe.

E dyta, nisjen e ekspeditës gjermane për të zbuluar misteret e dijeve të Thot-it, të kyçura në heshtjen e përjetshme të Sfinksit.

Ishte Himleri (Heinrich Himmler), themeluesi i repartit special SS, që ia ushqeui këtë ëndër Fyhrerit të tij. Të dy kreret e nazizmit, shpresonin të zbulonin shkencën e Atlantidëve dhe sidomos formulat magjike, që të sundonin Botën si Arianët mitikë. Sipas filologëve dhe antropologëve gjermanë të shk 19-20, gjermanët e kohëve moderne ishin me origjinë nga popujt e lashtë Arianë.

F. Osendovski, në librin e tij (Ferdinand Ossendowski « *Bêtes, hommes et dieux* ») pohon

se disa Lama të Tibetit, i kishin folur për një vënd të fshehur në thellësi të tokës të emërtuar “Agati” (në shqip: ag/dritë +Ati/Zoti dmth Zoti-Dritë) që ishte vënd-qëndrimi i Mbretit të Botës. Një mbrët i jashtzakonshëm që ndër shekuj kontrollon fatet e njerëzimit. Himler ishte i magjepsur nga Tibeti dhe ishte i bindur se pikërisht aty, ishte origjina e racës ariane dhe aty ruheshin forcat e lashta të pushtetit.

Ekspedita me shkencëtarë gjermanë e udhëhequr nga biologu Ernest Shefer (të gjithë anëtarë të trupave SS) u nis nga porti i Gjenovës në 21 prill të 1938, në drejtim të Indisë britanike për të kërkuar “rrënjët e humbura të popullit gjerman”.

Pas afro katër muajsh përpjekjesh për t’u lejuar të hynin në “qytetin e ndaluar” budist - Lhasa, grupi i



Ernest Schäfer (1910-1991)

shkencëtarëve gjerman më së fundi qëndronte perball tij. Antropologu Bruno Beger, kishte marrë urdhër nga Hitleri të zbulonte ngjashmëritë e kafkës midis popujve gjermanike dhe tibetianëve. Sipas Hitlerit, në rast se kjo vërtetohej, çdo forcë magjike që kishin trashëguar dijet e tibetianëve nga Arianët e lashtë, ju takonin edhe gjermanëve. Vetë ekspedita ishte emërtuar «Trashëgimia e Paraardhësve» (Héritage des Ancêtres).

Beger bëri qindra matje antropometrike të formës së kafkës, mbi vetullat, përmasat e fytyrës, por me gjithë kujdesin që patën kërkimet e tij, tiparet e gjermanëve nuk ishin të ngjashme me ato të banorëve aziatik në Tibet. Studiuesi nuk gjeti aty as ndonjë banor me flokë bjondë dhe sy bojë qielli. Të gjithë shkencëtarët i mundonte pyetja: A ka ekzistuar vërtetë një racë ariane dhe a ndodheshin vërtet në Tibet dijet dhe formulat e tyre magjike?

Megjithatë Sheferi ariti të marrë lejen për të vizituar fortesën Orion-Burakan, të ndërtuar nga Mbreti i parë i Tibetit para 1500 viteve. Për habinë e madhe të shkencëtarëve gjermanë, në vend të dijeve magjike të Arianëve të lashtë, në Tibet ata gjetën simbolin e tyre nazist “Svastikën”, me përmasa gjigande të shtrire mbi faqen e një mali me emrin “Kalash”. (fig poshtë)

Prej shpateve të tij buronin tre lumenjt më të mëdhenj të Botës. Mali Kalash mbahej si një mal hyjnor nga tre besime të ndryshme të Azisë dhe ndodhej 1500 km në perëndim të qytetit të Dalaj Lamës në Tibet. Fillimi i luftës së II Botërore e detyroi Sheferin të ndërpriste kërkimet e mëtejshme dhe të kthehej mbrapsht.



Mali i shenjtë budist Kalash në Tibet


Vetëm pas afro 50 vitesh nga ekspedita gjermane në Tibet, 200 km larg malit të shenjtë Kalash, u zbuluan gërmadhat e një mbretërie të lashtë tibetiane. Kryeqyteti i Mbretërisë legjendare Kuke ishte gërmuar tërësisht në brendësi të një mali. (4)

Këtu po e lemë ekspeditën e Sheferit dhe ëndrën e humbur të Hitlerit dhe do të nisim një “ekspeditë” të re : Zbulimin e Mbretit/Perëndi, që sipas traditës të popujve para-historikë, i dha emrin e tij malit të shenjtë – *KALASH*.

Kalashët, ushtarë të Aleksandrit ?

Koloneli anglez Robertson, që i pari evropian që zbuloi në fund të shekullit 19, në veri të gadishullit Indian, mes Vargmalit të Hindukushit (Afganistani Verior), Pamirit (Taxhikistan) dhe Karakorumit (Pakistani Verior/Himalajë) një popullsi të racës europiane që jetonte në izolim të plotë nga popullsia aziatike që e rrethonte. Një luginë e kësaj zone malore dhe banorët e bardhë të saj, emërtohen gjithashtu si mali i shenjtë i budistëve tibetjan: Kalash. Janë një fis, me popullsinë që jeton në luginën e Hundëzës të rafshnaltës së Pamirit. Gjuha që flasin, “burushaski” (gjuhë e burrave në shqip) nuk ka asnjë lidhje me dialektet e folura në gadishullin indian. Sipas gjuhëtarëve, gjuha e kësaj popullsie, për shkak të afrive mund të futet në familjen e gjuhëve dene-kaukaziane (dene-caucasica) ku bëjnë pjesë gjuha baske dhe e kaukazitë qëndrore. Gjuhëtari Ilia Kazul (Ilija Casule) mendon se gjuha burushaski, shpreh ndikimin e një gjuhe të lashtë indo-evropiane. (5) Analizat e ADN-së së kalashëve dhe hundëzakëve, dëshmuar lidhjen gjenetike të tyre me popullsinë europiane.

Studiuesit shqiptarë, duke krahasuar gjuhën e kësaj popullsie me gjuhën shqipe, kanë vërejtur jo vetëm rrënjë të përbashkëta, por edhe fjalë të njëjta që përdorin kalashët dhe shqiptarët e ditëve të sotme. Kjo përputhje çfaqet qartas në toponimet si psh: Lugina ‘Hundëza’- hundë; një vend moçalor emërtohet ‘Baltor’ si dhe qyteti ‘Balti’ – balta; mali Bubullimating që mund të lidhet me fjalën e shqipes –bubullimë; Nuristan (nur- një pamje bukurie,dial çam). Po edhe vargmali i Himalajave, sipas studiuesit Dr.Arif Mati vjen nga gjuha shqipe (mal maja) (6)



Vetë emri i gadishullit e ka burimin nga besimi dhe gjuha e pellazgo-shqipetarëve: Hindi = hyn (në dialektin çam ‘hin’)+ Di-a, dmth vëndi ku ka ardhur/hyrë Zoti, emër që e ka edhe gjuha më e përhapur në Gadishull – hindi. Edhe filozofi Sami Frashëri (1850 –1904) e emërtonte Hindi. Nga studiuesit e huaj nuk është gjetur origjina dhe kuptimi gjuhësor në gjuhët europiane, aziatike apo sanskriten e lashtë, për këto toponime dhe për vetë gjuhën ‘burushaski’, (gjuha e burrave, në shqip).

Ngjashmëria e madhe e Kalashëve në veri të Gadishullit Indian, me Shqipetarët e Gadishullit ballkanik, vërehet edhe në traditat historike kulturore, në ritet e simbolet e besimit dhe të jetesës së tyre të përditshme. “Zakonet rrojnë jo vetëm me shekuj- vëren J.G.Hahn (Johann Georg von Hahn, (1811 -1869) - por edhe me mijëra vjet, bile kemi (edhe sot) zakone të vjetra, të cilave nuk ua dimë kuptimin” (7)

Në vitet 20 të shekullit të kaluar, amerikania Rose Lane udhëtoi drejt Malsisë së Shalës në Veri të Shqipërisë. Në atë qoshe të haruar edhe nga Zoti, u hap një debat me një malësor të moshuar i cili ngulte këmbë se Filipi II, i jati i Aleksandrit të Madh, rridhte po nga raca ilire si e shoqja, Olimbija (Mirtali, stërmbesë e mbretit të Mirmidonëve, Akilit). Një djalosh që po dëgjonte kundërshtimin e mikes së largët, e cila siç duket nuk i njihnte “ligjet” e shqipetarëve, u hodh: “ Shqipetarët martohen me shqipetarët. Filipi II u martua me një grua prej popullit të vet, siç ka qenë gjithëmonë zakoni. Po të ishte grek, asnjë i parë i shqipetarëve nuk do t’i jepte bijën për grua” (8) Kjo traditë mijëravjeçare tek shqipetarët, u shkel mbas vitit 1945 (por jo masivisht) me krijimin e “Kampit socialist” të popujve vëllezër të një ideali. Por Hundëzakët e ruajnë me fanatizëm edhe sot këtë zakon. Ata nuk martohen me të huaj.

Kalashët për rastet e mortit, kanë një zakon - nuk i varosin të vdekurit, por i lenë deri sa treten në sipërfaqe të tokës, të cilin e ka hasur albanologu Nopça (Franz Baron Nopcsa von Felsöszilvás, 1877-1933) edhe në disa krahina shqiptare. Banorët në Karmë dhe Galishtë të Malësisë së Veriut të Shqipërisë, i kishin treguar se të parët e tyre i linin të vdekurit mbi sipërfaqen e tokës dhe vetëm kur mbeteshin kockat, i varrosnin. (9) Ashtu si iliro-shqipetarët, kalashët-hundëzakë nuk e pranonin nënshtrimin ndaj të huajve dhe kanë luftuar për lirinë e tyre. Sipas të dhënave historike, për 900 vjet ata kanë patur principatën e tyre dhe kanë jetuar të pavarur nga ndonjë shtet i huaj deri në vitin 1974.

Udhëheqësit kalash, në kohët e vjetra emërtoheshin *TSIAM* (Çam-popullsia e Thesprotisë), që më vonë u zëvendësua me titullin *MIR* (i miri/i urti në shqip). Sipas gojëdhënave të popullit kalash, në “Tsiam” është vëndlindja e kombësisë së tyre ku shpresojnë se do të kthehen një ditë. Studiuesi arvanit Aristidh Kola pohon se, vend-ndodhja burimore e kalashëve është tek lumi i lashtë thesprotas ‘Thiamis’, prej nga rrjedh edhe vetë emri i Çamërisë. ‘Tsiam’ domethënë Çam. (10) Me këtë emër njihen banorët autoktonë shqiptare në krahinën e Epirit.

Por, nuk është vetëm gjuha që i afron popullsinë kalashe me shqipetarët, por edhe simbolet e ritet besimtare.

Dhia Amaltea, sipas mitit pellazg, ushqeu Zeusin e Dodonës me qumeshtin e vet në ishullin e Kretës. Për adhurimin e dhisë në trojet arbërore, ka shkruar Plini i vjetër, Varoni, Eliani, Atheneu, etj. Dhinë e gjejmë të vizatuar në shpellën paleolitike pranë Butrintit (Shën Marinës) para afro 40 000 viteve. (11)

Edhe për kalashët dhe hundëzakët, dhia është kafshë hyjnore dhe gdhendin në dyert e shtëpive dy brirë dhije, si simbol të mbrojtjes së tyre nga Perendia Dezau (dhias-Zeus) dhe mbajnë për nder të tij, një zjarr të pashuar në shtëpitë e tyre. (12)

Në fig.(a, poshtë) kemi një skulpturë, të fundit të shk19, të Kafirëve Bashgali gjetur në Luginën Kalash të Pakistanit. Është një skulpturë gruaje në fron me dy brirë dhije mbi kokë. Në fig (b) Koka e Zeusit pellazg me brirë dhije dhe fig.(c) Heroi i Kombit shqiptar Gjergj Kastriot Skënderbeu (1405-1468) me një helmet me simbole pellazge dhe kokën e dhise.



Sipas gojdhënave të tyre, kalashët dhe hundëzakët e quajnë veten pasardhës të ushtrisë së Aleksandrit të Madh –Iskanderit, që është edhe emri i Heroit Kombëtar të shqiptarëve, Skenderbeut. Po a janë vërtet kalashët, burrat dhe gratë që e shoqëruan Aleksandrin e Madh deri në Indi? Unë mendoj, se faktet e sipër-pemëndura e mbështesin këtë origjinë sipas gojdhënave të tyre. Por, emri *KALASH* dhe *SIMBOLET* e besimit që i kanë ruajtur deri në ditët e sotme, zbulojnë një prejardhje shumë më të lashtë, se sa koha e pushtimeve të Aleksandrit në Indi më 326 pK.

Kalash = Swastika

Do t'i trajtoj këto emra me anën e gjuhës shqipe, e nisur nga fakti i ngjashmërive të popullsisë kalashe në gjuhë, zakone dhe simbolet e besimit, me ato të trashëguara tek shqiptarët e ditëve të sotme. Jo pa qëllim kam vënë shenjën e barazimit midis emrit të malit Kalash dhe emrit të simbolit Svastika. Këto dy emra, siç do ta shikojmë më poshtë, jo

vetëm që dëshmojnë përkatësinë e tyre pellazge, por edhe kanë të njëjtin kuptim simbolik në besimin hënor të Dodonës dardano-thesprote. Këto dy fise (të Kosovës dhe Iperisë/Epirit), ishin jo vetëm *NJE GJINI* (Titanët=Tanët, gjaku ynë) siç e tregojnë edhe Mitet, por edhe formuan besimin institucional të pellazgëve në Dodonë.

Në këtë drejtim na ndihmon materiali i dy studuesve të njohur të shkrimit pellazg, Luftulla dhe Liljana Peza, të cilët shprehen se: “Sipas mendimit tonë, duke gërmuar në domethënien e fjalës Swastika, del se kjo fjalë ka ardhur nga dy fjalë pellazgo/shqipe, që më pas janë huazuar nga gjuha sanskrite. Pjesëza e parë e fjalës “Sw” vjen po nga gjuha e lashtë pellazge Su=Zu (Zeu). Emri përbëhet nga dy fjalë: Zeu (Zeus) + ast d.m.th. “Zeusi asht” (dial.geg). (13)

Unë do t’i shtoj edhe pjesën “Ka” (Sw+ast(i)+ ka), jo si mbaresë (në para-histori nuk ka patur mbaresa apo nyje), por si një fjalë e cila shpreh kuptimin e krejt emërtimit dhe do të thotë “Zeu është Ka (u)”.

Zbërthimi i emrit të sipër-përmendur mbështetet edhe tek miti dhe skulpturat pellazge të Minotaurit (në shqip:Mino/emri i mbretit të lashtë pellazg+kau) (fig.a).



(a) Minotauri pasqyrohet me kokë kau. (b) Minotauri me trup kali dhe kokë njeriu.

Mendoj se pasqyrimi më i hershëm i Minotaurit ka qënë me kokën e kaut ,nisur nga tradita arkologjike e Perëndeshës-Zog. Kau dhe kali, siç do ta shikojmë më poshtë, mbartin të njëjtin simbol në besimin hënor të pellazgëve (fig.b).

Edhe emri Kalash ka po të njëjtën ndërtim: Kal+ ast, që në gjuhën e sotme bën Kal+ash(t) ku nënkuptohet emri i Mbretit, siç ndodh edhe sot kur themi “është luan” pa thënë emrin

e njeriut. Po ky emërtim, vërehet edhe tek emri Deukalion, i cili së bashku me familjen shpëtuan nga përmbytja e madhe dhe krijuan racën e re njerëzore : Deu/Zeu+kal+i on dmth Mbreti/Perëndi kali ynë (apo Zeu kalorësi i jonë). Sipas albanologut J.G.Hahn ky emër vjen nga gjuha shqipe “dhe-u” (14) Por studiuesi nuk na e shpjegon pjesën tjetër të emrit dhe i marrë si “dhe-u”, nuk ka kuptim sipas mitit. Plutarku dhe Aristoteli gojdhënë e Deukalionit e lokalizojnë në krahinën e Dodonës në Çamëri dhe J.G.Hahn shprehet se : “Besoj që (ky emër-shën im) është shumë i vjetër dhe priftërinjtë e Dodonës e kanë përdorur në vendin e tyre”. (15) Po këtë emërtim e gjejmë si toponim në Shqipëri - Kalimash : Kal+im+ash(t) dmth Zeu/kali i jonë.

Sipas M.Gimbtas, gjatë Paleolitikut në vizatimet e shpellave (La Pileta, Escural - Spanjë, Lascaux- Francë) gjatë viteve 15000- 10000, Kau lidhej me kultin e Hënës. (16) Priftëreshat që i shërbenin Perëndisë hënore, mbanin mbi kokë brirë (të kaut), si simbol të saj. (*Dizionario illustrato della civiltà etrusca – Mauro Cristofani*) (17)



(majtas) Kau i shenjtë, Perëndia Api në Egjiptin e lashtë . Brirët e tij në formën harkore mbajnë hënën e plotë, si Perëndia hënore Isis, që dëshmon për besimin pellazg në Egjiptin e lashtë .

Në Fjalorin e esoteristes së shk19, Helena Blavatski, lexojmë se në alfabetin e hebrenjve Kau (𐤀) është simbol i gërmës A (Aleph) me të cilën fillojnë pothuaj të gjithë alfabetet e botës. Kjo gërmë ka një fuqi të madhe mistike dhe shpreh vlerën numerike “Një”. Tek Kabala kristiane përfaqson Trinitetin tek Uniteti dhe është e ndërtuar nga dy Y me drejtim të kundërt

(⌘), (18) që nuk është gjë tjetër veçse Svastika. Ky fakt dëshmon drejtësinë e zberthimit gjuhësor që kemi bërë, si dhe lashtësinë e gjuhës shqipe.

Siç vërejnë studiuesit, në besimin e Kalashëve të Azisë, kali kishte një rëndësi të veçantë. Në shekullin 20, kur europianët mblodhën dhe restauruan objektet e kulteve të tyre, pjesa më e madhe e figurave prej druri ishin ato që paraqitnin kalin. Edhe në materialet arkeologjike të ilirëve, Dioskurët, binjakët e Zeusit paraqiten gjithmonë të shoqëruar me kuajt. Në mitet pellazge, kuajt me krahë shqiptonje çojnë çdo vit Apollonin në vendin e Ipe-borealëve. Siç dëshmon F.Pukëvil (François Pouqueville, 1770 -1838), edhe në shk 19, Shqiptarët shquheshin për kuajt e tyre të racës : « ...qentë e tmershëm (molosë-shën im) që ruajnë kopetë e bagëtive dhe kuajt e famshëm të Shqipërisë janë më të mirët në Turqinë Europiane, si nga bukuria e trupit ashtu dhe nga shpejtësia e vrapimit »(*Voyage dans la Grèce*, Paris,1820) (19)

Në këtë pikë të “ekspeditës” sonë duhet të sqarohen dy probleme:


Së pari: Përse emri “ka-u” dhe “ka-l” (‘kaështë rrenja) në besimin pellazg shprehin të njejtin simbol?

Së dyti: Nga e ka origjinën Mbreti hyjnor i Tibetit me emrin Kalash?

Dua të theksoj, se sqarimi i këtyre dy pikave, lidhet me problemin më të rëndësishëm të Historisë së lashtësisë europiane: Vërtetësinë me fakte, të ekzistencës historike të fiseve *ARIANE* dhe vëndin e *ORIGJINËS* së tyre. Që të sqarohet pika e parë duhet të zhytëmi në thellësitë e para-historisë, në periudhën kur në besimin e njeriut primitiv, nuk ishin krijuar akoma mitet e Perëndive me pamjen e njeriut.

Swastika – energjia e përjetshme

Për të sqaruar pyetjen e parë, më përpara duhet të kuptojmë së çfarë ka përfaqësuar simboli i swastikës apo kryqi i thyer, siç e njohim sot. Padyshim swastika është një ndër vizatimet gjeometrike të para-historisë. Ky simbol është gjetur i gdhëndur në kockat e mamuthit (Gagarin) që i përkasin periudhës së fundit të akullnajave, si simbol i besimit të parë të njeriut primitiv (20)



(a) Swastika (kryqi i thyer) në vizatimet e kulturës pellazge Vinka (Periudha neolitike, mijëvjeçari 6-5 pK) (b) Svastika dhe kryqi në veshjen e Malesise së Madhe, Shqipëri, shk20.

Besimi ka lindur krahas shkëputjes së njeriut nga bota shtazore (njeriu i Paleotropit,) dhe siç shprehet M.Eliade: “Të jetoje si njeri, ishte në vetvete një veprim besimtar”. (21) Ajo që i ka habitur studiuesit ka qenë qenia e figurave të njejta gjeometrike, domethënia e të cilave duket se ka mbetur e pandryshuar gjatë 30 000-9 000 viteve, në një hapësirë gjeografike, prej bregut perëndimor franko-spanjoll e deri në Siberi. Sipas studiuesit Leroi-Gourhan, kjo pandryshmëri e simboleve të besimit, ka të bëjë me përhapjen nëpërmjet

takimeve, të **të njejtis sistem ideologjik** që përcakton “besimin e shpellave”. (22) Këtë fakt e ka pohuar edhe shkencëtari arbëresh Xh.Katapano: “Studimet shumë-vjeçare të rendit filozofik, teofizik, historik, arkeologjik, etnografik, mitologjik, matematik, kimik, fizik më kanë çuar në përfundimin se **duhet përmbysur tradita, që e paraqet qytetrimin neolitik si frut kryqëzimesh**“ (23)

Ky pohim na sqaron se përse svastikën (krahas simboleve të tjera) e gjejmë në Europë, Afrikë, Azinë e Afërt dhe të Largët e deri tek Aztekët e Amerikës dhe përse ka ngjashmëri në simbole, mite dhe rite në këtë hapsirë gjeografike. Këto studime, dëshmojnë tezën se: Njeriut primitiv që i përkisnin **SË NJEJTËS RACË**. (siç do të shtjellohet më poshtë), duke lëvizur **NË VAZHDIMSI** gjatë mijra-vjeçarëve në hapsira shumë të mëdha gjeografike, ka përhapur (apo ju ka detyruar) vëndësve, **NJË BESIM** zanafillor, atë më të zhvilluarin për kohën, nga Europa deri në Azinë e Largët.

Po çfarë simbolizon svastika ? Studiuesi N.Stillo e trajton si shkronjë e shkrimeve lineare tepër të lashta në Europë, që i përkasin shk 6,5,4 pK , janë gjetur në shumë vende: në lindje të Beogradit, në Vinka , në Argisa të Larisë (8200 pK , Greqi), në Sesklo të Magnezisë (8700 pK), në manastirët e Çamërisë (5508 pK) etj. (24) Në fotot poshtë jepen disa forma të svastikës në obkttet arkeologjike.



(a) Kryqi bask (b) Buda (c) simboli në formë helike tek këmba e luanit në Egjiptin e lashtë. Museo Egizio,Torino .



(a) Qylym i fronit të Dalaj Lamës. Është simbol i riteve të besimit në Buddhism, Bön, Himalayan Shamanism, Korean Buddhism, dhe Japanese Buddhism (b) Hieroglifi që shpreh Svastikën në kulturën Azteke e emërtuar “Teotihuacan” (c) gur varri në trevat shqipetare.



(a) Simboli mbi varrin e Princit armenian Hasan Jalal Vahtangian (1214 - 1261). (b) Svastika dhe briri i kaut. Mozaik në Muzeun arkeol. Arle, Francë (c) Mozaik në Bazelikën e qytetit të Tiranës ,shk 4-5.

Deri më sot, nuk është dhënë një përgjigje shkencore së çfarë shpreh ajo në besim dhe jo rrallë lexojmë se është një simbol diellor. Nga fotot lart ,vërehet se i njeiti simbol përfshin pothuaj të gjithë Botën dhe kudo shpreh të njëjtën ide : *LËVIZJEN*. Pra svastika nuk ka paraqitur simbolin e Diellit rezatues, por të turbinës që është në lëvizje. Këtë figurë e gjejmë si simbol në mburojën e eolasve dhe të Eneas që quhet si prijësi i parë dhe themelues i eolëve latinë. (25)


Se çfarë shprehte në besim rrënja “ka”, do ta kërkoj tek popullsia pellazge, me gjuhën e së cilës (pellazgo-shqipen) janë emertuar **kau**, **kali** dhe **svastika**. “Ekspedita” jonë e lashtësisë, nuk ka marrë parasysh kufijtë e sotëm shtetërorë, por do të përfshijë të gjithë hapsirën ku kanë jetuar fiset pellazge. Përgjigjen e gjetëm pikërisht në shkrimet që u zbuluan në Egjipt, ku siç dihet Dinastitë e para dhe më të famshme, kanë qenë me origjinë *PELLAZGE*. Këtë e dëshmon edhe filozofia okulte, sipas së cilës egjiptianet e lashtë ishin Atlantidët-Arianë që shpëtuan nga përmytja. (*Il Glossario Teosofico*, Helena Petrovna Blavatsky)

Për rrënjën “ka”, që ndodhet në emërtimet **Kalash** dhe **Svastika**, në librin “*Mësimet e Ptahhotepit*” (mijvjeçarit të 3-të pK), thuhet: “Maksima 26- Mbi përdorimin e drejtë **të energjisë krijuese « ka »**; Ajo gjendet kudo, në qëniet me shpirt dhe tek ato pa shpirt. I takon të urtit të mësojë se si ta përdorë Ka-në.” (26)

Pra Svastika, në të gjitha format e saj, simbolizon në besimin e pëllazgëve *ENERGJINË KRIJUESE* të përjetshme e njohur sot si “shpirti”, të cilën Zoti e ka mëshiruar kudo në Natyrë.

Në shumë monedha të shtetit të Epirit (Aleksandër dhe Pirro Molosit) paraqitet kau në sulm. Kau flijohej Perëndeshës Dhemetra, Zeusit thesprot, Dionisit, Apollonit etj. dhe shumë toponime mbanin emrin e tij. Në kostumet popullore të krahinave të ndryshme në Shqipëri, gjendet i stilizuar kulti i kaut (Gjirokastër, Tepelenë, Berat, Kukës, Lezhë etj) (27)

Per iliro-romakët, koka dhe bishti i kalit, ishin vëndet ku ndodhej “Ka”-ja dhe para betejave ua bënëin fli Perëndisë së luftës Marte. Gjithashtu në helmetat e tyre, vendosnin bishtin e kalit, që Zoti t’i mbronte në luftë (fig.1 lartë).



(a) Detaj nga skulptura e luftëtarit të shk.1, Atikë. (b) Bishti i kalit tek qelesnja në kostumin shqiptar, Shkodër, shk. 20.

Këtë “bisht kali” e gjejmë edhe në qeleshen e shqiptarëve, që dëshmonte lidhjen me Krijuesin. Në lashtësi veshja, modeli i flokëve, simbolet tek armët, zbukurimet, etj tregonin se kujt popullsije dhe besimi i përkisnin.

Simboli i “Enejisë krijuese - Ka” ndodhet edhe tek popullsia Kalashe e Azisë (Bumburet) tek këmba e drurit të dy skulpturave binjake (fig.a) që i kushtohen “Kultit të të parëve”, që dëshmohet nga froni karakteristik i Perëndive të para-historisë.



fig.a



fig.b



fig.c

Për origjinën pellzgo-ilire të kalashëve “flasin” edhe qeleshet mbi kokat e statujave, që është karakteristikë e veshjes së traditës iliro-shqipetare. Tek (fig.b) kemi një malësor shqipetar, shk 20. Kjo skulpturë (fig c) gjithashtu ju kushtohet dy binjakëve me qeleshe, Dioskurëve, bijve të Zeusit. Statujat e kalasheve (fig.a) mendoj se i kushtohen mitit pellazg të këtyre binjakëve me qeleshe, bijë të Kaut (dëshmuar nga svastika dhe qeleshet).

Siç dëshmon Maria Gimbutas (*Il linguaggio della Dea*), në artin e Paleolitikut, të Hekurit e sidomos të Bakrit, svastikën e gjejmë të shprehur në statujat primitive, enë balte, pllaka, altarë, etj. si shprehje e figurës femërore të hyjnizuar. (28) Dalja në skenë e Mbretërve/ Heronj, që vendosën pushtetin me anën e *FORCËS* ushtarake, *LIGJEVE* dhe *DIJES* mbi hapësira të mëdha gjeografike, solli ndryshime të mëdha në besim. Perënditë mashkullore të Euro-Azisë që u vendosën në Panteonin e Hyjnive, (gjatë patriarkatit), morrën nga Perëndeshat, krahas fronit edhe simbolet e periudhës së herëshme (të matriarkatit) si kaun, shqiponjen, yllin/kryq, etj.

Kau dhe Kali, që sipas bësimit pëllazg shprehin “enegjinë hyjnore”, kishin vlerë simbolike të barabartë. Shumë sende apo dukuri të ndryshme në natyrë, por që shprehin simbole të njejtë në besim, u janë vënë emra apo kanë rrënjën e emrit të njejtë. Cirlot : « Analogjia është ndoshta guri i themelit i tere ndertesës simbolike...Analogjia si një process unifikues dhe regullues shfaqet vazhdimisht në art, në mite dhe në poezi » (29)

Prandaj emri i malit-Kalash dhe i simbolit të Svastikës në faqen e tij, shprehin të njëjtin *PORTRET* – Mbretin tokësor, emri i të cilit shpreh simbolin e “Energjisë krijuese” : Asht *KA* !

V - Mbreti më i drejtë i antikitetit dhe më i haruari i historisë

Që emri Kalash, i takon një Mbreti tokësor të hyjnizuar, na e dëshmon Esiodi : “Perënditë dhe njerëzit e vdekshëm kanë të njëjtën origjinë” (*Le opere e i giorni*, 108). (30) Fakt që e mbështet edhe emri i popullit “Kalash” që jeton edhe sot në atë hapsirë gjeografike. Studiuesi J.G.Hahn shkruan se :“Nuk është nevoja të sjellim prova që shumë emra popujsh të vjetër janë të njejtë me emrat e perëndive të tyre kombëtare”. (31) Shëmbull është edhe emri Alban i shqipetarëve, siç do të shikojmë më poshtë.

Emri në para-histori ishte “biografia” e njeriut, dmth shprehte cilësitë, “punët” dhe prejardhjen e tij. Prandaj njeriu kishte shumë emra, të cilat mund t’iu viheshin edhe të tjerëve në rast se dalloheshin për të njejtat merita. Kështu hasim disa Zeus, Horos, Moisi, Herkul, Agamemnonë, Dionis, etj. Por në Mit, kujtohej ay më i famëshmi, bëmat e të cilit na kanë mbritur deri më sot nga autorët e lashtë, objektet arkeologjike, gjuha dhe besimi.

Për të lehtësuar problemin, nuk po përshekruaj rrugën se si studiuesi Niko Stillo (“*Etruskishte-Toskërishte*”) arriti të zbulojë disa nga emrat, shpikjet dhe heroizmat e

“Mbretit më të drejtë të antikitetit dhe më të haruar të historisë”, siç e ka emërtuar ay bashk-kombasin e tij të para-historisë.

Nga mitet më të njohura të lashtësisë është ajo e Minotaurit, foton e të cilit e paraqitëm në fillim të materialit. Ky emër përbëhet prej : Mino+taur dmth Mino/ kau dhe sipas N.Stillos bëhet fjalë për mbretin e Mikenës- Mino, i njohur edhe me shumë emra të tjerë. Në lashtësinë egjiptiane e gjejmë me emrin e faraonit tokësor Amasi-t që egjiptologët e quajnë Ahmose (1550-1525 pK) (32)

Në gjuhën shqipe, Kalit i thonë edhe At, që është gjithashtu një nga emrat e Minos dhe në foton poshtë (fig.a) paraqitet si djalosh (në besim), i njohur me emrin Attis : At+ is ,në hebraisht “ is” ka kuptimin “Drita e Parë”dmth Ati / Kal + Drita (e Zotit) (33). Sipas Diodorit (Diodori 3,70,1) atë e quajnë “Ipokentaurë”, gjysëm kalë dhe gjysëm njeri, “sepse ishin të parët që e zbutën kalin dhe u mbrauajt miti se lindën dyformësh” (34) Kapelja “frige” e Attis apo Adonis (Kalorësi i parë, hyjnor) është e njejtë me atë të Zeusit (35) dhe shqipetarëve të Çamërisë në shk19 (fig.b)



(a) Skulptura e Attis me qeleshen frige ,shk 2 pK (b) Nje shqipetar nga Janina me qeleshen të njejtë si Attis.

Në materialet arkeologjike, (fig.c) mbretin e famshëm Mino e kemi të paraqitur në kulmin e moshës, gjysëm çjap e gjysëm njeri, i njohur me emrin PAN. Pani apo emri i plotë i tij - Alban shpjegohet me dialektin çam të gjuhës shqipe : A LË PAN dmth A (i pari) LË (lëri-vuri) PAN (panat-velat). Sipas miteve që i pari që përdori velat në anije. (36) Emri i tij është përjetësuar në vargmalet e Europës dhe Shqipërisë Veriore- ALPET. Tek latinët gjërma ‘p’ u ndrua me ‘b’ dhe sot kemi emrin Alban, që përbën një nga emrat e shqipetarëve dhe e gjejmë si toponim në shumë vende te Botës. Pani ka qenë mbreti-bari që mbrehu kaun (37) dhe i hypi kalit. Në mite, e njohim si baba të Zeusit të Olimpët, me emrin Kroni.

Emri i vërtetë i tij është Momfeu, Mbret i Çamërisë/ Thesproti (38) Ky vënd, nga vendësit autokton emërtohej- Iperi (Shqipëri –Ipe në dial. çam =shqiponjë, zogu i Zeusit) ku nga shkruesit, dy zanore kanë ndëruar vëndet (i/e) dhe ka mbetur Epir. Në Iperi lindën ritet e para të misterit dhe shumë mbret e mbretëresha u hyjnizuan si Perëndi.



(a)Gerasa (Jerash), Giordania. Dy svastika në dy anët e lepurit, qe në mite lidhet me hënën, dhe majtas dallohet qartë emri PAN.
(b)Pani me koke dhije dhe Kau ne sulm, me shkrimin poshte: Thorius (kau)-Albus. (39) Albani apo Pani, kishte dy djem binjakë, mbretë-luftëtarë, shpikës, ligjvënës dhe Priftërinj të mëdhenj: Nakon dhe Sharrian që historiografia i nje me emrin DIOSKURË . Ata emërtoheshin Kabirë (Cabir) (Ka+bir, në gjuhën shqipe: bij të Kaut) siç u emërtua edhe fisi i tyre.

Sipas Xh.Katapanos, pellazgo-ilirët duke kaluar nëpër Kaukaz, i janë ngjitur vargmalit të Himalajave që në epokën e Gurit. (40) Nga këto marshime drejt Lindjes, grykat shkëmbore të maleve të Kaukazit, në lashtësi emërtoheshin “Portat e Albanit”. (41) Që nga ajo kohë, nuk kanë reshtur emigrimet e këtyre fiseve drejt Lindjes. Ky fakt mbështetet në toponimet, gjuhën, mitet dhe simbolet e besimit pellazg, që kanë paralelet e tyre në Azi, sidomos në besim dhe gjuhën sanskrite. (shiko Petro Zhej “Shqipja dhe Sanskritishtja”,pj II,)

Besimi në Azinë e lashtë, sipas teksteve të Rig Vedës, i përkiste një elite priftërinjsh të nënshtruar ndaj nje aristokracije ushtarake. Pra bëhet fjalë për një ushtri që u diktonte banorëve autokton me anën e forcës. Në Rig Vedën indiane, flitej për një popullsi armike me emrin “Pani” të cilët u vidhnin lopët dhe nuk pranonin besimin vëndës (42).

Për pushtuesin më të madh të të gjitha kohrave na dëshmon edhe Diodori : « Më të kulturuarit ndërmjet indianëve tregojnë , një mit (...)Thonë se në vitet më të lashta, atëhere kur banorët e vëndit të tyre jetonin të shpërndarë në fshatra, ariti Dionisi nga anët e perëndimit me një forcë të konsiderueshme. Përshkoi gjithë Indinë, ngaqë nuk ekzistonte asnjë qytet i rëndësishëm i cili të kishte aftësinë që të paraqiste qëndresë (...) u bë themelues i qyteteve të rëndësishme duke përmbledhur shumë fshatra bashkë në vënde të përshtatshme, u predikoi të nderojnë hyjnitë dhe parashtroi ligje dhe gjykata. Dhe me pak fjalë, me veprat e shumta dhe të veçanta që kreu, u besua si Zot dhe ju bënë nderime të pavdekshme.Thonë se mbarti bashkë me ushtrinë, një numër të madh grash, dhe në betejat e luftës, përdori tambure dhe cimbele , se ende nuk ishin shpikur trumbetat (...) Kreu vepra më të ndritshme nga çdo mbret tjetër para tij (...) (43)

Që Diodori flet për Albanin, mbretin e Thesprotisë, na e dëshmon jo vetëm N.Stillo që

pohon se Dionisi dhe Ari ishin gjithashtu emrat e tij, por edhe emri i popullsisë “kalash” të Hundëzës, i malit në Tibet dhe simbolit të svastikës, që kuptohen me gjuhën dhe mitet iliro-pellazge. Asnje gjuhë tjetër nuk i ka shpjeguar deri më sot. Këtë e dëshmojnë edhe pasardhësit e fiseve iliro-pellazge: *ALBANËT* apo *ARBANËT* e sotëm (Shqipëri, Kosovë, Mal i Zi, Maqedoni, Greqi dhe Diasporë) që, siç e vërtetuar në fillim të materialit është e vetmja popullsi që ka ngjashmëri në gjuhë, besim e traditë me *KALASHËT* hundezakë. Janë gjithashtu legjendat e kësaj popullsie që dëshmojnë se origjinën e kishin në Çamëri.

Perfundimi: Emri i mbretit legjendar Kalash i përket Mbretit thesprot Alban (Alpan) apo Ari apo Joni, etj. Ushtria që mbeti pas tij dhe valët e fiseve iliro-pellazge, që vijuan të shkojnë në Lindje, siç bëri edhe Aleksandri i Madh, përhapën në Azinë e largët kultin e besimit hënor të Dodonës. Ata e “vulosën” emrin e tij (svastikën) në shpatin e malit të shenjtë në Tibet dhe në besimin budist. Këto fise pellazge, qenë të parat, që hapën rrugën midis Perëndimit dhe Lindjes, e cila më vonë morri emrin “Rruga e mëndafshit”. Origjina *ALBANE* dhe vënd-lindja *NË TREVAT HISTORIKE TË ARBËRVE* e Mbretit *ARI* dhe e fiseve të tij “*ariane*”, lexohet edhe në “pashaportën” e tij : Rrënja “*AR*” e emrit, e cila shpjegohet vetëm me gjuhën dhe mitet iliro-pellazge (F.Demi *Shqipe-ri ,emri , parahistorik i Zotit, në botën moderne, pjesa e I-rë*).

Këtë rrënjë e gjejmë edhe tek Perëndia pellazge e luftës, Ares. dhe tek latinet Marte (Mars), që quhej edhe Pirro e Silvanus (që gjithashtu lidhen me historinë e lashtë të iliro-shqipëtarëve) i cili kishte si simbol kulti, krahas shigjetës, Kalin dhe Kaun. Mbreti më i Madh i të gjitha kohrave -*ARI*- të cilin e kërkoi deri në Tibetin e largët, ekspedita gjermane e Himlerit, e humbi jetën në Kosovë, ku sot gjëndet qyteti i Prishtinës, emri i së cilës në gjuhën shqipe, e tregon këtë fatkeqsi. (45)

SHQIPE-RI, EMRI PARAHISTORIK I ZOTIT, NË BOTËN MODERNE

(PJESA E I-rë)

*Ai që studion filologjinë, duke përjashtuar korologjinë, etnografinë, historinë
e besimeve fetare, psikologjinë dhe vetë mitologjinë, nuk do të mund të hyjë kurrë
në Faltozen tepër të lashtë të Fjalës*
Xhuzepe Katapano

Problemi ,ndoshta më i vështiri i shkencës Historike është të zbulojë origjinën e emrave të popujve. Arsyeja është se emri, sikurse ADN e sotme, zbulon prejardhjen, moshën e ekzistencës dhe se çfarë ka trashëguar nga të parët e tyre. Për rëndësinë e veçantë që ka emri, do ta nisim këtë material pikërisht me pyetjen:

Nga e ka origjinën emri Shqipetar ?

Në zanafill kjo pyetje u shtrua në shkrimet e studiuesve të huaj. Mbi bazën e njohurive që kishin mbi historinë dhe traditën e shqiptarëve, gjatë dy shekujvë të fundit, dolën në pah dy teza kryesore: 1- E ka origjinën nga gjuha që flasin shqiptarët; 2- Nga emri i shqiponjës në flamurin e Skënderbeut dhe luftrat e shekullit XV kundër Perandorisë Osmane.

Teza e parë: E nxjerr origjinën e emrit „shqipetar“ nga ndajfolja „shiptoj qartë“. Për herë të parë këtë përfundim e gjejmë tek L.Benlou (Louis Beonlew „*La Grèce avant les Grecs*“, 1877) i cili i ndikuar nga mendimi i J.Xylander (Joseph Carl August Anton Aloys Ritter und edler von Xylander, 1794-1854) pohon se fjala « shqiptar » ngjason me fjalën « shqiptoj ». Por e braktis shpejt këtë teori sepse nuk ishte shumë e besueshme.(1)

G.Weigand-i, dëshmon se “shqip” dmth flas qartë, kuptueshëm. Edhe gjeografi Eugen Oberhummer (1859-1944) dhe albanologu austriak Hahn janë të këtij mendimi. Gjermani Gustav Meyer, origjinën e fjalës e gjen tek fjala latinë “excipere”- kuptoj, mendim i pranuar edhe prej Jeriçek-ut. (“*Die Balkanvölker*” 1917, f330) (2) Edhe në ditët e sotme ,për emrin e shqiptarëve, në botimet e studiuesve dhe në Enciklopeditë e huaja, zë vend kjo tezë.(3)

Edhe disa studiues shqiptarë, të ndikuar nga albanologët e huaj e pranojnë këtë origjinë të emrit.

Kristo Frashëri pohon se : Apelativi i ri lindi nga fjala shqip, të cilën e ndeshim që te Buzuku, “shqiptar”, ai që flet shqip, ai që e kupton gjuhën shqipe.(4)

Xhevat Lloshi: Emërtimet e reja për gjuhën, banorët dhe atdheun e shqiptarëve , janë formuar mbi bazën e ndajfoljes shqip : shqip, gjuha shqipe, shqiptar, Shqipëri.(5)

Bardhyl Demiraj (*Shqiptar dhe shqa. Histori popujsh përmes dy emrave etnikë*): Nga ana kuptimore, folja shqipoj apo më drejt shqiptoj, siç gjëndet sot e përhapur gjërësisht në të folmet e shqipes, në zanafillë ka pasur domethënien “kuptoj, marr vesh”, siç e jep Hahni e Meyeri etj. (6)

Ka edhe pohime “shkencore” se: „Studiuesi me të drejtë u largohet formave romantike dhe madhështuese të shpjegimit të emrit etnonimik të shqiptarëve përmes një shënje, që nuk ka qenë ndonjë herë totem i shqiptarëve, SHQIPONJES apo formës së shkurtër, shqipes.(7)

Për sa më sipër del se : Populli ynë e quajti veten Shqipetar sepse, anëtarët e tij flisnin qartë me njeri-tjetrin dhe e kuptonin gjuhën e tyre. Natyrshëm lind pyetja : Por edhe popujt e tjerë, e kuptonin qartë njeri-tjetrin në gjuhën e tyre, përse shqiptarët duhej të vet-quheshin si banorë « që mirreshin vesh », dhe të braktisnin emrat mijëravjeçarë të stërgjyshërve të tyre ?

Po t'iu drejtohem dokumenteve të para shkrimore, vëmë re se, gjuhët nuk kishin emërtime, por përcaktoheshin në gjuhë « të njejtë » të fiseve të caktuara dhe « të ndryshme » (barbare) të fiseve të huaja. Në shkrimet e Tit Livit lexojmë se: Aetoles, Acarnanes, Macedones “të tre popujt flisnin të njejtën gjuhë ...” (8) Popujt dhe fiset që flisnin të njejtën gjuhë, e quanin veten, fise të së njejtës etni. Në një dokument të Aleksandrit të Madh, zbuluar nga Lucia Nadin (Muzeu Correr, Venedik) shkruhet : « Unë Aleksandri, bir i Filipit, mbretit të maqedonasve, (...) pinjoll i FARËS së shquar të popujve Ilirikë të Dalmacisë dhe Liburnisë dhe të popujve të tjerë të së njejtës gjuhë që popullojnë Danubin dhe zonën qëndrore të Thrakës...» (9)

Në periudhat e mëvonshme, gjuhët u emërtuan sipas emrave të popujve, që e flisnin atë dhe asnjëherë s'ka ndodhur e kundërta, siç pohojnë mbështetësit e tezës së parë. Pra , emërtimi i Kombit tonë nuk e ka origjinën nga gjuha që është folur, por nga faktorë të tjerë thelbësorë. Natyrshëm lind pyetja: Për ç'arsye, një tezë e dështuar e shk19, nxjer kryet në shk 21?

BESIMI popullor- pohon Dhimitër Pilika- kudo në viset shqiptare e nderojnë shqiponjën si të shenjtë, të paprekshme (...) Atë e gjejmë në formë natyrale apo të stilizuar : mbi dru (arka, dollape, tavanë, djepe, lugë, furka, etj) ; mbi metal (kama, shpata, ene shtëpijake , zburime burrash dhe grash, pushkë etj) ; tekstil e lëkurë (opinga, rypa, kostume popullore, çorape, perde, qilima etj) ; gur (qemere, vatra, kamare).(10) Por edhe në këngë, valle, emra njerëzish, toponime dhe si simbolin kryesor të Kombit dhe Shtetit tonë.

Tëza e dytë e shikon origjinën e emrit të Kombit tonë nga emri i shqiponjës. Ky mendim pranohet nga shumica e studiuesve dhe nga të gjithë shqip-folësit.

Për të mos u zgjatur, po rradhish disa autorë të kësaj teze. Sipas Maksimilian Lambertz-it (...) emri e ka origjinën prej “shqiponjës”, si emër i një totemi nga koha e Skënderbeut dhe është më tepër shprehje e kombësisë. (11)

Mehdi Frashëri (*Historia e lashtë e Shqiperisë dhe e Shqiptarëve*): « Me qënëse Skënderbeu në flamurin e tij kishte shqipen, ata që ndodheshin nën këtë flamur, u thanë *shqiptarë*» (12)

Eqerem Çabej (*Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*) : Shqiptarët quhen kështu pas shqiponjës... (13) etj.

Por përfaqësuesit e të dyja tezave, janë të një mendimi se emri Shqiptar është i periudhës së mesjetës. Dhimitër S. Shyteriçi : Për herë të parë « shqiptar » ,si emër populli, që nis të zëvendësojë emrin « arbër » , haset tek « Concili provinciali » (bot shqip 1706,105,) « Kuvëndi i Arbërit » ; aty flitet për giuhën e Shqiptarëvevet , në origjinal « Schippetarevet » ; Ndërsa emrin e vendit « Shqipëri » e gjejmë për herë të parë në fund të shk XVIII, në gojën e bejtexhiut kolonjar Hasan Zyko Kamberit.(14)

Kjo bindje e ka burimin , se ky emër nuk përmendet për ndonjë fis apo vënd në

dokumentet e periudhës greko-romake dhe se « Arbëreshët e Italisë e të Greqisë nuk e njohin emrin shqipetar , e kjo dëfton se ky nuk kish filluar të sundonte në Shqipërinë e mbarimit të Mesjetës”. (E.Çabej « *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes* ») (15) Ky mendim mbizotron edhe tek autorët e huaj. Në Kongresin e III Ndërkombëtar të Studimeve Bizantine (Athinë,1930) Petros A. Furiqis (*Prejardhja e etnonimit arvanit*) , pohon se: Iliria(...)ka të ngjarë rreth shekullit të X-të u quajt Albania dhe pas shk XV u quajt Shqipëria. (16) Nathalie Clayer (Centre d'Etudes Turques, Ottomanes, Balkanique et Centralasiatique, de France) pohon se : Emri Shqipëri është i vonë, zhvilluar vetëm pas shekullit të XV-të. (17)

Ky përfundim i « vulosur » tashmë nga shkenca historike, i ka shtyrë disa studiues europianë, ta arkivojnë dosjen e origjinës dhe lashtësisë së Kombit tonë, në sirtarin e “çështjeve të pazgjidhura”. Fallmerayeri : « Në kohët e erës së vjetër asgjëkundi s’përmendet as kombi shqipetar as atdheu i tyre. Origjina e këtij populli, si dhe natyra e gjuhës së tij diskutohet së tepërmi.”(18)

Shtrohet pyetja : A varet njohja e një fakti historik, vetëm në se ndodhet apo jo në një dokument të shkruar? Ky kriter ka qenë i vlefshëm, para dy-tre shekujve, kur akoma nuk kishin lindur shkencat e tjera studimore si gjuhësia, arkeologjia, tradita popullore dhe nuk merrej parasysh analiza llogjike, e fakteve etj. Të vetmit që kanë pohuar të kundërtën, kanë qenë Rilindasit e fillim shekullit 20, si Sami dhe Naim Frashëri, Pashko Vasa etj. të cilët theksonin se *EMRI SHQIPETAR* është *SHUMË I VJETËR*. Si qëndron e vërteta historike ? Për të zbuluar lashtësinë e një emri, duhet vërtetuar barazimi „Emri = Simbol mitik“.

Shqiponja, simboli më i rëndësishëm parahistorik i Zotit

Një figurë është simbolike, pohon psikologu Karl Jang(Carl Jang), kur përmban diçka që qëndron më tej se sa pamja e saj e drejtpërdrejtë, e asaj që shikojmë. (19) Pra simboli i shqiponjës nuk duhet kuptuar thjesht si një zog i maleve, e për rrjedhojë shpreh shqipetarët që banojnë në një vend malor, siç mendohet jo rrallë herë. Sipas gjuhëtarit Petro Zhej, ” Të gjitha figurat simbolike, sa kohë që ne jemi e mbetemi në Botën reale, materiale janë të fshehura, të okultuara (të kallura), të groposura, të penguara, të ndaluara ,të padukshme...”(20) Për t’i kuptuar simbolet, duhet të njohim besimin e krijuesve të tyre dhe çfarë kanë dashur të shprehin me to. Hapi i parë në këtë drejtim është pranimi i faktit se:

1. Pellazgo-dardanët , ishin krijuesit e miteve të Europës para-historike që na kanë mbritur nga autorët e lashtë.
2. Nga bota e gjallesave, shqiponja ka qenë “mjeti” me të cilën njeriu primitiv e ka “parë” Zotin.

Studiuesi i besimit të lashtë, M.Eliade pohon se “zogu” është një nga pamjet e shpirtit hyjnor, dhe «Në mitet, legjendat dhe ritet që lidhen me hyjnizimin në qiell (il « volo magico ») në të gjitha kontinentet, nga Australia, Amerika qendrore deri në Zonat arktike, shprehet me krahët dhe pendët e shqiponjës». (21) Shqiponja është një prej simboleve më të hershme të njeriut dhe Perëndia më e lartë e Druidëve. (22)

Të gjitha Perënditë më të fuqishme, në mite dhe skulpturat e para, në një hapësirë të gjerë gjeografike, janë të paraqitur si shqiponja, gjysëm shqiponja, me krahët apo kokën e saj dhe kanë qenë hënore.



(23)

(nga e majta) Perëndesha hënore Sellena e tempullit të Dodonës me qeleshen shqiptare ; Mbreti Horos, i mbiquajtur Perëndia shqiponjë (Hr), i dinastisë së parë arkaike egjiptiane.; Emblemen e Pallatit të Dariusit I-rë në Suse. Sfera sipër me krahë shqiponje (Zoti), shpreh së ky mbret gëzon mbrojtjen hyjnore. Dy sfinksat poshtë, (me kokat e mbretit, që shikojnë në drejtime të kundërta, me krahë shqiponje dhe trup luani) tregojnë pushtin e pakufijshëm të Dariusit të I-rë duke shprehur : Në tokë, Zoti jam unë !



Sipas historianit të famshëm të Aleksandrisë, Filones, (30pK-45 pas K.) në « *Quaestiones et Solutiones in Genesis* » në besimin e lashtë Shqiponja përfaqson « Zotin e Dytë dhe Mënçurinë e tij »(24). Kjo është edhe arsya se përse Zeusi paraqitet gjithmonë bashkë me shqiponjën.

Figura e saj ka përfaqësuar jetën, vdekjen dhe ringjalljen, karakteristika këto të shpirtit hyjnor (fig. majtas) Në besimin (pellazg) të Egjiptit të lashtë, Perëndesha shqiponjë (Dea Zog i M.Gimbutas), shprehte “ba” (shpirtin) dhe “sheut” (hijen) si dy elemente përbërës të njeriut. (25)

Zogjtë në objektet e njeriut primitiv ,vëren arkeologia Maria Gimbutas, simbolizojnë idenë se vdekja dhe ringjallja janë të lidhura pazgjithshmërisht, (26).

Adhurimi i Shqiponjës, tek shqipetarët ka qenë i trashëguar nga të parët e tyre, siç e dëshmon edhe Eliani (De natura animalum, II, 140), i cili tregon se Mbreti i famshëm Pirro, riste në banesën e vet *si simbol stërgjyshor*, një shqiponjë, të cilën e mbajti pranë vetes edhe pas vdekjes së shpendit. (27) Adhurimi i simboleve të caktuara të besimit, në lashtësi tregonin përkatsinë etnike të fiseve. Një dëshmi të këtij fakti historik, na e ka sjell Xh.Katapano: Kostandini i Madh (...) dhe të gjithë Perandorët e tjerë të Ilirisë, që sunduan pas tij, *nën shenjën e Shqiponjës*, janë të gjithë *BOREAL*, “Bijë të Dritës”(bij të Zotit-shën im) (28)

Mitet dhe arkeologjia, na dëshmojnë se shqiponja ka shërbyer si simbol i Krijuesit. Për rrjedhojë emri “Shqipetar” është *FETAR*. Studiuesi L.Poliakov shkruan se :“Nuk është nevoja të sjellim prova që shumë emra popujsh të vjetër janë të njejtë me emrat e perëndive të tyre kombëtare”. (29) Këtë e pohon edhe Sami Frashëri (*Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet*,1899) : Kombi i tërë ka marrë emrin Shqipetar dhe vëndi ynë, emrin Shqipëri, fjalë të bëra prej shqipes Zogut të bekuar të Hyjit, që i faleshin prindërit e vjetër tanë, dhe që e kemi edhe në flamur. (30) Që nga “arti” i njeriut të Paleolitit, (*Il linguaggio della Dea M.Gimbutas*) e deri në ditët tona, Shqiponja së bashku me kryqin/yll, ka mbetur simbol kryesor i Krijuesit, në art, në ndërtime (kisha, xhami) (fig.1,3,4 poshtë) dhe veshjet e figurave më të larta fetare. (fig.2).



(31)

(nga e majta) Kisha S. Maria delle Grazie, ku ylli jepet në formën e rozetës tek shqiponja (1602,Pulja,Itali); Shqiponja tek shënjtëria e tij, Chrysostomos II, prelat i kishës së Qipros, komuniteti më i lashtë kristian pas Jeruzalemit ; Shqiponja dykrereshe në Xhaminë e Divrigi (Turqi); Pikturë murale në Manastirin e Decanit,Kosovë.

Edhe në jetën e përditshme (në traditën popullore) e atë administrative , ajo zinte vëndin qëndror. Në mbretëritë iliro-epirote janë prerë mbi 72 seri parash metalike, miliona monedha me simbolin e shqiponjës, prodhuar në Foenike, Orik, Bylis, Apolloni, Dyrrah, Korkyra, Kasopa, Leukada, Akarnania (treva historike shqipëtare) etj. (32)

Duke marrë parasysh faktin se :

1. Shqiponja është simboli më i rëndësishëm i besimit të njeriut primitiv ;
2. Se paraardhësit e shqipetarëve (pellazgo-ilirët) rradhiten ndër banorët më të lashtë dhe janë krijuesit e besimit të parë të Europës parahistorike ;
3. Se gjuha shqipe, nga studiuesit emërtohet si gjuhë natyrale dmth e krijuar, jo nga ndonjë gjuhë tjetër, por që nga koha kur njeriu mësoi të flasë; është jashtë llogjike të mendohet se, emërtimi *shqipetar* është i periudhës së mesjetës dhe mungon në shkrimet e historianëve të parë të lashtësisë. Këtë përfundim e vërteton emri *EPIROTE* dhe *EPIR*, për gjuhën, popullin dhe vendin e fiseve të etnisë shqiptare .

Ipe - Shqiperi dhe Miti i Krijimit të racës njerëzore

Duke folur për Epirin dhe banorët e tij, gjuhëtari Pr.Shaban Demiraj (*Gjuhësia Ballkanike*) pohon se:”Pyetjes lidhur me fqinjët veriorë të grekëve të vjetër dhe gjuhës që flisnin ata, paraqitet tejet e vështirë, gjithnjë për mungesë të dokumentimit të tyre. Nga grekët quhej Epir (Epiros) “tokë” ,për t’u dalluar nga ishujt përballë. Emri Epir pranohet në përgjithësi si një fjalë prej burimi grek, por ne nuk dimë se si e kanë quajtur vetë vëndësit këtë trevë (...) ku jetonin jo më pak se katërmbëdhjetë fise, nga të cilët më të njohurit kanë qenë haonët, thesprotët, amfillokët, mollosët, atintanët etj. (...) pyetjes se ç’gjuhë flisnin ata, është shumë e vështirë t’i jepet një përgjigje e argumentuar bindshëm” (33)

Për banorët e Epirit dhe gjuhën e tyre, Sami Frashëri na sqaron se Herodoti 484-420pK), Plutarku (50-125 erës sonë), Straboni (58pk-25 erës sonë), Ptolemeu (Ptoleme Klod shk II erës sonë),Mallet Brun, George Hahn, Albert Dumont, vërtetojnë se Epiri që nga kohët e lashta ka qenë tokë shqiptare. Këtë fakt e deshmojnë edhe të dhënat statistikore të nxjerra me kujdesin më të madh nga organet qeveritare (të perandorisë Osmane –shën im) vitin e kaluar, me rastin e krijimit të nahijeve.(34)

Do të shtojmë edhe faktin se, në dokumentet e lashta për Gadishullin Pellazgjik (Ballkanik) emri Iliri dhe Epir është i kudo-ndodhur, në kohën kur nuk çfaqet gjëkund emri Greqi, për ndonjë vend apo popull. Sipas Dr. Arif Mati (*Mikenet=Pellazg*, f104), Hellenët e vërtetë nuk janë quajtur kurrë “grekë”.

Origjinën shqiptare te emrit Epir e dëshmon edhe gjuha. Filozofi Sami Frasheri duke folur për gjuhët e popujve në lashtësi pohon se: „Përparimi i sajuar dhe letrar (i gjuhës –shën im) është çfaqur më vonë, kurse gjendja e natyrshme, është ajo bazë“ .(35) Gjendja natyrale e emrave dhe toponimeve është ajo që u trashëgua në mijra vjet në traditën popullore. Nje deshmi të tillë, na e sjell një legjendë çame e Thesprotisë mbi Pirron e famshëm, Mbretin

e Epirit : “Kur Pirro qe i vogël e çuan tek mbreti i Shkodrës : “O mbret i nderuar/ t’u rritet nami e rrofsh e klofsh sa malet/ Kaha **Iperoja** na të kemi ardhur/ të t’besojmë kët **zok** të **ipes** / të na rritet ipje e vërtetë. (36)

Në fjalorin e gjuhës standarte shqipe , fjala **IPE** nuk ndodhet, por në dialektin tosk të Çamërisë, emërton shqiponjën dhe tregon, se si besimi para-historik ka ndikuar në krijimin e fjalëve të reja. Njeriu primitiv, duke parë shqiponjën si zogun e vetëm të lartësive të mëdha nga mund ta shikonte Krijuesin, e gjykoj si ndërmjetësin e tij me të Plotfuqishmin . Ky mit pasqyrohet në gjuhën shqipe tek emri i shqiponjës : **IPE** (i+pe), ku « i », sipas eruditit arbëresh Xhuzep Katapano, “ në doktrinën e Thotit përfaqson Fuqinë Krijuese të Zotit është vetë **FJALA**”(37) + folja e kohës së shkuar – pashë/veta e dytë,njejes / (ti) pe. Ky emër do të thotë : „Zotin pe“ dhe i përket periudhës zanafillore të shoqërisë njerëzore-matriarkatit. Emri “shqiponjë” nuk ka gjini mashkullore në gjuhën shqipe.

Tek arbëreshët, shqipetarët e Italisë, Shqiponja emërtohej **AIN** emër, i cili në besimin e lashtë përfaqësonte syrin e Krijuesit. Në gjuhën hebraike, arabe, caldaike dhe siriane , emri Ain tregon syrin (*Appunti sui primi elementi di lingua ebraica*. Gastone Ventura) (38).

Syri në këto alfabete shpreh gjermën « O », me kuptimin e « hiçi-it » dmth asgjë (tabela poshtë). Hiçit në hebraisht i thonë **AIN** dhe shpreh Krijuesin që nuk mund të njihet. (39)

Herog. egjipt/gërma hebraike /emërtimi hebr./gërm.fenikase.



Studiuesi Petro Zhei (*Shqipja dhe Sanskritishtja*) pohon se : «Simboli 0 është ai i qendrës, i Frymës, i Zotit » (41)

Emri **AIN** e gjejmë si toponim në Azinë e Afërt, si ‘ Ain Zāra në Tripolitania, ‘ Ain Giālūt në Palestinë. **AIN** quhej edhe qyteti Levit në tokat e tribuve të lashta Judaike. Për të flitet në Bibël (15:32 dhe 19:7). (42) Po ky emër, në Francë është toponim i një zone të gjerë arkeologjike të para-historisë (komunat Belley, Pérouges, Bourg-en-Bresse dhe Trévoux). etj.

Me anën e toponimeve dhe simboleve të njejta mitike, të gjetura në hapësira jashtzakonisht të madha gjeografike dhe që shpjegohen më të njejtën gjuhë dhe besim (siç është rasti ynë), ne mund të përcaktojmë përhapjen e fiseve dhe të besimit pellazg, në periudhat para-historike. Këtë fakt e vërtetojnë objektet arkeologjike.



(43)

Në artin e popujve Aztekë të Amerikës, një rradhë me sy janë gdhëndur sipër shqiponjës së stilizuar (fig.1). Edhe në piramidat egjiptiane (fig.2), syri i madh qëndron mbi shqiponjën në qëndër, duke shprehur të njejtin mit: „Shqiponja është syri i Zotit“.

Po e lemë përkohësisht emrtimin e shqiponjës në gjuhën arbëreshe *AIN* dhe të përqëndrohemi tek tema kryesore: Zbulimi i origjinës së emrit Shqipëtar dhe vjetërsisë së tij.

Sipas Xh.Katapanos, në zanafillën e njerëzimit, formimi i emrit mbahej si një art i shenjtë dmth besimtar. Me zhvillimin e shoqërisë primitive, emrit zanafillor të shqiponjës *IPE*, ju bashkangjiten fjalë të tjera, duke shprehur gjuhësisht, ndryshimin dhe pasurimin e miteve të besimit pellazg. Emrin Shqipëtar (**Schipetar**, etj. në dokumenta) si emër i përbërë, mund ta risjellim në formën e lashtë: Sch + ipe + t' (të)+ar. Në kuptimin besimtar pellazg , kjo frazë lexohet : Fjala/Fryma Krijuese e Zotit Dritë.

Rruga e ndjekur: Sch = skep/sqepi (ch latine, para zanoreve lexohet në shqip- k) dhe gjuha e nxjerë dukshëm jashtë, tek shqiponja në flamurin tonë, shpreh mënyrën se si Zoti krijoi Botën me **Fjalën/ Frymën Krijuese + e Zotit** (i përfaqësuar nga fjala „ipe“-shqiponja) + t' **Ar**-it. Kjo e fundit, nuk është mbaresë, por një fjalë-rrenjë e stërlashtë , e cila ndodhet edhe në fillim të emrit Arbër / Arban si emërtim i Zotit (Hyjit). Këtë na e dëshmon Petro Zhei : Një tjetër mënyrë referimi tek Qendra (Zoti-shën im) është edhe kjo : operatori i lirë (rrënja e pastër) AR në një sërë gjuhësh shpreh «parimin dritësor ». (44) Maks Myler (Friedrich Max Müller, 1823- 1900) thekson se emrat e shumicës së popujve arianë janë të përbërë prej fjalës “arë” (45), për të dëshmuar lidhjen ose origjinën nga Zoti.

Duhet theksuar se, rruga e ndjekur në studim, nuk bazohet thjesht në një hamendsim, por në „gjurmët“ që u trashëguan në besimet e mëvonshme dhe në objektet arkeologjike. Sipas Testamentit të ri: „Në fillim ishte Fjala dhe Fjala që Zoti(...)të gjitha gjërat u bënë prej tij...“ (Giovanni 1,1-4) (46) Siç dihet, arsimimi i popullit u bë një dukuri masive vetëm

dy-tre shekuj para kohës sonë, dmth gjatë shk 19-20. Per rrjedhojë, simbolet mitike, me ndihmën e artit (gdhëndjet primitive, vizatimet në enë balte, skulpturat në metal, gur e mermer, pikturat murale, etj.), që nga koha e Paleolitit e deri në kohët moderne, kan luajtur rolin kryesor për të përhapur dhe përjetsuar besimin dhe mitet.

Ky fakt dëshmohehet në objektet e shumta arkeologjike, punimet ndërtimore dhe artistike që kanë mbritur deri më sot. Për të shprehur dukuri jo materiale, siç është „fjala“ apo „fryma“ me të cilën Zoti krijoi botën dhe banorët e saj, „artisti“ i lashtë përdori llogjikën.

Ai e shprëhu mendimin mitik, duke paraqitur organin e njeriut që e prodhon fjalën dhe e nxjerr me forcë frymën: gojën e hapur në maksimum dhe gjuhën e dalë dukshëm jashtë (fig.1,2,3 poshtë). Në Fjalorin e Dhjatës së vjetër shkruhet: Gjuha, një simbol për të folurin. (47)



(48) (nga e majta)Kalendari i Aztekëve ; Arti etrusk ; Perëndia Bes (Tempulli i Denerës, Egjipt) Sipas studiuesve, Perëndia Bes ka qenë i pranishëm në të gjitha periudhat e besimit të lashtë egjiptian. Deri në kohën e Faraonit Akhenaton (Dinastia XVIII,viti 1350 pk) është paraqitur më krahët e shqiponjës; Stema e Kastriotëve në shk15, me shqiponjën ku duket gjuha e nxjerrë dukshëm jashtë , formë e pandryshuar edhe në Flamurin e sotëm të Kombit dhe Shtetit shqipetar.

Kjo gjetje e njeriut primitiv, për të pasqyruar këtë mit të besimit, nuk njihet nga studiuesit e arkeologjisë dhe historianët, por e gjejmë të shprehur në një këngë të mrekullueshme arbëreshe kushtuar Shqiponjës. Kjo këngë është mbledhur në Helladë (Greqi) nga prifti arbëresh, At Anton Belushi (*Ricerche e studi tra gli arbërori dell'Ellade da radici arbëreshe in Italia a matrici arberorë in Grecia*): “Mëmë e mirë e Perëndeshë/ ç’akjë do kë fort të do/ neve t’mjerët mos harro/ edhe mbajna në kujdes; Sa të rrojëm nën hjes tënde/ e nga **skjepi të pështruarë/** veldit t’onë tue kënduar/ me gëzim edhe me besë ”. (Mëmë e mirë dhe Perëndeshë/ nga ai që fort të do/neve të mjerëve mos na haro/dhe na mbaj me kujdes; Sa të rrojmë nën hijen tënde/ të dalë (krijuar) nga sqepi (fryma-fjala) yt /vëndit tonë do t’i këndojmë me gëzim dhe besë) (49)

Në mbështetje të kësaj kënge dhe të mitit, do të sjell edhe një dëshmi tjetër. Shqipetarët e Iperisë (Epirit) gjuhën e tyre e emërtojnë „gjuha e Zogut“ (Ipes/Shqiponjës). Në një letër të Panajot Kupetorit dërguar Karl Reinholdit, më 25 të Shenmitrit 1857 (25.10.1857) i

shkruante “Kalofsh mir’ edhe shëntoshë ! Dje mora një kartë nga Zotëria e-jote, e shumë gëzuashë ,çë më kultove e më shkruajte edhe ndë *gjuhë të zogut*, undrë si thonë Arbëreshtë... (50)

Në fund të këtij rrugëtimi gjuhësor, mitik dhe të traditës, kemi të drejtë të pohojmë se: Fiset e lashta pellazge e quajtën veten „iperotë“ dhe pastaj „shqipetar“ në lashtësi, nisur nga simboli besimtar i Shqiponjës, për të treguar origjinën e tyre nga Zoti dmth „Jemi bij të Zotit!“. Këtë origjinë besimtare të banorëve, e kanë treguar studiuesit e huaj të shk19 në librat e tyre: Shqipetarët e quajnë veten, « bij të shqipes ».(51) Sipas Andre Leroi-Gourhan,(*Le Geste et la Parole*) : Miti gjenealogjik është forma e parë e reflektimit historik. Kështu anëtarët e një grupi njerzor “e kanë origjinën” nga një perëndi, nga një hero apo një kafshë. (52)

Për sa më sipër, emri i lashtë i Kombit tonë - **SHQIPETAR** - sipas besimit pellazg, shpreh **MITIN e KRIJIMIT**, nga Fjala / Fryma e Zotit-Dritë (siç thuhet edhe në Bibël).

Këtë fakt e dëshmojnë edhe mitet : Iperione (Shqiponjë) paraqitet si krijues i natyrës : Hënës, Diellit dhe Agimit (la Luna,il Sole, l’Aurora ; Hesiodo, *Theog*, 371; Diodoro V, 66) (53) Paraqitja e emrit të shqiponjës, si një figurë mashkullore, tregon ndryshimin e miteve në periudhën e patriarkatit. Në mitet e mëvonshme , shqiponja mbahet si stërgjyshe e Adamit, prej të cilit e kanë origjinën njerëzit që populluan Botën. Ky mit njihej edhe në Mesjetë. (54) Sipas autorëve të tjerë (Hygin, *Fable*; Pausanias, *Description de la Grèce*.)Iperone është ati i Titanëve(55) (Titanët ishin pellazg). E rigjejmë, si krijuese të racës njerëzore, në mitin e Deukalionit dhe Pirrës, emri i së cilës (siç do ta shikojmë në pjesën e II), do të thotë shqiponjë. Kjo legjend ishte e njohur në gadishullin Pellazgjik (Ballkan), sidomos në Epir dhe zonën e Thesalisë (56). Emri Pirra përdoret edhe sot e kësaj dite vetëm tek shqipetarët, por në gjininë mashkullore -Pirro, dhe ruhet në emrin e saj origjinal tek gjinia femërore - Shqipe. Në periudhën e kristianizmit, zhduket emri i shqiponjës dhe të gjithë popujt e tokës e kanë origjinën nga tre fëmijët e Noes - Sem, Kam e Iafet. (*Genesi* X, 1-32).



Të gjithë emërtimet që njihen historikisht për shqipetarët dhe paraardhësit e tyre Pellazgo-Ilirët, lidhen me Mitin e **KRIJIMIT** : Pellazg - të lindur prej dheut ; Ar+ban / Ar+bër : i banun/i bërë nga Ar-a/dheu; Ilir/Yll-ir shpreh origjinën nga Zoti/Ylli. Ylli = Drita Hyjnore.(57)

Al+ban/Al+ba(ë)ri-a (titulli i gazetës së arbëreshëve/Itali,majtas): të banun/ të bërë nga Al; ku **Al** apo **EL** (Eb.) në fjalorin esoterik përkthehet Zoti (58). Ne besimin e lashtë sipas gjuhëtarit dhe filozofit gjerman Hermann Karl Usener (1834-1905) „Plotfuqishmëria e Zotit shprehet me sasinë e emrave të tij “ (59)

Emrin e Zotit, Al dhe të shqiponjës *AIN*, e gjejmë si toponim të qytetit 4.000 vjeçar në Emiratet e Bashkuara Arabe : **Al-Ayn** (العين), që shkruhet edhe Al-Ain, në kuptimin besimtar do të thotë „Zoti - Shqiponjë“. (60)

Përfundimi i parë: Emri *SHQIPETAR* është i lashtë dhe pasqyron zhvillimin e besimit të parë të hapsirës mesdhetare, atij Pellazg dhe është një emër *FETAR*. Origjina e tij buron nga fjala para-historike *IPE*, e cila shpreh gjuhësisht simbolin e Krijuesit - Shqiponjën. Ky emërtim, i trashëguar tek shqipetarët e sotëm, shpreh *MITIN* e *KRIJIMIT* të njeriut, fakt që vërtetohet edhe nga emërtimet e tjera historike të Kombit tonë: Pellazg-Arbër-Ilir/Yllir-Alban, të njohura në të gjitha trevat tona kombëtare, si emërtime të së njejtës etni. Emri i shqiponjës në gjuhën shqipe është dokumenti i pakundërshtueshëm i autoktonisë dhe origjinës pellazgo-ilire të Kombit dhe gjuhës sonë. Rruga e formimit të tij në gjuhën shqipe, dëshmon se në zanafillën e historisë njerzore, emërtimi mbahej si një art i shenjtë, ku *BESIMI* dhe *GJUHA*, kanë shprehur dhe përsosur njëra-tjetrën.

* * *

Mbasi u munduam të zbulojmë nëpërmjet gjuhës, besimit, miteve, arkeologjisë dhe traditës së Kombit tonë, origjinën e emrit *SHQIPETAR*, mendoj së materiali do të ishte i mangët, po të mos përmendet rëndësia e mbrojtjes së gjuhës shqipe dhe sidomos e dialekteve të saj, nga keqtrajtimi që i bëhet fjalorit të saj nga ana e medias elektronike, intelektualëve, gjuhëtarëve dhe botuesve të teksteve (pa i përgjithshuar).

Me të drejtë studiuesja Mirela M. Sinani shtron pyetjen: Çështja është që tingujt dhe rrokjet themelore që mbartin kuptimin rrënjë të fjalës, duhet të mbeten të paprekura... A duhet flakur tej thesari i gjuhës së gjallë, pse kështu kanë vendosur dikur disa gjuhëtarë ?

Si mund të pretendojmë lashtësi të gjuhës sonë, kur heqim lidhjet më elementët më të vjetër gjuhësorë. (61)

Kjo ka ndodhur edhe me emrin e popullit tonë, i cili deri në fillim të shk 20 shkruhej *Shqiptar*.



Sot shkruhet *Shqiptar*, me arsyetimin se kështu e flet populli. Heqja e zanores «e», solli deformimin e rrënjës së lashtë «ipe».

Dihet se në te folurën e përditshme, populli jo vetëm i «ha» zanoret ose bashtingëlloret, por edhe u ndryshon vëndet apo i braktis

ato. Kjo dukuri e njohur, gjatë rrugëtimit historik të njerzimit, solli krijimin e dialekteve tek fiset e së njejtës etni, deri edhe të gjuhëve të reja, që sot përcaktohen si familje gjuhësore si psh gjuhët neolatine. Me krijimin e gjuhëve standarte (shk19-20), rrënjët e fjalëve, në shkrim « u mbrojtën » nga deformimet e të folurës popullore.

Atëhere, për ç'arsye në drejt-shkrimin e ditëve të sotme, duhej të zhdukej rrënja kryesore e emrit Shqipetar? Si pasojë bashkë me rrënjën « ipe », humbi origjina dhe kuptimi mitik (i Krijuesit-shqiponja) i emrit të popullit tonë, duke i hapur rrugën tezës së dështuar dhe antishkencore të shk19: « shqiptoj qartë ». Për fat, emri i vëndit - *SHQIPERI*, e ruajti gërmën “e” dhe rrënjën e saj para-historike.

Por , « muzeu » i gjuhës sonë, për emrin Iperi/Shqipëri , nuk i ka treguar akoma të gjitha thesaret e tij...

SHQIPE-RI, EMRI PARAHISTORIK I ZOTIT, NË BOTËN MODERNE

(pjesa e II)

*Duke mos u drojtur nga një përgënjeshtër prej historisë dhe duke qenë i sigurtë se nuk do të akuzohem se kam dëshirën për ta zmadhuar, meqë nga pikpamja e kombësisë i takoj të njejtit popull, mund të them se, populli shqiptar dikur ishte një popull i madh që banonte në dy kontinente, të Azisë e të Europës, nga Triestja deri në Sivas.
Sami Frashëri .(1)*

Një pohim i tillë, duke marrë parasysh hapsirën prej 28748km² të Shtetit Shqiptar dhe duke shtuar trevat historike të banuara nga shqiptarët në shk18-19, të Kosovës, Sërbisë, Bullgarisë, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Greqisë, përsëri do të na dukej i pabesueshëm. A qëndron për shkencën Albanologjike të shekullit 21 një tezë e tillë ? Këtë mund ta zbulojmë duke gjurmuar emrin e shqiptarëve në mitet, figurat historike dhe toponimet e hapsirës së Euro-Azisë të banuara nga fise pellazgo- shqiptare.

Shqiptarja, në emrat dhe toponimet e lashtësisë

Lidhjen e vetme të emrit të shqiptarëve në lashtësi me shqiptarët, studiuesit modern e shikojnë tek libri i Plutarkut (*Jeta e Pirros*) , ku tregohet se Mbreti i Molosëve Pirro II, kur u kthye në atdhe mbas fitores mbi maqedonasit (289 pas K) Epirotët e pritën duke e

përsëndetur me epitelin “shqiponjë” . (2) Kjo e dhënë, mendoj se është keqkuptuar nga historianët. Përse për fitoren e aritur, ushtarët do ta emërtonin shqiponjë, kur beteja nuk u zhvillua në qiell por në tokë, ku kafsha më e fuqishme është luani ? Theksimi i Plutarkut se e thirrën me emrin e shqiponjës, duhet kuptuar si një përkthim që bën autori brohoritjeve të ushtarëve « Pirro ! Pirro ! », në librin e tij të shkruar me gjuhën priftërore , (të bazuar në një nga dialektet e shumta të pellazgëve).

Në mbështetje të mendimit tim është fakti se Historia dhe mitet, tregojnë se para Pirros së famshëm, këtë emër të lidhur me shqiponjën, e kanë patur shumë figura të tjera historike dhe mitike :« Sipas rrëfimesh pleqërishte, nën tiparet e shkabës (emri mashkullor në gjuhën shqipe për shqiponjën), Zeusi dodonas që bashkuar me nimfën Aigina, që pat lindur *të parin bir të shqipes* Aiakun (Akilin-shën im), katragjyshin e Aleksandër dhe Pirro Molosit” (3)

Njihet nga mitet fakti se, Akili kur fshihej në oborin e mbretit Licomede (në Sciro) përdorte emrin Pirra(4) dmth „shqiponja“. Edhe Perëndia Mars i latinëve, një nga emrat e kishte Pirro. Po kështu në art,(piktura, skulptura etj) Zeusi paraqitet gjithmonë me shqiponjën, për t’u trëguar besimtarëve të lashtë: “ Jam Shqiponja ! ”, siç emërtohej edhe mbreti i dinastisë së parë egjiptiane Horos (Hr), i hyjnizuar si Perëndi. Në skulptura ay paraqitet si shqiponjë ose me kokën e saj.



(5)

Monedhë e Epirit e vitit 210 p.K.; Faraonin egjiptian Horos e therisnin “shqiponjë”. Edfou (Egjipt). Në një dokument (fig.posht) të Marcus Junianus Justinus (Justini Historiarum Philippicarum, libri XLIV), dallojmë dy fakte :

1. Emri “epirotë” dhe rrjedhimish edhe Epir është i mëvonshëm, sepse më përpara banorët quheshin Pirridë. Edhe Dh.Kamarda (Demetrio Camarda *Discorso Preliminare*) kur flet për banorët e lashtë të Epirit, nënvizon emrin e tyre Pirridi. (6)
2. Emri i Epirotëve në latinisht (**Pyrrhidae**) shkruhej njësoj , sikurse ay i Pirros (**Pyrrhus**) dhe i gruas së Deukalionit, Pirra (**Pyrrha**). Po kështu edhe në italisht : **Pirridi, Pirro** dhe **Pirra**.

sunt. Molossorum primum in ea regione regnum fuit. Post Pyrrhus, Achillis filius, amisso per absentiam Trojanis temporibus paterno regno, in his locis conседit, qui Pyrrhidæ primo, postea Epirotæ dicti sunt. Sed Pyrrhus, quum in templum Dodonæi Jovis ad consulendum venisset,

gno. I Molossi furono i primi che regnassero in quelle contrade; dipoi Pirro, figliuolo d'Achille, avendo perduto il regno paterno, da cui dovette allontanarsi a' tempi della guerra Troiana, prese stanza fra questi popoli, i quali dapprima si chiamarono Pirridi, e quindi Epiroti. Ma Pirro, ve-

(7) Ky është një dokument shumë i rëndësishëm gjuhësor dhe historik, i cili dëshmon se emri *PIRRIDI* i epirotëve, siç e thekson autori dhe Pirra/Pirro, në gjuhën shqipe kanë ardhur nga e njëjta rrënjë para-historike. Historiani A. Romualdi (*Gli Indoeuropei. Origini e migrazioni*) pohon se në shkrimet greke, emri « pyrrhos » përdoret shpesh, fakt që dëshmon se në lashtësi emri « shqiponja », dmth *IPE-riotë* (Epiriote/Shqipetarë) edhe sipas Marcus Junianus Justinus, përdorej për banorët e Jugut të Gadishullit Pellazgjik (Ballkanik).(8)

Toponimet, po të shpjegohen drejt, pohon Spiro Konda (*Pellazgët origjina e jonë e mohuar*), janë dëshmuese të vërteta, që provojnë se atje ku ndodhen, banonte populli me gjuhën e të cilit shpjegohen. (9) Siç dihet, emrat mitikë dhe toponimet e Lashtësisë, janë krijuar në kohën kur Gadishulli quhej me emrin e banorëve të tij Pellazg, dhe fiset që banonin në Epir, nuk janë përmëndur kurrë nga autorët e lashtë si të etnisë greke. Sikurs pohon edhe G. P. Anagnostopulli : „Emri i përveçëm Epeiros (Epir) mund të jetë fjalë para-helenike, si shumë nga toponimet e vjetra greke...” (Enciklopedia e Madhe Greke, vol XII, f 317, 1930 Athinë) (10) Megjithatë, studiuesit e shk19, por dhe sot, duke e mbajtur greqishten si gjuhën më të lashtë europiane, origjinën dhe kuptimin e çdo emri apo toponimi e kërkojnë tek kjo gjuhë, sipas së cilës, Epir do të thotë „tokë“ dhe Pirro „flokë kuq“.

Tradita gojore e regjistruar në shk 20 (Fatos Mero Rrapaj, *Këngë popullore nga Çamëria*, 1983), dëshmon se vëndi i fiseve thesprote, kaone, molose etj, emërtohej **Iperi**. Kjo fjalë e përbërë e gjuhës shqipe ka kuptim besimtar: Ipe/dialekti çam, shqiponjë + ri, dmth vëndi ku ri shqiponja/Zoti. Në dokumentet greko-romake dhe hartat e mesjetës, për të njëjtën hapësirë gjeografike, shkruhet **Epiri**, pra ka mospërputhje të emrit të traditës popullore, me emërtimin në dokumentet. Faktorët që kanë ndikuar, kanë qenë : Shkruesit e dokumenteve dhe natyra e gjuhës së folur pellazgo-shqipe .

Shtrëmbërimi i gjuhës nga shkruesit, ka qenë një problem i njohur që në lashtësi. Sipas Dh.Kamardës “Ka shkrime të lashta, si latine edhe greke, që dëshmojnë ndryshimin e madh (të fjalëve të njëjta-shën im) në shkrimet e kohës klasike. Platoni (në Cratilo) tek grekët dhe Ennio e Lucio tek latinët, ngulnin këmbë për përdorimin e një ortografie të saktë. (11) Një nga shkaktaret kanë qenë edhe përkthimet nga gjuha origjinale. Studiuesi arvanit Aristidh Kola, që është marrë me emrat në mitet dhe toponimet e lashta, vëren se : „Duhet të kemi parasysh faktin se grekët, emrat e huaj duke i greqizuar i ndryshonin shumë nga forma fillestare në gjuhën përkatëse“. (12)

Kjo „gjuhë fillestare“ para-greke e Gadishullit ishin dialektet e gjuhës pellazgo-shqipe.

Vicenzo Gioberti (1801-1852), një prej figurave kryesore të Rilindjes italiane, pohon se gjuha shqipe përmban gjurmë të gjuhëve që qarkullonin në Greqi, para pushtimeve deukalioniane dmth para se të formohet popullsia e emërtuar hellenike. (Vicenzo Gioberti « *Primato* » Bruselles 1844, T.II p.133) (13)

Por faktor i rëndësishëm, që ka sjellë ndryshimin e emrave në kohë, është edhe vetë natyra e gjuhës shqipe. Gjuhëtari i shquar arbëresh Dhimitër Kamarda vëren se, që në zanafill gjuha shqipe (pellazgo-shqipe ,shën im) ka treguar si tipar kryesor të fjalëve, tendencën për ndryshime të caktuara si : „Ndrimin e vëndeve të zanoreve, bashtinglloreve por edhe rrokjeve të tëra“ (14) U zgjatëm pak për arsyet historike dhe gjuhësore të ndryshimit të fjalëve në gjuhën pellazgo-shqipe, për të kuptuar se përse emrat, Iperi dhe Iperiot (Shqiperi-Shqipetar), i gjejmë në forma të ndryshme në dokumente.

Duke u bazuar tek faktet e sipër përmendura, mund ta ndërtojmë rrugën e ndryshimit të rrenjës *IPE*, tek toponimet dhe emrat e njeriut: Fillimisht Ipe/Iperia (emri i shqiponjës dhe i vendit, ku e/a tregon gjininë femër.) – Pieria (kalimi i zanores „i“, prapa bashting. „p“) - Pirro/Pirra , Pirria (emër njeriu/vëndi, nga rënia e zanores „e“ dhe vendosjen e „i“, pas bashtingllores „p“),- Epiri, Epirotë (ndrimi i vëndeve të i/e), etj. Kjo rrugë vërehet në shumë emra të njerëzve historikë, figurat mitike dhe toponimet e fiseve pellazge, brënda Gadishullit dhe në hapësirën Euro-Aziatike, duke nënkuptuar gjithmonë emrin e shqiponjës, siç « na e përktheu » Plutarku më lart.

Në mitet pellazge (gabimisht të emërtuara greke), ku çfaqet rrënja zanafillore *ipe* , kemi emrin **Iperione** të Perëndisë së Dritës (*Enciclopedia Italiana* 1933- Alessandro Olivieri). (15) Hesiodi e tregon bir të Qiellit (Uranit) dhe Tokës (Gea/Dhea, në shqip) dhe ati i Hënës, Diellit dhe Agimit. Në gjuhën greke (Ἑπερίων / Hyperíōn) përkthehet « ai që është lart » dhe sipas autorëve të lashtë ,Hygin dhe Pausania , ishte një Titan dhe ati i Titanëve. (Titanët ishin pellazg)(16) **Pieridi** (gr. Πιερίδες; lat. Pierides), emërtoheshin Iperiotet (epirotët, shqipetarët e jugut). Sipas Pausanias (IX XXIX.3) ky emër lidhet me vendin **Pieria**, emri i lashtë i një zone bregdetare të Maqedonisë, në lindje të malit Olimp, që e kishtë marrë këtë emër nga mali **Pieria** (cfr. Plinio Nat. hist. IV 29, 30, 33, 35), dhe ku banonin **Pieridet** (Πίερες) dmth iperiotet, fiset më të lashta të Thrakës. Tek latinët, Muzat janë quajtur **Pierides**, (Cicerone Nat. deor. III XXI 54) prej emrit të vëndit të origjinës, **Pierisë**.(Epiri) (17)

Këto të dhëna tregojnë se Iperia (Shqiperia) e lashtë shtrihej jo vetëm në Epirin e sotëm gjeografik, por edhe në hapësirën, që më vonë do të emërtohet Maqedonia e jugut. **Pirre**, siç dëshmon Straboni (Straboni Gjeografia IX 5, 23 f.443), ka qënë emri i lashtë i Thesalisë (18) dhe sot e gjejmë si toponim pranë Athinës.

Me origjin nga rrënja *ipe*, kemi toponimin **Perin** (Persian: پيرپ ; i njohur edhe si Ferīn, Parad, Pīrīn) në Iran (19) dhe të masivit malor -**Pirin** (bullg.Пирин, gr. Πίριν), në jug-perëndim të Bullgarisë. Në këtë zonë , sipas Pulevskit (Dictionary of Three Languages

Macedonian, Albanian, Turkish 1875) 22.7% të banorëve janë të etnisë shqiptare. (20) Origjinën shqiptare të kësaj treve e dëshmojnë edhe emrat e fshatrave: **Kalimantsi**, **Katuntsi**, **Kovachevo**, **Malki**, **Pirin**, **Vinogradi** etj. (21) Në perëndim të Europës kemi vargmalin **Pirene**, që shtrihen midis Francës dhe Spanjës. Në mite thuhet se emri është vënë nga Herakliu. (22)

Nga zëvendësimi i bashtingloreve buzore “p/b” (23) është formuar toponimin i Gadishullit **IBERIK** (Iperik dmth Gadishulli i Shqiponjave /shqiptarëve) përmendur nga Straboni dhe Appiani. Sipas Herodotit, është emërtuar nga hellenët (pellazgë-shën im), të ardhur afërsisht 3.800- 4.700 pK nga Gadishulli Pellazgjik (Ballkanik).

Një prej fiseve të mbijetuara nga para-historia janë baskët e sotëm (Baschi = shqip-bashkë dmth grup fisesh, dhe gjuha e tyre Eskuera = e shkuara, e vjetra) të cilët në lashtësi adhuronin Kaun si Perëndi dhe sipas Strabonit, formuan qytetrimin iberik. (24).



Në të majtë, monedha e Epirit v.234-168. Zeusi dhe Diona. Mbrapa Kau në sulm, simbol i besimit hënor të pellazgëve epirot

(poshtë) Simboli i shqiponjës në veshjen e luftëtarit dhe e fisnikut katalanas. (25)



Sipas Hahnit « plaku i maleve », stërgjyshi mitologjik i baskëve quhej **Arbasoa** (26) dhe **Pira** emërtohet një komunë spanjolle në Katalonjë (Catalogne/Tarragonë) (27) Simboli i Krijuesit-shqiponja edhe në mesjetë, mbahej si dëshmi e përkatsisë dhe mbrojtjes hyjnore në heraldikën katalanase (fig. lart,2) Në gadishullin Iberik, gjënden shkrime të lashta, të ngjashme me ato të Etrurisë (Itali) dhe Ilirisë (Shqiperi), të shkruara me alfabetin

pellazgo-fenikas dhe që lexohen vetëm nëpërmjet gjuhës shqipe (Nermin Vlora Falaski, *Pellazgët-Ilirët-Etruskët-Shqipetarët*). Ne traditen shqiptare ka mbijetuar origjina e perbashket e fiseve baske. Veshja e sipërme e gruas Dukagjinase (Mushamah), e ngjashme me ate te bustit femeror Iberik (Spanje) 300 pK.



Me të njejtin emër – **Iberia** (Iperia/Shqipëria) quhej mbreteria, që jo rastësisht ndodhej pranë mbretërisë tjetër **Albania** në hapsirën gjeografike të Kaukazit, në veri të Armenisë. Ky fakt i ka shtyrë disa studiues të shk 19, si ay grek Nikolla Nikokle (Nicocles Nicola) apo francezi Pukëvil (Pouqueville) t'i quajnë shqipetarët e sotëm, popullsi jo autoktonë në Ballkan, por të ardhur nga Kaukazi. (28)

Për këtë dukuri, Sami Frashëri ka sqaruar se: Emri Albania i përdorur prej gjeografëve të Greqisë së vjetër dhe të Romës, për krahinat e Dagestanit dhe të Shirvanit në Kaukaz, ka qenë emër i lashtë edhe i Skocisë. Del se me këtë emër të përbashkët emertoheshin tri vënde që ndodhen shumë larg njeri-tjetrit. Arsyeja është se populli kelt dhe ilirët, paraardhësit e shqipetarëve, kanë të njejtën origjinë dhe gjuhët e tyre janë të afërta me njera-tjetrën (29)

Sipas Dr.Arif Mati (Aref Mathiu) fiset thrako-frigjiane, nga e kanë origjinën armenët, kanë emigruar në rajonin e Kaukazit dhe të Armenisë së sotme nga Ballkani, rreth shk VII-VI pK. (30) Albanologu Hahn vëren se ka shumë toponime të njehta në hapësirën gjeografike të Ilirisë, Armenisë dhe Medisë. (31)

Që emri **Iberia** në Azi është i pellazgëve të **Iperisë** (Shqiperisë) dodonase, na e dëshmon edhe krahina qendrore e Sirisë **Pieria**, (sikurse Epiri i lashtë në dokumente) e cila shtrihej mbi bregun e djathtë të lumit Oronte, ku ndodhej kryeqyteti i Mbretërisë së Seleukëve me emrin Seleucia di **Pieria** (ἐν Πιερίας). Edhe vargmali i kësaj zone emërtohet **Pieria**. Studiuesit mendojnë se emri është sjellë nga ushtarët maqedonas të Aleksandrit të Madh. (32)

Studimi i toponimeve të njejta të lashtësisë, në hapsira shumë të mëdha gjeografike, tregon se në emigrimet e tyre, fiset pellazge bashkë me “plaçkat e shtëpisë”, mernin me vete edhe besimin, mitet dhe toponimet e Atdheut të origjinës. Sigurisht që këto lëvizje në drejtim të Lindjes nuk filluan me marshimin e Aleksandrit të Madh (326 pK) drejt Indisë, por që në zanafillën e krijimit të shoqërisë njerëzore. „Ne duhet të pranojmë - pohon Eduard Shnaider (*Pellazget dhe pasardhësit e tyre*)- se kjo ishte një specie njerëzore që jetonte në Europë, ose pak a shumë në Ballkan, para dukjes së periudhës së plinoçenit të epokës terciare, kur kishte një lidhje vijshmërie midis Azisë dhe Europës, me anën e kontinentit të zhdukur të Arcipelagut (33)

Përfundimi i dytë: Toponimet e shumta ,që e kanë origjinën e tyre nga emri i Shqiponjës-*IPE*, të përhapura në një hapsirë të gjerë gjeografike të Euro-Azisë dhe që kuptohen veçse me gjuhën shqipe dhe zhvillimin e saj historik, dëshmojnë se këto fise përbënin një bashkësi të madhe popujsh, të së njejtës etni. Sipas Nouveau Petit Larousse (Paris,1950 f 1599) : “Pellazgët, popull shumë i lashtë jetonte në periudhën para-historike në Greqi, në Arkipelag, në brigjet e Azisë së Vogël dhe të Italisë. (...) Traket e lashtë, Frigët, Lidët, Etruskët, Epirotët, Ilirët, Italiotët (Sanitët, Oskët, etj) dhe “Shqipetarët e sotëm”, konsiderohen së janë degët kryesore të Pellazgëve”.(34)

Edhe mbas mijëra vitesh, në dokumentet e Perandorisë Osmane të shk 19, Shqipetarët ishin popullsia me e madhe në Ballkan: “Më tepër se gjysmës e atij vëndi, që i thonë sot Rumeli a Mengë Ballkanit (Turqia europiane) ka qënë qëmoti Shqipëria, edhe njerëzit që kanë qënë mi të, që nga Trieshta (Trieste) e gjer më Sallonik, kanë qënë shqipetarë. (35) Sami Frashëri pohon se, shqipetarët kanë qënë jo vetëm një popull i madh, por edhe një Komb i lashtë: “Ky komp kaq’ i vjetërë e kaq’ i vjejturë (i vlefshëm-shën im) për histori, ka qen’ i shumë’ (i shumtë) e i fortë...” (36)

A ka patur Komb me emrin Shqipetar në lashtësi?

Për të pranuar këtë fakt, duhet të kuptojmë se ç’përfaqëson emri *KOMB*. Kjo fjalë nuk ekziston në ndonjë fjalor të gjuhëve europiane, përveçse tek Shqipetaro-Arbërit. Kombi dhe Nacioni, përfaqsojnë dy kategori të ndryshme historike: Kombi-etninë dhe Nacioni-shtetin. Mund të kesh disa shtete me të njejtën popullsi etnike, si psh Shqipëria dhe Kosova, por asnjëherë gjatë historisë së shoqërisë njerëzore, nuk ka patur dy kombe për të njëjtën etni. Kombësia ka kuptim shumë më të gjërë edhe se fjala Racë, e cila dallon vetëm natyrën antropollogjike të popullsisë . Në gjuhën popullore, shqipetarët e përcaktojnë kështu kombësinë e tyre: “Kemi një gjak, një gjuhë dhe një zakon!”, ku në zakonet përfshihet edhe besimi i të parëve të tyre pellazgo-ilirëve.

Por, si shpjegohet që gjatë historisë së tyre, shqiptarët e sotëm kanë patur disa emra kombëtar si Pellazgë, Ilir/Yllirë, Iperiotë /Epirot, Albanë, Arbër, etj. që shpesh janë përdorur njëkohësisht ose kanë zëvendësuar njëri-tjetrin?

Kjo dukuri nuk është e rastësishme. Siç e pamë në pjesën I-rë, të gjitha emërtimet e shqiptarëve „të çojnë“ tek **NJË FIGURË**- Krijuesi- i cili është : Shqiponja, Ar-a, Ylli, I pari dhe i vetmi (A-I) dhe shprehin vetëm **NJË MIT**, atë të **KRIJIMIT**të njeriut. Në këtë kuptim, këto emra shprehin një ide: Origjinën **HYJNORE** të fiseve (bijve të Zotit). Duke folur për shqiptarët Canestrini (« *Antropollogjia* »-Hoepli, Milano1878) shprehej se: „Kjo racë, ndër të gjitha ekzistueset (...) përherë diti t’i qëndrojë më pranë Zotit“. (37) Me “gjuhën” e fizikës moderne , Petro Zhej e shpjegon kështu: “Ne mund të themi se, gjer në një farë mase, një numër i madh fjalësh mund të vështrohen thjesht si mënyra të ndryshme të përcaktimit të Qendrës(...) gjuha referon gjithnjë tek Qendra, e rrjedhimisht tek simboli (Zoti) (38) Përsa më sipër, të gjitha emërtimet e shqiptarëve kanë përcaktuar vetëm **NJË KOMB**, të krijuar nga **ZOTI**.

Pr.Dr. Skënder Rizaj shpreh të njëjtin mendim: „Gjykuar sipas burimeve shkencore të dorës së parë, etnonomet pellgaz (sipas metatezës/vendkëmbimit bëhet pellazg), ilir, shqiptar (alban, arban, arnaut) jane sinonime“. (39)

Por cili prej këtyre emërtimeve ka qënë më i vjetri? Në Fjalorin Homerik të J.Panazidis (Athinë,1885), profesor i Universitetit të Athinës shkruhet : « Pellazgët, banorët më të vjetër të Greqisë, u shtrinë nga banesa e tyre e parë rreth Dodonës së Epirit (II 681) gjer në Thesali, Beoti dhe pjesë të Peloponesit, sidomos në Argolidë dhe Arkadi ». (40) Edhe në kohën kur shkruante Herodoti , ata ishin të pranishëm : « Më duket se e kam treguar qartë se pellazgët ishin një popull barbar, të cilët ruajnë *akoma edhe në ditët tona* gjuhën e tyre » (Historia, lib1) (41)



Në këtë hartë të shekullit 16, bazuar në përshkrimin e gjeografit Claudius Ptolemy, në qëndër duket qartë vënd-ndodhja e fiseve Pellazge. (42)

Sipas Plutarkut, Pellazgu i vjetër, ishte mbreti i parë në Epir (Plutarco , Pirro) dhe sipas autorëve të tjerët (Strab. Erodot. Stef. di Bizan. Scimno), **Epirotët** ishin **Pellazgë**. (43) Meqënëse rrënja „**ipe**“ (shqiponjë) e emrit **Iperiot** (Epiriot) ka formuar edhe emrin „Shqipetar“ (siç e pamë në pjesën I), me të drejtë themi se Pellazgët=Iperiotët = Shqipetarët e vjetër, siç i emërton edhe Spiro Konda : „Në Epir, përpara shk 13 pK, banonin katërmëdhjetë fise pellazgjike dmth Shqiptarët e vjetër“. (44)

Por, emri „shqipetar“ është më i lashtë edhe se ay „pellazg“ dhe këtë na e dëshmojnë, pothuaj të gjithë shkruesit e lashtësisë , të cilët kanë folur mbi popujt e gjykuar si „të parët e të parëve“ në Europë, me emrin **IPERBOREAL**. Shkenca Albanologjike e shtetit tonë, nuk ka folur kurrë për këto fise, duke lënë jashtë teksteve edhe vetë Pellazët, bashkëkohës të Herodotit, së bashku me baballarët e tyre Atlantidë. Përse Albanologjia duhet t'i studiojë popujt, të cilët edhe në kohën e Herodotit shikoheshin përtej kufijve të mitit, si një vezullim misterioz “ i Kohës së Artë “? Arsyeja është:

I- Sepse emri, i cili mrekullisht na ka mbritur i pa ndryshuar nga historianët e parë është fjalë e përbërë e gjuhës shqipe: Ipe(Shqiponja)+r(i)+Borë+al (Zoti) dmth Shqipetarët, bij të Zotit, që rinë në vëndet malore me borë. Ky është kuptimi i saktë gjuhësor. Të gjitha shpjegimet e tjera nuk qëndrojnë , sepse autorët e lashtë nuk e njihnin gjuhën iperiotë (shqipe) dhe e quanin „barbare“. Për rrjedhojë emri i fiseve Ipërboreale është mister edhe në ditët e sotme për studiuesit. Më qënëse fjala e gjuhës shqipe « ipe » dhe « borë » nuk gjëndet në fjalorin grek, studiuesit e huaj hamëndsojnë se, Iperboreal do të thotë : « ata që jetojnë përtej erës së veriut Borea ». (*Hyperboréens en grec ancien Ἰπερβόρειοι / Hyperbóreoi, au sens étymologique, sont ceux qui vivent « au-delà de Borée, le vent du nord »*).



(majtas) Borea, Vizatim në një enë balte e vitit 360 p.K, Luvër.

Lidhja e emrit „borë“ me „ipe“ (shqiponjë), nga studiuesit merret prej miteve. Sipas Tit Livit (cfr. Liv. XLV 29,8 (45) në Maqedonin e lashtë ndodhej mali Bora. Era e ftohtë e Veriut europian, që kalonte nga ky mal drejt Detit Jon, u quajt Perëndia Borea dhe banesën e kishte në Thrak.

Duhët të theksojmë faktin se, në të gjitha veprat e artit të Euro-Afro-Azisë së lashtë, ku figurat e Mbretërve-Heronj dhe Perëndi apo kafshëve fantastike, paraqiten me krahët,

kokën apo trupin e shqiponjës, ose kanë emrin e saj, kemi të bëjmë me mite me origjinë pellazge. *SHQIPONJA ËSHTË SIMBOLI MË I RËNDËSISHËM I BESIMIMIT PELLAZG.*

Fjalët Bora dhe Ipe , që shpjegohen vetëm me gjuhën shqipe, tregojnë jo vetëm përkatsinë shqipetare të emrit, por edhe „adresën e shtëpisë “ të fiseve Iperboreale - Gadishullin Pellazgjik (Ballkanik).

II- Iperborealët janë fise që kanë jetuar në trevat historike të shqipetarëve. Nga tradita gojore , për Iperborealët dihej vetëm se kanë jetuar në periudhën më të lumtur të shoqërisë njerëzore e quajtur „Koha e Artë“. Vëndi i tyre ishte Parajsa tokësore, ku jeta ishte e gjatë dhe plot gëzime, pa grindje e luftë, dhe ku kopështi përallor Hesperia (besoj se shqiptohej Iperia) ju afronte gjithshka. Fantazia e autorëve të lashtë, banesën e këtyre fiseve e shikonte në hapsira të ndryshme gjeografike, për të cilat nuk do të zgjatemi këtu. I vetmi mendim ku përputheshin të gjithë ishte se ata jetonin në *VERI*.

E gjithë ngatëresa për vënd-ndodhjen e fiseve Iperboreale , ka ardhur se në lashtësi nuk kishin njohuri gjeografike. Ishin autorët e mëvonshëm, të cilët nisur nga përshkrimet në mite, e çvendosën *VERIUN* e autorëve Jonian, në Gadishullin e Skandinavisë. Kështu lindi teza e fiseve Iperboreale, si „raca akullnajore“ nga u krijuan popujt dhe pasardhës të tyre u përcaktuan fiset gjermanike të kohës greko-romake. Filozofi gjerman Niçe pohonte (Nietzsche, *Anticristiano*, 1888) se: „Ne jemi Iperborealët “. (46) Ky përfundim „shkencor“ u përqaftua sidomos në shk19-20 nga nazistët.

Por ishte Straboni, ai që na la një vënd-ndodhje të saktë gjeografike: “ Shkruesit e kohrave më të lashta, duke i dalluar fiset, i kanë quajtur Iperborealë ato fise, që jetonin përreth Detit të Zi, lumit Istro (Danubit) dhe Adriatikut (Geografia, 11, 6, 2). Nga ky përshkrim, Straboni ka treguar trevat ku kanë banuar në kohën historike iliro-dardanët. Në librin e tij, Jacopo Durandi (*Saggio sulla storia degli antichi popoli d'Italia*,1769) pohon se Straboni (Lib.1) dhe Protarco tek Stefano Bizantino (de Urbib. f.727) përfshinin nën emrin Iperborealë, të gjithë popujt që jetonin përreth Alpeve Europiane si Kelto-Iberet dhe Kelto- Shitet . Edhe fiset e lashta të Italisë si Sikulët, Sabinët , Umbrët pretendonin se ridhnin nga Hiperborealët e vendosur në Illiri. (47) Këto të dhëna tregojnë se Iliro-Dardanët shtriheshin në të gjithë Europën veriore (perëndimore dhe lindore) që së bashku me Maqedonasit, kishin të njejtën etni me Iperiotët pellazgë.

Siç e vënë në dukje historianët e lashtë, Iperiotët (pellazget e Epirit) shtriheshin në jug të Gadishullit Pellazgjik (Ballkanik) rreth tempullit të tyre të parë -Dodonës. Ngrohja e klimës, shtimi i popullsisë apo ndonjë përmbytje katastrofike në jug, i detyroi një pjesë të emigronin drejt veriut, fakt që na e vërteton edhe Hahni kur flet për legjendat e Pellazgëve: Ndërsa pellazgët në jug e mbajnë veten si vëndës, tæk ata të veriut rron akoma gojdhëna që tregon ardhjen e tyre. (48)

Që fiset Iliro-Dardane e kanë origjinën nga fiset pellazge të jugut, e dëshmojnë edhe mitet: “Dardanin e lindi së pari Zeusi re-mbledhës”(Iliada Këng. XX, varg. 215) (...) Dardani, të cilin i biri i Kronit (dmth Zeusi-shën im) e donte mbi të gjithë djemtë...» (po aty , varg.304) (49) Për t’u dalluar nga vëllezërit e tyre të jugut, u shtua emrit kombëtar Iperiot një karakteristikë e vëndit të ri, “borën”, duke u emërtuar Iperboreal –Shqipetarët e vëndëve të borës. Që kemi të bëjmë me një “histori shqipetarë“ e dëshmon përhapja gjeografike e mitit të tyre. Sipas Enciklopedisë Italiane të vitit 1933, fiset Iperboreale njiheshin në gojdhënat e banorëve të Thrakës, Argosit dhe Peloponezit, por edhe në Siçili, tek Venetët e Italisë, Maqedoni etj, vënde ku ishin përhapur fisët pellazge. (50)

III- Apollo Iperboreal, ka qënë Perëndia shqipetare e Delfit. Siç e dëshmojnë studiuesit e miteve, figura e Perëndisë Apollon është e vonshme. Tempulli i lashtë i besimit hënor-Delfi, themelimin e të cilit Pausania (në Phocicis) jua atribonte fiseve Iperboreale.(Jacopo Durandi (*Saggio sulla storia degli antichi popoli d'Italia*,1769,f19) në kohën kur zbritën Dorët (XII-XI p.K.) që shpartalluan mikenasit , pësoi shkatërime të mëdha. Vetëm rreth shekullit IX-VIII p.K. ky tempull u ringrit përsëri, por duke iu përshtatur një besimi të ri: Apollonit diellor. (51)



The arrival of Hyperborean Apollo. Apollo came back from the land of the Hyperboreans with the annual r



Enë me figurën e Apollonit zbuluar në Shqiperi.(52) Apollo 320 pK. Belvedere Romë.

Në rast se lexojmë me vëmëndje se çfarë shkruhet për Perëndinë Apollon, dallohet se bëhet fjalë për mite kushtuar “kultit të të parëve” dhe shpreh nevojën e shpalljes së origjinës hyjnore të fiseve pasardhëse, të periudhës “hellenistike”. Ky qëllim shprehet qartas në mite nga “mbiemri” i tij, Apollo Iperboreal, si dhe lidhjes me ta: “udhëtimet” e Apollonit nga Delfi në vëndin e Iperborealëve dhe dhuratat e përvitshme që dërgoheshin nga këto fise, tempullit të Dodonës dhe Delfit, tempullit të Apollonit. (53) Studiuesi Julius Evola në veprën

e tij “ *Rivolta contro il Mondo Moderno*” pohon se : “Apollo Iperboreal ,sipas Virgjilit ,do të inaguronte një kohë të re të Artë, të Heronjve nën shenjën e Romës”.(54)

Në kohën kur është shkruar për herë të parë për Iperborealët nga Hesiodi (shk 8 p.K. Les Épigones fragment 150.21)1. Alcée (fragment 307) Herodoti (Hérodote, IV, 36) Diodori i Sicilisë(Diodore de Sicile, II, 47, 7) (55) ishin haruar mitet para-historike . Emri kombëtar i shqiptarëve të veriut ishte zëvendësuar me emrin Ilir të Illyrisë, ndërsa vëndi i origjinës së Iperborealëve, Iperia shkruhej tashmë Epir dhe historianët e parë nuk e dinin kuptimin gjuhësor të kësaj fjale. Për rrjedhojë,në vënd të Iperiotëve, „emigrantët“- Iperborealë u emërtuan si fiset e para të racës njerëzore.

Faktin se emri i parë kombëtar ka qënë Iperi-ot (shqiptar) e dëshmon, jo vetëm vendosja e fjalës **Ipe** në fillim të emrit të fiseve misterioze **Iperboreale**, por dhe mitet, sipas të cilëve Iperi-on (shqiptarja) kishte bir Agimin/Aurorën , dhe **nip Borean**, birin e Agimit (Eos) (56)

Pra fjala Ipe është bazë për emrin Iperboreal. Edhe biografia e familjes së Apollonit, i përket mitologjisë së Iperiotëve-pellazgë, Shqiptarëve të vjetër. Babai i Apollos, Zeusi dhe gjyshi Kroni, janë të racës së Titanëve dodonas, sikurse edhe nëna e tij, Leto (Latona tek romakët) e cila pati nga kjo lidhje, binjakët Artemis , që përfaqson dritën hënore dhe Apollonin , dritën diellore.(57)

Titanët janë pellazgë dhe sipas Plutarkut (Plutarco , Pirro) dhe autorëve të tjerë (Strab. Erodot. Stef. di Bizan. Scimno) fiset **Epirote** ishin **Pellazge** (58). Me qënëse Iperiotët /Epirotët janë Shqiptarë, (Epirotët ose Shqyptarët) siç e shpreh edhe Fran Bardhi (1606-1643) (59), për rrjedhojë Apolloni është një Perëndi e miteve shqiptare, siç e dëshmon edhe mbiemri i tij- Iperboreal (shqipet e veriut). Për studiuesin e emrave të Perëndive, Aristidh Kola, edhe emri i tij e ka origjinën nga pellazgo-ilirët: “Tek Dorianët (fise iperiotë) dhe Ilirët ekzistonte perëndia e dritës « Ylli »(...) që u bë « Apullaon » (*Gjuha e Perendive*,2003,f.169). Sot njihet me emrin Apollon.

Emri dhe miti i Apollonit është një dëshmi e çmuar historike dhe gjuhësore, e lidhjes shpirtërore dhe besimtare të bashkësive fisnore të së njejtës etni, të Ipe-ve, të Shqiptarëve të Veriut me ata të Jugut.

Mbas këtij rrugëtimi shumë të përmbledhur (për faktet që ekzistojnë) është e sigurtë se në studimet e mëtejshme albanologjike, panorama parahistorike e shoqërisë njerëzore, që koha shumë e gjatë, shkatërimet dhe zhdukja e dëshmimeve nga dora njerëzore e ka errësuar pothuajse tërësisht, do të ndriçohet edhe më tej.

Si përfundim të shtjellimit tonë (pjesa I dhe II): **BESIMI** ishte **ORIGJINA** e krijimit të **EMRAVE KOMBËTAR** të bashkësive të mëdha fisnore, të cilët i përkisnin së njejtës etni. Nga tradita popullore, mitet dhe dokumentet që tregojnë vijëmsinë e përdorimit të emrit Ipe/Iperi, prej parahistorisë deri në ditët tona, **Kombi i IPE-ve** (shqiptarëve), është më i lashti në hapsirën Euro-Aziate. Emri Epirot e ka origjinën nga emri **Iperiot** dhe shpreh

simbolin e Zotit – **SHQIPONJËN**, e cila ka shërbyer si emblemë themelore e Epirit të lashtë, para Aleksandër e Pirro Molosit. (60)

Sot nuk mund të caktojmë kohën, se kur emri kombëtar Ipe (Iperiot/Epiriot) u kthye në Schipetar (Shqipetar), për faktin se nuk e dimë se kur *Miti i Orakullit të Zotit* (shqiponja) u zëvendësua me *Mitin e origjinës së Njeriut nga FRYMA e ZOTIT*. E vetmja gjë e sigurt është se emri **SCHIPETAR** (Shqipetar) e ka zanafillën prej kohëve të erta të parahistorisë, kur u krijua ky mit dhe ka origjinë besimtare, fakt që vërtetohet lehtësisht nga mitet, gjuha shqipe dhe arkeologjia.

Emri *IPERBOREAL* është një dokument i vyer, në shërbim të albanologëve, që dëshmon autoktoninë dhe lashtësinë e Shqipetarëve dhe të emrit të tyre kombëtar. Ky emërtim tregon se bëhet fjalë për të njëjtën bashkësi fisesh historike -Titanësh- dmth *TË TANËVE* (shqip: tanët dmth fisi ynë), por të ndarë në dy degë të mëdha: të Veriut dhe të Jugut. Për mijëra vjet ata e kanë shprehur këtë ndërgjegje të përbashkët etnike, nën emrin e **Yllit** -Yllir (Iliro-Dardanët dhe shumë fise të tjera) dhe **Ipes** (Iperiotët, Epiro/pellazgët, Hellenët etj.) apo Geg dhe Tosk . Sipas J. Wilkes (1992), po të bazohemi në burimet greke, nuk mund të bëjmë asnjë dallim midis Ilirëve dhe banorëve të vjetër të Epirit. (61) Ishin kushtet historike (ardhja e fiseve të huaja aziatike) që e bënë të domosdoshme ripërdorimin e emrit parahistorik Schipetar, mbi të gjitha emërtimet e tjera kombëtare (që i dallonin dy bashkësit e mëdha), për t'iu treguar të huajve origjinën e përbashkët Hyjnore dhe pronësinë, „Zotër të trevave“.

Dr. Johan George von Hahn pyet: A bie fort në sy, që shkrimtarët romakë dhe grekë mos ta njohin emrin e përbashkët të disa popujve që ishin farefis? (...) Apo që pjesa më e madhe e Europës së qytetruar e injoron ekzistencën e një populli të madh në Greqinë e sotme, i cili nuk është grek, kështu që emri i grekëve e mbulon këtë komb të huaj ? (62)

Ky Komb i injoruar nga historiografia botërore edhe në kohën moderne, e ruan emrin e simbolit të Zotit parahistorik - **SHQIPONJËS**.

PLISI - MITI I ORIGINËS SË PËLLAZGËVË HYJNORË

Një gjë marrim ne përsipër : Gjithshka sa kemi sqaruar në lidhje me historinë, është e bazuar mbi llogjikën e fakteve ... Në qoftëse do të merren me to njerëz të tjerë, më të zotë dhe më të ditur se ne, ata do të jenë të shoqëruar në punën e tyre nga bekimet tona më të zjarra.

Pashko Vasa (1825 - 1892) « E vërteta mbi Shqiperinë dhe shqiptarët »

Si simbol i Beogradit , kryeqytetit të Serbisë, ngrihet madhështore Kolona “Fitimtari i Kosovës” (e përruar më 7.10.1928) kushtuar , sipas medias sërbe, fitores në Fushkosovë mbi turqit. Statuja shpreh forcën ushtarake (kolona, trupi nudo i mashkullit dhe shpata) si dhe mbrojtien hyjnore (shqiponja).



Modeli i monumentit, e ka origjinën tek tradita e Pellazgëve të lashtë, të cilët ngrinin shtylla të gurta mbas çdo fitoreje. Këtë fakt na e dëshmon Diodorit (Diodorus Siculus, shk 1 pK) i cili pohon se faraoni Sheshoshi (Sesostri) ndërtoi shtyllat në formën e organeve gjinitale të burrit, në rastin e popujve luftarak, duke besuar se mëncuria e shpirtit të çdo populli do të çfaqet qartë në brezat pasardhës nga pjesa kryesore e trupit (1)

Natyrën jo sllave të këtij monumenti e dëshmon edhe mbulesa e kokës (fig.1), origjina e së cilës, lidhet me mitet Pellazge dhe në të gjitha format e saj historike, ka qenë karakteristike e veshjes tradicionale të Shqipetarëve deri në ditët e sotme.

Sa e lashtë është mbulesa e kokës së shqipetarëve ?

Siç ka ndodhur edhe në studimet e tjera për traditën e Kombit tonë, edhe kjo temë të çon në periudhat më të herëshme të historisë njërezore. Për të ndjekur këtë rrugë dhjetra-mijë vjeçare, si udhë-rrëfenjës do të përdorim mjetet e mbijetuara nga ajo kohë e largët: *GJUHËN* pellazgo-shqipe, gjetjet arkeologjike dhe mitet.

Mbulesa tradicionale e kokës (sot e përdorur vetëm nga meshkujt) në shqip emërtohet *Qeleshe*, *Plis*, apo *Qylaf*. Pikërisht, tek dy emërtimet e para do të nis edhe studimi ynë. Emërtimi *Qeleshe* tregon se materiali i përdorur është leshi i bagëtisë. Sipas legjendave popullore të trashëguara nga periudha Ilire, Qeleshia punohej prej leshit të deles i shkelur (i shtypur me këmbë). (2)

Punimi me leshin e deles i Qeleshes, kishte një domethënie, sa historike aq edhe besimtare. Në kohën kur njeriu primitiv, filloi « të vriste mëndjen » duke shfrytëzuar natyrën jo vetëm për t'u ushqyer, siç veprojnë kafshët, mund të themi se nis edhe historia e *NJERIUT* të sotëm. "Njeriu, pohon Mircea Eliade (1907 -1986), është produkti përfundimtar i një vendimi të marrë që në Krijim (*al principio del Tempo*): të vrasë për të jetuar". (3) Materialet arkeologjike

tregojnë se kafsha e parë e zbutur prej tij ka qenë delja (para 8000 vjetësh). Studiuesja M.Gimbutas (1921- 1994) pohon se delet dhe dhitë, përbëjnë 90% të kockave të gjëndura në shtresat neolitike. (4) Me delen nisi edhe profesioni i bariut, emër që simbolikisht e mori mbreti në lashtësi (mbreti-bari) dhe më vonë drejtuesit e besimit kristian (bariu i tufës së besimtarëve).

Delja bën pjesë në të njejtën familje (caprinae) sikurse edhe dhia. Mishi dhe qumështi i saj janë një ushqim që sigurohej lehtë, ndërsa lëshi i dëndur, ritej shpejt dhe ngrohte shumë. Përgjithësisht lëshi i saj është në ngjyrë të bardhë. Ngjyra e bardhë është zotëruese në veshjen shqiptare. Në lashtësi ngjyra, forma apo materiali për objekte të rëndësishme, kishte një domethënie besimtare.

Për hir të këtyre cilësive, kjo familje (delja, dashi, dhia) zë vend të rëndësishëm në simbolet dhe mitet e besimit Pellazg dhe janë trajtuar krahas kaut, si kafshë të shenjta. Sipas studiuesit të traditës shqiptare, Mark Tirta, dhia paraqitet me cilësitë e hyjnisë së pyllit (...) Gjahtarët para se të dilnin për gjah në vëndet ku kishte dhi të egra, laheshin dhe kryenin një sërë ritesh. (5)

Dashi është përdorur në lashtësi për flijime kushtuar Perëndive huazuar në mitin kristian, ku Abrami flijon një dash në vënd të birit të tij Isakut.



(6)

(Nga e majta) Reljev i periudhës ilire, Perëndia Silvan me brirët e dhisë ; Dy koke dashi kane ne mes simbolin e Zotit (rrethi i formuar nga dy bordura , shpesh edhe ne formen e lules, me tophthin ne mes); Zeus-Ammon ulur mbi një fron me dy desh (fillimi shek.3 p.K.)

Që në mijëvjeçarin e VII-të, gjatë periudhës së bakrit e bronxit, figurinat e dashit të zbukuruara me figurat gjeometrike (V, zig-zaku, vijat paralele), përdoreshin si objekte kulti të Perëndeshës me kokë zogu (Perëndeshës Shqiponjë –shën im), në hapsirën Euro-Aziatike. Në kulturën ilire Vinka, figurina të Perëndeshës para-historike kanë brirë të dhisë (4500 pK). (7)

Në pjesën më të madhe të qytetërimeve të lashta delja ishte një kafshë simbolike që mishironte forcat e natyrës dhe lidhej me Perëndinë Hermes (Thot tek egjiptianët e lashtë) i cili mbahet edhe si shpikësi i shkrimit. Herodoti (484-425 pK) tregon se barbarët, për shkrimin e librave, kanë përdorur lëkurë delesh dhe dhish.(8) Në përkthimin e Strabonit (libri VII kapitull 5) për gadishullin e Ballkanit, nuk figuron emri i Dalmacisë, por emri Ardi (...) Në gjuhën baske, (që është gjuhë e trashëguar nga fiset pellazge të Ilirisë-shën im), “ardia”quhet delja. (9) Ndër fiset e njohur të Ilireve kanë qenë edhe Ardianët, emërtim i cili mund të ketë patur lidhje më kafshën hyjnore.

Përdorimi i leshit të deles dhe ngjyra e bardhë e saj (e ndriçimit hyjnor), dëshmonin rolin *SIMBOLIK*, fetar dhe administrativ, të vetë Qeleshes. Kjo vërehet tek fakti se në pikturat e enëve të qeramikes dhe skulptura e lashta, Perënditë dhe gjysëm-Perënditë e Olimpinit, që ishin Mbretër-Kryepriiftërinj (fig.poshtë) kanë mbi krye Qeleshen e rumbullakët apo në formë konike, por jo njerëzit e thjeshtë (e ka vetem Uliksi, majtas fig.2). Qeleshen e gjejmë edhe tek Faraonët dhe priftereshat e Egjiptit të lashtë. Figura e Qeleshes, në objektet arkeologjike të periudhës romake, përfaqësonte fëmijët e Zeusit- binjakët Dioskurë, si simbol i origjinës së tyre mbretërore dhe hyjnore.



(10)

E thënë më qartë : Qeleshja i shprehte popullit të thjeshtë, te drejtën hyjnore të Mbretit apo Faraonit, prifterinjve që zakonisht ishin nga rrethi i tyre familjar, për të gjykuar, drejtuar dhe mbajtur rrëgullin tek nënshtetasit e tij. Sipas studiuesit të besimeve të lashta M.Eliade “Rregulli shoqëror përfaqësonte një anë të rregullit kozmik. Që në krijim e Botës, të qënit mbret ka qenë një akt hyjnor. Krijuesi, ishte Mbreti i parë (...)Ai ia kalon këtë detyrë, birit dhe pasardhësit të tij, Faraonit të parë. Ky akt e shenjtëroi mbretërimin, si një institucion hyjnor” (11)

Qelesnja si simbol fetar dhe mbretëror është hyjnizuar në shumë objekte prej guri të etruskëve (fig.a poshtë) : në Marzabotto, Bologna, Pisa, Settimello (Firenze), Populonia, Volterra, Orvieto etj. dhe fiset e tjera pellazgo-ilire. Qeleshe/guri janë gjendur edhe në Delfi, që sipas studiuesve, përfaqsonin Perëndinë Apollon dhe në Tebë, Perëndinë Amon. Objekte të tilla arkeologjike njihen edhe në qytetrimin babilonez dhe hitit.

Ndër objektet arkeologjike hasen edhe Qeleshe-guri me simbolin e pellazgëve, shigjetën dy krahëshe (fig.c). Sipas studiuesit Petro Zhei (“*Shqipja dhe sanskritishtja*”) ,simboli i shigjetës me dy krahë tregon **NDARJEN** e kryer nga **ZOTI**, që solli krijimin e Botës materiale. (12)



Qelesnja u përdor si simbol i fëmijëve të Zeusit, Dioskurët (Castore dhe Polideuce) (fig.b).

Siç do të vërejmë më poshtë, jo vetëm elementet e përbashkëta të gjuhës, rriteve, simboleve apo miteve, por edhe veshja në objektet arkeologjike, dëshmon përkatësinë etnike, përhapjen apo ndikimin e fiseve të caktuara në hapsira të ndryshme gjeografike.

Mbretërit, që ishin në krye të ushtrisë apo fiseve, kanë sulmuar apo kanë marrë aratinë, të zbuar nga rivalët, drejt vëndeve më të përshtatshme. Kjo çvendosje ka qenë e **PËRHERSHME**. Siç pohon Nikola Lahovari : “Dihet tashmë së ka patur një epokë, nga mijëvjeçari III dhe IV, ku qytetrimet e të njejtit trung shtriheshin nga India deri buzë Adriatikut. Duke kaluar nëpër Iran , Mesopotami dhe Egjipt, në atë kohë, njerëzit që i përkisnin një tërësie, tipeve të njejtë fizikë dhe që flisnin gjuhë të së njejtës familje, banonin në luginën e Indusit, Persi dhe Kaukaz, Mesopotami si dhe brigjet e Detit të Zi dhe Egjeut, Afrikës së Veriut, Greqisë, Italisë, Francës, Iberisë dhe Anglisë. (13) Ky fakt, na lejon që për Qeleshen të gjurmojmë në të gjithë hapësirën Euro-Afro-Aziatike.



(14) Nga e majta në të djathtë, kemi të pasqyruar Qeleshen shqiptare tek një objekt arkeologjik (Shqiperi); Perëndia henore Men e frigeve, mijevjeçari i katërt (Mesopotami) ; tek statuja e gjetur në malin Lykaion-Arkadi (Helladë); Faraoni (Egjipt) dhe Albani 7 vjeç i ditëve të sotme.

Siç vihet re, Qeleshia përdorej në Europë, Afrikën Veriorë dhe Azinë e Afërt, fakt që përputhet me të dhënat historike të përhapjes së fiseve pellazgo-ilire. Emri Alban dhe Qeleshja, dëshmojnë trashëgiminë pellazge nga para-historia deri në shk21.

Në mijevjeçarët e fundit pK, shikojmë se Qeleshia nuk përdorej vetëm nga Mbrëti-Kryepriфт, rrethi i tij familjar apo krerët e ushtrisë, por edhe nga ushtarët e fiseve me përkatësi pellazge, siç parqiten në shumë relieve murale në të gjithë hapësirën mesdhetare. Qeleshja ishte pjesë e veshjes së luftëtarëve dhe qëllimi i përdorimit të saj ka qenë gjithëmonë besimtar: Mbrojtia hyjnore e përdoruesit dhe është paraardhëse e helmetës së mëvonshme metalike, si tek fiset ilire, galo-kelte, etj. Në periudhat para-historike, por edhe në ditët e sotme, simbolet e besimit pellazg kanë patur një vënd të rëndësishëm, në veprimet ushtarake. Këtë na e dëshmon edhe një ngjarje historike: “Në vitin 1715, feldmarshalli prusian Schulenburg, i këshillonte autoritetet veneciane, që ta bazonin ushtrinë e tyre tek elementi shqiptar: edhe në rast se do duhej të rekrutonin ushtarë nga kombësi të tjera, këta duhet të mbanin *kapelën shqiptare*”. (15)

Cilësimi vetëm për kapelën dhe jo veshjen, dëshmon së ajo luanë rolin e mbrojtjes hyjnore “të dorës së Zotit”, që ndikonte në moralin, si të luftëtarëve edhe mbi kundërshtarët (fig.a,b poshtë).



(16) (Nga e majta) Luftëtare hitite; Helmete e Kultures Golasecca;

Në foton (fig.c) kemi një skulpturë “kokë” pa trup, e shk7-6 pK, e emërtuar “Daun”. (17) Këto skulptura – Kokë, shprehin nje shkalle të re në besimin e pellazgëve: hyjnizimin e trurit. Sipas M.Eliade, “shpirtit” në trupin e njeriut nuk shikohej më tek zëmra, por tek truri. “Koka ,si burim i forcës hyjnore u bë keshtu nje objekt kult”. (18)

Dauni janë një nga popullsitë e lashta të krahinës së Pulies (Itali), por legjendat e tyre tregonin se Dauno, ishte bir i mbretit të Arkadisë (Helladë) që u hodh për të pushtuar toka në Italinë qëndrore. (19) Origjinën trako-ilire, e dëshmojnë edhe “kokat” e ngjashme të gjetura në krahinën e Panonisë dhe Trakisë (Helladë). Sipas studiuesve , shumica e këtyre kokave me qeleshe u përkisnin femrave priftëresha. Megjithëse në shumë skulptura të fiseve etruske, maqedone, trako-ilire, fiset iliro-trojane të Azisë së Vogël dhe deri në dinastitë e para të Egjiptit vërehet Qeleshja , çuditërisht, studiuesit e lashtësisë dhe të arkeologjisë, nuk e zbulojnë këtë lidhje me mbulesën e kokës në veshjen tradicionale të shqiptarëve të sotëm. “Krahasimi – thekson K. Nieri -shpesh lejon të dallosh lashtësinë e herëshme apo më të vonëshme, të disa fakteve kundrejt të tjerave” (20) Studiuesi Orhan Rexhepi (Preshevë), vëren se “Veshjet e luftëtarëve të ruajtura në rasat e Mikenës dhe në poçeri janë po ato veshje të sotme kombëtare shqiptare , fustanella dhe plisi”. (21)

Por historia e Qeleshes nuk mbaron këtu! Objektet arkeologjike, dëshmojnë se ajo ka patur një para-rendëse më të herëshme, e cila nuk kishte lidhje më figurën e shenjtë të deles dhe formën gjysëm-sferike që i vishet mitit të Vezës, por më mitin e *ORIGINËS* së *NJERIUT* . Për këtë fakt, na ndihmon po gjuha pellazgo-shqipe: emërtimi “Plis”, i përdorur në Malësinë e Shqiperisë, Kosovës dhe Malit të Zi. Ky emërtim është edhe më i lashti.

Historia e Plisit

Fjala *PLIS* në gjuhën shqipe emërton një copë dheu, që shkëputet kur hapet brazda për mbjellje apo ndonjë punim tjetër . Kur filloi të punohej toka dhe të mbilleshin bimët e egra, që shënoi lindjen e agrokulturës (afro para 7-8000 vjetësh) dhe vënd-banimeve të përhershme, atëhere ka lindur edhe hyjnizimi i dheut. Etruskët e Tarkuinës (Tarquinia, Itali), një fis pellazg, e shikonin fatin e tyre tek plisi i një toke të punuar në orët e para të mëngjesit. (22) Siç pohon albanologu Hahn (Johann Georg von Hahn, 1811-1869): “Pelazgët e kohës para-historike, ishin bujq të mirë, mjeshtër të zot dhe tek ata kulti fetar ishte mjaft i zhvilluem“. (23) Në këtë periudhë lindi edhe miti i Dhemitrës.

Nga toka buronin lumenjt që me ujin magjik ushqenin bimët dhe gjallesat e tjera dhe nga thellësia e saj, rrënjët lartësonin pemët e pyllit drejt qiellit. Toka “lindte” natyrën përreth, por edhe trette në gjirin e saj çdo gjë, sigurisht edhe njeriun që ecte mbi të dhe ushqej me prodhimet e saj. Mund të pohojmë ,vëren M.Eliade, së disa mite njiheshin nga njerëzit paleolitikë: në rradhë të parë mitet kosmogonike dhe *MITET* e *ORIGINËS* (origjina e njeriut, e kafshëve dhe e vdekjes etj) (24) Është interesant një e dhënë e Dr. J.Hahn : “Më duket se kam këndue te një vjershëtor i vjetër , se krijesa e parë e botës asht delja, *e cila ka dalë nga Toka.* (25)

Njeriu i lashtë, njohu fuqinë krijuese të Dheut dhe e quajti “ *Mëmë-dhe* ”, siç e emërtojnë edhe sot shqipetarët vënd-lindjen e tyre, por edhe disa popuj të tjerë europianë, duke bësuar se prej saj kanë lindur. “Pellazgu, babai i parë i popullit Pellazg, mbret në Argolidë. Sipas legjendave dhe miteve ishte Njeriu i Parë që jetoi në botë dhe në Arkadi, kishtë lindur nga dheu.” (Vojtech Zamarovský ,(1919-2006), “*Heronjtë e Miteve Antike*” f260, 1983) (26)

Vetë dy emertimet e lashta te fiseve te para, “lelege” dhe “pellazge”, ne gjuhën shqipe shprehin mitin e origjinës se tyre. Sipas studiuesit Niko Stillo (“*Toskerishte Etruskishte*”) emërtimi “Lelegë”, do të thotë « *lindur të lindëses tokë* » dhe Pellazgë do të thotë *pjellë* (dial.çam femijë) « *e lindëses tokë* » (të lindur nga toka-shën im) (27) Nga ajo kohë para-historike, tek shqipetarët ka mbetur emërtimi *FARE* për njerëzit e një fisi, i perjetësuar në Egjiptin e lashtë tek emri Faraon (fara+ (j) on, dmth prej fisit tonë). Ky emërtim diktohej për të bërë dallimin midis popullsisë vendëse të Egjiptit dhe sunduesve pellazgë. Sipas Herodotit, egjiptianët që kishin origjinë vëndëse, ishin të vetmit që nuk lejoheshin të hynin në asnjë tempull. (28)

Hyjnizimi i Tokës nuk lidhej vetëm me idenë e lindjes së njeriut, por edhe të *RILINDJES* së tij mbas vdekjes nga dheu. Kjo dëshmohej nga përdorimi që në kohët më të herëshme, të ngjyrës së kuqe (simbol i gjakut dhe i jetës), me të cilën lyheshin kockat e të vdekurve. Në rast se më përpara i linin të vdekurit në një guvë të shpellës, tani njeriu “bujk” i fuste në dhe, me bindjen se do “të rilindnin” përsëri. Këtë e deshmon edhe modeli, në formën e mitrës të varreve me një zgjatim “për të dalë”. Siç pohon M.Eliade , në periudhën Neolitike, për

paraardhësit tanë, jeta mbas vdekjes vijonte në botën e nëndheshme. (29)

Ky besim, e bënte varrin të shihej si një vend i shenjtë, traditë që është trashëguar në malësitë shqiptare në Veri dhe në Jug edhe sot, ku respektohen jo vetëm varret e të parëve, historia e të cilëve njihet pak a shumë nga populli, por dhe varret e vjetra, historinë e të cilëve nuk e njohin fare. (30) Hahn tregon edhe një zakon që kanë patur fiset e origjinës pellazge, si armenët, frigët dhe dardanët e Europës , të cilët “jetonin në banesa nën tokë” (Straboni, VII, f316) (31)



(Nga e majta fig.1) Në objektet arkeologjike shohim figurina që ju blatoheshin Perëndive , që mbanin mbi kokë një copë dheu-Plisin. Për ta bërë më të qartë simbolin mitik, kjo pjesë lyhej më bojën e zezë, (Hyjnesha nga Siria dhe Iraku ,periudha Halaf , 5.500/4.000 pK .Me këtë “shenjë” dëshmonin përkatësinë e fisit të tyre “të lindur prej dheut” dmth prej fiseve pellazge. Forma konike e fëmijëve të Zeusit, binjakëve Dioskurë apo e Aleksandrit të Madh është ruajtur tek shqiptarët e sotëm (fig.2) të zonës së Labërisë dhe Çamërisë (Molosia e lashtë).

Tek Perëndia Serapi copa “e dheut” ka formën cilindrike, si tek mozaiku etrusk (fig.3) e cila është forma e qeleshes më e përhapur tek popullsia shqiptare (fig.4). Sot e gjejmë si mbulesë të kokës, po në ngjyrë të zezë edhe tek priftërinjtë e Kishës ortodokse.

Vendosja e copës së dheut mbi kokë, ishte një ide e njeriut primitiv që e praktikonte mbi figurinat prej balte, të cilat liheshin në altare apo vëndet e shenjta. Praktikisht, Qeleshen njeriu e vendosi mbi kokë, shumë më vonë, në kohën kur mësoi ta përpunojë leshin e deles (kur filloi artizanati) gjithmonë për të treguar origjinën e tij hyjnore. Gjurmët më të lshata të përdorimit të saj janë gjëndur në mivejçeçarin e tretë pK.

Përfundimi i parë : Qeleshja në zanafill, ka shërbyer si simbol fetar dhe administrativ, fakt që e dëshmojnë objektet arkeologjike. Emërtimi *PLIS* është i periudhës para-historike dhe përcakton kohën e hyjnizimit të Tokës dhe krijimin e mitit të *ORIGINËS* dhe të *RINGJALLJES* së njeriut.

Këto mite, shprehin një fazë të re në besimin e lashtë, kur krahas forcave të natyrës, që mbizotronin deri atëherë në mitet e para, u ndërfut edhe figura e Njeriut. Miti para-historik i origjinës, mbijeton edhe sot tek emërtimi *PLIS* i Qeleshes dhe emri *ARBAN-ARBËRESH* (i banun/ i bërë nga Ara) të shqiptarëve. Në gjuhën shqipe Tokës së punuar i thonë - Ara, ku rrenja “ar” tregon natyrën hyjnore të saj. Edhe emri Pellazg dëshmon mitin e lashtë dhe në shqip, do të thotë :”Të lindur nga dheu” (Spiro Konda) . Ky fakt, dëshmon lidhjen e shqiptaro-arbërve me Krijuesin.

Qeleshja simbol i Krijuesit

Sipas M.Eliade: “Duhet të kemi gjithmonë parasysh, se shenjtërimin parësor, e kanë patur dukuritë qiellore dhe të shndritshme” (32) Xh. Katapano pohon se Pellazgët besimtarë të Egjiptit(12 000 pK), e shikonin “ prejardhjen dhe natyrën e burimit të ndritshëm : Zotin, mendimin e tij (...) si një “dritë bardhësore”. (33) Pra ngjyra e bardhë , që është ngjyra historike e Qeleshes sonë, ka shprehur Dritën hyjnore dhe e ka zanafillën kur në bësimin para-historik lindi idea e një *ZOTI* qiellor të cilin njeriu primitiv *E SHIKONTE* dhe i lutej.

Po kush ka qenë ky *ZOT* për Pellazgët?

Mark Tirta pohon se: Studimi i traditës dhe i besimit tek shqiptarët, na bind se kemi të bëjmë me një kult të lashtë vendës, sidomos në lidhje me Hënën, si fuqিদhënëse të prodhimeve bujqësore e blegtorale dhe fertilitetit të grave. (34) Hëna, në kultin e njeriut primitiv -pohon Giovanni Semerano- është një nga hyjnitë më të mëdha dhe më e rëndësishme se sa Dielli. (35) Ndërsa Edith Durham (1863 – 1944) vëren se në shumicën e tatuazheve që bënin femrat shqiptare në krahë, duar dhe gjoks, pasqyrohej figura e gjysëm-Hënës. (36)

Me figurën e Hënës në besimin primitiv lindi edhe idea e *ZOTIT* të ngjashëm me pamjen e njeriut (Perëndesha Sellenë / Diona). Në këtë periudhë besimi ishte *MONOTEIST* sepse besohej tek një Krijues. Më zhvillimin e shoqërisë njerëzore, që u shoqërua edhe me ndryshime në besim dhe krijimin e miteve të reja, Zoti nuk ishte më Hëna, por një burim hyjnor *DRITE* aq i largët, sa nuk mund të shihej nga syri i njeriut. Sot emërtimin *PAPA*(shqip: pa/nuk+pa/shikoj) e mban kreu më i lartë i besimit katolik (Papa), emër që buron nga roli i tij si ndërlidhës i Zotit (të padukshëm) me njeriun tokësor. Zoti shprehej në objektet arkeologjike me simbole të caktuara si : në formën e një vrime në disk apo ruaze në mes të lules, rombit, rrethit; pike a topthi në mes të kryqit, etj. “Sipas mendimit mitik-

pohon Petro Zhei - Qëndra (pika e prerjes së vijave të drejta) përcaktohet si përputhja e të kundërtave që identifikohet në instancë të fundit me *ZOTIN*. Qëndra = Zoti, Qëndra = Dritë ” (37)



Siç e shikojmë në fototn (nga e majta fig.1) mbi një pllakë varri, kemi simbolin e Zotit – topthi, në pikën e ndërprerjes së kryqit, ku çdo rreze ndodhet brënda rrethit (qiellit hyjnor); (fig.2) Zarathustra (profet persian ,shk 6 pK) në veshjen e të cilit kemi një varg ruazash ,simbole të Zotit , që i gjejmë edhe në veshjen tradicionale të shqiptarëve, të të dyja gjinive (fig.4) roli i të cilave është vetëm besimtar. Tophtha të tillë në formën e komçave, shohim edhe në veshjen e prelatëve katolik (fig.3)



fig.1



fig.2



fig.3

Në fotot lartë (nisur nga e majta fig.1) paraqitet mbulesa e kokës së Perëndisë hënore Horos, Attis dhe Shqiptarëve të shk19-20. Siç vihet re, kemi theksimin e majës së Qeleshës në formën e topthit, i cili, në varësi të materialit dhe mënyrës së punimit, anohet mbi kokë.

Ky topti i drejtë apo i anuar i Qeleshes është një nga format e shprehjes simbolike të Krijuesit (Zotit). Tek Qeleshja e shqipetarëve (fig.3) kemi të shtuar edhe një “bisht kali”, të njejtë si në helmetat romake, i përdorur si në veri të Shqipërisë (Shkodër shk19-20) dhe tek shqipetarët e Thesprotisë (Helladë shk 19) . Sipas besimit pellazg, tek bishti dhe koka e kalit, ndodhej “energija e pavdekshme” (e Zotit).

Me lindjen e besimit kristian, krahas formës së qeleshes pellazge (konike, gjysëm-sferike dhe cilindrike) u huazuan edhe tre ngjyrat e përdorura në lashtësi : e bardha, e kuqja e purpurt dhe e zeza, të cilat kanë gjithashtu domethënie mitike. Me poshte (nga e majta fig.1) kesula e zeze e shërbenjësit të kishës izraelite; (fig.2,3) ngjyra e kuqe dhe e bardhe tek katolikët dhe (fig.4) ngjyra e bardhe dhe e zezë tek ortodoksët.



Studiuesi Robert Graves (Robert Ranke Graves, 1895 -1985), këto tre ngjyra i lidh me tre ngjyrat e Hënës në mite, që personifikonin „tre fytyrat e saj“ dhe në objektet arkeologjike e gjejmë me grupin e tre Perëndive, në të gjithë hapësirën Euro-Afro-Aziate .



(majtas) Hëna e re është Perëndesha e bardhe: e lindjes dhe dashurisë . Hëna e plotë, Perëndeshë e kuqe: e dashurisë dhe luftës. Gjysëm-hëna, Perëndesha e zezë: e vdekjes, (38) por edhe e ringjalljes.

Siç vihet re në fotot e sipër-paraqitura të materialit, Shqipetarët i kanë përdorur në jetën e përditëshme (deri në shk19-20), të gjitha format historike të Qeleshes (konike, cilindrike, gjysëm-sferike dhe me majë të përkulur) si dhe ngjyrat (të bardhë, të zezë, të kuqe), të ardhura nga lashtësia. Format dhe ngjyrat e mbulesës së kokës, që i shikojmë sot tek shërbenjësit e besimit kristian, dëshmojnë se kur u krijua Qeleshja nga para-ardhësit e shqipetarëve, nuk kishte qëllim praktik (mbrojtjen nga të ftohtit ose për t'u vendosur nën helmetë, siç vërejnë disa studiues, apo si simbol të lirisë, siç lexojmë në disa enciklopedi), por *LIDHJEN* me *ZOTIN*, prandaj shqipetarët edhe në shekullin e 19 e quanin veten bij të një populli hyjnor.

E fshehta e bishtit të Qeleshes

Një „bisht“ i vogël që ngrihet mbi kësulën e Papës, nuk do të na tërhiqte shumë vëmëndjen, po të mos zbukuronte edhe Qeleshen e shqipetarëve të Çamërise (Helladë, Shqipëri) dhe Labërisë e në Veri (Shqipëri). A është një ngjashmëri e rastësishme, apo brënda saj fshihet një nga simbolet më të rëndësishme të besimit? Me qënëse e gjithë veshja e shërbenjësve të besimit, ka një domethënie që lidhet me detyrën e tyre, llogjika na çon tek arësytimi se ky „bisht“ duhet të jetë një simbol i lidhur me *Hyjnoren*, që nënkupton figurën e Zotit.

Për njeriun primitiv Zoti ishte Drita, që njihet me shprehjen *Ndriçimi hyjnor*. Njeriu i Paleolitit, nuk e zotëronte dhuntin e fantazisë, por ka shprehur në „artin“ e tij, vetëm atë që shikonte. Meqënëse „studimet“ e të lashtëve bazoheshin mbi krahasimin, ai e gjykoj rrezet si „dorën“ e Zotit, siç i shikojmë në murret e Piramidave egjiptiane apo skulpturat me shumë duar të besimit indian. Me këto vija të drejta (rrezet), ay krijoi simbolin e Yllit (✕ ✨ ; simbole të kultures Vinka/ Vinča), „fytyrën kozmike“ të Krijuesit, objektit më të largët qiellor. Dhimitër Pilika pohon se : „...Tek Ilirët, ylli lutej si perëndi e Dritës“. (39) Sipas P.Zheit Ylli = Qendra = O dhe fjales „yll“ në shqip i përgjigjet fjala El në hebraisht , emër që përdoret për Zotin. (40)

Ylli/kryq dy, tre e më shumë rrezesh, si simbol i *Dritës hyjnore* -Zotit, e gjejmë që nga vizatimet e shpellave dhe gjatë të gjithë historisë së zhvillimit të shoqërisë njerëzore (fig.1 në muzeun e Kalasë së Shkodrës). Edhe në ditët e sotme Ylli/kryq është simboli kryesor i besimit kristian dhe atij mysliman. Në mozaikun (fig.2 s. Apollinare Nuovo a Ravenna), shikojmë Yllin , shenjë e Zotit në mitin kristian, i cili lajmëron lindjen e Krishtit. Të bën përshtypje Qeleshja e Magjistarëve, e njejtë nga forma dhe ngjyra me ato të shqipetarëve të shk 19-20).Ylli/Zot, në hyrje të Kishën „Sagrada Familia“, në Barcelonë. (fig.4)



Yllin e kanë patur në monedhat e veta qytetet ilire të Apollonisë (të shoqëruar me hënën), Dyrrahut, Amantias, Korkyrës dhe Leukada (në trevat kaono-thesprote) në monedhën e mbretit ilir Monunit (shk III pK), në Etruri. (41)

Kjo „rrugë“ e ndjekur nga pellazgo-ilirët gjatë mijëra vjetëve, për të pasqyruar simbolin e Zotit tek Qeleshja, shprehet qartësisht në objektet arkeologjike.



(Nga e majta) Rrezet mbi kokën e mbretit Antiochos VI Dionysos të seleukëve, shprehin lidhjen me të Plotfuqishmin (Siria e lashtë); Simboli i Zotit, ylli ndodhet gjithmonë pranë Qeleshes së binjakëve Dioskurë (fëmijëve të Zeusit) në shumë monedha romake (211-208 pK); Ylli qëndron mbi Qeleshe, i mbajtur nga një rreze më e zgjatur.

Në pikturat murale, relievet e gurta apo monedhat metalike, pasqyrimi i Zotit me simbolin e yllit, nuk ishte problem. Por Ilirët apo më sakt “të diturit” që merreshin me simbolet e besimit në lashtësi, kishin gjetur një zgjidhje më praktike. Ata vendosën mbi Qeleshe, elementin e Yllit dmth *RREZEN*, atë që sot e shikojmë mbi kësulën e Papës dhe tek shqipetarët. Ndryshimet në besimin pellazg kanë ndodhur shumë kohë përpara së të shpallej kristianizmi. Karakteristikë ka qënë, se çdo fazë e re e tij apo çdo besim i ri që është çfaqur,

ka vijuar të përdorë po ato simbole ,por me një mit të ri. Tek kristianët, Kryqi/Yll shpreh tashmë jo Zotin, por sakrificën e Krishtit. Që kryqi kristian është huazuar nga lashtësia, na e deshmojnë objektet arkeologjike.



(Nga e majta) Në faqen ballore të varrit të Darios (Naqsh-e Rostam 486 pK, Persia e lashtë ,Siri) Kryqi/Yll tregon rrugën drejt Zotit, që ka ndjekur shpirti i mbretit të

vdekur; Prift i lartë i Kishës kopte (Egjypt) ka vendosur një kryq metalik (që njihet si kryq latin), i cili qëndron mbi kësulën e kokës.

Rrezen, simbolin e Yllit/Krijuesit, sot e gjejmë mbi qeleshen nga Shqipëria veriore; tek qeleshja e labërise dhe ajo çame, që është forma më e lashtë e saj dhe tek Papa në Vatikan.



Tek Qeleshja e shqiptarëve, “bishti” shpreh *RREZEN* – “fytyrën kozmikë” të Zotit (Dritës hyjnore), ndërsa në zbukurimet (kryesisht argjendi) dhe veshjen e trupit, simboli i Zotit shprehet me yllin/kryq, toptin apo ruazën. A ka qenë “bishti” i sotëm, që në kohën e krijimit të institucioneve të besimit katolik dhe çfarë ka përfaqësuar? Këtë përgjigje mund t’a japin vetëm materialet arkivore dhe studiuesit e Vatikanit.

Si përfundim: Plisi apo Qeleshja e shqiptarëve të sotëm është objekti që ka ruajtur dhe përcjellë *MITIN* e Origjinës së njeriut dhe Historinë e zhvillimit të besimit pellazg. Ajo ka simbolizuar lidhjen e njeriut tokësor me Krijuesin, siç e shprehnin edhe vetë pellazgo-ilirët, duke e quajtur veten *HYJNORË*. Këtë e dëshmon edhe emërtimi *ILIRË*, i paraardhësve të shqiptarëve të sotëm, që është emërtimi i simbolit kozmik të Zotit: *YLLI* -t(në dialektin çam - Illi).

BIBLA - HISTORIA E NJERËZVE ME PLIS

Janë të shumtë studiuesit që pohojnë se « Historia fillon me shkrimin » . Por gjithashtu duhet të pranojmë se, përpara se njeriu të krijonte alfabetin, për t'u shprehur, ai ka vizatuar apo gdhëndur figura dhe simbole në kockë, objekte prej balte dhe faqe të gurta. Kjo veprimtari , që sot emërtohet « art », ka qenë dhe vijon të jetë edhe në kohët moderne, një nga rrugët e rëndësishme, për pasqyrimin e periudhave të ndryshme të Historisë së njeriut.

Në materialin që do të trajtohet më poshtë, lidhur me « shqipetarët e vjetër » siç shprehej filozofi i shquar Sami Frashëri, krahas fushave të njohura si gjuhësia, arkeologjia, etnografia apo dokumentet e shkruara, do ta shfrytëzojmë edhe pikturën, për të sjellë fakte mbi Lashtësinë. Në këtë rrugëtim do të na ndihmojë Xhejms Tissot (*James /Jacques-Joseph Tissot 1836 – 1902*), një nga portretistët më të famshëm francez të shk19, që i përket brezit të rymës realiste në art.

Xhejms Tissot u rit në një familje të përkushtuar katolike dhe mbas vitit 1887 , në pikturat e tij (365 punime në vaj) autori ka trajtuar tema nga historia e Biblës (Testamenti i Vjetër dhe Testamenti i Ri). Si piktor që i jepte rëndësi të madhe detajeve, ai udhëtoi në Jerusalem, Palestinë dhe shtete të tjera të Lindjes së Mesme, për t'u njohur me vëndet dhe popullsinë që përfshiheshin në historinë e Biblës dhe ku gjëndeje një material i pasur arkeologjik .



Autoportret (1865) ; Bibla Testamenti i Vjetër i vitit 1611

(1)

Po çfarë lidhje kanë pikturat e Xhejms Tissot me historinë e iliro-shqiptarëve ? Pikërisht këtu qëndron edhe zbulimi, që ndoshta autorit as nuk i shkoi ndërmend, i një **FAKTI HISTORIK**, që nuk janë përmendur kurrë nga Historiografia botërore.

Në pikturën e parë (*fig.1*, poshtë) Xh. Tissot paraqet fiset hebreje në momentin e çfaqjes së një prej mrekullive të Zotit. Duke e ndjerë veten në prag të vdekjes për mungesë të ushqimit dhe ujit, hebrejt janë sulur të rëmbejnë *mana* (ushqimin hyjnor) që “dora” e Krijuesit ua ka hedhur nga qielli popullit të zgjedhur. Të habit fakti se në pikturë, disa prej tyre mbajnë Plisin e shqiptarëve mbi kokë. Në *fig.2* piktori paraqet një burr të moshuar. Të tërheq menjëherë pamja e tij gati-gati mitike: Balli i lartë, mjekra madhështore e sidomos vështrimi i tij që shpreh brengë, por edhe vendosmërinë e një vendimi të rëndësishëm. Në *fig.3* Bazoreliev ku tregohet se qeleshen në lashtësi e mbanin edhe femrat; Një skulpturë e rrallë e Aleksandrit të Madh me simbolin e besimit hënor të pellazgëve (ylli/hëna) (*fig.4*) dhe në *fig.5* një bari në malet e Labërisë (Shqipëria e Jugut, shk20).

Elementi i përbashkët i të gjithë grupit të figurave, pavarsisht periudhave mijëvjeçare që i ndajnë, është mbulesa e kokës, që në gjuhën shqipe quhet Plis ose Qeleshe. Siç pohojnë studiuesit, Plisi është pjesë e traditës së Kombit shqiptar. “Veçanrisht kësula e bardhë është ajo që, me gjithë ndryshimet e formës të rrjedhura nga fisi , e dallon shqiptarin nëpër gjithë Ballkan” (Eqrem Çabej “Shqiptaret midis Perëndimit dhe Lindjes” f29)



Plisi - simbol i të zgjedhurve të Zotit !

Sipas mitit, Moisiu udhëhoqi drejt tokës së premtuar, një përzijerje fisesh, ku bënte pjesë edhe fisi Levi, të cilët nuk kishin përfituar toka si fiset e tjera hebreje. Arësyeja ishte se ky fis merrej me shërbimin ndaj kultit të Zotit dhe ishin të vetmit që kishin të drejt të ishin priftërinj. Sipas Biblës, vete Zoti pohon: ” Unë kam zgjedhur levitët, ndërmjet Izraelitëve (...) levitët do të jenë të mi” (Numeri 3:11). Piktori ka përdorur Plisin, për t’i dalluar levitët nga njerëzit e fiseve të tjera hebraike (fig.1,lart). E bardha, e kuqja dhe e zeza ishin ngjyrat e përkatësisë ndaj fisit të Moisiut. (2) Sipas etnografëve, këto janë tre ngjyrat kryesore në veshjen e traditës së shqiptarëve dhe deri në shk 19-20, Plisi që përdorej prej tyre ishte i bardhë, i kuq dhe i zi. Megjithatë, tek shqiptarët në veshje, mbisundon ngjyra e bardhë , ngjyra e ndriçimit hyjnor e Krijuesit.

Në pikturën (fig.2, lart) (3) autori paraqet vetë profetin Mojsi (120 vjeçar), i vetmi që foli sy më sy me të Plotfuqishmin. (Nu 12:3; De 34:10; At 7:20; Eb 3:2-5). Xh.Tissot nuk ka lënë ndonjë shpjegim se përse Mojsiu paraqitet në të gjitha pikturat e tij me Plisin historik të shqiptarëve dhe është i vetmi portret në botë, ku ka këtë pamje. Lind pyetja : A ka patur Mojsiu origjinë iliro-shqiptare?

Të gjithë e njohin historinë e Moisiut. Sipas Biblës, ai lindi më 1571pK në Egjipt, (4) por disa studiues mendojnë më 1391/1386 pK (7 Adar 2368) duke e cilësuar si bashkohës të faraonit Akhetaton. (5) Ai u birësua nga motra e Faraonit dhe si pjestar i familjes mbretërore, Mojsiu ishte prift dhe ishte paisur me të gjitha dituritë e shkencës dhe besimit të shkollës së Thotit, (6). Në Egjiptin e lashtë, Faraonët dhe familjarët e tyre mbanin disa emra , sikurse edhe Perënditë pellazge të hyjnizuar në Olimp (*Niko Stillo“Etruskishtja-Toskërishtja”*). Historikisht njihen disa emra të Moisiut (Hosorsiphit), por kryesori mbeti ay që përdoret edhe në ditët tona.

Sipas Biblës, emri Moisi (në hebraisht מֹשֶׁה - Môsceh) do të thotë “i nxjerrë jashtë”, por rrënja “ms” është egjiptiane e do të thotë “fëmijë”(Esodo 2,10). (7) M.Eliade (historian i besimeve, mitolog dhe filozof, 1907-1986) gjithashtu emrin e Moisiut e shpjegon si egjiptian me kuptimin “i lindur, fëmijë”.(8)

Në lashtësi i kushtohej një rëndësi të madhe emërtimeve dhe tek pellazgët emri, sidomos i figurave kryesore të historisë së tyre, lidhej me mitet e besimit. Shpjegimet e mësipërme në Bibël nuk dëshmojnë rolin e Moisiut si profet dhe si figurë qendrore, në besimin Ebraik, Kristian dhe Islam. Por një legjendë e traditës gojore hebreje na ndihmon të zbulojmë kuptimin e emrit dhe gjuhën së cilës i përket. Kur Zoti i diktoi Moisiut ligjet sipas të cilave duhet të silleshin hebrejt me njeri-tjetrin dhe me popujt e tjerë (Torah) për të gëzuar vendin e një populli të zgjedhur, “Fëmijët e Izraelit i thanë Moisiut: Moisi, *mësuesi ynë*, na e mëso ... na e shpjego Torah-un” (Midrash *Tanchuma; Menachot 29b; Sotah 13b*). (9) Kjo legjendë përputhet me emrin shqip “mësues” dhe tregon profesionin e priftërinjve dhe sot e kësaj

dite. Poeti dhe eruditi shqipetar, Pashko Vasa (1825- 1892) pohon se “emri i Moisiut , nipit të Ramsesit të II dhe përhapës i krishtërimin, ka qenë tjetër dhe më vonë u quajt “Moisi” dmth mësues. Muse, shqip mësoj dhe musoj, do të thotë : unë mësoj ,unë jap mësim. Musois është ai i cili jep mësim, i cili na frymëzon dijen që lindi shkencën”. (10)

Përfundimi i parë : Kur tek një fjalë, kuptimi mitik përputhet me atë gjuhësor , origjina e emrit i përket popullit që e flet atë gjuhë. Për rrjedhojë emri i Moisiut është i gjuhës shqipe dhe tregon detyrën e tij si profet.

Por përkatësinë e tij etnike, nuk e dëshmon vetëm emri ...

Dhjetë urdhëresat e marra nga “ goja”e Zotit,
Mojsiu i ka shkruar në gjuhën pellazgo-shqipe.

Në ditën e parë të muajit të tretë që nga largimi nga Egjypti, izraelitët e lodhur dhe plot dyshime për fjalët e Moisiut dhe fatin e tyre, mbritën në këmbë të malit Sinai. Sipas urdhërit të Zotit, mbas tre ditë “pastrimi”, Moisiu i vetëm, ju ngjiti malit Sinai ku qëndroi dyzet ditë dhe netë, për të marrë nga goja e të Plotfuqishmi dhjetë Urdhëresat (Es17,8-13) , dy prej të cilave të shkruara “me gishtin e tij” mbi dy rasa guri që njihen me emrin TORAH. (11) Vendosja jo e rastësishme e ngjarjes, mbi një mal me emrin e Perëndisë hënore Sin të panteonit sumer, babilonez dhe të asirëve,(12) dëshmon jo vetëm besimin hënor të pellazgëve në këto vënde, por dhe origjinën pellazgë, të mitit kristian.

Torah (në hebraisht הַתּוֹרָה) personifikon vetë figurën e Zotit dhe përmban 613 urdhëresa. Sipas studiuesve është një fjalë e vjetër hebraike që tregon “mësimin” dhe shpesh përktthehet si “ligje”.(Stephen M. Wylen, *Settings of Silver : An Introduction to Judaism*, Paulist Press, 2001, p. 16) Siç vihet re, për këtë fjalë nuk kemi një përkthim gjuhësor. Sipas P.Zheit, Gjuhët e para kanë qenë simbolike dhe simboli është gjuha më të cilën E (Qëndra, Zoti) shprehet. (13)

Bazuar mbi të njejtin parim, albanologu Xhuzepe Katapano (*Thot Parlava Albanese*, Bardi Editore, Roma 1984) sqaron se : “ TORA ka të bëjë me çdo çast të jetës, me krejt ekzistencën njerëzore (...) rrjedh nga tingulli TR (tërë) , ku e para (t-shën im) tregon cakun dhe e dyta lëvizjen (r-rrota, rrethi -shën im) (...)

Ngaqë Zotit nuk mund t'i jepet një emër, që të shprehte thelbin e tij, realitetin përmbajtësor, Thoti e emërton : TËRË : i tëri, i ploti, absoluti (...) Pra TORA-HA është Arbërisht, përmbledh gjithë urtësinë, tërë dijen e drejtësisë ! ,, (14)

Ky shpjegim është shkencor dhe i bazuar mbi faktet gjuhësore, por janë trashëguar edhe fakte grafike. Mund të themi se, para përdorimit (ose krahas) të fjalës, njeriu „ka folur“ nëpërmjet gjesteve dhe vizatimit. Psikologu i njohur Karl Jang (*Carl Gustav Jung* ,1875

-1961) pohon se njeriu përdor fjalën, për të shprehur kuptimin e mendimit që do të trëgojë. Gjuha e tij është plot me simbole , por për të dhënë thelbin e mendimit, ai shpesh përdor vizatimin. (15)

Emërtimi në gjuhën shqipe Torah / Tërësi, i Zotit është shprehur në figurat që japin këtë ide të besimit, me të njejtin gjest-simbolik: duart e hapura që tregojnë gjithë-përfshirjen (gjithë horizontin, nga lindja në perëndim, nga Alfa deri tek Omega, nga qiellorja tek tokësorja). Ky gjest-simbolik, është i shprehur në shumë objekte arkeologjike dhe vizatime, jo vetëm me një kohë-zgjatje nga para-historia deri në mesjetë, por edhe me një shtrirje gjeografike në shumë hapësira kontinentale.

Ky gjest-simbol, që përfaqson njeriun e hyjnizuar apo „mishërimin e Zotit“ në Tokë, nga mitologët kristian iu përshtat mitit të sakrificës së Krishtit, për t'i dhënë popullit idenë e të dërguarit të Zotit. Në fotot poshtë, shihet përcjellja e simbolit besimtar në kohë.



(16) (Nga e majta në të djathtë) Figura e Perëndeshës së parë me trup njeriu e kokë zogu. Tre V posht qafës, simbol i femrës në lashtësi, dëshmojnë besimin hënor të pellazgëve ; Perëndesha hënore Iside në Egjiptin e Lashtë ; Statueta e Perëndeshës hënore, që (sipas H.Blavatsky *The Secret Doctrine*) dëshmohet nga dy gjarprinj në sejcilën dore (Creta, mijëvjeçari II pK) ; Kryqëzimi i Krishtit ,pikturë murale në Manastirin e Decanit, Kosovë; Krishti duke përdorur simbolin e duarve ,për të shprehur idenë ,si i dërguari i Zotit në tokë. (Vézelay Abbey, Burgundy, France, 1130)

Nuk mund të lë pa përmëndur edhe një fakt tjetër, emërtimin e vendit ku ruhen ligjet e urdhëruara nga Zoti (Torah) : “ARCA e Aleancës”. Në gjuhën hebreje lexohet - ,ārōn ha-bērīth , ku na bie në sy emri i vëllait të Moisiut Aaron, që besoj se shpjegon mitin e bërjes së arkës sipas udhëzimit të Zotit dhe jo kuptimin gjuhësor. Origjina e fjalës shqip “arka” (arca) e ka nga emri “bark” në kuptimin e barkut të njeriut që mban femijën. Por siç dihet, në gjuhët natyrale (gjuhët e njeriut primitiv) siç është shqipja, fjala ka edhe kuptim simbolik, të cilin na e shpjegon Fjalori Teosofik i H.Blavatskit(*Helena Petrovna von Hahn, 1831-1891*): Arka (Argha- kald.) - nënkupton mitrën e Naturës; Hënën e Re, një barkë shpëtimi; por edhe një kupë që përdoret për ritet fetare. (17) Herodoti e përmënd emrin “Arka-ia”, si emër të krahinës së Peloonezit, vend ku banonin « pellazgë aigia-lees ». (18) Kjo krahinë me vone u emertua Man-i, që ka qenë emri i lashtë në gjuhën shqipe i Hënës (Mana) (*F.Demi “Besimi hënor deshmi e autoktonise se Kombit Arber”*).

Por le të vijojmë tezën tonë. Faktet dëshmuar se emërtimi i librit të ligjeve (Torah) është i gjuhës shqipe, por brenda saj ka fjalë që përdoren edhe sot nga shqiptarët. Historia e shenjte e popullit hebraik, kapitulli i Gjenezës hapet me krijimin e botës : „Në fillim Zoti (Elohim) krijoi qiellin dhe tokën...“ (Gen. 1:1). Fjalën „në fillim“ e tregon shigjeta në (fig.1, poshtë) shkruar me alfabetin hebraik, por shqiptimi është në gjuhën shqipe.


→ נִפְּלִים m., pl. גִּבּוֹרִים, גִּבּוֹרִים (b. h.; emp. פִּלָּא) giants. Gen. R. s. 26 נ' בַּיּוֹמֵינוּ וְנ' בַּיּוֹמֵינוּ they are called *n'filim*, because they caused the downfall of the world; a. e. — בֵּן יִתְיָא a) name of a demon. Bekh. 44^b בֵּן נ' רִוּחַ נֶרְוָה *nervous prostration*, v. נֶרְוָה II.—b) name of a species of lizards, living in the water. Sifra Sh'mini, ch. VI, Par. 5; Hull. 127^a (בֵּן). Ex. R. s. 15 בֵּן רִוּחַ נֶרְוָה some ed. (corr. acc.).



Janë dhënë shpjegime të ndryshme për këtë fjalë: Në Fjalorin e orientalistit amerikan M. Jastrou (*Morris Jastrow, Jr., 1861 – 1921*) (fig.1,lart) kjo fjalë do të thotë „gjigand“. Ata u quajtën „niflim“ sepse ata shkaktuan shkatërimin (përmbytjen) e botës; është emër demoni. (19) Besoj së autori është nisur për këtë shpjegim nga mitet mbi fiset e para që jetuan në Tokë duke e lidhur me temën e Gjenezës. Ka shumë mundësi që M.Jastrou të jetë bazuar edhe tek Fjalori Teosofik i esoteristes më të shquar të shekullit 19, H.P.Blavatskit ku shënohet : „Nëfilim“ (ebr.) – Gjigandët, Titanët, Të rënët (Ëngjëjt –N.d.T.) (20) Me sa duket edhe H.Balvatski është mbështetur tek përkthyesit grek të Biblës hebraike ,të cilët fjalën „nëphilim“ (në gjuhën origjinale hebreje ph=f) e kanë përkthyer- gjigand.

Sipas Enciklopedise Treccani (*Enciclopedia Italiana -1933*), Titanët „të lindurit nga toka“ ishin brezi më i lashtë i pellazgëve ku bënte pjesë edhe Kroni, babai i Zeusit. Zeusi përfaqsonte brezin e ri të Titanëve që u hyjnizuan si perëndi në Olimp. (21) Gjigandët dhe Titanët janë pellazge dhe i përkasin dy degëve të të njejtës familje etnike (gegë dhe toskë), gjë që shpjegohet qart nga ana gjuhësore e emrit: „titan“ dmth „tanët“. Emërtimi „gjigand“ shpreh vetëm dallimin fizik, që dallon pellazgo-ilirët (shqiptarët) e veriut nga ata të jugut, të cilët vijnë më të shkurtër. Edhe sot popullsia e Shqipërisë Veriore dhe ajo historike (Dardania), emërtohet Gegë ,fjalë e rrjedhur nga Gigë (gjigandë). Pra ,shpjegimi që i bëhet fjalës „nefilim“ të çon tek mitet pallazge.


Që në Bibël kemi një histori pellazge, vërtetohet edhe me fakte gjuhësore. Teksti i vjetër, sipas studiuesve është shkruar në gjuhën aramaika dhe jo hebraike. Shkruesit hebrej duke mos e ditur kuptimin e fjalës e kanë lënë në origjinal. (22) Në gjuhën e sotme shqipe kjo fjalë shqiptohet qartësisht nga ana gjuhësore dhe ka kuptimin e „fillimit të një dukurie apo veprimi dmth zanafillën e ...“, që në Bibël është emërtuar „Gjeneza“.

Tek fjala „nëfilim“ me gërma hebraike, ndodhet edhe një shenjë e vogël  (si apostrof, fig.1,2 lart) mbas gërmës së parë dhe quhet „yod“ dhe në alfabetin hebraik ka vlerën numerike 10(numri perfekt, që përfaqëson Zotin). Sipas Rabbi Aqiva (shk.1), një prej themeluesve të

hebraizmit tradicional (shk. 1-6 pas Kr) , HaShem (një nga emrat e Zotit në Bibël) iu dha fëmijve të Izraelit jo vetëm dhuratën e shenjtë Torah (ligjet) por në të, shtoi edhe një dëshmi të veçantë të dashurisë ndaj tyre me anën e shenjës së yod-it, me të cilin ishte krijuar Bota (23) Pra germa „yod“ dëshmon vetë Krijuesin. Çdo germe, në alfabetin hebraik, i përgjigjet një pjesë e trupit të njeriut apo kafshës dhe germa « yod » përfaqëson figurativisht dorën (dorën e Zotit , siç paraqitet në muret e Pirmidave dhe në artin mesjetar të kristianizmit) dhe shqiptohet « Yod » ose « Youd» (24) Germa „yod“ u bë emërtimi i Zotit : „Got“ dhe „Gott“ në gjuhët gjermanike të Europës Veriore.(25)

Gjuhëtarët pohojnë se alfabeti hebraik e ka origjinën nga alfabeti aramaik (araméen) dhe e kanë përdorur hebretjtë dhe diaspora judeo-arabe, judeo-gjermane dhe gjuhë të tjera semitike. (26) Vetë alfabeti aramaik, e ka bazën nga alfabeti i fenikasve që është përhapur në Lindjen e Aferme në mijëvjeçarin e dytë pK. Ky alfabet u adoptua për të shkruar shumë gjuhë të tjera si hebraishten, nabetiane, siriane, palmiriane, mongole etj. mendohet edhe të turqishten e vjetër, i përdorur deri në shk 8 pK. (27) Fenikasit, apo “ Popujt e detit”- siç dëshmon Dr. Arif Mati (Aref Mathieu) - përbëheshin nga fise të ndryshme, në shumicën e tyre, të të njejtit trung etnik që quhet ‘pellazg, proto-ilir,frigjian apo thrako-ilir’ . Në Testamentin e Vjetër ata emërtohen si pasardhës të drejtpërdrejtë të Noe, krijuesit të racës së re njerëzore .(28) Në pasqyrën (poshtë), tregohet se si ka ndryshuar shenja e Krijuesit, nga alfabeti i hershëm aramaik deri tek shenja « yod » e alfabetit hebraik :

I -



(nga e majta) Alfabeti i hershëm Aramaik (shk 10 – 9 pK) ku germa “Z” është e njejtë me alfabetin fenikas dhe greqishtes arkaike (pellazge) siç shihet në pasqyrën II poshtë; Alfabeti Imperial Aramaik (shk 5 pK) ; Alfabeti hebraik. Kjo shenjë shënohet edhe si “ I ” e vogël (29)


Në gjuhën shqipe emri i Krijuesit fillon me gërmën Z (Zoti) sikurse edhe emri i Kryeperndisë së Olimpmit “Zeus”, rrënja e të cilit shpjegohet vetëm në gjuhën shqipe « zë, zëri » dmth ai që lëshon zërin si bubullimë. Në pasqyrën II, shihet se germa “Z” e alfabetit aramaik është e njejtë me atë të fenikasve dhe e alfabetit pellazg, të cilin gjuhëtarët e shekullit 19 e emërtuan gabimisht greqishtja e lashtë.

II -

Fenicio	Ebraico moderno	Greco arcaico	Greco classico	Etrusco	Latino classico	Latino moderno
Z	י	Ζ	Ι	Ι	Ι	Ι

(30) Gërma “Z”, më vonë grafikisht u shndrua në “I” që tek hebrejtë lexohet « Yod » dhe paraqitet si apostrof ose “i” e vogël. Në pasqyrën III (nga e djathta në të majtë), tregohet se gërma « Yod » apo “Iota” tek grekët dhe “I” e etruskëve dhe romakëve, e kanë origjinën nga hieroglifi egjiptian që pasqyron dorën. (31)

III -



Perëndia Thot ,krijuesi i alfabetit të lashtë egjiptian, si gërma fonetike morri tingullin e parë të emrit të figurës që vizatohej, dhe emri i dorës fillon me gërmën D vetëm në gjuhën shqipe. Dora (mano) sipas gnosticizmit do të thotë Zoti i Dritës. (32) Hieroglifi-figurë e dorës, me kalimin e kohës (grafika nr.III, lart) ka pësuar ndryshime, por i pandryshuar mbeti fakti se në mite, këto gërma kanë emërtuar gjithëmonë Zotin. Pra jo vetëm fjala “nëfillim” është shqip, por edhe gërma “yod” e alfabetit hebre (simbol i Zotit) e ka origjinën nga gjuha shqipe/arbërishte e Thotit pellazg.

Por hebrenjtë nuk morrën vetëm shkronjat nga egjiptianët. Studiuesi Dr. Arif Mati pohon se “Hebrenjtë i kanë huazuar nga egjiptianët bazat e tyre fetare, ligjet, rregullat e higjenës dhe supersticionet e tyre” (33) Studiues të shumtë ,vëren edhe M.Eliade, pohojnë se besimi hebraik nuk kishtë “krijuar” asnjë mit (...) Gjenia e besimit të Izraelit qëndronte në faktin se “Lidhjen e Zotit me popullin e zgjedhur, e kishte transformuar në një histori të shenjtë” .(34) Në vijim të tezës sonë, edhe Plisi është një nga dëshmitë e origjinës pellazge të Biblës hebraike.



(35)

(fig.1, majtas) Detaj i pikturës së gruas të Faraonit Menna (Vallee des Rois) Pamje të tilla janë shumë të ralla në artin egjiptian. Me Plis (pak më të zgjatur) është paraqitur Perëndia Horos, Osiris dhe disa Faraonë . Këtë formë të Plisit e gjejmë edhe tek priftërinjtë etruskë. Të bije në sy, se si Faraoni egjiptian (fig.2), Ismaili biblik, Danieli (fig.3) dhe Noe, në pikturën e Xh.Tissot, kanë të lidhur mbi qeleshe një rrobë apo shami, siç e përdorin edhe shqiptarët e Veriut të shk 20 dhe të Jugut historik (Arvanitasit) (fig.4-5).

Ne vërejmë të habitur se si trashëgohet për mijëra vjet një traditë edhe në veshje, e cila patjetër do të ketë një kuptim besimtar meqënëse lidhet tek Plisi. “Rëndësia e një ideje besimtare-pohon M.Eliade- faktohet nga aftësia e saj ‘për të mbijetuar’ në periudhat e mëvonshme” (36)

Siç pamë nga materiali i deritanishëm, në të gjitha pikturat e Xh.Tissotit ku paraqiten figurat biblike dhe fisi hebre (levit) me Plisin e shqiptarëve të sotëm (simbol i mitit pellazg të krijimit), kemi përputhje edhe me faktet gjuhësore dhe arkeologjike. Kjo i jep pikturave të tij, vlerën e një dokumenti historik.

Përfundimi i dytë : Emërtimi i librit të ligjeve të shkruar nga Moisiu -Torah - është vetë emri i Zotit. Si fjalë simbolike, gjen shprehjen e saj të plotë, vetëm në gjuhën shqipe. (Xh.Katapano) Brënda saj, ka fjalë shqipe të pa përkthyer dot, por të shkruara me gërma hebraike. *SHENJA* e Zotit në alfabetin hebre (Yod) e ka origjinën nga alfabeti fonetik i Perëndise pellazge Thot (Tot), nisur nga emri „dora“ siç emertohet edhe sot në shqip . Ndryshimi grafik dhe i tingullit të gërmës gjatë periudhave historike (D > Z > I > yod), shpreh ndryshimin në mite, por gjithëmonë ka përfaqësuar një figurë : *KRIJUESIN* dhe historikisht kanë shërbyer si rrenjë për emrin apo simbolin e tij (lat :Deus, ital:Dio; sanskr : Deva; iran : Div ; kanaen: El ose Il; shqip:Zot dhe Il / Ylli,në dial çam; etj.) Rrënja « Di » si emër i Zotit (Dio), në dialektin çam të gjuhës shqipe, shpreh Dijen dhe Driten.

Të gjitha këto fakte, dëshmojnë së historia e Biblës është shkruar në gjuhën pellazgo-shqipe nga Moisiu . Duhet të shënojmë se: Shqiptaro-Arbërit e sotëm janë pasardhësit e mbetur nga një racë shumë e madhe pellazgjike e Lashtësisë. Sipas studiuesit austriak J.Hahn (*Johann Georg von Hahn 1811 –1869*) „ Shqiptarët janë Pellazgët e Rinj“ (37), tezë e mbështetur edhe nga shumë studiues të tjerë të më vonshëm shqiptarë dhe të huaj. Gjurmët e Pellazgëve sot shfaqen në gjuhë, arkeologji, mite dhe simbolet fetare, tek shumë popuj të Europës , Azisë e më gjerë. Shkruajmë „Pëllazgo-Shqiptarët“ sepse emërtimi „Shqiptar“ shpreh një simbol shumë të lashtë besimtar –Shqiponjën, dhe është po aq i vjetër sa emërtimi Pellazg apo Ilir/ Yllir (edhe këto janë emërtime mitike) dhe jo i shekullit 15, siç e trajtojnë disa studiues të cilët nuk kanë njohuri mbi besimin dhe mitologjinë e Lashtë.

Tissot shprehës i simboleve të besimit pellazg dhe traditës së shqiptarëve

Xh.Tissot nuk bën pjesë në rradhën e studiuesve , udhëtarëve apo të punësuarve nga Perandoria Osmane ,që kanë njohur trevat historike dhe popullin shqiptar. Por në pikturat e tij (me aq sa kemi patur mundësi të njihemi) në ciklin mbi Biblën, figurat kryesore dhe pasuesit e tyre, shprehen me karakteristika të veshjes dhe simboleve pellazgo-shqiptare, që ruhen edhe në ditët e sotme , siç do ta vërejme më poshtë.

Ngjashmëria në tregimin biblik midis Moisiut dhe Noe është se të dy kanë bërë “marrëveshje me Zotin” për t’iu bindur dhe zbatuar ligjet e tij. Si shenjë të marrëveshjes me Noe, për të mos shkaktuar përmytje që do të zhdukte njerëzimin, Zoti çfaqti Ylberin (*Genesi, IX, 6-17*). (38)



(39)

Në pikturën (*fig.1*) e Xh.Tissot duket “shenja” e Zotit- ylberi . Kjo fjalë në gjuhën shqipe shpreh qartësisht mitin (yll+bëri) dmth tregoi praninë e tij. Në gjuhët e tjera, emri i ylberit nuk e bën shpjegimin e këtij miti.

Në pikturën (*fig.1,lartë*) , përveç Plisit të rrethuar me një shami, na habit edhe një detaj tjetër në veshjen e familjes biblike - thekët - që zbukurojnë përpaset e mbrapme të femrave. Veshja e traditës shqiptare e ka të theksuar përdorimin e thekëve si në brez, përparset e vogla përpara dhe mbrapa trupit, në shamitë e kokës , në trasta, mbulesa si dhe në veshjen e burrave të Shqiperisë së Mesme (*fig.2,3 lartë*). Edhe sot ne i shikojmë tek besimtarët hebrej fjet (simbolike) që zgjaten në veshjen e burrave , që tregojnë rolin e tyre besimtar.

Duke parë pikturat kushtuar Biblës hebraike, të krijohet bindja se Xh.Tissot nuk ka qenë vetëm njohës i mirë i saj, por edhe i simboleve të lashta të besimit parakristian. Këtë e dëshmon edhe një detaj tjetër në veshjen e profetëve dhe engjëjve, por edhe tek shqipetarët dhe ka lidhje me simbolin kryesor të Kristianizmit : **KRYQIN**. Në materialet arkeologjike Kryqi në besimin pellazg përfaqson grafikisht Yllin, fytyrën kozmike të Zotit dhe origjina e ketij simboli, sqarohet me gjuhën shqipe. Ne Enciklopedine Judaike (*Encyclopaedia Judaica*, vol.7. NY, Gale, 2007 pag.672) emërtimi i lashtë i Zotit është *El* qe korespondon me *Ilu* në gjuhën akadiane (akkadian) dhe *El* ose *Il*, në gjuhën kanaene (caanite) por nuk dihet origjina e tij. Pranohet përgjithsisht se rrënja vjen prej *Yl* ose *Wl* nënkupton “të jesh i fuqishëm” ose “i pushtetshëm”.(40) Misteri i origjinës së emrit të Zotit në gjuhët e lashta semitike (akadiane, kanaene dhe me vone hebraike), zbulohet në shqip, ku rrënja “yll” (dial.çam Il) jep kuptimin gjuhësor e mitik, të simbolit kozmik të Zotit-Yllit. Studiuesja e shkrimeve në gur në Shqipëri, Greqi, Itali dhe shumë vende të tjera, Nermin Vlora Falaski (“*Patrimonio linguistico e genetico Probabilita della Monogenesi delle Parole*”) pohon se : „Yll“ (yj- yjnor – hyjneron) nuk e kam gjetur në asnjë gjuhë tjetër me perjashtim të shqipes (...) megjithëse ishte e përhapur në të gjitha mbishkrimet e lashtësisë, nga Egjeu deri në Atlantik (41)



Duke filluar nga e majta në të djathtë (lartë): Profeti Ezekiel dhe (fragment) Engjëjt që përzenë Adamin dhe Evën nga Parajsa- Xh.Tissot ; Skenë nga miti i Clytemnestres, gruas së Agamemnonit, mbretit të Mikenes dhe Argos (380-370, Louvër); Libri i të vdekurve, Deir el - Madina , Dinastia XVIII (1428-1351 pK); Veshje e traditës nga Gjirokastra, shk20 Shqipëri. (42) Në dy pikturat e para të piktorit,(fig.1,2) profeti dhe engjëlli, zbatuesi i urdhërave të Zotit, kanë në veshjen e tyre formën e kryqit, sikurse edhe Ilirët e lashtë, Faraoni egjiptian dhe shqipetarët e ditëve tona. Është një fill kohor dhjetra-mijë vjeçar i simbolit, po të kemi parasysh, se shenja (X) është nga më të herëshmet tek njeriut i shpellave.

Në gjuhën shqipe (dial.çam) fjala Krijues, Kryq (Kri-q), Krisht (Kri-sht) kanë origjinë mitike prej emrit Kokë (Kri-et). Në lashtësi, shumë fjalë janë formuar nga e njejta rrënjë, kur kanë patur lidhje në mitin e besimit. Megjithatë na ngacmon mendimi se si e zbuloi, piktori i shquar francez, Plisin?

Duke gërmuar në materialet arkeologjike në vendet ku shëtiti piktori gjatë dhjetë viteve të fundit të jetës së tij, ne kemi mundësi t'i japim pëgjigje pyetjes sonë, duke u nisur nga faktet llogjike. Me qeleshe, simbolet pellazge, figurën apo krahët e shqiponjës, nuk janë “veshur” vetëm Faraonët më të shquar të Egjiptit të lashtë , por edhe Mbretër/Profetë të hyjnizuar si Perëndi, të Azisë së Afërme dhe Qëndrore (fig.poshtë). Ishte intuita e tij prej artisti dhe studiuesi, që e çoi tek idea, se në lashtësi , Plisi ishte një simbol shumë i rëndësishëm besimtar dhe tregonte lidhjen me Krijuesin.

Një kokë me Plis, (fig.poshtë) fragment i statujave gjigande mbi 9 metra të larta, të shoqëruara nga shqiponja, pranë varrit të Mbretit Antiochus, Theos Commagene pranë Malit Nemrut . (Turqia lindore, në kufi me Armeninë) (43)



Përfundimi: Qëllimi i studimit nuk ishte thjesht të kënaqim kureshtjen tonë në lidhje me Plisin e shqipetarëve në pikturat e Xh.Tissot. Synimi ishte të dëshmonim se edhe një popull si ay shqipetar, për të cilin studiuesit ankohen se s'kanë të dhëna historike për origjinën, besimin dhe gjuhën e tyre, mbart brenda traditës së tij fakte, jo vetëm për Lashtësinë e tij, por edhe të shumë popujve të tjerë, që deri më sot janë të mbuluara me mister ose janë keq-shpjeguar nga ana shkencore. Detyra që i vuri vetes Xh.Tissot për të pasqyruar sa më besnikërisht Historinë e Biblës hebraike, e çoi në mënyrë të pavetëdëshme, në zbulimin e Plisit të pellazgo-shqipetarëve dhe të simboleve të besimit të parë euro-afro-aziatik. Vetë emrat e lashtë dhe të sotëm për Zotin dhe simbolin e tij, nuk mund të shpjegohen pa ndihmën e gjuhës dhe traditës së shqipetarëve.

Faktet e sjella tregojnë, se popujt e lashtë e dëshmonin përkatësinë e tyre fisnore dhe besimin, edhe me gjestet, ngjyrat, zbukurimet, pjesët dhe formën e veshjes, e deri tek modeli i flokëve e detaje të tjera, të cilat nuk u përmëndën për të mos u zgjatur.

Ky studim zbulon gjithashtu një nga dukuritë universale të shoqërisë njerëzore: nga njëra anë « luftën », përpjekjen titanike të popujve drejt së ardhmes dhe nga ana tjetër, po një « luftë » për të ruajtur çdo trashëgimi të pasurisë së tyre shpirtërore që nga zanafilla. Ky fill lidhës i dy poleve të kundërta kohore , (të së shkuarës dhe të ardhmes), përbën atë që emërtohet « palca kurrizore » e një Kombi. Siç vëren eruditi arbëresh Xhuzeppe Krispi “Kombi i lashtë i ruan , si gjuhën ashtu dhe zakonet “. (44)

HËNA DHE DIELLI, SIMBOLE KULTIKE NË DY KOKAT E SHQIPONJËS PELLAZGE

Pelasgetë kishinë nje besë te bukur' e vjershëtore. Besonin gjithë shenjat' e natyrës e trupet' e qjellit; i faleshinë djellit, henës, yjvet të mëdhenj, qiellit, revet,eresë, detit e të tjerave. Kjo besë, që thuhet "mythologji" është bes' e të parëvet prindër tanë, pelasgvet.

Sami Frashëri

Mbi simbolin e flamurit shqipetar, shqiponjës dy krenore të zezë në fushë të kuqe, janë bërë studime të shumta. Edhe në ditët e sotme, ajo vazhdon të përfaqësoje gjuhën, kombin, emërtimin e Shqipetarëve, por edhe simbolet shtetërore të vëndeve të tjera, brënda dhe jashtë Europës. Studiuesit e lashtësisë, pohojnë njëzëri se, shqiponja është një nga figurat kultike më të lashta, më të fuqishme dhe më jetëgjata.

Ka patur shumë hamëndsi për figurën e shqiponjës në flamurin tonë, sidomos për

qënien e dy kokave të drejtuara në anë të kundërta, përmendja e të cilëve do të hante shumë vend e kohë. Por, shkenca historike edhe sot, nuk na thotë gjë se : Përse Shqiponja përfaqësohet aq gjerësisht në Histori, karakterin kombëtar dhe në çdo fushë tjetër të jetës së shqipëtarëve, si tek asnjë popull tjetër? Përse në objektet arkeologjike dhe ato kultike, pothuaj të të gjithë Kontnenteve, figura e saj zë një vend aq të rëndësishëm ? Për t'iu dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, do të duhet të mësojmë fillimisht, rolin e saj në *BESIMIN* e *PARË* të historisë njerëzore.

Kur lindi gjuha dhe besimi, tek njeriu primitiv ?

Prof. Anxhelo Karkanji (Angelo Carcagni), duke studiuar vizatimet në muret e shpellës Grotta dei Cervi në Porto Badisco (Itali), ka nxjerrë përfundimin se lindja e besimit është e lidhur me lindjen e gjuhës (...) dhe është zhvilluar krahas saj , afërsisht 50 mijë vjet përpara. (1)

Për të shprehur besimin e tij, njeriu primitiv fillimisht ka zhvilluar në formën e mjaftueshme për komunikim – gjuhën, dmth një sasi të caktuar fjalësh.

Në studimin e tij “*Gjuha dhe mendimi simbolik*”, Prof A. Carcagni pohon se fjala që krijoi njeriu primitiv, nuk përcaktonte vetëm një send apo dukuri, siç ndodh sot, por shprehte një mendim të tërë. Për rrjedhojë, fjala luante rolin e një simboli : “ Me zhvillimin e të folurit, njeriu primitiv përftoi një mundësi të re të marrdhënieve në komunitet, të *shkëmbimit simbolik* (...) Roli i saj zanafillor (i fjalës) është ndërtues në zhvillimin e njeriut dhe duhet të njihet në përbërësit e saj kryesor: Të vendosë identitetin e grupit, të krijojë një rregull shoqëror të lidhjes dhe të bashk-jetesës, të disiplinojë sjelljet subkoshiente (...) Kur flasim për shenja dhe simbole të botës neolitike, të jetës neolitike, të qytetimit neolitik, nuk bëhet fjalë për çështje thjesht emërtime”. (2)

Duke e kuptuar faktin se gjuha e parë që krijoi njeriu, përbëhej nga fjalë-simbole që shprehnin një mendim mitik, kemi gjetur *ÇELËSIN* që hap portën e labirintit të Lashtësisë dhe të besimit pellazg, nga e ka origjinën edhe emri dhe miti i shqiponjës i flamurit tonë kombëtar. Ku e mbeshtes këtë mendim?

Lieblein, në një paragraf të shkruar në vitin 1884 pohonte se: “ Vete idea e Zotit ishte zhvilluar në një periudhe më të herëshme të gjuhëve sesa gjuha indo-europiane (...) Kur të kemi arritur deri kaq larg (sa të zbulojme këtë gjuhë zanafillore-shën im), ka shumë të ngjarë, që në këtë gjuhë para-historike, të gjejmë edhe fjalë që shprehin idenë e Zotit “ (3) Për natyrën besimtare të fjalës, na dëshmon edhe veziri –profet i faraonit Djedkarë Isési, Ptahhotepi (-2400), i cili ka shkruar se: “Fjala shkruhet me një yll, sepse synohet të përndritet shpirti i lexuesit *me një dritë me prejardhje hyjnore*”. (4)

As Lieblein dhe as Pr. Angelo Carcagni apo studiues të tjerë, që pranuan natyrën simbolike dhe besimtare të gjuhës së parë të krijuar në lashtësi, nuk kanë mundur ta vërtetojnë me fjalorin e gjuhëve të lashta apo të sotme. Të parët që e kanë faktuar këtë lidhje, kanë qënë studiuesit arbër.

Në veprën madhore “*Thoti fliste shqip*”, Xhuzepe Katapano na jep kuptimin simbolik dhe besimtar të emrit të shqiponjës (*AIN*, në arbërisht): **A**=At, Parimi i Parë, Zot At i Përjetshëm, **I**= Fjala Krijuese, **N**= protomateria (lënda fillestare, e parë, prej nga u krijuan të tjerat) (5)

Studiuesi zbuloi tek shkrimet në papiruse, gdhëndjet e gurta të Piramideve apo në emertimet e Perëndive të Egjiptit të lashtë, edhe shumë fjalë/simbole të tjera, me anën e gjuhës arbërishte -shqipe. Ky fakt tregon origjinën e besimit në Egjiptin e lashtë, si dhe gjeografinë e përhapjes së fiseve pellazgo-ilire dhe të miteve të tyre. Spiro Konda pohon se “Atje ku ka fjalë pellazgjike, atje gjënden edhe pellazgë që banojnë” (6)

Përfundimi i parë : Emri *AIN* në gjuhën arbëreshe, tregon se Shqiponja në lashtësi përfaqsoje vetë Zotin dhe mitin e Krijimit dhe gjuha pellazgo-shqipe ka qënë gjuha e Besimit të parë në hapsirën Euro-Afro-Aziatike, që vazhdon të flitet edhe sot nga shqipetarë arbëreshët në çdo cep të Botës.

* * *

E panjohura më e madhe rreth figurës së shqiponjës, sigurisht lidhet me paraqitjen e saj në lashtësi, me dy koka të kthyera në anë të kundërta, e zbuluar edhe në tempullin e parë të Pellazgëve në Dodonë, në vitin 1878.(7) Duhet pohuar, se krahas saj, ka qëndruar edhe trajta e shqiponjës me një kokë. Deri më sot, nuk është bërë ndonjë lidhje apo dallim midis tyre apo hershmërisë së njëres ndaj tjetrës. Kjo bashkjetesë është pasqyruar edhe në flamujt, si dhe në çdo krijimtari të traditës, në periudha të ndryshme. Mendoj se shpjegimi më i saktë i qënjes së dy kokave tek shqiponja, duhet kërkuar tek lidhja e saj, e padyshimtë, me shqiponjën njëkrenore - e zogut që përfaqsoi *KRIJUESIN*.

Krijuesi me fytyrë te panjohur

Le të kthehemi sërisht tek vizatimet në muret e shpellave, që janë dëshmitë e para materiale që kanë mbritur në ditët tona, nga periudha më e herëshme e njeriut që flet dhe mendon. Në vizatimet e shpellës Grotta dei Cervi, ndërmjet figurave të shumta të botës që e rrethonte njeriun primitiv, duken edhe vizatime abstrakte (fig.1 poshtë) që lidhen, sipas studiuesve, me besimin e banorëve primitiv. (8)



Në këto vizatime, vënd të veçante, zë portreti i “shamanit” prehistorik (Grotta di Cervi) drejtuesit dhe organizuesit të parë të bashkësive primitive.

Emërtimi “shaman”, siç e përcaktonin edhe Perëndinë Bes, është i shekujve të fundit, por në gjuhën shqipe mund ta shprehim më sakt me emrin “Kreu” apo “Ati”, siç e gjejmë për mbretin-bari të Thesprotisë pellazge (Niko Stillo “*Etruskishte Toskerishte*”). Pa dyshim se ka qënë, jo vetëm i fortë fizikisht dhe i gatshëm t’i vërsulej kujtdo që mund të rrezikonte jetën e gjinisë së tij, por dhe një verejtës i palodhur i botës që e rrethonte.

Duke vërejtur, Kreu mësoi të vlerësojë forcën e natyrës dhe të botës shtazore, por dhe të mundësive të njeriut për t’u mbrojtur. Ky “peshim forcash” e shtyu të kërkojë dhe të shpik, për të mbijetuar, “mjetet” (por edhe me pamjen e tij), për “duelin” me kundërshtarin. Ishte Kreu, që morri vëndin e ndërmjetësit, midis gjinisë së tij dhe rrezikut, të cilin e luftonte por edhe e merrte me të mirë.

Shumë shpejt, njeriu primitiv vërejt se vetëm me *NJË*-rën, nuk mund të matej, bile as ta shikonte formën e saj, as ta prekte dhe as t’ia dëgjonte zhurmën apo zërin. Fuqia e saj ishte kaq e madhe, sa mund të zhdukte çdo gjë të lëvizshme apo të palëvizshme në natyrë, bile edhe vetë atë e fisin e tij. Kur çfaqej *AJO*, çfaqej edhe njeriu dhe bota përreth tij, kur largohej, bashkë me të zhdukej edhe bota që e rrethonte njeriun dhe sundonte vetëm errësira-Terri. **Ishte AJO që krijonte gjithshka!** Fuqia e saj bënte të mundur të çfaqej e të zhdukej edhe vetë Terri. Atëhere Kreu dhe njerëzit e fisit, vendosën ta nderojnë, ta marrin me të mirë, t’i kushtojnë valle dhe muzikë, t’i çojnë një pjesë nga gjahu dhe prodhimet e tyre. Në mëndjen e njeriut primitiv, akoma shumë pranë botës shtazore, **AJO ishte DRITA!** Studiuesi Jaho Brahaj me të drejtë e emërton “Nëna e Madhe e Dritës së Jetës”. Kështu lindi Besimi i *Dritës hyjnore!*

Për të mos u zgjatur në këtë pikë, po sjell një esse të përkryer, të patriotit Adem Demaçi, me titull “Kush është Zoti ?” ku shprehen qartë të gjitha karakteristikat fizike, kimike dhe filozofike të kësaj dukurie natyrore. Mjafton në vënd të emrit “Zoti”, të vendosni “Drita” dhe do të vëreni se nuk do të ketë mosperputhje, në asnjë përcaktim:

“Zoti është i vetëkrijuari dhe krijuesi i gjithësisë e i asgjësisë. Zoti nuk ka formë as fillim, as mbarim. Zoti nuk ka pamje, as formë, as ngjyrë, as shije, as erë të caktuar. Zoti ngërthen në vetvete të gjitha pamjet, të gjitha ngjyrat, të gjitha shijet e të gjitha erërat e mundshme. Zoti është edhe përtej teheve të gjithësisë e cila edhe më tutje zgjerohet. Zoti i tejkalon të gjitha dimensionet hapësinore e kohore në kuptimin e mendjes së kufizuar njerëzore e cila njih vetëm kohë njëvijore që mbështetet në kujtesën e vet të vazhduar që përdorë si pikë të brendshme referuese egon e vet. Prandaj, mendja e kufizuar në kohë e në hapësirë, duke u mbështetur në përvojën e vet, mendon se edhe Zoti edhe shpirti edhe energjia duhet ta kenë një fillim të vetin, duhet ta kenë të kaluarën edhe të tashmen e vet. Në të vërtetë, vetëm mendja dinamike e ka të qartë se Zoti është i amshueshëm, sepse ai është vetëm në të tashmen, vetëm në prezent. Sepse vetëm e tashmja ka të kundërtën e vet (...) Zoti është gjithkund, sepse Zoti është i gjithëpranishëm. Të gjitha shfaqjet ose manifestimet fizike, bimore e biologjike janë shfaqje, ose manifestime të Zotit. Gjuha e Zotit është heshtja.” (9)

Duhet të sqaroj se, *Drita* është vlerësuar nga njeriu primitiv, por edhe sot e kësaj dite, me ngjyrën e bardhë, ndërkohë që kjo ngjyrë përfitohet nga 7 përbërësit e saj me ngjyra të ndryshme. Në këtë kuptim, mund të themi se nuk ka një ngjyrë të vetën specifike, sepse përmban në vetvete edhe ngjyrat e tjera, pra nuk ka ngjyrë.

Siç dëshmon Mehdi Frashëri, Shqipëtarët edhe sot bëjnë be “Për këtë dritë!” (10) Këtë pohim na e sjellin edhe studiues të tjerë si Dhimitër Pilika: “Gurra e stërmoçme na bindin se ylli lutej si perëndia e Dritës” (11) George G. M. James pohon se : “Misteret egjiptiane kishin tre nivele studentësh : 1- njerëzit e vdekshëm dmth njerëzit në provë; 2- inteligjentët dmth ata që kishin arritur vizionin e brëndshëm; 3- krijuesit ose *Bijtë e Dritës*, të cilët njësoheshin me *Dritën (ndergjegjen e vërtetë shpirtërore)*.”(12) Spiro Konda shton se :” Rrënja “di” në sanskritisht do te thote “ndrit” ,shkelqej” (13) Edhe studiuesi arbëresh Xhuzepe Katapano e shikon Krijuesin në këtë këndvështrim: “Prejardhjen dhe natyrën e burimit të ndritshëm : Zotin, mendimin e tij, të shfaqur brënda relativitetit të asaj kohe dhe hapsire, si “*dritë bardhësore*”. Prandaj mendoj se shkenca esoterike e lashtë, e pandryshueshme sepse e sakte , e mësuar në tempujt e Egjyptit- qëndër e botës- dhe e rrezatuar ngado, është me origjinë « boreale » (ipe-borealët janë dardano-thesprotët - shën im) (14)


Duke nënkuptuar Krijuesin si “*dritë bardhësore*” emrin “bardhë” e gjejmë në toponime, emra njerëzish dhe fisesh. « Mbreti Dardan Bardhylus, “Ylli i Bardhë”(449?-359? pK) ishte ai, i cili formoi fillimisht mbretërinë e Maqedonisë dhe që e cila më pas, u shndërrua në perandorinë e famshme maqedonase nga Filipi II (359-336 BC)» (15) Historiani, Dion Kasi, thotë se, “Vendi që quhet sot Maqedoni ish i banuar prej barbarëve: ”Ilirë dhe Bardhë”... » (16) “Në gjuhen e hititëve dhe në atë ilire, fjala “ALP” do të thotë “i bardhë” (17) ,nga vjen

edhe emërtimi i vargmalit më të gjatë në Europë, që vijojnë edhe në trevat tona –Alpet. Edhe emri i mbretit të parë të Thesprotisë ka qenë “Alpan” (Alban).

Studiuesit dëshmojnë se Zoti në fillim qe grua (do trajtohet tek materialet e tjera), dhe në gjuhën shqipe emërtimi është i gjinisë femërore (Drita). Shqiponja, përfaqësuesja e saj, në gjuhën shqipe nuk ka gjini mashkullore. (18) Edhe tempulli i parë i institucionalizuar i pellazgëve-Dodona, i kushtohesh një Perëndeshe grua (Sellenës/Hëna) emrin e së cilës e mori besimi hënor pellazg “SELLENIZMI”, sot i shpërfytyruar në përmbajtje - “hellenizmi”.

A është shprehur figurativisht Drita hyjnore - Zoti?

Në Europën jug-lindore në qeramikën neolitike (mijëvjeçari i VII pK) e deri në periudhën e bronxit , dallohen figurina që paraqesin gruan me kokë-zogu, që sipas studiueses Marija Gimbutas (“*Il linguaggio della Dea*”) duket se shërbejnë për të njejtin qëllim: “për të shprehur Krijuesen hyjnore”, (19). Ky binjakëzim midis gruas/krijuese dhe zogut/shpendit të lartësive, ishte mënyra me të cilën njeriu primitiv, në pamundësi për ta shprehur Krijuesen “pa formë” - DRITËN hyjnore – e personifikonte në art, me përfaqësuesen e saj në Tokë, “Dean-zog” (Hyjnesha-zog). Një model i bukur i saj (majtas) ndodhet në muzeun e Prishtinës në Republikën e Kosovës.



Dea-zog Prishtine/Kosove, terakote 6000pK . Në krahun e djathtë është një model i saj i më vonshëm i shk 3 pK-Antigone (Shqiperi). Për nga bukuria e paraqitjes,mund t'i quajmë “Mona Lizat” zanafilllore Pellazgo-Ilire. Po përse mendojmë se ky zog, ka qenë shqiponja?

Për tre arsyeje:

1. Studimet paleografike e dëshmojnë Shqiponjën mbreterore në Europë, që në periudhën e Pleistocenit të mesëm (800 000-128 000 pK) (20) dhe njeriu primitiv e vlerësonte mbi kafshët e tjera, sepse ishte shpendi qiellor më i fortë, fluturonte më lart dhe ushqehesh në tokë. Pra ishte kafshë e Qiellit dhe e Tokës dhe në këtë drejtim kishte përparësi ndaj luanit.
2. Në periudhat e më vonshme figura e shqiponjës shprehet qartazi tek skulpturat e para të Sfinksit (gruas me krahë shqiponje dhe këmbë zogu) dhe tek të gjithë Perënditë femërore dhe shumë më vonë ato mashkullore. kishin krahë të saj, si simbol i natyrës së tyre hyjnore .
3. Siç pohojnë studiuesit, shqiponja dhe jo ndonjë shpend tjetër është kulti më i lashtë. Shume karakteristika të mënyrës së jetesës së shqiponjës, u ndoqën nga njeriu zanafillor dhe u kristalizuan në karakterin e iliro-pellazgëve si: lidhja e fortë me truallin dhe familjen e tij, sulmi i furishëm, besnikrija etj. Lidhja e *Dritës hyjnore* me “tokësorët” bëhej nëpërmjet rrezeve në formën e dorës (në një nga flamujt e përdorur nga shqiptarët, ka patur edhe figurën e dorës). Shqiponja dhe Rrezja (Perëndia Ra tek egjiptianët) personifikonin Krijuesen-Dritë.



Rezet me “duar” të diellit “mbrojnë” familjen e Akhenatonit; Rrezet, si simbole të *Dritës hyjnore*, u përdorën si kurora mbi kokën e Mbretërve dhe Heronjve. (Dupondius-Didius_Julianus, IX-X sec.)

Edhe mbi kokën apo dy kokat e shqiponjës, shikojmë kurora-rreze, që me kalimin e shekujve u shndëruan në kurora të stilizuara mbretërore, që kishin humbur tashmë kuptimin e tyre hyjnor dhe përfaqsonin pushtetin e mbretit dhe familjen mbretërore.

Drita hyjnore dhe miti i Shqiponjës

Përpara se të flasim për mitin e shqiponjës është e nevojshme të përmëndim, një nga pengesat shumë të rëndësishme të Historiografisë : Mosnjohjen e dialekteve të gjuhës pellazgo-shqipe, gegërishtes, toskërishtes si dhe të gjuhësisë historike. Po sjell një shëmbull pikërisht për emrin e shqiponjës dhe të vendit tonë . Studiuesi Sh.S. duke folur për emerit e popullit “Shqipetar” dhe të vendit tonë “Shqiperi”, pohon se : “Studiuesi me të drejtë u largohet formave romantike dhe madhështuese të shpjegimit të emrit etnonimik të shqiptarëve, përmes një shënje që nuk ka qenë ndonjë herë totem i shqiptarëve, shqiponjës apo formës së shkurtër, shqipes” .(21) Janë të shumtë edhe studiues të tjerë, që emërtimin “shqipetar” dhe “Shqiperi”, e lidhin me ngjarjet e shk 15 në kohën e Skënderbeut, duke e quajtur si një emërtim të vonët mesjetar. Por faktet historike pohojnë të kundërtën. Arkeologu Hasan Ceka dëshmon se, shqiponja si emblemë kombëtare shqiptare, nuk është as e shekullit tonë, as e kemi trashëguar vetëm nga mesjeta, por ka zbukuruar shpinën e një tok monedhash të Ilirisë, si psh të Lidhjes Epirote, Bylysit, Apollonisë, Orikut (H.Ceka « *Monedhat Antike-burim historik* » (22)

Gjithashtu, në rast se i drejtohem folklorit të krahinës së Çamërisë, emërtimi i këtij shpendi dhe i vendit të arbërve i ardhur që nga lashtësia, ka qënë “Ipe” dhe “Iperia”. Sikurse edhe emërtimi në arbërisht *AIN*, emëri i shqiponjës *IPE* është fjalë/sombol i besimit pellazg. Përdorimi i lashtë i këtij emri, faktohet nga emërtimi “Epir” (Shqipëri) ku dy zanore “ i ” dhe “ e ” kanë shkëmbyer vendin tek bashkë-tingllorja “ p ”, një dukuri e njohur gjuhësore. Kështu nga Iperi, u bë Epiri – Epir. E gjithë krahina e Epirit është një pjesë e Shqiperisë së lashtë, emër i zogut hyjnor të Krijuesit. Sipas R.Bedo, në mburojen e trefishtë të mbretit Geyron, paraqitet shqiponja e zezë, që lidhet me simbolin e lashtë të Epirit. (23) Në gurën popullore të Çamërisë, e gjejmë të përdorur pikërisht në këtë formë. Në një gojdhënë çame, shërbëtori i manastirit i drejtohet djaloshtit, i cili u bë një nga figurat më të njohura në Europën e fillim-shekullit të 19, me emrin Ali Pash Tepelena: “...Ali, e di se do të bëresh njeri i madh e do të kumandoç gjithë Iperon? (...)Aliu u bë më i madhi e më trimi në Ipero, pas Pirros” (24)

Nuk mund të ri pa thënë, se gjuhëtarët që merren me drejtshkrimin, duhet të mos lejojnë heqjen e gërmave në emërtimet që na vijnë nga të parët tanë. Emri “shqipetar”, siç shkruhesh në kohën e Rilindasve , sot shkruhet padrejtësisht “shqiptar”, me arsyetimin se “kështu shqiptohet sot”, megjithëse emri i vëndit e ka ruajtur formën e tij. Në këtë formë humbet rrënja origjinale “ipe”(shqiponjë) dhe sot na mbetet “shqipt+ar”që nuk na thotë asgjë dhe ngatërohet me shpjegimin “shqiptoj qartë” qe s’ka asnjë lidhje historike apo mitike me gjuhën tonë. Sot anglishtja, shqiptohet ndryshe nga anglezët dhe ndryshe nga amerikanët, por shkruhet njësoj, pra drejtshkrimi nuk duhet të diktohet nga e folura e përditshme, që shpesh i shtrëmbëron fjalët, për arsye nga më të ndryshme.

E bëra këtë parashtrim, për të kuptuar lexuesi se në mitet pellazge, zogun hyjnor e gjejmë

nën emrin “*IPE*” dhe me mbaresat e gjuhëve më të vona- Iperione apo Hyperion, etj. Për rrjedhojë, emrat “Shq-**ipe**-tar” dhe “Shq-**ipe**-ri” vijnë nga kohët mitike të Lashtësisë dhe nuk fillojnë të përdoren nga periudha e Mesjetës. (Se si u krijua forma “shqipetar” do të flitet në një material tjetër). Sipas miteve, Iperioni ishte nga fisi i Titanëve (Titanët janë Pellazgë), bir i Tokës (Gea/Dhea) dhe i Qiellit (Uranit), i dashuruar me motrën hyjnore Teia, Thia apo Tia, pati tre fëmije, po titanë : Hënë (Sellena), Diellin (Elios) dhe Agimin (Eos). (Esiodo, Teogonia) (25)



(majtas) Eos me krahë shqiponje (si bir i Ipes) i tërhequr prej kuajve gjithashtu me krahët e shqiponjës , si shprehje e natyres së tyre hyjnore; Kairos, me krahë .Sipas Ione prej Chio, Kairos ishte fëmija e fundit e Zeusit.(26)

Të gjitha Perënditë më të lashta janë hënore dhe kanë, në objektet arkeologjike, krahë shqiponje, duke përfshirë edhe Zeusin vetë, që dëshmonte përkatësinë e tyre ndaj besimit hënor.

Emri Tia, mendoj se është shtrëmbërimi i emrit Di-a (ose zëvendësimi i njohur të “D” me “T-Th” të greqishtes) , Diona e mëvonshme, gruaja e Zeusit në Dodonë dhe përfaqsohte rrezet e Dritës, për këtë arsye e kishte edhe emrin Aria. (27) Në periudhat e më vonshme, Diona tek thesprotët pellazgë, apo Aurora tek latinët, do të përfaqësoje Hyjneshën e Tokës-Dhemitrën pellazge dhe Mater Matutën etruske. (28) Tia (Di-a) në mite, cilesohet titane e shikimit dhe e dritës, dmth e Dritës që shikon gjithshka dhe së bashku me Iperione (shqiponjën) përfaqsonin *Dritën hyjnore*-Krijuesen. (29) Të mos harrojmë, se në hieroglifet egjiptiane, Krijuesi përfaqsohej nga penda e shqiponjës që shprehte gërmën “I” (...ndina “I” do me thene :”Ti je Perëndi!”) (30) dhe ndodhet tek të gjithë emrat që kanë lidhje me dritën.

Vasil Tole tregon traditën e shqiptarëve gjatë ritit të vajtimit të të vdekurit: „Populli thotë se kërcet dhoma kur ia marrin një të “qare me bote”, e ja bëjnë të gjitha – i i i „ (31) Në zanafill, kjo „i” e zgjatur, ishte thirrja që familjarët i bënë Zotit (Krijuesit) për ta pranuar shpirtin e të vdekurit, por tashmë kuptimi i saj është i panjohur për vajtueset. Shumë studiues “*Dritën*”

e kanë trajtuar si simbol të Diellit. Por siç del nga mitet, për njeriun primitiv, Dielli krahas Henës, Rrufesë, Zjarrit, vetëtimës, etj janë çfaqje të pamjeve të shumta të *Dritës hyjnore* që u përfaqësua me shqiponjën dhe rrezën/Di-an. Kostandini i Madh-shprehet Xh.Katapano-dhe të gjithë Perandorët e tjerë të Ilirisë ,që sunduan pas tij, nën shenjën e Shqiponjës, janë të gjithë borealë, “Bijë të Dritës”. (32)

Shqiponja ka përfaqësuar shënjtërimin dhe gjatë historisë, shumë figura që kryen vepra të mëdha, u quajtën “shqiponja” duke nënkuptuar emërtimin “hyjnore”. Këtë emërtim nuk e ka marrë vetëm Pirro Burri, por edhe figura të tjera historike si mbreti/Perëndi Horus i Egjiptit apo Tougrul Beig (993 – 1063 era jonë), themeluesi i shteti Selxhuk të Azisë ,etj. (33) Edhe në shekujt modernë, tek fiset aziatike shqiponja ishte simbol i Krijuesit. Tek fisi Jakuti i Siberisë , Kreu që luante rolin e ndërmjetësit midis popullit dhe Zotit, emërtohesh “bir i shqipes” në kuptimin e njeriut hyjnor. (34)

Shqiptarët, duke trashëguar emrin e simbolit të Krijueses-Ipes (Shqiponjës) e kanë quajtur gjatë shekujve, veten, gjuhën dhe vëndin e tyre “Hyjnore”, e drejtë e ligjeruar (jo nga romantizmi apo nacionalizmi i shk19) por nga mitet mijëravjeçare të Historisë së njerëzimit. Por, siç ishte në lashtësi zakoni i përdorimit të disa emërtimeve, pellazgo-ilirët u vet-quajtën edhe me emërtime të tjera: Alban (Alpan)-Ilir-Arbër -**Shqipetar**, të gjitha të lidhura me periudhën zanafillore të miteve dhe janë emërtimet më të lashta kombëtare.

Në gjetjet arkeologjike, simbol të Hënës kemi Perëndeshën Sellenë, dhe në mite është bijë e Shqiponjës (Ipes). Në shekujt e mëvonshëm është haruar kuptimi mitik dhe është emërtuar me një nga “punët” e saj (Hëna ndikonte në arritjen e suksesit në luftë) dhe statuja e Sellenës u emërtua “Perëndesha e Fitores”. Ky rol magjik i Hënës ishte i njohur edhe në mesjetë nga të gjitha popullsitë euro-aziatike. Marin Barleti, duke përshkruar rrethimin e Shkodrës, pohon se “Turqit , sipas urdhërit të sulltanit ,ishin rradhitur për sulm ; vetëm ata prisnin , sipas zakonit të vet, që të dilte Hëna e re. (35)

Edhe Shqiponja, është përdorur në formacionet ushtarake, si simbol i forcës dhe fitores hyjnore. Pra Shqiponja me një kokë, për shumë mijëvjeçarë ka përfaqësuar *Dritën-hënore*, besimin e Pellazgëve hyjnorë (“*sellenizmin*”), shumë më përpara se të çfaqej shqiponja me dy kokë.

Përse besimi i parë ka qënë hënor dhe jo diellor ?

Sipas Marija Gimbutas , në gjetjet e shumta arkeologjike, Hyjnesha zanafillore në besimin e njeriut primitiv, nuk ishte shprehje e femrës riprodhuese, siç ndodhi pas fillimit të bujqësisë, dhe as ai i mëmësisë. Duket më bindës trajtimi i Hyjneshës (Dea) si të plotfuqishme mbi Jetën, Vdekjen dhe Rigjenerimin (rilindjen), tre fazat e kudo-ndodhura të Natyrës. (36)

Faktori kryesor që ndikoi në lindjen e kultit të adhurimit të Hënës dhe lindjes së besimit të parë-atij hënor (*sellenizmit*)- që ndryshimi ciklik i formës së saj. Sipas studiuesit M.Eliade, njeriu primitiv vërente se Dielli nuk pësonte ndryshim në pamjen e tij, pra ishte statik, ndërkohë që Hëna çfaqej herë e plotë, herë e përgjysmuar apo vetullore dhe kishte netë kur nuk dukej fare, për t'u çfaqur natën tjetër përsëri e përsëri... Pra ishte diçka që ndryshonte përjetësisht, ishte një objekt i “gjallë”, në lëvizje. (37) Kjo lëvizje e formës së Hënës në tre faza, ishte e ngjashme me jetën e njeriut (lindja-maturia-vdekja) dhe përfaqësonte botën e pavdekshme sepse rilindte në vazhdimsi.

Në traditën e popullit tonë gjejmë “rilindjen” mbas vdekjes, të pasqyruar tek figura e shqiponjës (shpendit kultik i Hënës): “Në një festival folklorik zonal, një i moshuar nga Mërturi i Gurit (Pukë) paraqiti një valle që imitonte shqiponjën në momentin e mbarimit të jetës. Me levizjet e valltarit, duke dridhur gjithë trupin dhe krahët hapur, tregohej se si shqiponja vdes dhe ringjallet përsëri...” (38) Ndryshimet që pësonte Hëna, sollën lindjen e mitit të saj: Njeriu primitiv kur vinte nata, vëzhgonte i mbërthyer nga kureshtja, Hënën ngjyrë argjendi rrethuar nga dritëzat e shumta e të vogla (yjet) në qiellin e natës . Ajo ishte gjithëmonë aty lart, shoqëruesja e tyre e pandarë, dhe me dritën e saj të zbehtë, nuk linte të zhdukej njeriu dhe natyra përreth tij nga terri i natës. Prandaj ajo ishte mikeshë e tyre dhe kur përgjysmohej apo hollohej shumë, ata shqetësoheshin dhe mendonin se mos e hante ndonjë përbindësh (gjarpri-bolla) kur largohej dhe shkonte nën tokë, sipas imagjinatës së tyre. Emri i Hënës, vjen nga rrënja shqipe “ha” (ajo së cilës i hanë anën-Hana). Shqiponja, përfaqësuesja e *Krijueses-Dritë*, i sulej gjarapërit për të mbrojtur fëmijën e vet (Hënën). Shqiponja -vëren Jaho Brahaj- sipas mitologjisë përfaqëson *fuqinë e Dritës*, që lufton kundër fuqive të errësirës nëntoksore, e simbolizuar me gjarpërin...në monumentet e lashta të arkeologjisë, të dokumentuara në të gjithë truallin Ilir e më gjerë, paraqitet lufta e shqiponjës me gjarpërin“. (39)

Mendoj se emri “Sellena” është i më vonshëm se sa “Hëna”. Siç dihet, në zanafillë të miteve pellazge, hyjnitë ishin dukuri të natyrës (Qielli, Uji, Toka, Dita, Nata etj) por të pa pasqyruara si figura. Shumë më vonë, forcat dhe dukuritë natyrore morrën pamjen njerëzore, duke u emërtuar Hyjni dhe Hyjnesha. Këtë e dëshmon edhe fakti, se në gjuhën pellazgo-shqipe, emri mbeti në formën e tij mitike zanafillore, kurse në greqisht e ka emërtimin nga Perëndesha “Sellena” (Seleni), i vënë nga shkruesit e lashtë fetarë, që hartuan gjuhën priftërore greke dhe shpreh një fazë më të vonshme të besimit. Për sa më sipër , Besimi krahas Gjuhës, është një nga treguesit se gjuha pellazgo-shqipe është gjuhë zanafillore, që

studiuesit i emërtojnë “gjuhë natyrale” dhe është më e lashtë se greqishtja.

Edhe emri i Diellit e ka burimin nga ai i Hënës. Studiuesi M.Eliade pohon se në Rodi, “gjatë festimit kushtuar **Halieia**-s (Diellit) është afruar një karrocë me katër kuaj... ky emër vjen nga “**halios**”, që është forma dorike e emërtimit Helios (Diellit)”. (Holmberg “*Die religiösen Vorstellungen der altoischen Völkern*” (40) Rrënja “ha” e kuptueshme nga mitet mbi Hënën, ndërton emërtimin e Diellit, por nuk ka lidhje me ndonjë mit të tij. Ky është një fakt që dëshmon se ajo, ishte “Zoti i parë”.

Perëndesha e Henës në mite, kishte kultet e veta më të rëndësishme si : shqiponjën, yllin, gjarpërin dhe demin, që simbolizonin forcën e saj magjike rigjeneruese. Si simbole mbrojtëse hënore, në mburojën e Akilit ndodheshin: katër yje-rozeta, të cilat i rinin si kurorë shqiponjës (gjetur në një pjatë të pikturuar në qytetin Vulçi të Etrurisë) (41)



Flamuri shqiptar nga 1914 deri 1920, ku pasqyrohen shqiponja, ylli dhe rrufeja, simbole kultike të Krijuesit (*Dritës* hyjnore) dhe Shqiponja perandorake e Napoleonit, i cili nuk preferoi shqiponjën dy krenore të Karlit të Madh, i ndikuar në shk15 nga modelet lindore, por atë të besimit hënor dodonas - shqiponjën me një kokë dhe rrufe.

Siç vëren studiuesi Jaho Brahaj “Shqiponjën një krenore në stemat hieraldike familjare, e gjejmë më përpara tek Arbërit (në flamurin e Principatës së Arbërit, shk12), se tek popujt e tjerë të Ballkanit dhe Europës,” (42)

Siç përmënda rastin e shkrimit të fjalës “shqiptar”, edhe për rastin e flamurit tonë, me çdo ndryshim që mendohet, duhet të merren ata studiues, që e njohin historinë e lashtë të popullit tonë. Duke hequr yllin në flamurin shqiptar, i cili është gjithashtu një figurë/simbol i besimit pellazg, pavarësisht që u përdor nga ideologjia komuniste, sikurse u përdorën edhe shumë simbole pellazge nga nazistët (dhe mund të zëvendësohej me yllin gjashtë cepësh të Skëndërbeut apo tetë-cepësh të Aleksandrit të Madh), ne zhdukëm me duart tona në flamur, faktet historike të Kombit tonë dhe simbolin e Krijueses- *Dritës hyjnore*.

“Shqiponja dhe Ylli, simbolizojnë që në kohët më të lashta, dritën, shpirtin pra *vetë*

zanafillën e jetës dhe të çdo krijimi, që janë thelbësisht të rendit mendor”. Sipas Moisiut, shqiponja dhe ylli, janë sinonime (43)



Aleksandri i Madh mbi qelshen e të cilit dallohen qartë simbolet e besimit *sellenik*: Hëna dhe Ylli (44); Ylli gjashtë cepësh dhe Hëna, bizhuteri e përdorur në Malësinë e Madhe.

Siç vihet re, rrezet me të cilat shprehet ylli, simbolizojnë *Dritën hyjnore* dhe qëndron mbi Hënën, sikurse edhe mbi kokën e shqiponjave, në flamuj apo emblema ndër shekuj. Ky ka qenë edhe simboli i Afërditës (një gjysëm-Hënë e vendosur pranë një ylli)(45) si dhe emblemë shtetërore e Epirit antik, gjendur tek një dorëshkrim (shkXVII) i pabotuar deri më sot. (46) Ylli me Hënën ka qenë edhe simbol i Ilirisë.



(majtas) Stema e Gjergj Kastriot Skënderbeut.

Përfundimi i dytë: Perëndia e *dritës hënore* -Sellena, ka qenë përfaqësuese e besimit të parë të institucionalizuar të Dodonës - *Sellenizmit*, i cili zgjati për një periudhë dhjetra-mijëvjeçare. Përparsia e kultit të Hënës ka ardhur nga krahasimi i çfaqjes së saj (në tre forma) e ngjashme me tre cikle të jetës në Tokë dhe zbulimi shkallë-shkallë shkencor, i ndikimit të saj, në jetën e njeriut dhe mbi natyrën. Kjo shkencë primitive, bazohet në aftësinë e intuitës së njeriut primitiv dhe krahasimit të dukurive në botën që e rrethonte.

Shqiponja me një kokë ka përfaqësuar “*Dritën hënore*” dhe ka qenë më e lashtë se shqiponja dy krenore.

Besimi hënor (me shqiponjën me një kokë) përfaqësoi në zanafillë matriarkatin; Besimi diellor (me shqiponjën me dy kokë) patriarkatin dhe forcën ushtarake të pushtetit administrativ.

Pellazgët, nga nevoja jetike apo fati i keq gjatë luftrave me fiset e tjera të një gjinie, (prandaj dhe lufta e tyre quhej “lufta e Titanëve” dhmth “e tanëve”-njerëzve tanë) u përhapën drejt perëndimit, veriut, jugut dhe lindjes, duke e zgjeruar hapsirën gjeografike të besimit të tyre *sellenik* (hënor).

Për të ndërtuar historinë e lashtë të paraardhësve të popullit tonë, domosdoshmërisht duhet të studiohen edhe gjurmët që lanë ata në toponime, mite dhe gjuhë, në vëndet ku emigruan. Kjo metodë plotësoi shumë studime mbi lashtësinë, për faktin se shumë gjurmë të tyre, kanë mbijetuar në vëndet ku kaloi apo sundoi raca pellazgjike. Studiuesi i besimit të lashtë G.Dumezil, pohon se “Pjesa më e madhe e figurave të panjohura të rrjeshtuara nga Wissowa, gjetën shpjegim të kënaqshëm dhe përputhen harmonikisht me të dhënat e dokumenteve, të sjella nëpërmjet paraleleve me popujt e tjerë indo-europian” (47) Duke ndjekur ngjashmëritë në mitet dhe ritet, në Europën veriore (galo-keltët, iberët etj), në Azinë e Vogël (frigët, shumerët, hititët, hurritët, skithet, etj) në Afrikën veriore dhe deri në Azinë e largët, zbulohet rruga dhe koha e lëvizjeve të fiseve pellazge. Kjo pllakë guri (fig poshte) e gdhëndur, gjëndeje brënda varrit të mbretit të dinastisë së parë « Thinite », Horusit (afersisht 3040-3020 pK).



Horusi emërtohej Perëndia shqiponjë (Hr) dhe ishte mbret i dinastisë së parë arkaike në Egjiptin e lashtë . Në këtë monument të lashtë, në kompleksin e Abydos, paraqitet një shqiponjë, një gjarpër dhe tre vija paralele në formën e kolonave.

Edhe në hieroglifet që pasqyrojnë emrin e tij, kemi figurën e shqiponjës, gjarpërit dhe tre vijat paralele, që i gjejmë si tre simbole të Dhemitres zanafillore, që dëshmojnë vijëmsinë e të njejtit besim *sellenik* të pellazgeve në Egjipt. Ky fakt dëshmon edhe vjetërsinë e besimit të Dodonës, krahasuar me atë egjiptian. Në pllakën mortore të Horusit, këto simbole i përkasin tashmë një figure mashkullore, që tregon rritjen e figurës së burrit, jo vetëm në pushtetin tokësor, por edhe atë besimtar.

Kulti i tij nderohej veçanrisht në qytetin e lashtë Nekhen, që në gjuhën kopte përkthehej “Qyteti i Shqiponjave”.(48) Sipas miteve, Horusi është bir i Perëndisë Osiri dhe Perëndeshës Isis. Sipas studiuesve të mitologjisë egjiptiane, syri i tij i majtë ishte hëna dhe i djathti – dielli. Pikërisht syrin e majtë (të hënës) egjiptianët do ta mbajnë si nuskë mbrojtëse, sepse mendonin se kishte fuqi magjike. Ajo që të bie në sy është bashk-vendosja tek një njeri, i dy kulteve: atij diellor dhe hënor.



(49) (foto majtas) Perëndesha Maat me krahë të shqiponjës dhe Perëndesha Isis e ulur në fron. Hëna e plotë, mbi kokën e saj, dëshmon se ishte një Perëndeshë hënore. Xh.Katapano pohon se “is” në hebraisht ka kuptimin e “Dritës së Parë”(50)

Marrja e simboleve kultike të figurës femërore (Krijueses) nga ana e figurës mashkullore-Faraonit, nuk do të thotë se në besimin *sellenik* (të emërtuar “hellenik” më vonë) nuk kishte më vend për hyjnesha gra. Kjo dëshmohet nga vëndi i rëndësishëm që zinte Perëndesha hënore Isis në Egjiptin e lashtë, me Hënën e plotë mbi kokën e saj (dhe jo Dielli, siç shprehen disa studiues) pohuar edhe nga Plutarku: “Ndërmjet statujave të saj me brirë, janë ato me Hënën e re”. Siç vëren edhe Wilkinson Richard H. : “Isis u bë një nga Perënditë më të rëndësishme në Egjipt” (51)


Simbolet kultike dhe skeleti mitik i ngjashëm, që vërejmë në të gjithë hapsirën Euro-Afro-Aziatike, dëshmojnë jo për kryqëzimin (sinkretizmin) e besimeve të ndryshme, siç lexojmë sot në librat historik, por për shkallë të ndryshme të zhvillimit në kohë, të të njejtit besim pellazg, elementët e të cilit janë marrë dhe dhënë ndërmjet popujve të së njejtës racë (drejtuese-ushtarake). Edhe Herodoti (484 – 425 pk) e pohon qënien e të njejtit besim në Egjipt dhe gadishullin Ilirik. Duke folur për hyjnit e egjiptianeve, ai shkruan : « Nuk kam sigurisht qëllim të tregoj gjithë sa dëgjova për hyjnitë e tyre, përveç emrave të vet, se mendoj që të tërë njerëzit të njejtat (gjëra) besojnë për hyjnitë » (52) Ky fakt vërtetohet me njohjen e hartës gjeografike të përhapjes së fiseve dhe grupeve luftarake Pellazgo-Ilire të kësaj periudhe.

Gjithashtu nuk mund të mohojmë pasurimin e skeletit të besimit hënor pellazgjik dhe atij diellor të mëvonshëm, me mite dhe emërtime të ndikuara nga ngjarjet dhe personat historikë (që u quajtën Perëndi, Profetë apo reformatorë të besimit) me elemente të kulturës së hapsirës afro-aziatike.

Simboli i shqiponjës, që në hieroglife emërtonte Horusin, do të jetë emri i parë (faraonët emërtoheshin me disa emra, njëer pas tjetrit) në emërtimin e Faraonëve egjiptian si, Kheops, Toutankhamon, Amenhotepin e III etj. Shumë vënde dhe figura historike u mbiquajtën me emrin e shqiponjës, për të dëshmuar natyrën hyjnore të tyre, por Shqiponja, simbol i Krijueses-Dritës hyjnore, mbijetoi në vijëmsi dhe në të gjitha format e shprehjes së saj (komb, gjuhë, vend, traditën kulturore, flamur etj) vetëm tek arbëreshët dhe shqiptarët, që dëshmon përkatësinë e tyre prej Pellazgëve Hyjnorë.

Egjipti i lashtë, është vendi ku iliro-pellazgët sundues, kryen “REFORMËN” e parë të besimit të tyre hënor - *Sellenizmit*. Kur flasim për besimin e Egjiptit të Lashtë, duhet të kemi parasysh dy faktorë :

1. Besimi ishte në “pronësi” të familjes mbretërore, udhëheqësve të lartë fetare e ushtarak dhe drejtonte jetën administrative të shtetit dhe shpirtërore të popullit.
2. Përfaqësuesit më në zë të Lashtësisë egjiptiane, ishin të huaj, me origjinë pellazgjike, e shprehur në mitet, ritet, kultet, toponimet, gjuhësinë, emërtimet dhe biografinë e tyre e dëshmuar në studime të shumta shqiptare. Studiuesit shqiptarë, po japin një ndihmesë të paçmueshme, duke zbuluar fjet lidhëse të periudhave dhe zhvillimeve të shoqërisë njerëzore, të errëta deri më sot.



Statuja e Horusit nën kultin e shqiponjës, përpara tempullit Edfou dhe (djathtas) vijimi i mitit të luftës kundër gjarpërit, në Egjiptin e lashtë.

Siç pamë edhe më lart, Horusi-Perëndi dhe mbret tokësor, mbante në emërtim, kultin e shqiponjës, gjarpërit dhe tre vijave paralele të besimit hënor pellazgjik.

Në Afrikën Veriore, ngritën qytetrimë të zhvilluara edhe shumë mbretër të tjerë pellazgë, origjina e të cilëve nuk përmendet nga historiografia botërore. Sot, si një nga Faraonët më të famshëm (ndoshta pse lidhej edhe me emrin e nipit të tij, Merenptah– Moisiut, krijuesit të besimit të krishter) njihet Ramsesi i II(1304 -1213 pK) i mbiquajtur Ramsesi i Madh.

Xh.Katapano vëren se ai mbante emërtimin “Larte” që ishte karakteristik për mbretërit etruskë, fakt që dëshmon origjinën etrusko/trojane të Ramsesit II dhe të Moisiut. (53) Ramsesi i II është pasardhës i një vargu të gjatë faraonësh të racës së tij, përfaqësuesit më të rëndësishëm të të cilëve, i gjejmë në Dinastinë e 12-të (1983 – 1778 pK).

Po ç’lidhje ka Dinastia e famëshme në Egjiptin e lashtë, me simbolin e shqiponjës në flamurin dhe traditën e shqiptarëve? Kjo Dinasti është pjesa e “humbur” apo “e zhdukur” e Historisë mijravjeçare e Kombit të Titanëve Pellazgë , por edhe e origjinës sonë, “e varrosur” nga Historiografia e shk19-të. Kjo periudhë zë fill me bashkimin e Egjiptit dhe mbretërimin e Faraonit, Amenemhat I-rë (1983 – 1953 pK) një administrator, ndërtues dhe luftëtar i shquar, që pranoi i pari bashk-administrimin me djalin e tij, Sessostri I-rë duke krijuar një Perandori të papushtueshme, të begatë dhe të lulëzuar. E gjithë dinastia e tij, që vijoi ndër shekuj, si emër të parë mbante figurën e Shqiponjës hyjnore, kultit hënor dodonas (Horusin).

Diodori (Diodore de Sicile- shk I pK) i sjelle nga studiuesi Niko Stillo (“*Etruskishte Toskerishte*”), në “Bibliotekën e tij historike” përmend faktin se : “Në vitet e vjetra, mbretërit e Azisë ishin vendës, por nuk kujtohet asnjë veprim i tyre i çmuar dhe as ndonjë emër konkret.



Obelisku i Sessostrit të I në Eliopoli dhe Skulptura e Faraonit Sessostri I

I pari mbret që arriti gjer tek ne, në histori dhe kujtesë ishte Ninoja, mbreti i asirëve i cili nënshtroi : Egjiptin, Fenikinë, Sirinë Koile, Kilikinë, Pamfilinë e Likinë, madje Karian si dhe Lidinë, vuri nën skeptrin e vet dhe Troadën e Fringjinë në Helespont dhe Propontiden Bitininë e Kapadokinë, si dhe kombet barbare që banonin në brigjet e Detit të Zi gjer te lumi Tanai (Don)”(54)

Ky Mbret-luftëtar, që për madheshinë e Perandorisë (Euro-Afro-Aziatike) që krijoi, vendosjes së ligjeve, sundimit por edhe të demokracisë së nënshtetasve të lirë, ndërtimin e tempujve si bosht i qyteteve të shumtë që ngriti, zhvillimin e bujqësisë, veprave ujitëse, urave etj, dhe sidomos administrimin e mënçur që vendosi, ju dha vendi i Kryeperëndisë. Miti i tij pas vdekjes, pushtoi hapsira shumë më të mëdha, se sa kur qe gjallë i zoti. Ky Mbret tokësor, nën emrin e Ninos, mbretit të asirëve, të Sessostri I-rë në Egjipt, Sheshoosit tek pellazgo-ilirët, Tinia tek etruskët, Minosi dhe Heleni në Mikenë, Di-as apo Zeusit mbi Olimp, Dionisit në mite (dhe shumë emrave të tjerë, të trashëguar tek mbretër pellazgë), sundoi në tokë e në qiell, nën hijen e Shqiponjës.

Në Dhjatën e Vjetër, Heroi dhe Mbreti i racës arbërore, më i famshëmi në Historinë njerëzore, është emërtuar Noe. (55)

Kush më shumë se Kombi ynë duhet ta çvarrosë këtë Dinasti pellazge, duke lidhur fjetet e këputura nga koha dhe ideologjia? Jo thjesht për të zbuluar origjinën e simbolit të flamurit dhe të emrit tonë kombëtar, por edhe për të përmbysur dogmat e Historiografisë për ardhjen e fiseve “indo-europiane”, “ndikimin” oriental të besimit apo përhapjen e besimit “hellenik” (“*sellenizmit*”) nga Aleksandri i Madh, i cili në fakt ,në fushatat e tij vetëm e ripërtëriti besimin dodonas, duke shpallur edhe veten “bir” të familjes hyjnore. Ai ndoqi në gjithshka, shëmbullin e paraardhësit të tij pellazgo-ilir, Sessostri të I-rë dhe të qyteteshteteve që u krijuan nga ushtarët e tij, të cilët përhapën kudo ku shkelën, (Afrikë -Azi dhe Europë) qytetrimin ilirik.

Lartesimi i kultit Diellor –shprehje e forcës së pushtetit tokësor

Për studiuesit e sotëm të besimit, figura më e rëndësishme në historinë mijërvjeçare të Egjiptit të lashtë, që i dha vëndin e Krijuesit- Diellit dhe vetes, Profet të tij, ka qenë Amenhotepi i IV, Faraonit i dhjetë i dinastisë së 18 (sundoi më 1355-1338 pK).

Në besimin hënor (*sellenizmin*) që përfaqësonte “matriarkatin”, figura qëndrore e gruas (Diona në Dodone dhe Isisi egjiptiane), në periudhat e mëvonshme mitike, u zëvendësua nga ajo e mashkullit (Zeusi në gadishullin Ilirik dhe Osirisi, në Egjipt,) që përfaqësonin “patriarkatin”, duke marrë edhe simbolet e saj më të rëndësishme si shqiponjën, demin, gjarpërin, etj. Edhe nën mbretërimin e babait të tij, Amenhotepin e III (sundoi 1391-

1353pK). (56) kishte filluar ngritja e simbolit diellor. Por, i biri e mohoi dhe e luftoi besimin tradicional hënor, të cilin themeluesi i shkencës krahasuese të miteve, Max Myler (Max Müller 1823-1900) e quan “hénothéisme”. (57)

I vetëquajturi Akhénaton, pranohet si “reformator i parë i besimit” dhe “krijuesi i besimit monoteist” sepse vendosi besimin Diellor (Aton) si kultin e vetëm shtetëror. Bashkë me kryeqytetin, ai ndryshoi edhe të gjithë administratën e tij, ku vendosi ata që kishin përqafuar besimin e ri.

Krijimi i perandorive, të mëdha gjeografike të Faraoneve egjiptian dhe hyjnzimi i figurës së sunduesit mashkull, të fortë ushtarakisht dhe me pushtet të pakufizuar administrativ e sidomos zhvillimi i madh i shkencës së lashtë, nxorri në plan të parë rëndësinë e njeriut të ditur – të llogjikës - si mjet pushteti. Filozofi më i madh romak, Plutarku (viti 46 pK- 125) pohonte se: “Njeriu përbehej nga tre pjesë : trupi (soma) shpirti (psyche) dhe llogjika (nous). Shpirti i njerëzve të drejtë, pastrohej në Hënë, trupi i kthehej Tokës ndërsa llogjika (shkonte drejt) Diellit” (58)

M.Eliade shprehet se “për orfikët (Dielli) është inteligjenca botërore. Macrobio, ia dedikon kultit diellor të gjithë teologjinë dhe i paralelizon me Diellin Perënditë : Apollon, Liber-Dionysos, Marte, Mercurio, Esculapio, Ercole, Serapide, Osiride, Horus, Adone, Nemesi, Pan, Saturno, Adad e deri Jupiterin” (59) Le të kujtojmë se, që nga shkolla e Thotit në Egjiptin prehistorik dhe deri tek ajo e arbërit, Gjergj Xhemisto Pletones (1355-1452), në Mistra të gadishullit Ilirik, ku mësohesh shkenca e lashtë “, synohej formimi i njeriut të fortë e të përkryer ; të fuqishëm në trup e mendje” (60) dhe mësimi ishte i rezervuar vetëm për “udhëheqësit” e ardhshëm.

Njohja e vlerës së “llogjikës” (dijes), nxiti ndryshimin edhe në kulte, të cilat në lashtësi ishin të detyrueshme sikurse “Kushtetuta” e ditëve të sotme. Baza e mësimëve të Shkollave të Misterit, ishte studimi i ekujlibrave, që e gjejmë edhe në komentet që janë bërë për dy kokat e shqiponjës, si psh femër-mashkull, lindje-perëndim dhe gjithçka që u nda apo e ishte e dyzuar. Këto çfaqje binjake e ndanin shoqërinë në dy klasa themelore: atë femërore, që duke qënë më e fuqishme, zhvillojnë ndjenjat dhe klasën tjetër ku rryma mashkullore përforcon cilesitë mendore. (61) Edhe sot qarkullon idea se meshkujt janë më të zgjuar se femrat, pasojë e ideologjisë mijeravjeçare e pushtetit administrativ në Lashtësi.

Përdorimi i këtij ekujlibri apo dualizmi, sipas M.Eliade buronte nga traditat e lashta të Hellenëve (Pellazgëve –shën im) dhe njëhej edhe nga Platoni. (62)

Përfaqësuesi më i madh i këtij ekujlibri, ishte ai midis Hënës dhe Diellit, (dy planetet më të mëdha që shihen nga Toka) e shprehur në simbolin kultik, të dy kokave të Shqiponjës. Për të kuptuar zhvillimin e besimit tek njeriu para-historik, shumë studiues kanë gjurmuar besimet e fiseve apo popullsive të sotme, që jetojnë të mënjanuar nga bota moderne. Mircea Elade dëshmon se, në fiset afrikane, simboli i Hënës përfaqësonte matriarkatin ndërsa i

Diellit patriarkatin : “Festa e Hënës së re ndiqej vetëm nga gratë, kurse festa e Diellit festohej vetëm nga burrat. (63)

Vendosja e pushtetit patriarkal në besimin e Egjiptit të lashtë, pasqyrohet qartësisht në ndryshimin e emërimit të Krijuesit e zbërthyer nëpërmjet gjuhës arbërishte nga Xhuzepe Katapano (“*Thoti fliste shqip*”): nga Amon (A-m-on=at+nënë+jonë), në Aton (At-on=at+ynë) (64) Siç vërehet, është mënjeluar figura femërore që mbisundonte në besimin hënor. Perëndia Diell-Aton, që deri në atë kohë paraqitej vetëm si hieroglif me kuptimin “dritë”, Akhenatoni e paraqiti si emër të një faraoni. Ai ngriti kultin e Diellit mbi kultet e tjera dhe ndërtoi tempullin Aton në një qytet të ri Akhétaton (Tell-er-Amarna). Nga emri i tij, u hoq emri i Horusit dhe figura e shqiponjës (përfaqësuese e besimit hënor) dhe mbeti vetëm i Perëndisë “Ra” që përfaqësonte *Dritën hyjnore*.

Reforma e tij, kundër Perëndisë Amon, nuk pati sukses dhe mbas vdekjes së tij, vijuan të adhuroheshin perënditë tradicionale. Megjithëse revolta e Akhenatonit dështoi, ajo gjeti vijues të tjerë në shekujt e mëvonshëm, tashme jo në Egjipt, por në Azinë e Afërme (Mithra), në Gadishullin Ilirik (Apolloni) dhe sidomos në Perandorinë romake, me triumfin e “Diellit fitimtar!” (Sol-Invictus).

(foto poshte) Shqiponja hitite (J.Brahaj “*Flamuri i Kombit Shqiptar*”)



Sipas studiuesve, Perset dhe Epirotët ishin të parët që e përdorën, si simbol ushtarak dhe më vonë u bë emblema të Egjiptit, Perandorisë romake dhe të perandorëve të Lindjes dhe Perëndimit.(65)

Sot në përgjithësi, mendohet se kulti i Diellit ishte kryesor dhe më i përhapuri në botë. Në


fakt, eruditi gjerman i shk19, Adolf Bastian (1826 –1905,) vërejti se ky kult ishte i përhapur në hapësira shumë të kufizuara të botës, si në Egjipt, në Azi dhe në Europe, vetëm tek disa popujt, me një zhvillim të lartë në lashtësi. (66) Ai u përhap dhe u bë kult shtetëror nga mbretër që përfaqësonin pushtetin ushtarak.

Pikërisht në Azinë e Vogël gjejmë në zbulimet arkeologjike, shqiptonjën tashmë me dy koka, shprehje e bashkjetesës së dy kulteve: atij hënor dhe diellor. Sipas studiuesve i përket kulturës së popujve Hititë. Gjithashtu dëshmohet se qytetrimi i tyre kishte patur ndikim të madh nga qytetrimi i mëparshëm i popujve Hurritë (Mesopotami, mijëvjeçari 3 pK). Në ikonografinë e hurriteve, Hëna dhe Dielli paraqiten dëndur të binjakëzuar. Hurritët udhëhiqeshin nga një kastë aristokratike luftëtarësh (67) dhe figura qëndrore e besimit të tyre ishte Perëndia e luftës.(68)

Studiuesi Trevor Bryce në librin e tij *“The Kingdom of the Hittites”*,(Oxford 1998) duke ju referuar emrave të mbretërve hititë verën “ se ata kanë prapashtese -ili, mënyrë e cila i identifikonte ata me yllin (...) Përveç Ilireve dhe Hititëve, nuk ka asnjë popull tjetër në Azi apo Evrope, që të përdorë prapashtesën -ili pas emrit të një mbreti.(...) Hititët dhe Iliret kishin të njëjtën kulturë e qytetërim dhe të njëjtën gjuhë. (69) Edhe Dr.Arif Mati e pohon këtë fakt: “Prijsit Hititë nga ana etnike ishin të përafërt me Trojanët, Thrakasit ose Frigjanët dmth një popull Pellazg. Popull i famshëm “i malësorëve me kokë të rrumbullakët“ të cilët kanë shkelur tokën e Lindjes së Mesme rreth viteve 4000 pK” (70)

Pra koha dhe vëndi ku u zbulua shqiptonja me dy kokë, lidhet me fiset pellazgo-ilire , që nuk e braktisën kurrë besimin hënor, por pranuan ekujlibrin e dy kulteve, nëpërmjet dy kokave të shqiptonjës hyjnore. M.Eliade pohon se, filozofija mistike e indjanëve nuk trajton supremacinë e Hënës apo të Diellit, përkundrazi përpiqet t’i baras-vendosë, sepse kjo formulë (Hëna-Diell), vinte që nga periudha primitive, si shprehje e ripërtëritjes (71) Fakti, që pas rënjes së mbretërisë hitite (1180 pK) e deri në periudhën e Perandorisë romake nuk është gjendur asnjë gjurmë e shqiptonjës me dy kokë, dëshmon se në Azi, ky simbol nuk ishte vëndës, por kalimtar, i sjellë nga fise luftëtarësh pellazgo-ilir, gjatë pushtimeve të tyre në këtë trevë.

Shqiptonja dykrenore ka qenë emblemë e Dyerve fisnike të Gropajve, Muzakajve, Aranitëve, Kastriotëve, dhe shqiptonja me një kokë, e Zakariajve dhe Buzëzezëve (72)



Shqiponja dy krenore e Perandorëve arbër Paleologë, në Stamboll; Emblema e shtetit të Arbërit .

Përfundimi i tretë: Besimi pellazg hënor u përhap në të gjitha vëndet, që pushtuan dhe sunduan, mbretërit Heronj dhe Profetë të origjinës ilirike: në Europë, Afrikën veriore, Azinë e vogël e deri në Azinë e largët. Ky besim pësoi ndryshime në mite, duke u dhënë rolin kryesor Perëndive meshkuj dhe kulteve të tyre. Kjo dukuri pasqyroi kalimin drejt shoqërisë patriarkale me administrata të fuqishme politike dhe ushtarake, të drejtuara nga Mbreti- Diell, simbol i dijes, i pushtetit dhe i ligjit, duke simbolizuar forcën e pushtetit, me forcën e ndriçimit diellor.

Një nga dukuritë e rëndësishme në mitet, pohon Mircea Eliade, është ay i “heronjve diellorë”, sidomos tek blegtorët nomade, fise nga dolën në shekujt e mëvonshëm të ashtuquajtura nacione “që bejnë historinë” (...) dukuri sidomos e shteteve indo-europiane. (73)

Kështu shqiponjës që përfaqësonte Krijuesin-“Dritën hyjnore”, ju shtua krahas kokës së parë “dritës hënore” edhe një kokë e dytë “drita diellorë”, një ekujlibër i pranuar me vështirësi dhe nganjëherë edhe me luftë. Siç dëshmon A.Kola (*Gjuha e Perëndive*) në shk.VII pK një popull nga Iliria luftoi kundër Delfit deri sa u arit një marrëveshje , sipas së cilës perëndija e re e Dritës - Apolloni do të bënte parashikime në emër e për llogari të Atit Zeus të Dodonës. (74)

Prandaj nuk janë të rralla pamjet me tre kurora mbi kokën e shqiponjës dy krenore: dy të vogla (Hëna- Dielli), mbi sejcilën kokë dhe një e madhe në mes, që përfaqëson ZOTIN-Dritë. Kjo ka qenë “reforma” e parë e besimit pellazg, shumë kohë përpara se të ndodhte “reforma” e dytë, që shënoi fillimin e një lufte fetare dhe administrative (që zgjati me shekuj), kundër

besimit 50 mijë vjeçar të Pellazgëve hyjnorë që përfundoi me lindjen e Kristianizmit. Besimi i ri, zëvendësoi kultin zanafillor të Hënës dhe jet-shkurtër të Diellit, me kultin e njeriut tokësor, të lidhur me Krijuesin: *KRISHTIN*.

Në këtë material, kam hedhur vetëm disa teza, për të skicuar *HISTORINË* e besimit zanafillor të Pellazgo-ilirëve, e simbolizuar me figurën e *SHQIPONJËS* dhe Rrezes (Yllit).

Njohja e besimit pellazg “*Sellenizmit*”, pohon faktin se ay ka qenë besim monoteist, që ka njohur vetëm një Krijues- *Dritën hyjnore*. Pellazgo-ilirët të cilët e krijuan këtë besim, kanë përdorur simbolin e Shqiponjës, të Yllit (Illi-në dialektin çam) dhe të Tokës (Ar), në gjithshka që ka patur të bejë me jetën e tyre: emërtimin e vëndit, gjuhës, vetes, toponimeve, simboleve kombëtare etj, duke ju dëshmuar fiseve të tjera, lidhjen që kishin me *KRIJUESIN* dhe duke e quajtur veten - *BIJ TË TIJ HYJNORË*.



Flamuri shqiptar në Hënë, gjatë misionit Apollo 14 (1971) vendosur nga astronauti i NASA-s me origjinë shqiptare, Alan Shepard.

TEK ZOTI PASH VËNDIN TIM

Dhimitër Kamarda

Besimi dhe Atdheu, ka qënë zanafilla e lëvizjes më të fuqishme ideore dhe kulturore e elitës shqiptare të shekullit 17-19, që në historinë botërore njihet me emrin e përgjithshëm *RILINDJE*. Ajo që e bashkonte lëvizjen shqiptare me atë europiane ishte fakti se:

- Frymëzuesit dhe veprimtarët e saj, kanë qënë nga rradha e figurave të shquara intelektuale.
- Synimi për të zbuluar dhe mbledhur pasurinë e traditës (folklorike-besimtare) dhe historike të Kombit shqiptar, e cila do të dëshmonte karakterin e ndryshëm etnik me popujt e tjerë dhe origjinën e lashtë.
- Përkushtimi ndaj çështjes kombëtare.

Por, kjo lëvizje kulturore në fillim, dhe çlirimtare më vonë (shk19-20), tek shqiptaro-arbërit kishte shumë dallime nga lëvizja europiane, si për shkaqet e lindjes, ashtu edhe rrugën e ndjekur dhe autorët kryesor të saj. Një prej këtyre dallimeve ka qënë fakti, se zuri

fill në shk17 në « shtëpinë e Zotit » në gjirin e eruditëve kishtar, jashtë truallit të saj natyror, e pafinancuar dmth vullnetare dhe shkaku, ishte i natyrës fetare.

Siç dihet mbas vdekjes së Skëndërbeut (1467) dhe pushtimit Osman , së bashku me familjet u larguan drejt Gadishullit italik edhe përfaqsesit e besimit të krishter lindor të shqiptarëve. Përveç vështirësive që gjetën në tokën e Papatit katolik për pranimin dhe ushtrimin e riteve të besimit të tyre ortodoks bizantin, një problem i madh shpirtëror ishte trajtimi i tyre, si etni dhe besimtar të Kishës Greke. U pa e domosdoshme të dëshmohej në « atdheun e dytë » karakteristikat etnike dhe Historia e vërtetë e Kombit shqiptar. At Nikoll Keta ju mësonte nxënësve të tij se : « Studimi i historisë së paraardhësve, buronte nga një kureshtje e ligjshme vetjake , si kërkesë e vetë natyrës njerëzore, meqënëse ky veprim ishte shprehje e vullnetit dhe dashurisë Hyjnore ».(1)

Siç pohon studiuesi Matteo Mandala , At Gjergj Guxeta dhe veçanrisht bashkëpuntori i tij, At Pal M. Parrino e kuptuan se për të treguar dallimin midis besimeve të etnisë greke dhe asaj arbërore (shqiptare), do të ishte më e frytshme të rindërtohej identiteti historik , kulturor dhe besimtar i shqiptarëve , se sa ajo e debateve shtërpe teologjike. Të dëshmohej origjina dmth se shqiptarët formojnë një etni autoktone që zë një trevë të caktuar ballkanike, duke zhvilluar nje qytetrim dhe kulturë të vetën, si besimtare dhe shoqërore , që flisnin një gjuhë të ndryshme nga ajo e popujve fqinj, me të cilët nuk i bashkonte asnjë tipar i përbashkët (...) Për këtë qëllim, përveç filozofisë dhe teologjisë duhej të përfshihesh edhe historia (...) Vetëm në këtë mënyrë bëhej e mundur të hidheshin poshtë shpifjet « dhe të korrigjohej gabimi i madh popullor që i njësonte Shqiptarët me Grekët»(2) Kjo ishte edhe arësya , shkruante At V.Dorsa, që më detyroi t'i rikthehem të famshmes *Lashtësi* , (...) për ta ndarë historinë e grekëve, nga historia e popujve (...) që nga autorët e lashtë përcaktohen Pellazgë, Epirotë, Maqedonëe nganjëherë Ilirë dhe nga autorët modernë, Kombi Shqiptar. (3)

Do të përqëndrohem tek përfaqsesit e ritit ortodoks bizantin, (pa mohuar kontributin edhe të etërve të besimeve të tjera) për faktin se puna e tyre shkencore formoi *SHKOLLEN E PARË* të studimeve Albanologjike , pothuaj në të njejtën kohë me ato europiane. Përpjekjet e Gj.Guxetës, P.M.Parrinit, V.Dorsës dhe Xh.Krispit, në krahasimin e gjuhës shqipe me greqishten, latinishten dhe gjuhët e tjera të lashta, ishin disa dhjetvjeçar më të hershme së ato të gjermanit Franz Bopp (1791-1867) (« Das Albanesisches in seinen Verwandtschaftlichen Beziehungen »,1855) themeluesit të gjuhësisë krahasuese nga lindi edhe shkenca e gjuhësisë. Duhet theksuar se studiuesit e huaj për t'u njohur me gjuhën shqipe, rruga e parë që shkelën ishte ajo drejt « burimit » arbëresh në Itali, ku u njohën me shkrimet mbi folklorin dhe traditat zakonore, të mbledhura nga etërit fetar dhe intelektualët. Kështu psh monografia e parë për gjuhën shqipe e Conrad Malte-Brun (1775 – 1826) tek Gjeografia Universale (L.119) ka të përfshirë studimin e priftit Angelo Masci, « Mbi origjinën dhe zakonet e Shqiptarëve » shtypur në Napoli më 1807.(4) Gjithashtu, shumë studiues janë mbështetur tek veprat e De Radës si : Hyjni pellazge (1840), Identiteti i pellazgëve me

shqiptarët (1846), Lashtësia e kombit shqiptar dhe afri e tij me helenët dhe latinët (1864), Pellazgët dhe helenët (1885), Konferenca mbi lashtësinë e gjuhës shqipe (1893), Pellazgo-shqiptarët (1897), Tiparet e gjuhës shqipe dhe përmendoret e saj në periudhën parahistorike (1899), të panjohura edhe sot nga lexuesit shqip-folës .

Studiuesit e huaj si Niebhur, Gioberti gjuhëtarët e njohur Max-Müller, Schleicher , Curtins, Benlow dhe Graziadio Isaia Ascoli (1829-1907) pohon At Dhimitër Kamarda qe kishin shkruar për origjinën e popullit dhe gjuhës së shqiptarëve « por, asnjëri prej tyre nuk e trajtoi në thellësi, punë që në të vërtetë ishte bërë më përpara, sidomos për sa i përket emrave nga Z.Krispi dhe V.Dorsa. (5) Të huajt që merreshin me temën shqipëtare, e kuptonin rëndësinë e madhe të njohurive që studiuesit arbëresh kishin mbi gjuhën, historinë dhe traditat e tyre. Kjo i shtynte t'iu bënin thirrje “që në ndihmë të shkencës, ata duhet të afroreshin për të zhvilluar një bashkëbisedim të hapur mbi natyrën e gjuhës së tyre”. (Pr Domenico Comparetti « Notizie ed osservazioni in proposito degli Studii Critici del Pr. Ascoli (estratto dalla Revista Italiana n. 126, 134,140, 1863, Pisa1865). (6)

Gjuhtarët arbëresh me veprat e tyre të shkruara në gjermanisht, frëngjisht dhe italisht , dhanë ndihmesën e tyre gjuhtarëve të huaj në përcaktimin e gjuhës shqipe si pjesë e familjes indo-europianë. Pra “Shkolla Albanologjike” e arbëreshve, jo si një Institucion arsimor, por si një veprimtari e bashkuar e një elite autodidakte, kishte kohë që e kishte nisur rrugëtimin e saj. Në rradhët e kësaj shkolle rënditen shumë eruditë priftërinj arbër të shekullit 17-19, si : Nilo Katalano (1637-1694), Josif Nikollë Brankati (1675 – 1741), Gjergj Guxeta (Giorgio Guzzetta 1682– 1756), Pal M. Parrino (Paolo Maria Parrino 1710 – 1765), Jul Variboba (1727 – 1788). Nikolla Keta (1741 – 1803) , Ëngjëll Mashi (1758 – 1821), Mikel Skutari (1762 – 1830), Zef Krispi (1781-1859), Vinçenco Dorsa (1823-1885), Filippo Matranga (1822-1888), Binard Bilota (1843 – 1918), Zef Skiroi (1865 – 1927), etj.

Në këtë shkrim, do të trajtoj disa teza të rëndësishme, gjuhësore dhe historikë, të dy veprave të At Dhimitër Kamardës (1821-1882), « *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese* », (Livorno 1864) ; « *Appendice al saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese* », (Livorno, 1866) duke ju bashkangjitur edhe mendimet e pararendësve, bashkohësve të tij dhe studiuesve të më vonshëm, të cilat (tezat) janë vënë në dyshim apo nuk janë shtruar fare nga Albanologjia e shk 21. Gjuhëtari gjerman Gustav Meyer (1850-1900) shkruante (« *Etymologische Wörterbuch der albanesischen Sprache* » Strassburg, 1891) se, emri i Dh.Kamardës , meriton të kujtohet dhe të vlersohet në historinë e shkencës (gjuhësisë historike) sepse « për herë të parë » në veprën e tij (*Saggio di Grammatologia ...*) është bërë « një trajtim i plotë krahasues i gjuhës shqipe ». (7) I shpreh mirnjohjen time Bibliotekës së ShBA, e cila e ruante librin e gjuhëtarit të famshëm arbëresh, « *Saggio di Grammatologia comparata sulla lingua Albanese* » (ribotim i vitit 1923) në koleksionin e veprave të rëndësishme të kulturës botërore dhe me ndërmjetsinë e librarisë Amazon në Itali, u bë e mundur ta kisha në dorë. Vepra tjetër « *Appendice...* » (1866), që në fakt është një shtesë e së parës, është shfrytëzuar nga Interneti.

Teza e parë: Sa është mosha e gjuhës shqipe ?

Siç na dëshmon Herodoti, mbreti Psametiku (Egjypt) për të njohur se kush popull është më i vjetri, vendosi të mësojë se cilën fjalë të parë do ta shqiptonin dy fëmijët e ritur nga dy gra që ju ishte prerë gjuha. Cilit popull do t'i përkiste fjala, ay do të pranohej si më i lashti. Ky tregim duhet të ketë qenë një prove e vërtetë historike, sepse na ka ardhur deri në kohët tona fjala e parë që shqiptuan fëmijët « bek », që e kishin dëgjur nga udhëtarët e një karvani të ndalur pranë banesës së tyre. Nga kërkimet e njerzve të mbretit midis gjuhëve të asaj kohe, doli se në te folurën e fiseve frigjiane kjo fjalë përcaktonte bukën. (8) Pamvarsisht vendimit të shpallur nga mbreti, na intereson fakti se këtë fjalë e ruan edhe sot, vetëm gjuha shqipe: « buk ». Pra shumë kohë para Herodotit, lashtësia e popujve shikohej në vartësi të lashtësisë së gjuhës që flisnin. Deri sa gjuha shqipe do të merrte denjësisht, nga autorët e shekullit të 19, kurorën e *GJUHËS SË PARË*, « *Shkollës albanologjike arbëreshe* » ju desh një rrugë e gjatë kërkimesh, sa gjuhësore aq edhe historike, folklorike dhe fetare.

Pothuaj një shekull para se Kamarda t'i futej kësaj pune, ishin rrahur mendime të ndryshme për zbulimin e lashtësisë dhe origjinës së gjuhës shqipe. Nisur nga pohimi i autorit të parë të Historisë së Skëndërbeut, Marin Barletit (1450-1513) se gjuha shqipe rridhte nga latinishtja, Gjergj Guxeta mendonte se ajo duhet të ishte një përzjerje e latinishtes dhe gjuhës së vjetër maqedonase. Ndërkohë bashkëpunatori i tij P. Parrino, mbronte idenë se gjuha shqipe, sidomos ajo e arbëreshve të Italisë, ishte e njejtë me gjuhën maqedone (të lashtë-shën im). (9) Por që të gjithë mohonin ndonjë afërsi apo lidhje me gjuhen greke.

Në vijim të bindjes së albanologëve nismëtarë G.Guxetës , P.M.Parrinos, edhe V.Dorsa pohon se Shqipëtarët çfaqen qartësisht me një origjinë, përkatësi dhe lidhje shpirtërore të përbashkët duke formuar kështu një familje , ku gjuha e zakonet, i dallojnë qartësisht nga grekët.(10) Pra rruga e vetme për të dëshmuar lashtësinë e gjuhës shqipe dhe rrjedhimisht e Kombit që e fliste atë, mbetej të vërtetohej lidhja apo trashëgimia e saj nga gjuha e maqedonëve të lashtë. Por siç dihet, nga kjo gjuhë nuk ka mbetur ndonjë dokument i shkruar me maqedonishten e Aleksandrit të Madh. Lindi kështu nevoja të krahasohej gjuha shqipe me një gjuhë tjetër të lashtë, nga e cila kishin mbritur vepra të shkruara. Me qënëse në rrethet filologjike europiane të shk 18-19, greqishtja mbahej më e lashtë se latinishtja, priftërinjt eruditë arbëresh , si zotërues të saj dhe profesorë të kësaj gjuhe në shkollat fetare dhe Universitetet e kohës, ju futën punës për krahasimin leksikor dhe gramatikor të shqipes me të. Sipas Dh.Kamardës, gjatë krahasimit u vërejt se « shqipja përmban shumë elemente nga më të lashtat e të folurës greke, të cilave ne as nuk ua dimë shqiptimin e vërtetë (...) dhe kjo më shtyn të pranoj, lidhjen e shqipes me sanskritishten, te pohuar nga Franz Bopp». (11)

Pothuaj 30 vjet para Kamardës, Zef Krispi i habitur, kish pohuar se « duke gjurmuar origjinën e gjuhës greke, është një gjë e bukur të shohësh se si ajo të kthen , në pjesën e saj më të madhe, tek gjuha shqipe » duke hedhur i pari idenë se ajo «mbase është më e lashtë

se greqishtja dhe në thelb, gjuha me të cilën flitej në shekujt para Homerit » (Malte-Brun libr.199,f243). (12) Kjo tezë do të trajtohet në fund të shk19 nga Sami Frashëri : “Ka shumë fjalë që vërtetojnë se format e tyre shqipe janë bazë, ndërsa format në gjuhët e vjetra greke e latine janë derivate të tyre. Kjo tregon se gjuha shqipe është më e vjetër se greqishtja ose latinishtja e moçme dhe se populli shqiptar është shumë i vjetër. (13) At Dh. Kamarda pohon se « shumë fjalë shqipe, përputhen me ato të gjuhës së lashtë të grekëve » duke shtuar se ato « janë unaza,(të ndërmjetme lidhëse-shën im)midis gjuhës së lashtë aziatike (sanskritishtes) me gjuhën e re hellene, asaj gjuhe të humbur, nga buroi gjuha e klasikëve grekë e mbritur tek ne, përmes librave të tyre të pavdekshëm». (14)

Duket sikur këto përfundime hedhin poshtë studimet e gjuhëtarëve nismëtar, që u shprehën për dallimin rrënjësor midis këtyre dy popujve kufitarë ballkanikë të shekullit 19. Por duhet të kemi parasysh, se si lëndë studimi, nga gjuhëtarët u mor fjalori i greqishtes së lashtë i shkruarve të parë dhe, siç shprehej francezi Robert De Angely (*Enigma*), “Po të mos kishin qënë shkronjat e njejta (të « greqishtes së lashtë » dhe asaj të shk19-shën. im), pashmangërisht do të ishte deklaruar se gjëndemi para dy gjuhëve të ndryshme” (15) Mjafton të shkruajmë një listë të vogël fjalësh shqipe, greke dhe hellene të lashta dhe nga krahasimi i tyre i drejtpërdrejt, vërtetohet se shqipja është krejtësisht e njejtë me greqishten homerike, gjë që nuk ndodh me greqishten e re, do të shkruante më vonë studiuesi i miteve pellazge , arvanitasi Aristidh Kola (16)

Merita e Kamardës në studimin e gjuhës shqipe ishte edhe fakti se shfrytëzoi arritjet e shkencës së porsa-lindur në Europë, Fonologjisë (Studimi i tingujve të gjuhës). Duke përdorur metodën krahasuese me gjuhët europiane, ai pohon se gjuha shqipe është shumë e pasur në tinguj dhe « përmban jo vetëm të gjithë tingujt e greqishtes dhe latinishtes, siç shqiptohen sot në Greqi dhe Itali, por do të shtojmë edhe të frëngjishtes e gjermanishtes ». (17)

Në shekullin e 18 etërit arbëresh si P.Parrino e sidomos Nikoll Keta (“*Tesoro di notizie su de’ Macedoni*”1777), duke shfrytëzuar të dhënat historike mbi fiset e lashta shqiptare dhe maqedonase të shumë autorëve, të lashtë dhe modern, hebrej, egjiptian, grekë, latinë, italianë, francezë, metodë që Eqerem Çabej do ta quante “moderne dhe globale, e cila edhe sot është thellësisht e drejtë” , aritën në përfundimin se gjuha maqedone e lashtë dhe ajo shqipe, i përkisnin trugut gjuhësor “feniko-pellazg”.(18) Duke ndjekur gjurmët e At V.Dorsës i cili pohonte se gjuha shqipe ishte “e thjeshtë , shprehëse, imituese dhe poetike , cilësi që nevoiten për të vërtetuar origjinën e saj të lashtë”(19) dhe të At Z.Krispit :”Se tingujt, në gjuhën shqipe, duke qënë të shumtë dhe të papërcaktuar, na qartësojnë natyrën origjinale të saj, siç është pa dyshim , vetë gjuha që Zoti i dha njëriut të parë”,(20) Dh.Kamarda i kushtoi një rëndësi të veçantë vetë formimi të fjalëve të saj.



Gjuha shqipe , vëren autori, është e varfër me fjalë të përbëra (nga bashkimi i dy fjalë me kuptim të plotë si dhe më parashitesa e mbrapashtesa -shën im) me të cilat është e pasur greqishtja dhe gjermanishtja . Në gjuhën shqipe, si emrat edhe foljet ndodhen me shumicë në gjëndjen e rrënjëve të pastra. Këto fjalë/rrënja (të përbëra vetëm nga dy/tre gërma si : ha, pi, ri, shi, re, vë, di, pa/me pa, mal, gur, lis, etj-shën im) janë trashëguar nga gjuha-mëmë. (21) Kamarda e pëcaktonte si një formë zanafilore e krijimit të fjalëve, si tek çdo gjuhë tjetër, por e mbetur deri më sot tek shqip-folësit nga «mungesa e kulturës» ,ku nënkuptonte mungesën e arsimimit dhe shkrimit të librave.

Studiuesi arbëresh do të mbetet i habitur , sikur të shikonte se edhe pas tre shekujve, në kohën e internetit, në fjalorin e shqiptareve fjalët/rrënja para-historike janë në përdorim të pandryshuara, dhe padyshim ky fakt ka shpjegimin e vet. Intuita prej shkencëtari, e shtynte të parashikonte se në formën një rrokëshe të fjaleve « fshihet » kyçi i lashtësisë se gjuhës shqipe dhe « studimi i tyre kërkon një vëmëndje të veçantë ». Koha tregoi se kishte të drejtë.

Njohësi i veprës së Dh.Kamardës, francezi Eduard Shnaider (*Pellazget dhe pasardhësit e tyre*) mbasi bëri një përlllogaritje të fjalëve-rrënja, pohon se « gjuha shqipe ka 785 të tilla, që e tejkalon tepër shumën e fjalëve rrënja të të gjithë gjuhëve të tjera, të vdekura dhe të gjalla. Dhe ky numër nuk është përfundimtar (...) Me 75 tinguj zanore, dhe 31 bashtingllore të forta dhe 785 fjalë-rrënja, një gjuhë mund të arrijë në një shkallë përsosmërije të paparë ». (22) Përfaqësuesi i madh i “*Shkollës Albanologjike arbëreshe*” Jeronim De Rada (1814 – 1903), do të shprehej : “Gjuha Shqipe , në analizë të fundit është ajo Gjuhë e Parë (Lingua Primeva) ose Mëmë (Muttersprache) ose së paku e afërmja e saj e ngushtë e më përfaqësuese, nga copëzimi i së cilës, si Ai (Zoti-shën im) në Sakrificën e Madhe Kozmogonike të një Qënie

Hyjnore, të gjitha gjuhët e tjera erdhën e u ndërtuan mënjanë” (23)

Kamarda na sjell edhe mendimet e figuravë të shquara europiane, që janë shprehur mbi lashtësinë e gjuhës sonë si Theodor Stier i cili pohon se kohën e origjinës së gjuhës shqipe, duhet ta vendosim ,në periudhën kur nuk flitej as greqishtja, qoftë moderne apo antike, as latinishtja, as ndonjë nga të folurat që njohim sot apo që janë zhdukur. Ndërsa figura më e rëndësishme e Rilindjes italiane Vincenzo Gioberti (1801 –1852) në librin e tij « Primato » (Bruselles1844, T.II p.133) , këmbëngul se gjuha shqipe , përmban gjurmë të gjuhëve që kanë qarkulluar në Greqi para pushtimeve deukaliane dmth para se të formohej popullsia e emërtuar Ellenike (24)

Sot, studimet shqipetare mbi origjinën dhe lashtësinë e gjuhës shqipe, e kanë tejkaluar shumë nivelin e studimeve europiane. Studiuesi Petro Zheji, duke shfrytëzuar ligjet e fizikës moderne, shkrimet fetare, fondin dialektor e historik të fjalëve shqipe, duke i krahasuar ato me fjalorin e sanskritishtes , hebraishtes dhe të gjuhëve moderne, vërteton se fjalët shqipe kanë natyrë simbolike dhe mitike , tipare të gjuhës se krijuar nga njeriu i parë. Ai sjell shembuj të shumtë se si rrënjët e gjuhës shqipe zbërthejnë kuptimin e rrënjëve të sanskritishtes, gje që nuk e ben dot ajo vetë për fjalët e saj dhe të gjuhës shqipe. Kjo dëshmon se shqipja e lashtë ka qene gjuha *MËMË* e gjuhëve te «vdekura» dhe me kalimin e kohës, prej burimit të saj rrodhen gjuhët e tjera. Kjo, vëren P.Zheji, shpjegon edhe faktin se:« Në gjuhën shqipe ndeshen gllosa të të gjitha gjuhëve të botës, gjë që, krahas cilësish të tjera të spikatura, e bën shqipen një gjuhë *SIMBOLIKE* » (25)

Për sa më sipër, gjuha shqipe/arbërishte është i vetmi monument “i gjallë” para-historik europian (i pa vlersuar akoma nga *UNESCO* për faj të institucioneve Albanologjike) që dëshmon se si njeriu i parë, duke ndjekur tingujt e botës qe e rrethonte dhe duke besuar në forcat e mbinatyrshme, nisi të shprehej. Gjurmët e kësaj gjuhe të njeriut primitiv, që i ra kryq e tërthorë një hapësire jashtzakonisht të gjerë të Europës, Afrikës dhe Azisë, gjuha shqipe i ruan edhe sot, të shprehura në të gjithë treguesit e saj: në pasurinë e fondit themelor të fjalëve, strukturën e tyre dhe sistemin gramatikor.


Teza e dytë: A janë Ilirët paraardhësit e të gjithë Kombit shqipetar ?

Në rrugën që duhej ndjekur për të përcaktuar origjinën e Shqipetarëve, sipasV.Dorsës, një mjet i domosdoshëm, krahas historisë shërben edhe gjuha. (26) Edhe ne, për t'i dhënë përgjigje tezës së dytë, fillimisht do të ndjekim rrugën gjuhësore. Në shtesën që i bën Librit të parë (*Saggio...*), Dh.Kamarda, thekson se, për një studim të thelluar mbi natyrën e gjuhës së Shqipetarëve, i cili nuk ishte bërë deri në atë kohë, duhej të përfshihej e gjithë e folura popullore dmth jo e një, por e dialekteve kryesore (27) dhe këtu kishte parasysht ,jo vetëm

të folurën e shqiptarëve në trevat e tyre natyrale (Shqiperi, Mal të Zi, Kosovë, Maqedoni, Sërbi, Greqi), por edhe të arbëreshëve të Italisë dhe të ishujve Jonian.

Në botimin e Akademisë së Shkencave “Historia e Popullit Shqiptar”, (vëll.I, Toena, 2002), duke folur për gjuhën e Kombit tonë është përdorur emërtimi “gjuha shqipe” për periudhën e historisë moderne, “gjuha arbëreshe” për të folurën e arbëreshëve të Italisë dhe Greqisë dhe “gjuha ilire” për gjuhën e lashtë të shqiptarëve. Natyrshëm lind pyetja: A mund të thuhet psh se në Jugun e lashtë dhe mesjetar, gjuha që përdorej emërtohej “ ilire” dhe populli që e fliste e quante veten “Ilirë”?

Sipas studimeve Albanologjike, gjuha shqipe përbëhet nga dy dialektet kryesore, Geg dhe Tosk, pranuar nga të gjithë gjuhëtarët, shqiptarë dhe të huaj. Kamarda duke folur për këto dialekte sqaron edhe shtrirjen e tyre gjeografike. Sipas tij e folura e Gegëve fillon nga lumi Shkumbin, i cili rrjedh në mes të Epirit të ri (Iliri) dhe të vjetër dhe e ka burimin nga malet e Kandavisë në këmbë të liqenit të Ohrit dhe e folur deri në Mal të Zi, në kufi të Bosnjë-Hercegovinës dhe Sërbisë (së shk19). E folura Toske ,mbisundon nga Shkumbini deri nëEtolia, duke u përhapur në shumë zona të Greqisë dhe ishujve të saj. Pak më poshtë shton se, edhe gjuha e shqiptarëve të Italisë, sikurse ajo në Greqi, i përket dialektit tosk. (28)



Kjo ndarje gjuhësore ka përcaktuar edhe dy ndarjet gjeografike të dy bashkësive më të mëdha fisnore të shqiptarëve të vjetër: Iliro-Maqedonëvet dhe Iperiotëve (Epiriotëve), të dokumentuara në librat e historianëve të parë si dhe hartat e mbritura deri në shk16-17. (majtas)

Do të mjaftonte ky fakt, për të dëshmuar gabimin në përdorimin vetëm të emërtimit “Ilirë” për origjinën e shqiptarëve. Për të dhënë një panoramë të qartë të paraardhësve të Kombit tonë, Kamarda i kushton një vëmendje të veçantë edhe fakteve historike. Duke mbështetur përfundimet e Johan G. Han (1811-1869) , i cili kishte bërë studim të thelluar për origjinën e shqiptarëve,

Kamarda pohon se ata janë pasardhës të Iliro-Maqedonëve dhe Iperiotëve (Epirotëve) të lashtë. (29) Këta popuj, në kohë më të vjetra, sipas shkruarve të parë (Erodoto L.I.56,58. II.52-Tucidide L.I 3.-Strabone L.V.VII.- Dionigi Alicarnass. Ant.Rom.I.17.- Esiodo,etj.) së bashku me Hellenët, i përkisnin familjes Pellazgjike dhe Lelege. (30) Duke mos vënë në dyshim përfundimin e Hahnit që shqiptarët i emërtonte “Pellazgët e Rinj” dhe sidomos të thënieve të historianëve të sipërpërmëndur, dalim në përfundimin se “origjina ilirë” e shqiptarëve është një tezë historike e mangët, pra jo e saktë. Që fiset Ilire janë shqiptarët e lashtë, qëndron si fakt historik, por jo i plotë. Si i tillë, ay nuk mund të jetë një e *VËRTETË HISTORIKE*.

Studiuesi arbëresh, për të qënë sa më besnik kësaj të vërtete, duke u mbështetur në shkrimet e Herodotit dhe të autorëve të tjerë, na sjell një list të gjatë me emrat e fiseve të lasha “që në atë kohë përbënin dy bashkësitë kryesore, shumë pak të dallueshme me njera-tjetrën, që emërtoheshin Ilir dhe Epirotë, dhe sot Gegë e Toskë.” (31) Dh.Kamarda kur emerton Ilirët gjithëmonë ju bashkangjit edhe fiset Maqedone. Që në shk 17, At Parrino dhe nxënësi i tij Nikolla Keta, të nisur gjithëmonë nga shkrimet e historianëve të parë, por të pasuruara edhe me shëmbuj nga tradita kulturore dhe ajo besimtare e këtyre fiseve, pohonin se emrat “Ilir”(që nënkuptonte edhe fiset Albani të Shqipërisë së mesme), “maqedon” dhe “iperiot” ishin thjesht emra, me të cilat historikisht emërtohej i njëjti popull para-hellenik që banonte prej shekujsh në hapsirën ballkanike, me tipare etnike, gjuhësore, veshje dhe zakone të përbashkëta. (32)

Për sa më sipër, na lind e drejta të shpallim se, fatkeqsisht në botimet e sotme, teza e “origjinës ilirë” ka fshirë gjysmën e historisë së lashtë të Kombit tonë. Faktet historike, gjuhësore, arkeologjike, mitet, kultura e traditës dhe sidomos *BESIMI* dhe *RITET*, dëshmojnë se shqiptaro-arbërit e kohëve moderne e kanë origjinën nga fiset *ILIRO-IPERIOTE*, (iliro-epiriotë) që Kamarda shpesh e përdor në formën “Ilirio-Epiroti o Schipetari” (33), historia e të cilëve lidhet me Pellazgët Hyjnorë. Shfrytëzimi vetëm i të dhënave të një shkence (gjuhësisë apo historisë) në metodën e përdorur për zbulimin e origjinës së popujve dhe gjuhës së tyre, ka sjellë pengesa të mëdha për studiuesit dhe shpesh me përfundime të gabuara. Shëmbull janë mëdyshjet, gjatë dy shekujve, të gjuhëtarëve të huaj për origjinën e gjuhës dhe të vetë shqiptarëve: Është ilire apo trake? Kështu ilirologu i njohur Radoslav Katičić pohon me bindje se “Asgjë në natyrën e provës nuk është paraqitur deri tash për prejardhjen trakase të gjuhës shqipe... E vetmja gjë që mund të bëjmë tash është të jemi mendjehapur duke mbajtur mend në këtë kontraverzë se barra e provës u bie atyre që mohojnë prejardhjen ilire të shqipes.” (Katičić 1976: 187-8). (34)

Po përse duhet kërkuar origjina, “ilire apo trake”, kur Shqiptaro-Arbërit e sotëm janë pasardhës të bashkësive fisnore, edhe të Ilireve edhe të Iperiotëve, Maqedonëve dhe të Thrakëve të lashtë? A nuk është dëshmuar se këto fise i përkisnin një etnije, u janë drejtuar të njëjtëve orakuj dhe Perëndive, kanë folur një gjuhë, por në dialekte të ndryshme dhe kanë lënë toponime në të gjithë Ballkanin që kanë kuptim vetëm në shqip?

Kamarda pohon se “Që nga koha kur janë përmëndur prej shkruesve (Straboni, Tolemeu), Maqedonët dhe Trakasit e lashtë, u zhdukën gradualisht si bashkësi, si rrjedhojë e konflikteve të vazhdueshme dhe pushtimeve barbare. Fiset lindore të tyre, u asimiluan prej Sllavëve dhe Bullgarëve , një pjesë u bënë Rumunë ndërsa pjesa perëndimore e tyre, ju bashkangjit fiseve të së njejtës etni, të Ilirisë dhe Epirit, që nuk u asimiluan kurrë plotësisht, as nga Romakët, e aq më pak nga Sllavët, Bullgarët apo Turqit”. (35) Dhe në rast se duhet të flasim për pasaktësira historike, problemi nuk qëndron vetëm për fiset Trake, por veçanrisht për Helenët e lashtë.

Tëza e tretë: Hellenët sipas Kamardës

Siç e pamë në fillim të materialit , nismëtarët arbëresh të “*Shkollës albanologjike*” kishin si qëllim të dëshmonin dallimin midis etnisë së Shqiptaro-Arbërve me Grekët, të emërtuar në shekullin e 19, por dhe sot e kësaj dite nga historianët europianë si “Hellenë”. Në fakt, ky dallim u përkiste “Grekëve të rinj” të pas revolucionit të 1821, për të cilët Nermin Vlora Falaski pohonte se: “ Në Mesjete nuk ka patur grekë-hellenë. Grekët e sotëm janë, në të vërtetë, përzjerje e etnosit shqiptar, vllah dhe turk”. (36) Studiuesi J.Ph.Falmerayer (“*Fragments aus dem Orient*”, II, Stuttgart 1845, f381,382) që vizitoi krahinat e Peloponezit, Atikës dhe zonave të tjera në vitin 1833 në librin e tij shkruante se: «çdo njëri bindet që kudo në Greqi flitet shqip») (37)

Kamarda duke e kuptuar rëndësinë e madhe të këtij problemi në studimet historike, e ndjen të nevojshme, pas dy vitesh, t’i bëj një shtesë botimit të librit të parë. Për të sqaruar përkatsinë etnike të Hellenëve të lashtë, ay sjell jo vetëm fakte nga shkruesit e parë dhe mitet, por krahason traditën zakonore, ritet dhe shpjegon ligjet fonetike të gjuhës shqipe, që sollën gjatë mijëra vjeçarëve largimin e gjuhës së hellenëve nga burimi i saj pellazg.

Mund të themi , me aq sa kemi mundur të lexojmë deri më sot, se teza “Hellene” asnjëherë nuk është trajtuar kaq gjërësisht në këtë këndvështrim. Është fakt se edhe në kohën tonë, për origjinën e emrit “grek” dhe atij të lashtë “hellen” dhe arsyes se, përse emri “hellen” barazohet me emrin “grek”, studiuesit nuk na kanë dhënë dëshmi historike, gjuhësore apo besimtare. Kjo mangësi ka sjellë, që në Historiografinë europiane dhe botërore, bashkësitë fisnore iliro-iperiote dhe maqedone , të trajtohen etnikisht të ndryshme nga ato të hellenëve të lashtë dhe në përgjithësi me të gjithë fiset e Jugut ballkanik. Kamarda dëshmon (siç do ta shikojmë më poshtë) se *GJUHA*, në çdo kohë ka shprehur afërsinë e ngushtë të tribuve Iliro-Maqedone-Iperiole me ato Hellene dmth të Eolo-Doro-Jonëvet . (38) Ky trajtim i gabuar i Historisë së lashtë është rrjedhojë edhe nga moskuptimi i emërtimit “barbar” (që përbën një tezë më vete), në kohën kur Herodoti e ka përdorur për gjuhën e këtyre fiseve dhe rënien e studiuesve në “kurthin” politik të fjalimeve të Demostenit kundër mbretërve maqedonas.

Kamarda na jep një *LASHTËSI TJETËR* nga ajo që paraqitet sot, gjë që i bën veprat e tij « *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese* » dhe « *Appendice al saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese* », materiale shumë të rëndësishme për një debat të hapur shkencor.

Historia e Lashtë e Greqisë, siç emërtohet sot, ka dy kulme të lavdishme që kanë mrekulluar të gjithë brezat pasardhës të shoqërisë njerëzore: Luftën e Trojës dhe lufrat afro-aziatike të Alaksandrit të Madh. Që të dyja trajtohen si shëmbuj të triumfit të gjenisë luftarake “hellene” dhe të pushtimit ndërkombëtar të qytetrit dhe gjuhës së tyre, me emrin përgjithësues “*HELLENIZËM*”.

Ernst Cassirer, në librin e tij “*Gjuha dhe Miti*” (Sprache und Mythos, 1925) shprehet se në çdo emërtim gjuhësor (bëhet fjalë për gjuhët natyrale-shën im), karakteri mitik është parësor (...) gjithshka në origjinë (edhe tek emrat -shën im) është e lidhur me mendimin mitik-besimtar. (39) Emri Hellen dhe për pasojë edhe Hellenizëm e kanë origjinën nga Selleni dhe Sellenizëm, ku nga dy gërmat e shuara fishkëlyese (s / h), e dyta ka zëvendësuar të parën dhe shpesh nuk shqiptohet (selleni-helleni,-elleni), që Kamarda e cilson si një ligj fonetik të gjuhës së lashtë shqipe. Ky ligj i lashtësisë dhe perfundimi i E.Cassirerit vërteton se, emrat Hellen dhe Hellenizëm, e kanë origjinën nga besimi dhe mitet e Pellazgëve. Në ato kohë para-historike sundonte vetëm një besim: ay *HËNOR*. Sellena ishte emri i Perëndeshës hënore që kishte mbretëruar e para në fronin e tempullit të Dodonës. Këtë lidhje me mitet nuk e gjejmë për emrin “grek”. Deri në shekullin e 19 (në kohën e luftës çlirimtare të 1821), besimi i lashtë i shqipëtarë-arbërve emërtohej “S/hellenizëm” dhe luftohej nga Kisha ortodokse. (F.Demi *Rruga e zbulimit të emrit të besimit Pellazg dhe i vashës krahë-shqiponjë*). E lemë këtu trajtimin besimtar të emrit “Hellen” dhe le t’iu kthehemi fakteve historike të rënditura nga Kamarda dhe që kanë lidhje me këtë tezë.

Sipas Aristotelit (Meteor.I,14) Epiri ishte Hellada e parë, shkruan Kamarda, dhe sipas Homerit (II,XVI,223) “grekët” e parë apo Ellinët apo Sellinët ishin dodonas, fise të Kaonisë (Stefan. Eustat, Hahn I,231,255) që sot i njohim me emrin Molossë (ne shqip dmth malësorë). Tek Straboni, shkruhet se Gadishulli ishte i banuar nga popullsitë Trake, Maqedone, Ilire, Iperiotë dhe Hellene (40) dhe janë të shumtë autorët e lashtë (Erodoto, Tucidite, Dion. d’Alic. (I,17) që pohojnë se në Epir, sikurse edhe në pjesën tjetër të Greqisë, ndërmjet Shqipëtarëve dhe Hellenëve, nuk ka asgjë që i dallon, përveç faktit se të parët kanë një energji më të madhe. (41) Duke ndjekur faktet e sjella nga shkruarit e lashtë (Strab. Erodoto, Stef. Biz, Scimeo etj.) se Hellenët e kishin origjinën nga Epiri dhe Hellada e parë shtrihej përreth Dodonës dhe se Pellazgët dodonas ishin Iperiotët, atëherë arrijmë në përfundimin se Hellenët e lashtë, nuk ishin ndonjë fis tjetër veçse vetë Iperiotët, mbi të cilët mbretëroi Deukalioni që ngriti tempullin e Dodonës. Kjo llogjikë e fakteve tregon se emri Hellenë (Sellenë), të cilit edhe sot nuk i shpjegohet kuptimi nga historianet, e ka origjinën nga besimi hënor dodonas, siç u theksua edhe më lart.

Studiuesi arbëresh Dh.Kamarda pohon se: “Qytetrimii vërtetë i Greqisë (...) fillon kur

Thesalët dhe Iperiotët(epiritotet), nën emrin e Dorëve, shtrinë pushtetin e tyre në Peloponez dhe mbi të gjithë Helladën (...) Pushtimi i Azisë, një ide e trashëguar prej kohrave pellazgjike të Luftës së Trojës , ishte në të vërtetë luftë e pellazgëve (bashkësive fisnore të ilirëve-maqedonëve-iperiotëve), siç vëren edhe Hahni. Në rast se do të kishin qëndruar të lidhur me njëri-tjetrin dhe do të udhëhiqeshin nga një politikë e mënçur, nuk do të ishin mundur nga Romakët dhe aq më pak nga Turqit”. (42) Këtë tezë të “*Shkollës arbëreshe të Albanologjisë*” e trajtoi gjërësisht më vonë Aristidh Kola në librin e tij « *Arvanitasit dhe prejardhja e grekëve* » ku sjell edhe një dëshmi të rëndësishme historike. Në Peticionin e « Lidhjes Arvanitase » më 1897, shqiptarët i kujtojnë mbretit gjerman- Otton, origjinën e banorëve të shtetit të tij Hellen : «Grekua para se të bëhej grek, ishte shqiptar, dmth pellazg» . (43)

Studiuesi francez Robert D’Angely ,duke u bazuar tek profesori grek Γ.Ι.ΚΑΡΒΕΛΛΑΣ, në kapitullin: “*Mbi elementin bizantin ose shqiptar ndërmjet viteve 610 e 1453 të Bizantit*”, i cili jep të dhëna, nga tekstet dhe procesverbalet origjinale, të regjistruara kishëtare të kohës, pohon se: “ Nga leximi i këtyre teksteve, del fakti se më 1204, domethënë shumë kohë para datës 1375 (të shënuar sikur ka qenë ajo e ardhjes së parë të punëtorëve shqiptarë në Greqi), në këto vise ka patur gjithmonë shqiptarë ”. (44) Por nuk kane qënë vetëm studiuesit e shekujve modernë të cilët e kanë pohuar këtë fakt. Edhe Denis Halikarnasi, paraardhësi i shqiptaro-arbërve, Pellazgët i përcakton stërgjyshër të Helenëve, që banonin në Peloponez, prej kohësh më të lashta. (Denis.i Hal. Ρωμ. Αρχ.Ι, 17). (45) Përsa i përket përbërjes etnike të popullsisë së sotme të Helladës (Greqi) , që në shk 19 u quajtën “Helenët e rinj” (Grekët e rinj) kërkon një studim më vete.

Duke mbritur në këtë pikë, mbi origjinën e përbashkët të fiseve ballkanike të lashtësisë, na lind pyetja se përse sot gjuha greke dhe shqipe kanë dallime kaq të mëdha? Kamarda e trajton gjërësisht këtë dukuri.

Teza e katërt: Kulla e Babelit dhe Ligji i Gritit

Rrugëtimi që ka ndjekur mendimi besimtar (feja) mund të paqyrohet ,sipas Usenerit, vetëm nga historia e gjuhës. (Usener, p316) (46) Kjo shprehje është shumë e thellë si nga përmbajtja e saj filozofike , aq edhe historike dhe gjuhësore, siç e dëshmon në veprën e tij Petro Zhei (*Shqipja dhe Sanskritishtja*). Ne do të mjaftohemi ta lexojmë ndryshe: Tek mendimi besimtar gjëndet historia më e lashtë e gjuhës. Këtë na e tregon Bibla (Gen. 11, 1-9) në mitin e ndërtimit të Kullës së Babelit. Miti fillon me pohimin se më përpara, në Tokë flitej NJË GJUHE. Njerëzit e mbledhur në vendin e emërtuar në Bibël, Sennaar (Babilonia e lashtë) vendosën të ndërtojnë një qytet rreth një kulle, maja e sëcilës do të takonte Qiellin. Kur të arinin deri në lartësinë hyjnore, do të përmëndinin një EMËR dhe do të mbeteshin gjithëmonë të bashkuar.



Zoti, që e kishtë kuptuar aftësinë e njeriut dhe për t'i penguar të shkelnin vëndin Hyjnor, vendosi t'i jap sejcilit fis një gjuhë të ndryshme. Kështu të pushtuar nga mosmarrvëshjet, fiset nuk e ndërtuan dot kullën dhe u përhapën, pa mundur t'i afrohen Krijuesit dhe mbretërisë së tij qiellore. (47)

Si çdo mit edhe ky, fsheh në vetvete ide dhe histori të vërteta të shoqërisë njerëzore. Një prej të cilave është edhe sot në qëndër të kundërthënieve gjuhësore e historike : A është folur në zanafill vetëm një gjuhë (teoria e monogjenezës) nga e cila më vonë kanë lindur gjuhët e tjera?

Studiuesit arbëreshë të “*Shkollës Albanologjike*” ishin mbështetës të tezës së NJË GJUHE MËMË, të cilën e shihnin tek gjuha e Pellazgëve hyjnorë. Arësye e qënies së shumë gjuhëve në kohët e reja Kamarda, e shikon tek dukuria e rëndësishme e gjuhëve e zbuluar për herë të parë në vitin 1806 nga Friedrich von Schlegel: Ndryshimin tek fjalët, i vëndeve të tingujve, zëvendësimin me tinguj të tjerë apo edhe rënien e tyre, i shkaktuar nga shqiptimi i ndryshëm në të folurin e njerëzve. Në vitin 1822, kjo tezë u përpunua nga Jacob Grimm (*Deutsche Grammatik*) dhe sot njihet me emrin “ligji i Grimmit” që u bë baza kryesore në metodën e shkencës së Gjuhësisë krahasuese. Në “*Shkollën e Albanologjisë*”, siç pohon vetë studiuesi arbëresh, ay ishte i pari që shkeli mbi tapetin e kësaj shkence. Sipas Kamardës, gjuha shqipe duke qënë gjuha e njeriut primitiv të lindur në gjirin e natyrës, që në zanafill ka shprehur paqëndrueshmërinë e tingujve. “Veçanrisht , lehtësinë e zanoreve të kapërcenin apo të ndryshonin vëndin me zanorët e tjera dhe bashtinglloret, në fillim, në fund dhe sidomos brënda fjalëve, një tipar që duhet të merret parasysh kur flitet për gjuhën shqipe”. (48)

Tek kjo dukuri e shqipes, por edhe tek gjuhët e tjera, që buron nga shqiptimi jo i saktë i tingujve nga ana e njeriut , Kamarda shikon origjinën e formimit të dialekteve. Me kalimin e shekujve duke u larguar për herë e më shumë nga gjuha mëmë, kanë lindur gjuhët e reja. Kështu ka ndodhur edhe në Helladë (Greqi), ku tek dialekti i Atikës, që gradualisht u bë mbisundues mbi dialektet e tjera, ndryshimi i tingujve tek fjalët u bë shkas i krijimit të greqishtes atike dhe me kalimin e shekujve, të gjuhës së re Hellene.(49) Kamarda i cili “ka bërë studimin më të plotë të shqipes“, siç u shpreh Gustav Meyer, thekson se nga krahasimi i gjuhës shqipe dhe gjuhës romaike apo greqishtes së re, vihen re ngjashmëri, jo vetëm në strukturën gramatikore, por edhe në rrënjët dhe fjalët e përbashkëta.(50) Për të mos u zgjatur , nuk po zgjerohem më tej me dukuritë e tjera shoqëruese të këtij ligji fonetik , që studiuesi arbëresh i shtjellon në veprat e tij.

Studiuesi arvanitas i emrave tek mitet pellazge, që sot padrejtësisht emërtohen “greke”, Niko Stillo pohon se : “Gjuha pellazge kishtë 5 dialekte. Keto dialekte, në Comente Vatikana të gramatikës së lashtë greke (të Dionisit Trakasit) janë : jonike, eolike, dorike, atike, dhe e përbashkët. Tre prej tyre dmth jonike, dorike dhe e përbashkëta, janë gjuhë të popullit (...)ndërsa dialekti atik dhe eolik janë gjuhë e priftërinjve, të cilat Herodoti i quajti fetarë. Dialekti i dorëve është dialekti popullor e në ditët e sotme quhet tosk, një nga dialektet e gjuhës shqipe, ndërsa dialekti fetar atik sot quhet gjuha greke. Dialekti jonik është gegërishtja e sotme e shqipes (...) Këto dialekte kishin edhe alfabetë të ndryshme”. (51)

Para Kamardës , Z.Krispi megjithëse nuk e njihte akoma “ligjin e Grimmit” , por nisur nga krahasimi i rrënjëve të lashta të shqipes dhe gjuhës homerike, pohonte se :“Gjuha shqipe ka qënë një nga trungjet e parë, prej nga buroi më pas ajo gjuhë hyjnore e helenëve”. (52) Johan G. von Hahn na sjell edhe mendimin e vetë popullsisë së Helladës (Greqisë): “Edhe sot e kësaj dite, grekët e rinj dhe shqipetarët e quajnë veten të një prejardhje “(53) Studiues të tjerë të huaj si Hans Krahe, i cili ka bërë studime mbi të folurën e fisit të *DORËVE*, vërejtën se « një numër fort i madh fjalësh të dialektit dorik, nuk mund të shpjegohen me greqishten, por shpjegohen me anë të ligjeve gjuhësore të ilirishtes » (54) Për rrjedhojë, siç thekson A.Kola, gjuha shqipe “ndihmon të shikojmë zhvillimin e gjuhës greke, që nga vitet e lashta pellazge deri në periudhën aleksandrine dhe më vonë”.(55) Duhet të shtojmë këtu se këtë rol, të cilin Petro Zheji e emërton “motivues” të gjuhës shqipe dmth që sqaron kuptimin e rrënjëve në gjuhët e tjera, ajo e luan edhe për gjuhët “e vdekura” si sanskritishtja.

Në përfundim–Tezat e shtruar shumë shkurtimisht në këtë shkrim, bazuar në veprën e At Dhimitër Kamardës, drejtesinë e të cilave e ripohuan studiuesit e tjerë shqiptaro-arbër dhe të huaj, bashkohës të tij dhe të ditëve të sotme, dëshmojnë se në shkencën e sotme shqiptare dhe atë europiane të Lashtësisë dhe Gjuhësisë historike që trajton Gadishullin Ballkanik, ka pasaktësi të mëdha. Sot, padrejtësisht emërtimi “grek” i panjohur në kohën e Homerit, ka shtrëmbëruar të vërtetën historike, në rradhë të parë të vetë Helenëve Pellazg , e thënë më sakt, të etërve të tyre Iliro-Maqedon dhe Trako-Iperiotë. Siç pohon studiuesi i lashtësisë, Aristidh Kola (« *Arvanitasit dhe prejardhja e grekeve* ») :“Shqiptarët vërtetohen si grekët (helenët-shen im) më autentik, sepse përveç pjesës kryesore të gjuhës pellazge, që e ruan sot gjuha shqipe, ekzistojnë edhe rezultatet e kërkimeve antropologjike, të dokeve, zakoneve, të karakterit dhe përgjithësisht të botkuptimit, i cili ka përputhje të plotë me helenët paraklasikë ose me dorët e mëvonshëm”.(56)

Do të kujtoja me këtë rast një shprehje të Noam Chomsky, që i përshtatet shumë gjëndjes në të cilën ndodhet sot problemi i *LASHTËSISË*: “Si është e mundur që ne kemi kaq shumë fakte, por dimë kaq pak ?”

BASHKJETESA FETARE DHE ANA TJETËR E MEDALJES

Shqipëtar i vertetë është ai që ka mendjen e zemrënë shqipëtare

Sami Frashëri

Bashkjetesa fetare e shqiptarëve ka çuditur ndër shekuj të huajt, që në historinë e vëndeve të tyre kanë patur luftra fetare, ku viktimat nuk njihnin moshë. Arsyeja e habitës së të huajve është se, jo vetëm në lashtësi apo gjatë Kryqëzatave Mesjetare, por edhe para dy dhjetvjeçarëve, në zemër të Europës demokratike, kanë ndodhur beteja të përgjakshme, siç ishte edhe lufta e sërbeve në Bosnjë-Hercegovinë dhe në Kosovë, nën flamurin e ortodoksisë. Kjo luftë (fetaro-gjeopolitike) u gërshetua, siç ka ndodhur gjatë historisë njerëzore, me interesat pushtuese, pastrimin etnik dhe genocid të egër mbi popullsinë.

Tek arbërorët historikisht, çdo besim i ri ka bashkjetuar (dashje-pardashje) krahas besimit të lashtë, duke plotësuar nevojat shpirtërore dhe të mbijetesës së tij. Toleranca fetare e arbërorëve është një dukuri e kaherëshme. Një prej „dy baballarëve“ të Kishës Romake, siç e kanë përcaktuar historianët e katolicizmit, Shën Jeronimi me origjinë ilire ishte kundër përjashtimit të kulteve të tjera në jetën shoqërore. E kjo 1600 vjet më parë ! (1) Për këtë dukuri unike të popullit shqiptar, kanë shkruar jo vetëm udhëtarët kuriozë, politikanë, të

punësuarit pranë kancelarive të mbretërive ballkanike, albanologë , ambasadorë të vëndeve të huaja, por edhe përfaqësues të feve të ndryshme.

Kjo bashkjetesë e besimeve fetare tek shqiptari, dhe mes shqiptarëve të besimeve të ndryshme, është komentuar herë-herë, si shprehje e mungesës së një besimi të vërtetë dhe ka provokuar dyshimin në përkushtimin e tyre ndaj besimit të krishter apo musliman.

„Në dëshmi të ndryshme të këtyre shekujve (16-18) ...tregohet se janë shumë të përciptë në kultin e krishterë, thuhet se kanë emrin të krishterë, po aspak besimin (Kerubini)“(2) Studiuesit më seriozë dhe që kishin ngrënë në sofrën e tij, duke shijuar bashkë me gjuhën e ëmbël shqipe edhe rrëfenjat dhe këngët kreshnike, e shpjegonin këtë dukuri, jo në mungesën e besimit fetar, por në përkushtimin parësor ndaj Kombit dhe Farës (gjinisë) së tyre. „Shqiptarët paraqiten si popull i kundërt nga të gjitha kombësitë e tjera të Sulltanit (...) Shqiptari është gjithëmonë shqiptar. Sërbit myslyman dhe bullgarit myslyman, ua kanë fshirë ndjenjën e nacionalitetit, fuqija e fortë e Islamizmit“(3)

Por nuk është qëllimi i këtij shkrimi, të trajtoj vëndin që zë Kombi dhe Fara përkundrejt Fesë dhe as mbi bashkjetesën fetare tek Shqiptarët, por t'i përgjigjem pyetjes se ...

Cila është ana tjetër e medaljes?

Ana tjetër e medaljes sigurisht lidhet me të kundertën e asaj që dëshmuam më lart, pra me « luftën fetare » ndërmjet Shqiptarëve, apo më shqip “vëlla-vrasjen” për shkak të besimit të ndryshëm fetar, ngjarja kulmore e së cilës qe lufta e vitit 1821, në jugun e Gadishullit Ballkanik.

Në historiografinë botërore dhe atë shqiptare, kjo luftë emërtohet “Revolucioni grek i 1821”. Në bazë të ngjarjeve të ndodhura, aty s'ka patur ndonjë revolucion, sepse nuk u përmbys asnjë shtresë klasore siç ndodhi në Revolucionin francez (1789-94), idetë e të cilit frymëzuan shumë popuj të asaj kohe. Parullën e tij “Liri-Barazi-Vëllazëri” edhe sot e gjen të shkruar ngado në murret e shkollave franceze. Përkundrazi, të gjithë aktorët e atyre ngjarjeve, qenë në një mëndje se: “Kryengritja nuk duhet të ketë asnjë element përmbysjeje shoqërore” (4) Emërtimi si “revolucion” i ngjarjeve, gjatë dhe pas vitit 1821, nga historiografia greke, u bë jo vetëm për “ta lidhur” me vëndin e nderuar që zë Revolucionin francez, por edhe për ta bojatisur fytyrën e vërtetë të kësaj lufte, e cila kaloi tre faza:

- Si një luftë çlirimtare kundër pushtuesit turk
- Vazhdoi si një luftë civile dhe fetare për pushtet dhe pasurim
- dhe përfundoi me spastrim etnik dhe një genocid të paparë, që vazhdoi në shumë

dhjet-vjeçarë edhe pas vitit të lartpërmëndur, për të krijuar një shtet homogjen dhe të krishterë ortodoks.

Çfarë ndodhi në të vërtetë në këto vite?

Jo vetëm fuqitë e mëdha europiane si Anglia, Franca, Austro-Hungaria dhe Rusia, por edhe popujt e shtypur të Gadishullit Ballkanik, e kuptuan se Perandoria e Osmanëve në fillimet e shekullit 19, i kishte ditët e numëruara. Një shtet « klandestin » në fakt ekzistonte me të gjitha tiparet e një shteti europian perëndimor, dhe ky ishte Pashallëku i Janinës i Ali Pashë Tepelenës.



Ali Pash Tepelena, pikturë e Louis Dupré (1825)

Qëllimi i Pashait shqiptar ishte, pranimi dhe njohja e tij (me hir a me pahir) nga ana e Parandorisë dhe Fuqive të Mëdha. Përpjekje për krijimin e një shteti shqiptar u bënë edhe në More. « Në vitet para kryengritëse Theodor Kolokotroni dhe Ali Farmaqi kishin shtruar planin e çlirimit të Moresë . Në qeverisjen e shtetit të lirë, do të kishte një këshill qeveritar prej 12 të krishterësh dhe 12 myslimanësh » (5). Por, Ali Pasha nuk donte shtete të vogla shqiptare, por një shtet të fuqishëm me sipërfaqe të gjërë tokësore, ku të përfshiheshin edhe popullsi të etnive të tjera. Në këtë shtet, gjuha zyrtare do të ishte ajo e shumicës së popullit- shqipja dhe e administratës-greqishtja. «Aliu thirri në Janinë një kuvënd me përfaqësues të shqiptarëve dhe të grekëve. Në kuvënd ai shpalli krijimin e një shteti monarkik kushtetues, i drejtuar prej tij, i përbërë nga Shqipëria (me katër vilajetet e saj-shën im) dhe Thesalia. Greqia qëndrore

dhe Moreja do të formonin një shtet grek autonom, nën protektoratin e Aliut ». (6)

Duhet vënë në dukje, që kjo ide e Aliut mbeti si qëllim i bashkë-luftëtarëve të tij arvanitas edhe mbas krijimit të shtetit helen, por me drejtim të kundërt : Bashkimin e trevave shqiptare me ato të shtetit Hellenik dhe nën emrin e Konfederatës, në fakt të zgjerohej shteti grek, duke asimiluar dhe kthyer në fenë ortodokse, popullsinë autoktone shqiptare. Ishin arvanitasit, drejtues të shtetit helen, që krijuan edhe platformën e « Megalo-idhesë »

,që vazhdon të trazojë shpirtrat e qeverive greke edhe në shekullin e 21.

Në bazën e shtetit natyral shqiptar, të cilin donte ta krijonte Ali Pashë Tepelena, u vendosën dy nga idetë e Revolucionit francez, ajo e “lirisë” dhe “vëllazërisë” (midis feve dhe etnive). Gjatë sundimit të tij, çdo besim kishte liri të plotë ushtrimi dhe përfaqësimi në administratën e tij. Për këto ide të Ali Pashes, historiografia greke, e trajton veprimtarinë e tij të shkëputur nga ngjarjet e vitit 1821 dhe e paraqet si një despot të pamëshirshëm që u ra në qafë suliotëve „vllaho-grekë“. Por, Perëndimi e vlerësoi shumë figurën e tij. Viktor Hygoi do të shprehej për Ali Pash Tepelënën se: « Ishte i vetmi kolos që shekulli ynë mund t'i kundërvë Napoleonit (me origjinë arbëreshe nga emigrantët e krahinës luftarake të Manit në Peloponez, që shkuan në ishullin e Korsikës- shën im) »(7) Edhe Historiografia zyrtare shqiptare, e trajton të shkëputur nga ngjarjet e vitit 1821 dhe formimi i shtetit Hellen.

Përse ngjarjet e periudhës 1821-1930 i emërtojmë si një pjesë e rëndësishme e historisë së shqiptarëve, ndërkohë që bëhet fjalë për krijimin e shtetit Grek?

Sepse përveç rolit të Ali Pashë Tepelënës në këto ngjarje, ishin kryengritjet e vazhdueshme të shqiptarëve, që tronditën themelet e sundimit të turqve në Ballkan, dhe sepse në pjesën jugore të Ballkanit, aty ku kishte qëndën jo vetëm Perandoria e Osmanllinjve por edhe ajo Bizantine, popullsia mbizotëruese ishte arbërore me gjuhën e popullit shqipen. Në Greqi, arbëreshët « përbëjnë trupin kryesor të popullit kryengritës(...) në këto vite dëgjohen vetëm arbëreshë dhe maniate. Kladi, Meksi, Buzhiku, Griva, Mallami, Pulio, Dragoi, Himariotet, Buejt dhe një numër i madh të tjerë, që ngritën popullin për të dëbuar turqit (...)Nuk kishte vënd në gadishull, të cilin shqiptarët mos ta ngrinin kundër Turqisë këta 400vjet. » (8) Edhe nëpër zyrat e qeverive “hellenike” të krijuara pas vitit 1821, nuk mungoi te valvitej fustanella kombëtare shqiptare, si veshje e zyrtarëve të saj të lartë.

Nga ana e historiografisë greke, këto luftra paraqiten si beteja të krishterëve ortodoks grekë, sepse myslimanët “turq”, nuk e dëshironin çlirimin nga “Baba dovleti”(Perandoria Osmane). Pamvarësisht kombësisë së banorëve, me emërtimin „turk“ dhe „grek“ përcaktoheshin sipas besimit fetar.

Por faktet historike flasin ndryshe: “Më shumë lëvizje kryengritese kundër turqve kanë bërë shqiptarët myslimanë, se sa ata të krishterë” (9) Kjo dëshmon edhe një herë, se për shqiptarët, çështja kombëtare ishte mbi fenë, fakt që u dëshmuua vite më vonë. Në Kuvënderin e Lidhjes së Prizrenit (1878) u vendos të diskutohej për programin e veprimeve, pa folur për fenë. Pjesëmarrësit e të gjitha besimeve, kur bëhej fjalë për çlirimin e vëndit të tyre, u ngritën për luftë sepse: Të gjithë jemi shqiptarë ! » (10)

Përse fuqitë europiane nuk e perkrahën „shtetin shqiptar“ te Pashait të Janinës? Sepse për perëndimorët dhe Rusinë cariste, Ali Pash Tepelena ishte “një kockë që nuk kapërdishej” dhe nuk u nënshtrohej zbatimit të planeve të tyre në Ballkan. Ëndra e Luanit të Janinës

ishte të krijonte një shtet të fuqishëm natyral shqiptar brenda një konfederate, jo vetëm i të krishterëve, por i të gjithë besimeve fetare i cili do të bashkëpunonte me Fuqitë e Mëdha, por gjithmonë në interes të tij.

Politik-bërësit e mbretërive europiane, kishin vite që e vrisnin mendjen se çfarë do të behej me tokat dhe popullsinë e Perandorisë osmane, fundi i së cilës dukej se ishte i pashmangshëm. Historiani austriak J.Ph.Falmerayer shkruan se, sipas mendimit evropian « restaurimi i Bizantit, kjo aksiomë, mund të ishte vetëm një restaurim sllavo-grek, jo bizantin. » Për Fuqite e Mëdha “ një sundim i sukseshëm në këto vënde, qetësia e brëndëshme dhe lulzimi i shtetit ishin të mundëshme vetëm nepërmjet rusëve, të cilët ngjanin me ta, në mëndësi dhe besim” (11)

Është me të vërtetë e çuditshme që Europa, në strategjitë e saj gjeo-politike t'i jepte rëndësi vendimtare faktorit fetar. Por në këtë rast ndodhi pikërisht kështu. Anglia, Franca, Rusia dhe pariya vëndëse, bashkë me Klerin “janë të një mendje që shteti i ri duhet të jetë i krishterë” (12) Më vonë, ata sajuan një shtet azmatik hellen, ku tre partitë ekzistuese, « angleze », « franceze » dhe « ruse » duke luftuar kundra njëra tjetrës për të vendosur në pushtet njerëzit e tyre, u bënë shkaktare të dy luftrave të pergjakshme civile. Në këtë “garë” për ta përfshirë Ballkanin jugor në influencën e saj, Rusia që më e sukseshme. Ajo kish kohë që vepronte, si me luftime dhe diplomaci, ashtu edhe me veprimtari të fshehta.

Mbas dështimit të ndërhyrjeve të vitit 1769,1790 dhe së fundi më 1807 në Jugun e Ballkanit me idenë e pan-sllavizmit dhe krijimit të shteteve ortodokse rreth Turqisë, Rusia vendosi t'ua lërë këtë detyrë, në dorë të krishterëve ortodoksë vëndës. Për këtë qëllim u themelua në Odesse, shoqëria e fshehtë « Filiki Eteria »(14.09.1814) drejtuesi i së cilës u vendos fanarioti Alexander Ypsilanti, një kalorës i gardës perandorake të Carit të Rusisë. Siç shprehej edhe kasapi i Luftës së II botërore, Hitleri: « Forca, pa një themel shpirtëror është e destinuar të dështojë ». Themeli ideologjik i kësaj shoqërie, do të ishte besimi ortodoks. Ortodoksia krijoi urrejtjen midis shqiptaro-arbërve dhe vëndin e perkatësisë kombëtare dhe vëllazërisë, e zuri ekstremizmi i egër fetar. Ky themel shpirtëror, siguroi edhe suksesin e planeve të Filiqi Eterisë dhe shfarosjen masive të shqiptarëve.



Në pikturat e autorëve të huaj të shk19, kushtuar “revolucionit grek” të 1821, e shikojmë shpesh të valvitet flamuri me kryqin e ortodoksisë pranë luftëtarëve me fustanella .

Anëtarë të Feliki Eterisë ishin edhe komandantët arvanitas të 1821 si : Jani Gura, Jani Koletti (gjatë qeverisjes së të cilit, u vu në zbatim plani famëkeq i “Megali Idhesë”), Odise Andruco, Bubulina, Marko Boçari etj. Shumë prej tyre kishin shërbyer në ushtri apo administratën e Ruisë cariste. Veprimtaria e kësaj shoqërije dhe sidomos e Kishës ortodokse shkaktoi luftën civile, që zgjati deri në krijimin e Mbretërisë Hellene, të bavarezit Otton Wittelsbach (1833).

Në fakt, kjo organizatë e fshehtë, nuk kishte ushtri dhe as njihej nga populli , bile anetarët e thjeshtë, nuk e dinin se kë kishin mbi krye, te ashtuquajturit “të padukshmit” dhe as planet reale të saj, por ajo kishte mbështetjen e Carit të Ruisë, për këtë arsye Ali Pash Tepelena, i cili kërkonte aleatë kundër turqve, ju drejtua për bashkëpunim, por pa sukses. Ai e kuptoi se duhej të mbështetej vetëm tek mobilizimi i masave popullore “pa dallime fetare”. Shqipëtarët kur niseshin për luftë këndonin : « Nderin dhe Kombin i kemi bashkë / Të krishterë e myslymanë » (13)

Marko Boçari, përpara betejës në Mesollongj (9.09.1823) , shtrëngoi duart me bashkë-luftëtarët e tij duke u betuar për të luftuar deri në pikën e fundit të gjakut kundër Mustafa Bushatit. Trimëria e tij mahniti bashkohësit europianë që i kushtuan poezi dhe e përjetësuan në pikturë . Poeti i madh anglez, Lord Bajroni (George Gordon Byron 6^e, 1788- 1824) mbajti një fjalim mbi varrin e Marko Boçarit, i veshur me kostumin tradicional shqipëtar.



Vdekja e Marko Boçarit , Ludovico Lipparini.

Shoqëria “Filiki Eteria” ja kishte nevojën e shqiptarëve, si të krishterë dhe sidomos myslimanëve që “janë fuqija më efektive e përlshjes me Turqinë” si bardhunjtët, laliotët në More. (14)

Në 1820, “Kuvëndi i Kapedanëve të Rumelisë” themeloi Aleancën Kombëtare të Grekëve (me grekë duhet nënkuptuar shqiptarë të të dy besimeve) që pati një jetë të shkurtër (nga 15.1.1821 deri më dhjetor të 1821). Vulosja e kësaj marrëveshje , shënon nisjen e luftës së përgjithëshme dhe jo më 25.3.1821, sipas historiografisë greke, kur Prifti Gabriel, bën meshën e Shën Mërisë. Qëllimi i ndryshimit të dates, u bë që të theksohej autorsia ortodokse dhe greke, i të ashtuquajturit « Revolucion grek 1821 » .

Mbas rrethimit të Ali Pash Tepelenës nga turqit, ndihmësi i tij besnik, himarioti Odise Andruco, u vendos në krye të Këshillit të Kapedanëve të Rumelisë, për të vazhduar planet e tij. Në fazën e parë të luftës, kur mbizotëronte fryma e Ali Pashë Tepelenës, ajo e çlirimit nga sunduesit osman, thirrja për luftim ishte « Ja vdekje ,ja Liri ! ». Por pas një viti, ajo u zëvendësua me thirrjen « Në njerën dorë thikën dhe në tjetrën kryqin!», që vite më vonë udhëhoqi andartët grek gjatë masakrave mbi popullsinë shqiptare të jugut të Shqipërisë dhe në Çamëri .

« Sa panë se peshorja anonte nga ana e kryengritësve, shkruan historiani arvanitas A.Kola, despotët, pedantët politike të syzeve miopike dhe rendikotave, erdhën në Greqi, jo për të luftuar, por për të zënë postet. Të gjithë këta përpiqeshin të fanatizonin masat e krishtera, që të prishnin Aleancën.” Despotët donin kope me dhentë e veta” (15) Fundi i ekzistencës së Aleancës, shënon edhe fillimin e fazës së dytë të luftës , asaj të Kryqëzatës fetare kundër shqiptarëve të besimit mysliman, nga shqiptarët e besimit ortodoks, në bashkëveprim me ortodoksët vllah, turq të konvertuar, sllavë dhe fanariotë të mbështetur nga të gjitha Fuqitë e Mëdha.

Ne nëndor 1821, kapedani Tahir Abazi me urdhër të arvanitasve të tjerë myslimane të Aleancës, shkoi në Kuvëndin e Parë të Grekëve, si dhe për të parë vendet e çliruara. Kudo sheh xhami të rënuara, myslimanë të vrarë dhe familjet e tyre të skllavëruara. Myslimanët shqiptarë sulmonin kundra ushtrisë turke (e përbërë me shumicë po nga myslimanë shqiptarë), nga ana tjetër vriteshin nga bashkë-kombasit e tyre të krishterë. Në kujtimet e tij, historiani arvanitas Makrijani shkruan:”Ndërkohë që grekët (shqiptarët-shën im) , e vëllazëruar të krishterë dhe myslimanë, po përpiqeshin të çlironin Njohorin, mbriti gjysëm i vdekur në front, i vetmi arvanitas mysliman që kishte mbetur i gjallë nga thika e “aleatëve” të krishterë të Moresë. Atëhere (myslimanët) “zunë britmat nga dëshpërimi. Thanë: “Zoti im, përse zëmrohesh me ne fatkeqët? Dhe armiqt tanë (turqit) na vrasin dhe miqtë tanë (të krishterët) që ndërsa na japin besën e të qënimit miq, me pabesinë e tyre na vrasin fshehtas »(16)

Këto veprime befasuan jo vetëm kapedanët myslimanë të shqiptarëve, por edhe ata të krishterë që donin të çliroheshin nga turqit dhe jo të vrisnin vëllazërit e një gjaku. Ata që mendonin kështu, u vunë në listën e myslimanëve të destinuar për t'u vrare. « Ata që gjatë kryengritjes vazhdojnë të këmbëngulin që të vënë në jetë planin e tij (të Ali Pashe Tepelenës-shën im) duhen zhdukur me çdo lloj sacrifice...Pra t'i përdorim për sa kohë nuk përbëjnë rrezik » (17)

Për të qënë më të saktë, kjo luftë vëllavrasëse mbi baza fetare të shqiptarëve, nuk filloi më 1821 dhe nuk mbaroi me njohjen e shtetit Hellen (1830). Të gjithë historianët flasin për luftën e suliotëve me Ali Pash Tepelenën, por nuk përmenden shkaqet e vërteta të saj. Asnjë libër mësimor grek por as shqiptar, nuk përmend masakrën e Dervishanës të vitit 1772, shëmbullit klasik të fanatizmit mesjetar fetar, që morri përmasa katastrofale në fazën e dytë të ngjarjeve të 1821. Shtatëqind suliotë të krishterë, sulmuan fshatin mysliman çam të Dervishanës (26.07.1772) dhe mbasi i therrën pa perjashtim burrat dhe djemtë e rinj të fshatit duke ju a prerë kokat, rrëmbyen si robinja të gjitha gratë dhe vajzat. (18)

Kjo masakër e kishte burimin, jo thjesht në kundërshtinë e fshatit çam ndaj banditizmit të kleftëve suliotë, por nga drogimi fetar ortodoks, që gjakun e vet, por të fesë tjetër e shikonin si « një të keqe » e cila duhej zhdukur. Mbas vitit 1821- 1822, kjo « vëllavrasje fetare » do të përfshinte të gjithë jugun e gadishullit ballkanik. « Është e tepërt të rradhisim këtu të gjitha rastet ku këta zotërinj (kapedanët ortodoks shqiptarë së bashku me ortodoks të kombësive

të tjera-shën im) godisnin dhe vrisnin pa asnjë lloj arësyeje arvanitasit mysylmanë, që i dorëzoheshin ushtrisë së krishterë duke braktisur turqit, ndërkohë që nuk bënë të njëjten gjë me turqit halldup » shkruan A.Kola. (19)

Për ta ndezur edhe më shumë, zjarrin e ortodoksizmit dhe urrejtjes fetare në Greqi, Rusia cariste dergoi mijëra priftërinj (apo civilë nën robën e tyre), për të ngjallur urrejtjen dhe futur përçarjen, midis myslimanëve dhe të krishterëve”. (20)

Disa prej pasardhësve të kapedanëve shqiptarë ortodoksë, që udhëhoqën Kryqëzatën fetare gjatë « Revolucionin grek të 1821 », i përsëritën barbarinë mesjetare, duke kryer krime nga më çnjerëzore sidomos në trevat e jugut të Shqipërisë dhe Çamëri. Napoleon Zerva, emri i të cilit do të shënohet përherë përkrah kriminelëve më gjakatar të shekullit të 20-të (siç thuhet « pasuria tretet-emri mbetet »), vijoi shfarosjen dhe dëbimin e popullsisë autoktone çame, të nisur nga stërgjyshi i tij suliot Tusas Zerva. “Djali i Markos, Dhimitri Boçari, u bë tre herë ministër i luftës nën mbretërit Oton dhe Georgios I, i asaj ushtrie që sipas shkrimtares M.Vickers dogji dhe masakroi 46 fshatra myslimanësh vetëm në Shqipërinë e sotme të jugut, pa llogaritur Çamerinë dhe gjithë trevat që mbeten jashtë kufijve shqiptare, duke mos prekur as edhe një fshat ortodoks”. (21)

Ekstremizmi i tejskajshëm i besimit fetar, i ktheu shqiptarët ortodoks në makineri vrastare kundër vëllezërve të tyre, dhe jo vetëm kaq, por « fatkeqësisht kjo dukuri ka bërë që në Ballkan të zhduket kultura e popujve të vjetër të cilët besonin në kishën ortodokse, dhe trashëgimia e tyre kulturore dhe territoriale të manipulohet nga shtete dhe kishat nacionale“.(22)

Si vallë zuri vënd fanatizmi fetar në shpirtin e shqiptarit, sa ta quaj „të huaj“ bashkë-kombasin e tij dhe me një urrejtjeje të papërmbjtur, të ngrejë dorën kundër gjakut të vet për ta zhdukur? Në këtë shpërftyrim, merita kryesore i takon përpjekjeve të Kishës Ortodokse greke. Një nga bashkë-kohësit e atyre viteve, francezi Pukëvil vëren : “Grekët e sotëm (të krishterët) e them me siguri, se nuk do të shohin në kryengritjen e tyre, asgjë tjetër përveç triumfit të fesë së tyre...” (23)

Por fanatizmi fetar nuk ishte faktori i vetëm. Grykësia për pasuri dhe pushtet e kapedanëve shqiptarë ortodoks, do të përbënte bazën mbështetëse të saj. Masat popullore, sipas traditës, ndoqën krerët e tyre, por nuk fituan asgjë. « Mbas mbizotërimit të kryengritjes dhe krijimit të shtetit të pavarur grek, të varfërit u bënë më të varfër dhe të pasurit më të pasur. Kapedanët (...) morrën feude (prona-shën im) me këtë mënyrë : Hipnin në një kodër dhe aq sa u zinte syri në terren, bëhej prona e tyre personale » (24) Kjo grykësi për pushtet dhe pasuri, e nxitur nga fanatizmi fetar, dhe e mbështetur nga interesat e Fuqive të Mëdha , shkaktuan luftrat civile, pasojat e të cilave do të ishin të denja vetëm për penën e Shekspir.



Odise Andruco emërtohesh si një nga kapedanët më të shquar të luftës çlirimtare të 1821. Ishte luftëtar i madh, organizator, inteligjent dhe shumë popullor. Krahu i djathtë ishte Jani Guri dhe siç ndodh në çdo luftë, lidhja e tyre kundër ushtrisë osmane u kurorëzua, jo me betime besnikerije, por nën breshërinë e plumbave dhe vringëllimën e shpatave.

Ishte po ai kapedan Guri, që e arestoi ,ish komandantin e tij (1825) dhe për dy muaj e torturoi pikerisht në Akropolin të cilin Odise Andruco e kishte mbrojtur nga turqit, që të tregonte se ku e kishte fshehur pasurinë. Odisea u mbyt me litar dhe historia greke e përjetësoi si « tradhëtar » të kauzës çlirimtare të grekëve. Dhe nuk ishte vetëm Odise Andruco viktimë e kësaj lufte për pushtet, por edhe kapedanë të tjerë si Kolokotroni, Delijani, Griva dhe shumë të tjerë që u burgosën, u vranë apo u persekutuan nga kundërshtari i tyre politik, Jani Koletti (ish mjek në oborrin e Ali Pashë Tepelenës) dhe mbështetësit e tij, që të gjithë me gjak shqipetari.

Lufta për pushtet, la pas dore luftën kundër turqve dhe ishte popullsia, ajo që u bë viktimë e hakmarrjes së egër të ushtrisë osmane. Në qershor të 1824 qeveria e Kolettit, Konduriotit dhe Mavrokordatos, morri nga anglezët një kredi për armatosjen e ushtrisë, prej 520 000£ (një shumë e lartë për kohën). Këto para u përdorën kryesisht për të blerë kapedanët, nga kampi i kundërshtarëve politikë („rebelëve“, siç i quanin).

Ndërkohë trupat e Hysen Beut të ardhura nga Egjipti si ndihmë për Perandorinë Osmane, pushtuan ishullin e Kasos . Urdhëri i ditës qe :“Të gjithë meshkujt mbi 8 vjeç do të vriten, gratë dhe fëmijët do të shiten!” (25)

A e përjashtojnë njëra tjetrën, dy anët e medaljes? Sigurisht që jo. Përkundrazi, në historinë tonë kombëtare, duhet të zënë vënd të dyja ,« bashkjetesa fetare » dhe « lufta fetare » e shqipetarëve, sepse të shkëputura ato nuk na japin të vërtetën historike.

Kjo luftë fetare dhe civile në Jug të Gadishullit , që zgjati afro dhjetë-vjet, deri sa u shpall mbretëria e bavarezit 17 vjeçar, Otton Wittelsbach (1832), çuditrisht ishte një „rivënie në skenë“ e tragjedisë trojane të Homerit, ku aktorët e të dyja anëve: fitimtarët dhe të humburit, kishin „një gjuhë, një gjak dhe një zakon“ dhe ku „kali i Trojës“ bëri të mundur, të arrihej fitorja e pashpresë.

PIKTORI QË PËRJETËSOI NË HELLADË HISTORINË E SHQIPETARËVE

Teofil Haxhimihali (1867-1934)

Sot vlerësohet si piktori më i famshëm i artit popullor i Greqisë dhe një nga përfaqësuesit më të mëdhenj të rymës moderne të pikturës hellene të fillim shekullit 20. Veprat e tij janë paraqitur në Galeritë e të gjitha qyteteve europiane dhe janë blerë me çmime shumë të larta, në Londër dhe Nju Jork nga koleksionistët privatë.

Emri i tij familjar është Theophilos Kefalas (1863/70-1934) lindur në Varia afër qytetit Mitelen, në ishullin e Lesbos. Ishte më i madhi nga tetë fëmijët e familjes së tij. Njerëzit e kanë njohur me emrin Teofil Haxhimihali, mbiemër i nënës së tij Penelopë, bij e piktorit të njohur të ikonave Kostantin Haxhimihali (Costandinos Hatzimihalis). Që në moshë të njomë çfaqti dëshirën për pikturën dhe pas disa vitesh e la shkollën, për të jetuar në fillim pranë gjyshit dhe më vonë si ndihmës i dajës, i cili punonte si ndërtues dhe piktor në zbukurimin e shtëpive. Tradita e pikturimit mbi copë dhe dru, me të cilën u njoh në punishten e gjyshit dhe përvoja në pikturën murale, prodhimin e ngjyrave dhe përdorimin e tyre në materiale të ndryshme pranë dajës Gjergj Zografi (George Zographos), ishin shkolla

e vetme e Teofilit të ri. Zograf, në shqip emërtohesh puna e një piktori dhe shpesh mbetej si mbiemër i tij në vëndin ku jetonte dhe punonte.

Jeta pranë familjës së nënës dhe në vëndlindjen e tij, ishullin Lesbo, ishin vendimtare në formimin e karakterit të tij, si njeri dhe piktor. Sipas shkrimeve të Plinit të Vjetër dhe Strabonit, emri më i lashtë i ishullit ka qënë Pellazgji, emërtuar nga banorët e tij, fiset eole. Herodoti pohon se eolët ishin Pellazgë. (Hérodote, *Histoires*, 7.95) Lesbo ishte edhe vëndlindja e shumë poetëve të famshëm si Leschès de Pyrrha (VIIIë -VIIpK), poeteshës Safo (Sapho, v.-640/-v.-600 pK), poetit e muzikantit Arion de Méthymne (VII pK), Terpandre (Térpandros, VII pK), poetit më të madh lirik, Anacréon (Anakréôn, 550 - 464pK). (1) Në këtë ishull, që nga lashtësia e deri në kohën e Teofilit të ri, kanë banuar përherë fise të pëllazgo-arbërve të vjetër dhe më vonë ata të rinj, të ardhur nga trevat kontinentale. I frymëzuar nga mitet dhe objektet e shumta arkeologjike, me të cilat bashkëtonin banorët e ishullit, në pikturat e Teofilit zënë vënd të rëndësishëm figurat mitologjike dhe pothuajse të gjithë heronjt e shquar të lashtësisë.



Perëndesha Athina dhe Artemisi (rreth vitit 1927/1934) ; Akili ; Aleksandri i Madh, Muzeu Historik Kombëtar, Athinë.

Theofili ndjente një dëshirë të madhe të udhëtonte, të njihej me njerëz të rinj dhe sidomos me qytete të famshme të së shkuarës. Në moshën 18 vjeçare vendoset në qytetin e Smirnës në Turqi (Izmiri i sotëm). Përreth këtij qyteti bregdetar ndodheshin qytetet e lashta si Efesi, Laodicea, Filadelfia, Sardi, Thyatira e Pergamo.

Të dhëna për jetën e tij janë shumë të pakta dhe asgjë nuk dihet me siguri. Më tepër për Teofilin-njeri, « flasin » pikturat e tij, se sa ndonjë autor, artikull i kohës apo i ditëve të sotme. Kështu nga periudha e rinisë, kemi firmën e tij tek autoportreti me shënimin « Kafaz i Konsullatës, Smirna ». Kjo dëshmon se një nga punët e tij ka qënë si « kafaz » (siç flitej në gjuhën shqipe për rojet) pranë konsullatës së shtetit të ri hellen në Smirna. Gjithashtu shkruhet se edhe kur ka kryer punë të tjera, asnjëherë nuk e braktiste pikturën. Në Ballkan, shqiptarët mbaheshin si rojet më besnike, që e ruanin të zotin duke mos kursyer edhe

jetën. Flitet edhe sot, se në Rumaninë e shekullit 19-20, bankierët dhe tregëtarët preferonin të kishin shqipëtarët si « kafaz ». Le të kujtojmë rojen besnik të Lord Bajronit, i cili e çoi trupin e tij (në kushtet e atëhershme) deri në Angli, duke plotësuar amanetin e zotit të tij. Kjo detyrë vlerësohej prej tyre si një çështje nderi dhe e shënjtë dhe nuk shikohej thjesht si një burim fitimi. Teofili më vonë tregonte me krenari se si kishte vrarë një turk, për të mbrojtur konsullin nga një tentativë vrasjeje.

Një fakt tjetër na dëshmon shqetësimin e piktorit për luftën çlirimtare kundër turqve. Në 1897 midis Mbretërisë hellene (Greqi) dhe Perandorisë otomane shpërtheu një konflikt ushtarak i njohur si « lufta e 30 ditëve ». Shkak u bë problemi i Kretës. Banorët e mbetur nën sundimin e sulltan Abdulhamid II, krahas kryengritjeve të armatosura, kishin dërguar Mbretërisë hellene dhe Fuqive të Mëdha, memorandumimin e përfaqësive të të gjitha provincave (3.02.1895) ku kërkonin vetqeverisjen dhe mbrojtjen e tyre. (2) Në atë kohë në shtetin e ri të Helladës, mbretëronte me dorë të hekurt mbreti danez, Giorgio I (1845-1913), i cili udhëhoqi politikën e tij sipas projektit të “*Megáli Idéa*” (1844) të mbretit Otton I (1815-1867). Duke përfituar nga vendimet e Kongresit të Berlinit (1878) Giorgio I, kishte pushtuar krahinën e Thesalisë dhe më 1881 edhe Epirin e jugut. Rasti i Kretës ishte një arësye e mjaftueshme për zgjerimin me toka të reja, dhe për këtë qëllim të hynte në luftë me Perandorinë otomane. Në këtë prag lufte, ku humbësit e vërtetë do të ishin banorët, Teofili u nis drejt Athinës për t’u shkruar vullnëtar. Megjithëse edhe vëndlindja e tij, ishulli Lesbo, ishte akoma e pushtuar, çështjen e lirisë, ay e shikonte si një detyrë kombëtare.



Piktori i oborit të sulltanit Abdyl-hamitit II, italiani Fausto Zonaro e përjetoi masakrën e Domokos duke na lënë edhe dëshminë, se si u flijuan luftëtarët shqipëtarë të mbretërisë së Helladës. (piktura lart) . (3)

Kulmi i luftës u arit në betejën e Domokos(17.05.1897) që vulosi edhe fitoren e turqve. Ushtria e mbretit Giorgio I u mund keqas, ndërsa Perandoria otomane pati mundësi të pushtonte një pjesë të Thesalise. Ne nuk e dimë nëse Teofili arriti të marrë pjesë apo jo në luftë, por humbja, gjaku i derdhur dhe masakrat mbi popullsinë e tronditën thellë piktorin e ri. Po këtë vit , tashmë në moshë të pjekur, ai vendoset në Volos, qytetin-port më të rëndësishëm të gadishullit Pelion, ku vijoi , për vite më radhë të pikturonte portrete të njerëzve, muret e brëndëshme të shtëpive, dyqaneve dhe kafeneve. Të fitoje jetën si piktor, sidomos në ato kohë kur popullsia ishte më shumë bujqësore dhe e varfëruar nga luftrat civile dhe sulmet pushtuese të shteteve te reja fqinje ishte shumë e vështirë. Teofili megjithatë punonte pa u lodhur në çdo punë që i afrohej, edhe si bari, siç lexojmë në disa shkrime, për të mbajtur veten dhe për të siguruar bojra, furça dhe pëlhurë për pikturat e tij. Në këtë kohë, sipas specialistëve, pikturat e tij tregojnë pjekurinë e Teofilit si artist.



(majtas) Murri i brëndshëm i shtëpisë së Jani Kondo (Giannis Kondos) në Volos e pikturuar nga Teofil Haxhimihali(1912), sot e kthyer në galeri arti të pikturave të tij ; Portreti i dy heronjve, Erotokritos dhe Arethusa, të poemës së poetit të madh të Kretës, italianit Vincenzo Kornaro (Vitsenzos Cornaros) shk 17. Në mbarë Gadishullin e sunduar nga Bizanti , poema ishte shumë popullore, për hymnin e saj kushtuar kurajos, nderit dhe miqësisë. (4)

Mbasi provon fatin e tij duke shëtitur në krahina të ndryshme, i përbuzur dhe i shpërfillur nga « helenët e rinj », i moshuar, i sëmurë dhe i varfër, më së fundit kthehet përfundimisht në vëndlindjen e tij, Mytilenë. Në shtëpinë e vëllait të tij Stavros, ay gjeti mikpritjen dhe mbështetjen për punën e tij në vitet e fundit të jetës. Në murin e shtëpisë së tij ,ruhet edhe sot piktura e dy heronjve (foto lart) të poemës së famshme. Më vonë largohet së bashku me nënën, për të jetuar në një shtëpi tjetër, ku edhe mbylli sytë më 26 mars 1934.



Në foto shtëpia ku jetoi vitet e fundit të jetës në Mitlenë. Vdiq në varfëri të plotë dhe i vetmuar, dy vjet pas vdekjes së nënës së tij. (5) Në kujtimet që ka lënë Teofil Haxhimihali tek bashkëkohësit dhe studiuesit e artit të cilët kanë folur për pikturat e tij, është përcaktuar si njëri thellësisht i përkushtuar ndaj historisë, figurave të shquara të mitologjisë dhe heronjve të epokës moderne, natyrës dhe njerëzve të thjeshtë të vëndit të tij.

Kjo « histori popullore » që la piktori shëtitës, më kujton fotografitë që ruhen në arkivën e familjes Marubi (Shkodër). Një trashëgimi, që edhe kur mungojnë dokumentet, mund të sjellin fakte për studimet historike të kohës (siç do ta shfrytëzojmë më poshtë edhe ne) por edhe jetësore për autorin. Populli ynë thotë se çdo njëri ka yllin (fatin) e tij, dhe ky yll, do të jetë takimi i piktorit, tashmë me përvojë, me Strati Eleftheriadis (1897-1983) me origjinë po nga ishulli Lesbo. Këtu duhet të ndalemi pak, për të folur për këtë njeri, në mënyrë që lexuesi jo profesionist i pikturës, të kuptojë vlerën artistike të pikturave të Teofil Haxhimihalit.

Stratis Eleftheriadis (1897-1983), i njohur në rrethet artistike të Parisit me emrin E.Tériade, ishte larguar në moshën 18 vjeçare nga vëndlindja e tij, ishulli i Lesbos, drejt



Parisit. Në kohën e tij, njihet si një nga kritikët dhe botuesit më të mëdhenj mbi artin në Francë. Fillimisht e nisi punën si kritik arti në revistën « L'Intransigeant », më vonë si bashk-themelues i revistës « Minotaure », themelues i revistës « Verve » dhe autor i 27 botimeve me piktura e gravura të piktorëve të famshëm dhe disa veprave të vetë artistëve. Mbështeti dhe i bëri të njohur autorët e rymave të reja në fushën e letërsisë, skulpturës dhe pikturës, që më vonë krijuan « shkolla » të artit modern europian dhe atij botëror. Tériade bashkëpunoi me figura të shquara si Maurice Raynal, Albert Skira, Michel Leiris, Raymond Queneau, Matisse, Georges Braque, Picasso, Chagall, Fernand Léger, Miró etj.

Në kohën e tij, ishte një zë i rëndësishëm i kritikës letrare dhe artistike, i vlerësuar nga lexuesit francez dhe ata botëror. (6)

Një nga zbulimet e tij qenë edhe pikturat e Teofilit. « Tradita bizantine e pikturës murale, me veprat e tij u rilind në mënyrë natyrale – shkruante E.Teriade për të -Thjeshtësia, ndjesia magjike në çdo kombinim të ngjyrave, ornamentet e freskëta, imagjinata spontane dhe së fundi krijimtaria e thjeshtë, kjo thjeshtësi krijuese e cila e bën artin primitiv (popullor-shën im) të barazvlefshëm, ose më të mirë se çdo shprehje e sofistikuar artistike. Të gjitha këto e bëjnë Teofilin një person unik, në sytë e kaltër të të cilit pasqyrohen thesaret e ngjyrave fisnike, të vështira për t'u gjetur. E bën të barazvlefshëm artistin, me nivelin e të gjithë piktorëve të artit popullor dhe me piktorët e sotëm më novator. Guximi kriues, sundon tek ay deri në atë shkallë, sa na mahnit ». (7) E.Teriade i jep para Teofilit për të siguruar çdo material të nevojshëm për të pikturuar dhe porosit tablo në pëlhurë, me qëllim që t'i bënte të njohura në Paris. Pikturat e shumta që grumbulloi kritiku i artit në shtëpinë e tij (86 prej të cilave sot ndodhen në muzeun e piktorit), dëshmojnë për punën e madhe të Teofilit gjatë këtyre viteve. Por vetë ay nuk ariti të shijonte suksesin e tyre dhe as përfitimin material në “kryeqytetin e artit botëror” siç emërtohej Parisi, sepse ekspozita u hap në Luvër më 1936, ndërkohë që piktori kishte vdekur në varfëri të plotë, dy vjet para çeljes së saj.

Pikturat e tij lanë mbresa në rrethin artistik të asaj kohe dhe sot tregëtohen me çmime të larta (deri në gjashtë shifra) nga Galeri me emër në Londër, Nju Jork dhe Athinë. Teriade, që në thellësi të shpirtit kishte mbetur bir i vëndlindjes së tij, ishullit Lesbo, jo vetëm që e bëri të njohur botërisht emrin e tij, por në vitin 1965 ndërtoi në Mitelen, (Lesbo) muzeun e Teofil Haxhimihalit duke i dhuruar edhe 86 piktura të autorit, nga koleksioni i tij privat. Mbledhja e pikturave nga E.Teriade, ekspozita në Paris dhe sidomos hapja e muzeut, krijoi mundësinë që veprat e tij, të mos jenë thjesht zbukurime të mureve të kafeneve dhe disa shtëpive private (disa prej të cilave u dogjen gjatë luftimeve me turqit dhe disa u shkulën për t'u shitur), por të vlerësohen nga shumë njerëz të shquar. Poeti dhe nobelisti në letërsi (1963) Yórgos Seferiádis, pohon se Teofili në pikturat e tij kishte shprehur një këndvështrim të ri, që shumë artistë nuk e kanë arritur. Ai kishte ndriçuar mendimin e njerëzve. “Ishte një artist i madh por i panjohur për ne dhe kjo është e pafalshme”(8). _____



Kurse sociologu francez Louis Roussel (1921 -2011) me keqardhje pohon : “Nuk e kam dëgjuar kurrë emrin e tij. Çfarë gabimi. Kishte një personalitet kaq të jashtzakonshëm dhe arriti të bëjë kaq shumë, duke patur parasysh se kishte filluar nga hiçi » . (9)

Piktori Yannis Tsarouchis (1910-1989) vuri në dukje se “veprat e tij kanë sjellë atë, që piktura greke e shekullit XIX nuk e ka shprehur”. (10) Po çfarë nuk ka shprehur piktura, por edhe historia greke? Historiografia greke ka heshtur për popullsinë arbërore, pasardhëse e heronjve mitik të lashtësisë dhe autore e luftrave çlirimtare kundër Perandorisë Osmane.

Për Teofilin kjo ishte një padrejtësi e madhe që i bëhej banorëve autoktonë të Helladës. Lufta e përgjakshme për çlirim , shkruante historiani austriak J.Ph.Falmerayer (*Elementi Shqipëtar në Greqi*, 1857) ishte „një revolucion krejtësisht shqipëtar, jo hellen, sepse të gjitha bëmat vërtet të shkëlqyeshme, të cilat bënë bujë edhe më pas, u kryen nga luftëtarët e popullit shqipëtar” (11)

Ky udhëtar i palodhur dhe vetmitar, i “armatosur” me penelë dhe bojrat e tij, kishtë marrë përsipër një detyrë fisnike, që të bëhej përfaqësues dhe ta përjetësonte historinë e tyre. Ky mission “mesianik” i piktorit, nuk përmendet në asnjë jetëshkrim të tij. Në fakt nuk ka as ndonjë botim të veçantë për të. E gjithë biografia e botuar mbi Teofil Haxhimihalit mund të përfshihet në dy rrjeshta : Ishte i apasionuar mbas miteve të lashtësisë, figurave heroike të 1821 dhe jetës së njerëzve të thjeshtë. Kishte mani të çuditshme të mbante fustanellën e gardës greke.

Personaliteti i vërtetë i Teofil Haxhimihalit, botkuptimi i tij, arsyeja se përse ndërroi mbiemrin, përzgjedhja e tematikës së pikturave dhe mënyra që kishtë zgjedhur për jetën e tij, çuditërisht nuk është studiuar asnjëherë, as kur ishte gjallë dhe as në ditët e sotme. Nuk dimë as se çfarë na ka lënë të shkruar vetë piktori mbi copën e portreteve dhe të figurave historike, që të kishim një dokument ku të mësonim se ç’ka dashur të shprehë në ato tabllo.

Ja si përshkruhet përgjithësisht “portreti” i Teofilit, në Greqinë e sotme, i marrë nga libri i Stratis Myrivilis : “Ai ishte njëri i çuditshëm dhe njerëzit mendonin së ishte gjysëm i marrë. E ka kaluar kohën në vetmi dhe varfëri, i veshur më fundin e tij të përçmuar. Ju do të habiteni se si i shkoi ndërmend një banori të ishullit, të vishte fustanellën. Ky ishte pasioni i tij (...) Ishte një njeri trup-vogël dhe i zbehtë, por tek ay zjentë dëshira për të patur pamjen, që Zoti ia kishte mohuar. Nganjëherë në karnavale ai mblidhte miqtë e tij dhe paraqitej me veshjet e Perëndive të Olimpinit (...) Shumë herë, i veshur me fustanellë dhe mbasi ngjeshte në brez jataganin, do të pikturonte pjesë nga lufta e Pavarsisë së Helladës. Ai kishte pasion temat heroike, ngjarjet nga jeta e Ali Pashait...” (Nga libri *Vasilis Arvanitis* i Stratis Myrivilis shkruar më 1934). (12)

Në të gjitha shkrimet, Teofil Haxhimihali paraqitet si piktor grek. Është e vështirë në botimet biografike të banorëve të Greqisë, të përcaktosh se kush është grek dhe kush nuk është. Kjo për arësyen e thjeshtë se mendohet se të gjithë ata që banojnë apo kanë banuar aty, që nga lashtësia e deri në kohën e Teofilit, dmth në shk 19, janë helenë-grekë. Gjithashtu në këtë shtet, janë ndryshuar jo vetëm toponimet, por edhe emrat dhe mbiemrat e banorëve të tij, të vjetër dhe të rinj. Prandaj këtë detyrë do t’ia lëmë vetë piktorit.

Siç paraqitet në fotografi (poshtë) dhe siç e kujtojnë bashkohësit e tij, Teofili që në rininë e herëshme dhe deri ditën që mbylli sytë, ka mbajtur vetëm një nga veshjet tradicionale të shqiptarëve, tipin me fustanellë, të përhapur në Shqipërinë e Jugut dhe të Veriut (mjafton t’i drejtohesh fonotekës Marubi-Shkodër). Ai mbante flokë të gjatë të kapur bisht nga mbrapa, siç ishte tradita e lashtë e shqiptarëve, e luftëtarëve të Ali Pash Tepelenës dhe e heronjve të 1821-ës. Nga trasta që e hidhte mbas supit, lidhur tek një shkop, i valavitej një flamur i vogël me shqiponjë. (13)

Mbajtja e veshjes së shqiptarëve, nuk ka qënë thjesht një mani e piktorit , siç shkruhet, apo mahnitje ndaj bukurisë burrërore të saj, siç e shikojmë tek fotografitë e të huajve në fonotekën Maurubi dhe pikturat e shumta të shekullit 19. Përkundrazi, prej saj ai u përçmua dhe u tall nga “helenët e rinj” dhe nuk u kuptua (apo nuk kanë dashur ta kuptojnë) nga shkruarit mbi jetën e tij.



(nga e majta) Teofili me nënën e tij; Foto e rojes shqipetare e gardes mbretërore ; Oscar Wilde (1854-1900), gjatë vizitës në Helladë,1877; Mbreti Otton me veshjen tradicionale shqipetare. (14)

Për Teofil Haxhimihalin, ky kostum lidhej me vetë qënien e tij shpirtërore, si origjinë, si njeri dhe si piktor. “Fustanella është një provë konkrete e identifikimit të tij” pohon intelektuali sicilian Fernando Buscemi në komentin e tij për dokumentarin “Theofilos”(1987). (15)



Siç përmëndëm për toponimet, emrat dhe figurat historike është “greqizuar” edhe fustanella, dhe sot mbahet e shpërfytyruar nga rojet e gardës në Athinë. (foto majtas) Në botimet mbi origjinën e saj, shkruhet se është një veshje e traditës së grekëve dhe shqipetarëve. Dihet se veshja e traditës përcakton edhe origjinën e njerëzve që e mbajnë atë, apo e kanë veshur në të kaluarën. Për këtë problem do të paraqesim mendimin e vetëm disa autorëve që e kanë njohur shtetin e

Helladës (Greqi) në fundin e shk19 dhe fillimin e 20-ës.

Zbuluesi i Trojës, arkeologu Heinrich Schliemann (1822-1890)shkruan :”Fustanella është veshje originale Shqipetare dhe është adaptuar nga Grekët vetëm pas Revolucionit. Ajo është trashëguar në Shqipëri që nga kohët më të lashta; atë e gjejmë shpesh tek statujat antike, duke përfshirë dhe atë të Pirros në Muzeumin e Napolit” (*Ithaka, der Peloponnes und Troja: Archäologische Forschungen.by Heinrich Schliemann,1869,f 57*) (16) Poeti dhe diplomati anglez në Athinë James Rennell Rodd (1858-1941) shton se :”Që nga koha e luftës për pavarësi, veshja shqipetare u bë veshja kombëtare e Greqisë kontinentale” (*The Customs and Lore of Modern Greece,Rennell Rodd, botuar D. Stott, 1892, 2006 f23, 73,291*)

(17)

Edhe gazetari anglez Brailsford Henry Noel, (1873-1958) që morri pjesë në një mision ndihme në Maqedoni në vitin 1903 pohon se: "Kostumi kombëtar i Toskëve është një "kilt" (si e skoczeëve-shën im) ose *fustanella* e bardhë prej lini, që u përshtat për ushtrinë greke" (Brailsford, Henry Noel "*Its Races and Their Future*", 1906 f230) (18) Lista me emrat e studiuesve edhe më të vonshëm, të cilët pohojnë origjinën shqiptare të fustanellës është shumë e gjatë, por do të mjaftohemi me dëshminë e James P. Verinis, (*Journal of Modern Greek Studies*(May 2005), pp. 139—175.) se në Greqi fustanella bëhet traditë, falë shqiptarëve në kohën e pushtimit Osman të shk 15 dhe ka qënë e përdorur gjërisht që në shk 12-të. (19)

Huazimet e popujve fqinj nga tradita e shqiptarëve, nuk ka qënë vetëm tek veshja e tyre, por edhe në fusha të tjera të kulturës. Historiani dhe etnologu serb Tatomir P. Vukanović (1907–1997) duke folur për balladat e ngjajshme mesjetare të popujve ballkanik, pohon se: « Janë më të bukura këngët kur këndohen në shqip, se në gjuhët e tjera. Prandaj edhe sllavët edhe turqit edhe ciganët këto këngë i këndojnë, jo në gjuhën e tyre, por në shqip » (20) dhe siç dihet, origjinali gjithëmonë është më i bukur se kopja e tij, siç e dëshmon edhe fustanella.

Si përfundim *fustanella* përfaqëson origjinën shqiptaro-arbërore, të atyre që e kanë veshur në Greqi. Teofili e mbante fustanellën, për të shprehur identitetin e tij kombëtar si kundërvënie ndaj propagandës, aktivitetit shtetëror dhe institucioneve fetare në Greqi, ndaj çdo çfaqjeje shqiptare: në gjuhë, etni, traditë dhe sidomos në kulturë dhe besim. Siç shkruhet, Teofili asnjëherë nuk e ka shkelur pragun e Kishës ortodokse. (21) Odise Andruco, një nga luftëtarët e Ali Pash Tepelenës në luftën kundra Perandorisë osmane, ishte frymëzuesi i Këshillit të kapedaneve të Rumelisë për të krijuar një shteti pa dallime fetare. Portreti i tij ishte një nga më të dashurat për Teofilin.

Si një *MESIA* i së vërtetës historike të shqiptaro-arbërve të vendit të tij, siç tregojnë banorët që e kanë njohur piktorin, në festat shtetërore apo të traditës, organizonte në sheshin e qytetit apo të fshatit ku banonte, çfaqje teatrale popullore me tematikë nga lufta heroike e 1821 apo mbi figura të lashtësisë si Aleksandri i Madh. Ai luante gjithëmonë rolin kryesor duke përgatitur vetë edhe veshjen e tij. (22)

Teofil Haxhimihali, është një figurë madhore si njeri dhe piktor, sepse përjetsoi në pëlhurë, muret e shtëpive dhe kafeneve të qytetit e të fshatit, historinë dhe heronjtë e vërtetë të Helladës, ata që shoqëria helene kishte filluar t'i shikonte ndryshe. Disa prej tyre u vranë, të tjerë u burgosën e u quajtën "tradhëtarë" dhe ata që mbetën u emërtuan grekë. Me penelin e tij të thjeshtë dhe shpesh nën dashamirësinë e banorëve për bukën e gojës, ai u la njerezve "Iliadën" e tij, jo me vargje, por me vizatime. Në "homeriadën" e Teofilit, krahas betejave të Tiseut, Akilit, Aleksandrit të Madh dhe figurave hyjnore të Artemidës, Athinasë, Zeusit dhe shumë të tjerëve, zënë vënd edhe heronjtë e kohëve të reja, që nga Skënderbeu, Paleologu bizantin, e deri të Ali Pash Tepelena, Marko Boçari, bab e bir Andruco dhe shokët e tyre

luftëtarë. Tek pikturat e tij ndihet melodia e shtruar e bariut të fshatit, blegjerima e tufës që ka pushtuar livadhin në perëndim të diellit, thirrjet entuziaste të valltarëve me fustanella apo heshtja pritëse e shitësit pranë tezgës në rrugën e qytetit. Veprat e tij, janë bërë shumë të njohura në Greqinë e sotme dhe për artdashesit europiane dhe më gjërë. Por figura madheshtore e Teofilit “homerik”, që mbante gjallë në shpirtin e popullit të tij bëmat e të parëve të tyre, nuk është zbuluar as sot. Në sytë e njerëzve ai ka mbetur një njeri i çuditshëm, që kishte zgjedhur një jetë prej nomadi dhe maniak për t’u veshur me fustanellën e tij. Duke gjetur ato pak të dhëna mbi jetën e tij dhe sidomos duke u njohur me vetë veprat e piktorit (disa prej të cilave paraqiten më poshtë), pa asnjë vështirësi mësojmë përkatësinë e tij etnike, mendimet dhe misionin që i kishte vënë vetes. E. Teriade u përkujdes që “Iliada” arbërore e piktorit të mos humbasë dhe të njihet kudo në botë, duke përciellë në këtë mënyrë tek çdo shikues, bashkë me veprat edhe “zërin” e vet Teofil Haxhimihalit : Jam dhe do të mbetem përjetësisht shqipetar !



(nga e majta) Odise Andruco (1790-1825), biri i të famshmit kryekomitetit Andrea Verushi, nga Livanti i Lokridhës; Adamantios Korais (shqipetari që hartoi gjuhën moderne greke) dhe Rigas Feraios. (1911) Fatkeqsisht, si edhe në pikturat e tjera, nuk e dimë se çfarë është shkruar posht pikturës; Luftëtari suliot Marko Boçari (1900) (23)



Luftëtarë të 1821



Hakmarrja e Akilit pranë mureve të Trojës, 1922



Agamemnoni duke çuar vajzën e tij , Efigjeninë në tempullin e Artemidës.

Sipas mitit, Agamemnoni, mbreti i Mikenës dhe Argosit, gjatë gjuetisë kishte vrare një dre, kafshën e shënjtë të Artemisës. Kalkante (Calcante), prifti-orakull i tempullit të saj, për t'ia ulur zëmërimin, i tha Agamemnonit, se duhej sakrifikuar një virgjëreshë dhe Ifigenia ishte zgjedhja më e pranueshme.

Kur një grua e vjetër e pyeti Teofilin « Çfarë po pikturon o bir ? Ai u përgjegj : « Një femër që sakrifikoi jetën e saj për të shpëtuar Helladën ». (24)

Shenim : Sipas studiuesit arbëresh At Dhimitër Kamarda, Aristoteli pohon se Hellada e parë ishte Epiri. (Meteor.I,14)

DARDANIA E PAZBULUAR


E vërteta asnjëherë nuk mund të zbresë në nivelin e atij që e kërkon, përkundrazi për ta marrë , i takon kërkuesit të ngjitet në nivelin që ajo gjendet. Rruga më e mirë për të përcjellë një të vërtetë është një lloj komunikimi që i kapërcen kufijtë e fjalës : është të kuptuarit intuitiv.

Helena Balvatsky

Për Shqipërinë veri-lindore natyrale, nuk dihet ndonjë emërtim gjeografik më i lashtë se sa toponimi Dardania, origjinën e të cilit janë përpjekur ta zbulojnë pothuaj të gjithë emrat e shquar të historisë dhe gjuhësisë albanologjike dhe botërore. Libri i parë që ka folur për popujt e lashtësisë ka qenë edhe libri i parë i historisë europiane, Iliada e Homerit ku shkruhet: “Dardanët i drejton Enea i shquar...” (Omero, *Iliade* II, 816-823) (1) dhe më vonë i përmend edhe Straboni (64 pK - 19 pas K) “people of the Dardaniatae...”(fis i Dardanisë) në librin e tij (*Descriptive Ethnology: Europe, Africa, India*).⁽²⁾

Ndërsa Edith Durham (*Prejardhja e disa fiseve dhe disa kanune e zakone të Ballkanit*) pohon se në hartat e vitit 140, të astronomit dhe gjeografit Claude Ptolémée (90 - 168 pas

K) gjejmë toponimin Dardani dhe vetëm kohët e fundit, emri i saj është fshirë nga hartat tona: “ Mendoj se emri i saj nuk është shkruar në hartat e shekullit të nëntëmbëdhjetë ”.(3)



Faqja e parë e librit XXVII të Strabonit Rerum geographicarum libri XVII. (1620) (4)

Që nga shekulli i 18-19, kur studiuesit filluan të gjurmojnë origjinën e gjuhëve dhe rrjedhimisht edhe të shumë toponimeve, e deri në ditët e sotme, për emrin Dardania (europiane), të gjithë kanë qënë të një mendimi se e ka origjinën nga emri “dardhë”.

- Johann Georg von Hahn (*Albanische Studien*, I ,1854) që nga të parët që emrin e dardanëve e lidhi me fjalën shqipe “dardhë”. Duke parë, përveç afërsisë në shqiptim edhe faktin se ,” Sidomos shpati i saj lindor (i Dardanisë) ishte i veshur plot me dardha të egra (...) për rrjedhim kuptimi i emrit Dardania në zanafill gjan të jetë “vënd dardhash.” (5)

- Edith Durhami, duke e mbështetur mendimin e Hahnit, vëren se në gjuhën serbe në tokat fushore përtej Drinit, që u serbizuan në fillim të mesjetës, ndodhen toponime Krushevo, Krushevas dhe Krushenica. Në gjuhën serbo-kroate këto emërtime kanë kuptimin dardhë (kruška).

- Sipas Eqerem Çabejit (*Emri i Dardanisë dhe izoglosat shqiptaro-kelte*), shpjegimin që dha G.Hahni “ është i mbështetur mirë si materialisht, si gjuhësisht

(...) Ky emër del ndër të tjera në Veri në anët e Iballës e të Mirditës, në krahinën e Lezhës, në Shqipëri të Mesme, në anët e Elbasanit, në Skrapar, në rrethin e Korçës e të Leskovikut, si emër krahine Reç-e-Dardhë në Shqipërinë Verilindore, si kompozitë Dardhëzeza në Mollas afër Gramshit”. Pas trajtimit të një vargu emrash të drurëve dhe të bimëve, në gjuhën kelte dhe shqipe, E.Çabeji mendon se origjina e fjalës “dardhë” mund të jetë nga gjuhët e fiseve kelte të lashtësisë, që kishin hyrë në Ballkan në shkV. (6)

- Idriz Ajeti (*Studime gjuhësore në fushë të shqipes*) e lidh origjinën e emrit Dardania nga “dardhë”, duke u nisur nga emri i fisit dardan Pirustë (Pirustae) të ngjashëm me emrin latin të dardhës “pyrrus” (7)

- Skënder Rizaj (*Pellazgët Hyjnorë*) pohon se : Toponimi dhe antroponimi Dardan është fjalë pellazgjishte – dardanishte – shqipe: Dard (h) + An (ë)= ana e dardhave. Dhe vërtet në Pellgun e Dardanisë sot e kësaj dite ka shumë dardha, madje të llojeve të ndryshme dhe me shije dhe erë të lloj-llojshme. (8)

Nuk po zgjatëm më tej, meqënëse ky mendim qëndron edhe sot në çdo botim historik

mbi këtë toponim. Pra, pamvarësisht se emri “Dardania” është nxjerrë nga studiuesit me origjinë nga gjuhë të ndryshme, të gjithë bashkohen tek mendimi se e ka burimin nga emri i pemës së dardhës. Ky përfundim nuk është bindës nga fakti, se emrat e figurave të lashtësisë shprehin simbole të besimit dhe emri i dardhës nuk njihet si i tillë.

Për të njejtin toponim, (bëhet fjalë për Dardanië e Azisë së Afërme) historianët e huaj pohojnë se e ka origjinën nga emri i Dardanit, i njohur në mitologji nga veprat e Homerit e të shumë shkruesve të tjerë të lashtësisë. Në rast se Straboni dhe autorët e tjerë, e kanë gjetur në popull emërtimin Dardania (europiane) dhe me qënëse deri në kohët moderne nuk ka ndryshuar, kjo dëshmon se ky emërtim është zanafillor dmth i trashëguar brez pas brezi, që nga koha kur bashkësitë fisnore kishin një identitet tashmë të formuar. Për rrjedhojë, ky emër ka një origjinë parahistorike dhe rruga e parë që do të ndjekim, do të jenë burimet shkrimore ku përmendet emri Dardan.

Për të vijuar qetësisht kërkimin tonë, duhet t’i japim në fillim përgjigje pyetjes, që shumë studiues modernë e shikojnë te dyshimtë për popujt europianë: A janë shqiptarët e sotëm të Kosovës, pasardhës të fiseve Dardane të Strabonit? Dr. Arif Mati (*Odisea e pabesueshme e një populli parahelen*) (f21,2007) shkruan se është rast unik në Europë, fakti se shqiptarët e sotëm kanë rrjedhur prej një popullsie autoktone. I pari që e pohoi këtë fakt në vitin 1774 ishte gjuhëtari suedez Johann Erich Thunmann (1746 - 1778). (*Über die Geschichte und Sprache der Albaner und der Wlachen*) (9) por edhe studiuesit arbëreshë të Italisë .

Që nga shekulli i 18-të e deri në ditët tona, kjo tezë është pasuruar me dëshmi shkencore historike, gjuhësore, arkeologjike, të besimit dhe të traditës, nga studiues shqiptarë dhe të huaj, prandaj do të mjaftohem duke sjellë provën e një shkence të kohëve të fundit - të gjenetikës - sistemin HLA. Sipas përfundimeve të studimeve botërore të zhvilluara në këtë fushë, Pr. Genc Sulçebe (*Fakte gjenetike që hedhin dritë mbi lashtësinë dhe autoktoninë e popullit Shqiptar*) pohon se rivërtetohet autoktonia e popullit shqiptar në trojet e tij.(10)

* * *

Sipas shkruesve të lashtë, njihen katër figura mitike me emrin Dardan. (Hom. Il. xx. 459; Eustath. ad Il. pp. 380, 1697; Paus. viii. 24. § 2.) (11), por tre prej tyre nuk përmenden që të kenë emërtuar ndonjë qytet, apo hapësirë gjeografike, për rrjedhojë do të ndjekim emrin e...

Dardanit nga buroi dinastia e trojanëve të Iliadës

J.G.von Hahni (*Studimet Shqiptare*) pohon se sipas gojëdhënave, ai ishte djali i Zeusit dhe i Elektrës (bijës së Atlasit) dhe vëlla i Iasonit dhe Harmonisë. Vendlindja e tij, sipas miteve është Arkadia, krahinë pellazge e gadishullit të Peloponezitet (Greqi). Por mite të tjera

thonë se është me origjinë nga Kreta apo qyteti etrusk i Krotones (Crotone,Itali) (12)

Sipas Pierre Gautruche, (1602-1681) (*L'Histoire poetique, Pour l'Intelligence des Poetes & des Auteurs Anciens*, 1668) Dardani është bir i Elektrës dhe Perëndisë romake Jupiter . Me qenëse kishtë vrarë vëllanë e tij Iasonin, u detyrua të arratisë drejt Azisë së Vogël në Frigji . Ai u martua me Bateian, vajzën e mbretit Teukër dhe ndërtoi qytetin që njihet në histori me emrin e tij - Dardania. Mbretërinë e trashëgoi Erichthoni, biri i Dardanit, pastaj nipi i tij Troisi, i cili kur u bë mbret e ndërroi emrin e qytetit në Trojë edhe vendi u quajt po me këtë emër. Një nga fëmijët e Trosit ishte Anchise që së bashku me Venusin (Afërdita pellazge dhe Turan etruske) patën për djalë Enean e famshëm, por kurorën mbretërore e trashëgoi djali tjetër i tyre, Ili (Ylli) i cili i dha qytetit të Trojës emrin Ilium. Nipi i tij Priami, ishte trashëgimtari i fundit i fronit mbretëror dardan të Trojës. Priami i dha Trojës një shkëlqim që nuk e kishte parë asnjëherë , por për fat të keq, e pa me sytë e tij se si u shkatërua, pa mbushur akoma 300 vjet të jetës së saj. (13) Disa autorë të lashtë kanë shkruar se nëna e Dardanit, Elektra e cila me gjashtë motrat e saj ishin kthyer në yje të ndritshme, mbas rënies së Trojës e humbi shkëlqimin.(14)

Sipas Virgjilit (Énéide III,VII) Enea Dardani, mbasi u largua nga Troja u vendos në Latium dhe pasardhësit e tij themeluan Romën. Është e dukshme që mbi mitet e mbritura nga lashtësia , në periudhat e mëvonshme “vihej dorë” për të ndërtuar historinë dhe origjinat e fiseve të vendeve të tyre. Manipulimet më të shumta të miteve janë bërë në kohën e Rilindjes italiane, për të nxjerrë qytetin etrusk Cortone, vend-origjinën e themeluesve të Romës dhe të Trojës.(15) Megjithatë historianët e pranojnë se mitet greke (pellazge) janë më të lashta se ato romake dhe anojnë në mendimin se vendlindja e Dardanit ishte në Gadishullin Pellazgjik (Ballkanin e sotëm). Studiuues të tjerë të kohëve moderne, me Dardanin trojan, kanë lidhur origjinën e popujve europianë.

Në Fjalorin e William Hazlitt (1811-1893) “*Dictionary of Ancient Geography, Sacred and Profane*”,1851) shkruhet se “origjina e Dardanit është prej fiseve të Moesisë (...) Janë fise barbare por të dhënë pas kënaqësive dhe muzikës”. (16) Në mitet “greke” (pellazge) përmendet një Dardan, nip i Kadmit dhe Harmonisë, motrës së Dardanit trojan, i cili mendohet se u ka dhënë emrin Dardanëve arbër.

Albanologët nuk e përmendin në historinë e vendit tonë origjinën arbërore të themeluesit të Trojës dhe lidhjen e tij me Kosovën (Dardaninë e lashtë), të penguar nga “pema e dardhës” (tezë e shk 19) dhe faktit se, legjendat tona popullore nuk kanë pasqyruar ndonjë heroizëm apo vetë Dardanin trojan. Lidhja e vetme e përbashkët ka mbetur vetëm emërtimi. Me qenëse, emrat e paraardhësve dhe të figurave mitikë tek arbërit trashëgoreshin (17) ka mundësi, që Dardani i Trojës të ketë qënë brez pas brezi me origjinë nga Dardania europiane , por nuk jemi të sigurtë nëse ka qënë pikërisht ai, që u ka dhënë emrin fiseve arbërore dardane dhe vëndit të tyre. Të ndodhur në këtë udhëkryq, do të kthehemi përsëri tek pika jonë e nisjes, dmth në shkencën e gjuhësisë, për të zbuluar burimin e emrit të Dardanisë, të përmendur nga Straboni.

Fillimisht do ta kërkojmë në toponimet e hapësirës mesdhetare . Për emërtimet e popujve dhe toponimeve, do të merret për bazë rrënja e emrit Dardan “ dard” dhe forma të afërta të saj ,të formuara nga shqiptimi i ndryshëm i tij. Siç e ka vënë në dukje Straboni (xvi. F 785), emrat pësojnë ndryshime kur kalojnë nga një gjuhë në tjetrën. (18)

Në veprën e William Hazlitt (*Dictionary of Ancient Geography, Sacred and Profane*), na jepet një e dhënë e rëndësishme se, një nga fiset ilire quhej **Dardi**. (19) Edhe Pr. Eqerem Çabej pohon se në dokumentet e vendit tonë ky emër shfaqet për herë të parë në Kadastrën e Shkodrës të vitit 1416-17, si “villa clamada **Darda**”. Në anët e Përmetit në Jug, ku ka gjasë të hyjë edhe **Darsi** (...) si dhe emri i krahinës **Darsia** në Shqipëri të Mesme. (20)

Gjithashtu E.Çabej vëren se : “ Tema Dard- në onomastikën e kohës antike ka qënë e përhapur përtej caqeve të trevës dardane dhe të trevës dardane-trojane. Ajo na del më një anë te **Dardas**, emri i një ‘praetor Epiroatarum’, te **Derdenis**, emër i shpeshtë princash makedonë-elimiotë, bashkë me **Derdia**, emri i një qyteti në trevën elimiote, me **Derdaia** në Tesali, **Derdenis** në ishullin Lesbos, më anë tjetër në truallin italik, në Apuli, si emër i një populli **Dardi** të daunëve, si emër krahine **Dardensis** dhe si emër i një qyteti **Dardanon**” (21)

Tek Stefan Bizantini (Stephani Byzantii , « *De Urbibus et Populis* ») gjejmë toponime : **Daristane**- qytet i Persis ku jetojnë fiset Daritae; **Darion**- qytet në Frigji ; **Daunium** – qytet në Itali ;**Darsii**- popull i Thrakës ; **Darsania** –qytet në Indi ; **Daridna**- qytet në Paphlagoniaie (22). Lidhur me një fakt tjetër, do të paraqitet një hartë më e zgjeruar e rrënjës “dard”.

Por këto të dhëna nuk na ndihmojnë për të zbuluar origjinën e emrit e të dy Dardanive , sepse shkruarit e parë nuk janë marrë me këtë punë dhe ata modernë (K.M.Sheard “*Complete Book of Names...*”) pohojnë se zanafilla e emrit është e panjohur dhe ka mundësi të jetë paragreke. (23) E vetmja mënyrë për të zbuluar origjinën e emrit, na mbetet të mësojmë se çfarë mendonin dhe besonin njerëzit e lashtë, në kohën kur lindi nevoja t’iu tregojnë të tjerëve përkatësinë e tyre.

Dardania emër parahistorik ?

Emri Dardania është fjalë e përbërë, nga rrënja dard + an (ia), ku “an” nuk është mbaresë por fjalë që dëshmon se nga vjen (psh- jam nga këto anë ; shkodran, lezhian etj). Fjala “dard ” gjendet në fjalorin e sotëm të shqipetarëve (2002, internet), vetëm në formën e fjalës “dardallë” për një shkop të gjatë, të përdorur në peshkim. (24) Duke e zgjeruar hapësirën gjeografike edhe në trevat e banuara nga fiset pellazge të lashtësisë, fjalën “dard” e gjejmë:

Dard - në gjuhën katalane (Spanjë) - shigjetë.

Dardo - në gjuhën spanjolle (Spanjë) –shigjetë

Dardu- në gjuhën korse (Korsika) – shigjetë

Dard- në gjuhën franceze – shigjetë apo heshtë druri me majë hekuri.

Dardar - si ndajfolje në gjuhën franceze - shumë shpejt, pa kthim.


Dar-dar - shigjetë, në fjalorin e fiseve në Tibet dhe kjo ka arsyen e vet që do trajtohet më vonë. (25)

Këto të dhëna dëshmojnë se fjala « dard » emërton shigjetën apo heshtën . Nuk mund të themi se kjo fjalë nuk ka qënë edhe në gjuhën tonë, sepse Fjalori i botuar i gjuhës shqipe nuk përfshin të gjithë leksikun dialektor (gegë dhe tosk), e sidomos atë të vjetër, as atë të shqipetarëve në trevat autoktone, të arbëreshëve të Italisë dhe kolonive shqiptare, ku janë ruajtur shumë fjalë të lashta. Megjithatë, ne kemi mundësi ta vërtetojmë origjinën arbërore të fjalës « dardë = shigjetë/heshtë » me mjete të tjera : nëpërmjet *BESIMIT* dhe *HISTORISË*.

Sipas Petro Zhejit (*Shqipja dhe sanskritishtja*)“Gjuhët e para kanë qënë simbolike. Duke qënë kështu, ne me të drejtë e kërkojmë shpjegimin e fundit të një fjale, jo tek një koncept, por tek një simbol “ (26) Të nisur nga ky fakt, ne do të nisim gjurmimin në periudhën më të herëshme të historisë, në kohën kur u krijua gjuha dhe do të vërejmë rolin besimtar që zinte shigjeta tek ta.

Gjurmët më të hershme të përdorimit të harkut me shigjeta i përkasin kohës së Paleolitikut të hershëm (nga 120.000 deri në vitet 20.000) (27) Studiuesi nga Presheva, Ibrahim Kelmendi (*Prej miteve deri në Butmir*) pohon se kultura më e vjetër e Europës mendohet të ketë qënë kultura Vinka, qendra e së cilës përfshinte hapësirën prej Thesalisë deri në Pruth, Starçevo , duke u përhapur më vonë në të gjitha anët e Europës.

Në vitin 1866 A. Arcelin dhe A. Ducrost, zbuluan një shpellë të Niaux de Ariège (Francë) në vizatimet e së cilës janë pasqyruar shumë shigjeta. (28)



Niaux de Ariège (Carsac, Dordogne) b- vizatime në objektet arkeologjike të kulturës Vinka. (29)

Në fig.1 duken qartë dy shigjeta mbi trupin e bizontit. Në fig.2 vërehet se shigjeta përdorej nga njeriu primitiv i kulturës Vinka me një kuptim të caktuar. Çuditërisht pamja grafike e shigjetës së njeriut të shpellave është pothuajse e njejtë me atë të shekullit 21. Megjithatë, kanë një dallim jashtzakonisht të madh midis tyre. Shigjeta e jonë është "një mjet" që e kemi trashëguar dhe e përdorim për të trëguar drejtimin, ndërsa ajo e stërgjyshërve tanë të shpellave është prodhim origjinal i një botkuptimi zanafillor praktik, filozofik dhe besimtar (simbolik).

George Dumézil (*La religione romana arcaica Miti, leggende, realta*) duke folur për besimin e romakëve, pohon se idea e "shpirtit" në zanafill, nuk lidhet me vdekjen, por me "energjinë – magjike" të përjetëshme tek sendet. (30) Njeriu primitiv habitej se si shigjeta mund "të fluturonte dhe të vriste" dhe i shikonte këto veti si shprehje e "shpirtit" hyjnor të saj. Fakti që shigjeta "e ndihmonte dhe e mbronte", mendon E.Cassirer (*Sprache und Mythos*) ishte origjina nga buroi më vonë idea e Zotit. (31) Ky fakt dëshmohej në studimet e bëra mbi shoqëritë e lashta. G. Dumézil pohon se përpara se të bëhej Marsi Perëndi e luftës, adhurohej kulti i heshtës dhe kur vendosej ndonjë marrëveshje, betimi bëhej mbi të. (32) Në tempujt kushtuar shigjetës, zhvilloheshin rite të ndryshme si psh në rastet e vdekjes së mbretit apo familjarëve të tij. (33) Romuli betohej për heshtën e tij. (34)

Në të gjitha besimet e lashta, shigjeta ishte arma me të cilën Perënditë dënonin njerëzit, si Zeusi dodonas, Athina, Artemisi, Apolloni, Rudra indiane, perëndia egjiptiane Sikhmet, etj. Sipas shkrimeve të Kuranit (V.3) në Babiloninë e lashtë, shigjeta përdorej nga orakujt për të parashikuar fatin dhe ishte simbol i pushtetit dhe mbretërimit (35)

Në fig.1, (poshtë) shigjeta në gur-varr është përdorur pikërisht si simbol besimtar. Trekëndëshi, gjysëm-hëna dhe ylli brenda saj në formën e tophit, dëshmojnë besimin hënor të Kartagjenasve. Poshtë është Perëndesha hënore Tanit.



a-Gur varri i Kartagjenës (British Museum) shk 2-1 p.K.; b-Kopia romake e Pallade Athinës; c- Amuletë argjendi me figurën e majës së shigjetës shk 5-3p.K.; d- maja të heshtave të kohës së luftës trojane. (36)

Rëndësia e veçantë e shigjetës dhe heshtës, për bashkësitë fisnore dhe mbretëritë, diktohej nga fakti se, që nga periudha e gurit e deri në kohën kur filluan të përdoren armët e zjarrit (shk 12-të, Dinastia Song), ishtë ARMA kryesore goditëse në largësi, gjatë gjuetisë dhe luftimeve. Sidomos me zbulimin e metaleve, shigjeta dhe heshta u bënë mjete më praktike se sa gurët apo topuzët prej druri, të përdorura në zanafill. Sipas Homerit, armatimi kryesor i Grekëve në kohët e fundit ka qënë heshta së cilës në kohët heroike i vendosej një kokë metalike. (Hom. Il. 2; v. 320; Eustath.) (37) Duhet vënë në dukje se ngjarjet dhe emërtimet pellazge të lashtësisë, shkruarit latinë në Fjalorët historik, i kanë emërtuar “greke”.

Rënditëm këtë biografi të shkurtër të shigjetës, për të kuptuar vendin shumë të rëndësishëm që ka zënë në besimin e lashtë dhe arsyen, se përse mbretërit më të fuqishëm të mitologjisë, e kanë patur kultin apo emrin e saj dhe është nderuar si Perëndi. Sipas Mircea Eliadës : ”Emrat e shumë popujve në lashtësi ishin të perëndive të tyre” (38) Më qenëse “dardha” nuk ka patur ndonjë kult, nxjerrim përfundim se emri Dardania dhe i dardanëve i pohuar nga Straboni, e ka origjinën nga emri i Mbretit Shigjetë (Dard) dhe ishte Orakulli i Zotit në atë vend. Hahni e pohoi këtë fakt , si nga ana gjuhësore edhe mitike dhe nuk e kuptoj se, përse e lidhi emrin e Dardanisë dhe banorëve të saj me pemën e dardhës. Në veprën e tij “*Studime shqiptare*” Hahni shkruan : “Jemi të mendimit që kuptimi i vërtetë i emrave të fiseve të sigunëve (Herodoti, V,9) dardanasve , kuretëve, kuiriteve, samnitëve dhe sabinëve vjen nga arma kryesore e tyre. Kjo fjalë (Dard-an) nga tingulli i ngjan fjalës italiane, spanjolle « dard » dhe angleze « dart » : « heshtë ». (39)

Një fakt tjetër është emri Gjetë, i një prej fiseve dardano-ilire. Ky emër, sikurse edhe i shumë emërtimeve të fiseve të gadishullit Pellazgjik, gjen kuptimin vetëm në gjuhën shqipe dhe është forma e shkurtuar e emrit “shigjetë”. “Armët më të preferuara të Herkullit, ashtu si tek Gjetët, ishin harku dhe shigjetat- pohon studiuesi francez Eduard Shnajder- Gjet vjen nga “shgjet”, që në shqip bën shigjet, prandaj ata popuj (skithët dhe gjetët-shën im) ishin pellazgë”. (40) Kur flasim për fiset e Gjetëve, këtu futen edhe fiset Dake.



a- Mbretëria e mbretit dardan Burebistra ; b- Monedha Trajane në Dakinë romake 107 p.K. Gur-varre ilire në Bosnjë . Simboli i zik-zakut, i rrethit dhe dora , dëshmojnë besimin hënor të popullsisë. Harku me shigjetë (djathtas lart), i përdorur këtu si simbol besimtar dhe fustanella shqiptare, tregon përkatsinë fisnore dardane . (41)

Historiani latin i shk 3 pK, Marcus Junianus Justinus në veprën e tij (*Epitome of Pompeius Trogus*) shkruan :” Dakët janë pasardhës të Getëve”. Constantin C. Giurescu (*Formarea poporului român.*) duke u mbështetur tek trashëgimia gjuhësore, pohon se ”Ata (Dakët dhe Gjetët) janë dy emra të të njëjtit popull [...] të ndarë në një numër të madh fisesh”.(42) Që Gjeto-dakët janë fise dardane e dëshmon edhe qelshja në monedhën e prodhuar në Daki. (fig.2 lartë) Përdorimi i emrit “dakë” dhe përfshirja e të gjitha fiseve veriore ballkanike nën emrin “ilir”, besoj se është pasojë e administratës romake , e cila donte ta fshinte emërtimin “dardan” nga dokumentet e tyre , për telashet e mëdha që u kishin shkaktuar këto fise , sidomos nën udhëheqjen e Burebistrës.

Faktet e mësipërme mbi emrin “dard=shigjetë”, mbështeten edhe nga mitet, sipas të cilave, shpikës i harkut mbahet Apolloni Ipeboreal (43) figura e të cilit lidhet me vendin e Ipeborealëve, që sipas përshkrimit të Strabonit (Geografia, 11, 6, 2), ndodhet pikërisht në zonën gjeografike të Dardanisë së lashtë .(44) Për të mbështetur mendimin tonë për emrin e Mbretit- shigjetë (Dard), që krijoi bashkësinë e parë të organizuar të fiseve dhe të prftërinjve fat-thënës, emrin e të cilit e trashëgoi krahina e Dardanisë dhe shqipetarët e Kosovës, do të lidhim disa fakte të zbuluara në fushën e historisë, gjuhësisë dhe miteve më të hershme.

Dardania, superfuqia e metalurgjisë.

Dardania e lashtë, përfshinte bashkësi të shumta fisesh, kufijtë gjeografikë të së cilës është vështirë të përcaktohen sot me siguri. Kjo për faktin se, zanafilla e saj i përket periudhës “pa libra” dhe njerëzit i regjistronin mendimet e tyre nëpërmjet simboleve, që kanë mbritur tek ne në objektet arkeologjike, emrat dhe toponimet. Ky lloj “shkrimi” mund të “lexohet” vetëm nëpërmjet njohjes së besimit dhe gjuhës arbërore , gjë që e bëri të mundur gjuhëtari i shquar Petro Zheji dhe ku do të mbështetemi për të zbuluar, jo vetëm origjinën e emrit të Mbretit Darda, por edhe historinë e jashtzakonshme të Dardanisë dhe të arbërve në përgjithësi.

Hapësira gjeografike ku bën pjesë Dardania (Ballkani qëndror), siç e vuri në dukje edhe Pr.Ibrahim Kelmendi, i përket hapësirës gjeografike me kulturën më të hershme dhe më të zhvilluar europiane : kultura Vinka, Cucuteni, Bug-Dnester, Trypillian, etj. të emërtuara sipas vendeve ku janë gjetur objektet arkeologjike. Kultura Vinka (mijëvjeçari VI –III pK) përfshinte brigjet e lumit Danub dhe hapësirën gjeografike ku shtrihet shteti i sotëm i Kosovës, Rumanisë, Bullgarisë, Maqedonisë, Sërbisë (45) si dhe Shqipëria veriore dhe qendrore , banime të lashta të fiseve pellazgo-ilire. Nga gërmimet arkeologjike të kryera në Sovjan , afër Korçës (Shqipëri) u zbulua vend-banimi i një bashkësie fisnore afro 10 000-7 000 vjeçar pK, i cili, sipas arkeologëve, pranohet si më i vjetri i njohur deri më sot në Europë.(46)

Studiuesi nga Presheva I.Kelmendi pohon, se Neoliti i kompletuar me vegla, kafshë të zbutura, bujqësi e shtëpia , për të parën herë u shfaq në Ballkan dhe në krahinat e Karpateve dhe prej këtej gjëlltiti Europën. Kultura ballkanike Vinka I , që përfshinte edhe Dardaninë e lashtë, ka qënë më e vjetër edhe se ajo Sumere. (47) Këtë fakt e mbështet edhe arkeologu Hasan Ceka : “Nuk duhet të nënvleftësohet nga ana tjetër fakti se fjalori blegtoral i gjuhës shqipe është një nga më të pasurit në Europë . Ka shumë të ngjarë pra, që këtë trashëgim populli ynë të mos e këtë as nga shekujt e kaluar, as nga mesjeta, por për traditë nga kohët më të lashta antike”. (48)

Në mbështetje të kësaj teze, edhe M.Gimbutas kur flet për shkrimin e Europës parahistorike pohon se : “Qytetërimi europian” (Europa parahistorike përfshinte zonën mesdhetare-shën im) e kishte krijuar shkrimin (figura simbolike) afërsisht në vitet 5300-5200 dmth 2000 vjet përpara Sumerëve (49)

Gjetjet arkeologjike në trevat shqiptare të lartpërmendura, tregojnë jetesën e organizuar të fiseve dhe faktin se, njeriu primitiv përfundimisht ishte shkëputur nga jeta e vëllezërve të tij “me katër këmbë” që ushqëheshin me çfarë gjenin në natyrë. Tashmë ai ishte në gjëndje të mbillte, të rriste dhe të prodhonte ushqimin e tij. Ky “revolucion” arriti shkallën e tij më të lartë, kur në sajë të zjarrit dhe banesave brënda shpellave, stërgjyshërit tanë zbuluan mrekullinë e metaleve. M.Garashani (*Ilirët prejardhja e tyre*) vëren se, zhvillimin e gjenezës (së shqiptarëve) në viset e Ballkanit , mund ta përcjellim që prej fillimit të kohës së metalit. (50)

Njohja e nxjerrjes dhe e punimit të mineraleve, sidomos prodhimin e thikave, majave të shigjetave dhe çekanëve metalik, ndikoi në rritjen e prodhimeve bujqësore, kushteve të jetesës dhe gjuetisë. “Zotërimi i zjarrit nuk garantoi vetëm mbijetesën dhe zhvillimin e njeriut si specie, por prodhuan edhe një botkuptim mitiko-besimtar, duke nxitur dhe ushqyer imagjinatën”, pohon M.Eliade.

Njeriu besimtar e shikonte zjarrin si një shfaqje të Zotit dhe minatorët që ishin njëkohësisht edhe farkëtarë, si “magjistarë” të cilëve i Plotfuqishmi u kishte zbuluar një nga misteret e tij. “Ky zhvillim i arritur gjatë periudhës Mesolitike i dha fund barazisë kulturore të bashkësive fisnore të periudhës së Paleolitikut (në Euro-Azi, shën im) dhe u bë shtysë për shfaqjen e shumëllojshmërisë dhe dallimeve midis tyre, që do të bëhet karakteristika kryesore e qytetërimeve të mëvonshme” (51). Studiuesja e shkrimeve pellazge, Nermin Vlora Falaski, vë në dukje se nga të gjitha fiset që shtriheshin në lashtësi, nga Danubi deri ne Azinë e Vogël, më të zhvilluarit ishin ato që përfshiheshin në trojet nga Kosova deri në Çamëri(52).



(53)

a- Monedhë e emërtuar Dardanika prodhuar në Dardani .b- Monedhë argjendi e qytetit dardan Damast ΔΑΜΑΣ - ΤΙΝΩΝ – ΚΗΦΙ.

Në Dardani, pohon H. Ceka, njihej dhe përpunohej që herët hekuri, bakri, argjendi, dhe shumë rrallë ari ; këto shërbenin kryesisht për të përgatitur vegla pune, armë (heshta, shigjeta, shpata etj) (...) duke filluar nga shk IVpK edhe monedha. (...) Në krahasim me artizanët e viseve ilire të luginave të Matit e të Drinit, që ishin dhe vazhduan të jenë mjeshtër të dëgjuar në përpunimin e metaleve deri thellë në kohën e sundimit romak, metalpunuesit e Epirit mbetën prapa dhe nuk arritën dot një zhvillim të lartë në këtë degë të artizanatit . Shkaku kryesor duhet kërkuar në mungesën e mineraleve në tokat e Epirit. (54) Mungesa e pasurisë minerale apo e njohjes së përpunimit të tij, në jugun ballkanik, dëshmohej edhe nga origjina e objekteve në varrezat e Mikenës. Carlo D'Adamo (*Sardi Etruschi e Italici nella guerra di Troia*) pohon se objektet prej ari, të tipit të Europës qendrore, të zbuluara në Mikenë provojnë lidhjen tregëtare të kahershme të qytetimit mikenas me hapësirën danubiane. (55)

Treva e fiseve arbërore të Dardanisë, ka qënë qendra më e lashtë e nxjerrjes dhe pëpunimit të mineraleve në Europën jugore dhe për këtë dëshmojnë krahas arkeologjisë edhe mitet. Në veprën e Titus Livius (*Le Decades Qui Se Trouvent*, 1617) shkruhet se Vestalet e para, priftëreshat e kultit të zjarrit, quheshin **Geganie** (Gege), (Geganie ,l'une des quatre premieres Vestales.) (56), që dëshmon se fiset Dardane kanë qënë përpunuesit e parë të mineraleve duke përdorur nxehtësinë. Udhëtarja amerikane Rose Lane (*Majat e Shales*) pohon se sipas zakoneve të **fiseve në brendësi të** maleve veriore shqiptare “Baza e ceremonisë fisnore është adhurimi i zjarrit. Nusja merr me vete nga shtëpia e saj një dhuratë të përhershme: një palë masha zjarri (57) Masha e vogël, krahas zbukurimeve të tjera, ishte pjesë e veshjes së gruas mirditore. Ishte detyra e saj , e njejtë me atë të priftëreshave Vestale në tempujt romak, që të kujdesej që zjarri të mos shuhej.

Kultin e zjarrit, e dëshmon edhe miti i Erithonit i cili, herë del si djalë i Efestit (farkëtarit të Perëndive të Olimpmit) dhe i Geas (Tokës) dhe në mitet e tjera, si djalë i Dardanit dhe

Bateias , shpikës i qerres dhe përdorimit të monedhave. (58) Sipas studiuesit C. D'Adamo, miti i Erithonit duke përfshirë Efestin, Athinanë dhe Gean (Tokën) shpreh në mënyrë simbolike, nevojën e vajit të ullirit i cili e rriste shumë temperaturën e furave, e nevojshme për përpunimin e metalit. (59) Këtë nevojë të punishteve dardane, e plotësonte Jugu në këmbim të veglave, zbukurimeve dhe prodhimeve të tjera prej argjendi, bronxi dhe hekuri. Gjithashtu, miti i Erikthonit ,na dëshmon se një nga figurat e mëvonshme të Mbretit arbëror Dard apo farkëtarëve dardanë, në mite ka qënë Efesti dhe ndihmesat e tij metal-punues, në shërbim të oborrit hyjnor të Olimpfit.

Sipas Mircea Eliades, Njeriu farkëtar në lashtësi ishte edhe “njëri i ditur dhe besimtar”. (60) Në lashtësi lidhja me Zotin, në fiset e së njëjtës gjini e dëshmonte Qeleshja. Në foton poshtë (fig.1) Efesti paraqitet me qeleshen “frige” të shqipetarëve të Çamërisë, si e mbretit dardan Burebistra (fig.2), e pasuesit të tij, Decebalit (fig.3), dhe e Paridit të Trojës (fig.4). Në objektet arkeologjike Efesti paraqitet edhe me plisin e shqipetarëve të Kosovës së sotme.



(60) Diëgo Vélasquez (1599-1660), Efesti pret Apollonin në farkën e tij, Madrid, Prado; b-Statuja e Burebistrës Calarasi ; c-Decebalit në kolonën e Trojanit , Romë; d- Parisi i Trojës (vit.117–138)

Prodhimi i objekteve të para metalike dhe zbutja e kalit, krijoi “supërfuqinë” e parë fisnore të lashtësisë, e cila sipas fakteve të sipër-përmendura ka qënë *DARDANO-ILIRE*, të cilët i nënshtruan apo i zbuuan bashkësitë e tjera kufitare të së njëjtës gjini,(në formë centrifugale) dhe në periudhat e mëvonshme hapën epokën e “kryqëzatave” të vazhdueshme nga Perëndimi drejt Lindjes (dhe jo e kundërta). Këtë fakt e gjejmë të shprehur simbolikisht me udhëtimin e Argonautëve (luftëtarëve-marinarë), që kërkojnë lëkurën e artë (burime të reja minerale , floririn). Sipas miteve, pohon Aristidh Kola (*Arvanitasit dhe prejardhja e grekëve*), Dardani ishte i pari njeri, që u largua nga Europa në Azi me mjete lundrimi dhe mbante titullin e prijësit të shumë popujve dhe kombeve që erdhën pas tij në Azi.(61) Le të kujtojmë se këtë fakt, ia përmendën Aleksandrit të Madh priftërinjtë, kur mbriti në Indi. Kjo

rrugë u ndoq më vonë edhe nga vëllezërit e tyre të Jugut (Iperiotët dhe fiset e tjera pellazge).

Një nga qendrat më të vjetra minerale të Europës, ka qënë vend-banimi **Damast**, kryeqytet i Dardanisë së lashtë. Në Fjalorin e William Hazlitt, shkruhet: Damastium-qytet i Pirustëve në Iliri, i njohur për minierat e tij të argjendit (62) Siç dëshmon Hasan Ceka emri i Pirustëve “ përmëndet në burimet e shkruara antike vetëm duke filluar nga mesi i shk të parë të erës së re (...) në burimet më të lashta por edhe ato të vonat historike, si banorë të kësaj pjese të Ilirisë përmenden dardanët, që shquheshin për një organizim të fuqishëm ushtarak e shtetëror, si dhe për sulmet e tyre të vazhdueshme ndaj mbretërive fqinje ilire (viti 230) e maqedone. Me këtë identifikim (pirust=dardan - shën im) nuk janë në kundërshtim as të dhënat e tjera burimore (Livi XLV26).(63)

